RËNDËSIA DHE NDIKIMI I MBIKËQYRJES BANKARE NDËRKOMBËTARE BAZEL III. IMPAKTI I SAJ MBI STRATEGJINË E BANKAVE TREGËTARE NË SHQIPËRI

Avis Andoni

Dorëzuar
Universitetit Europian të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programittë Doktoratës në Shkenca Ekonomike, me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore "Doktor"

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Adrian Civici

Numri i fjalëve: 92 000

Tiranë, Qershor 2015

ABSTRAKTI

Përgjate dy dekadave të fundit kemi mundur të asistojme ndryshime, zhvillime dhe rritje të konsiderueshme të sektorit financiar në të gjithe anët e globit. Por, në të njëjtën kohë jemi përballur edhe me kriza financiare, kolapse bankare, që kanë çuar në përkeqësimin e deri stopimin e aktivitetit ekonomik. Janë pikërisht këto problemetë shumta, që kanë tërhequr vëmendjen e politkëbërësve dhe rregullatorëve, sidomos të sistemit bankar, të cilët kanë vënë në dyshim tekset ekzistuese, për të siguruar stabilitet e harmoni në sistemet bankare kombëtare e ndërkombëtare dhe në të gjithë sektorin financiar në përgjithësi.

Qëllimi i këtij studimi qëndron fillimisht në thellimin më specifik të literaturës përkatëse mbi fenomenin e mbikëqyrjes bankare ndërkombëtarebazuar në shqyrtimin e propozimeve të bëra dhe paralelizimin e tyre me sistemin bankar shqiptar. Nëpërmjet procesit të thellimit teorik, synohet kuptimi më konçiz dhe analizimi më i avancuar i implementimit të rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare. Duke analizuar e shqyrtuar këndvështrimet dhe optikat e ndryshme ekonomike mbi këtë fenomen, studimi synon të arrijë në një tablo më të qartë për sa i përket mekanizmave të regulloreve mbikëqyrëse,më specifikisht të Bazel III,të implementimit, prurjeve dhe ndikimeve potenciale të tyre. Në fakt, nga anliza arrijmë në nxjerrjen e problematikave të ndryshme të implementimit të Bazel III, dhe ngrejmë pyetje të shumta mbi mënyrën, kohën dhe nivelin e penetrimit të Bazel III, por fokusi i studimit tërhiqet nga ndikimet potenciale mbi strategjinë e aktivitetit bankar në Shqipëri.

Për këtë, studimi do të bazohet përtej strukturës teorike, në ngritjen e një pyetësori drejtuar bankave të nivelit të dytë për të përftuar të dhëna primare në nivelin bankar, të dhëna të cilat na mundësojnë paralelizimin e dy sferave (mbikqyrje sipas Bazel III dhe strategji bankare) dhe më tej vërtetimin e ekzistencës së një relacioni mes tyre.

ABSTRACT

Along the last two decades we have been able to assist changes, developments and significant growth of the financial sector in all corners of the globe. But, at the same time we have been faced with financial crisis, bank collapses, leading to the deterioration of economic activity up to it's stoppage. There are precisely these many problems that have attracted the attention of policymakers and regulators, especially those of the banking system, who have questioned the existing texts to ensure stability and harmony in national and international banking systems and in the entire financial sector in general.

The purpose of this study lies primarily in deepening the relevant literature more specific about the phenomenon of international banking supervision based on the review of different proposals and their parallelism with the banking system. Through the process of deepening the theoretical frame, we aim a concise understanding and advanced analysis of the implementation of international supervison regulations. Analyzing and considering the different viewpoints and economic optics on this phenomenon, the study aims to arrive at a clearer picture regarding the mechanisms of the supervisory regulations, specifically the Basel III agreement, its implementation, flows and their potential impacts. In fact, from the analysis we extract various issues of the Basel III implementation, and raise numerous questions about the manner, time and level of penetration of Basel III, but the focus of the study drawn from the potential impacts on the strategy of banking activity in Albania.

For this, the study will be based, beyond the theoretical structure, on the establishment of a questionnaire addressed to commercial banks to obtain primary data on the banking level, data that enables us to paralelelize the two spheres (supervision under Basel III and banking strategy) and further confirmation of the existence of a relationship between them.

FALENDERIME

Falënderimet e mia për ndihmën akademike, kërkimore, logjistike e personale i shkojnë së pari udhëheqësit tim, Prof. Dr. Adrian Civicit, pa të kjo doktoraturë nuk do kish qënë e njëjtë, interesante dhe kaq e bukur. Dëshiroj të falenderoj përzemërsisht kolegët e mi Prof.Ass. Elvin Meka, Prof.Ass. Arben Bakllamaja, Dr. Jonida Këllezi dhe Dr. Evis Gjebrea për bashkëpunimet dhe mbështetjen e vazhdueshme të tyre. Falenderoj shumë familjen time për përkrahjen e tyre dhe kurajon e vazhdueshme. Por mbi të gjitha falenderoj partnerin tim Igli Gjelishti i cili ka qënë jo vetëm një mbështetje për mua, por një shtysë, një motivim dhe një lehtësim për realizimin e kësaj doktorature.

LISTA E ILUSTRIMEVE

Figura 2.1 Roli i sistemit financiar në zhvillimin ekonomik (përpunuar nga autori)…....15

Figura 3.1 Struktura e implementimit të marrëveshjes së Bazelit (Bank for nternational Settlements.....82

Figura 3.2 Struktura e Marrëveshjes së Bazel II (Bank for International Settlements).....87

Figura 3.3 Struktura Zbulimit të Informacionin nën Marrëveshjen eBazel II (BIS) 89

Figura 3.4 Skema efektit pro-ciklik të kapitalit të vet.....96

Figura 3.5 Datat kyçe të marrëveshjes Bazel III 99

Figura 3.6 Efekti i jastëkut kundër-ciklike në periudhë recesioni.....106

Figura 3.7 Dikotomia e pikëpamjes pro-ndër nën spektrin e huadhënies.....115

Figura 3.8 Sfidat që i paraqiten bankave nga implementimi i Bazel III.....124

Figura 4.1 Modeli LCAG i Harvardit, (Learned, Christenen, Andreës dhe Guth).....137

Figura 4.2 Modeli 5P i Mintzberg…….....138

Figura 4.3 Modeli BCG…….……..139

Figura 4.4 Modeli Porter…….142

Figura 4.5 Analiza SWOT dhe alternativat strategjike që burojnë prej saj……...149

Figura 4.6 Qasja e vendosjes së strategjisë…….....151

Figura 5.1 Vektorët e elementëve të mbikqyrjes e strategjisë ……..……..171

Figura 6.1 Përberja e sistemit financiar shqiptar. Burimi Banka e Shqipërisë……..181

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 2.1 Numri i reformave në sistemin mbikqyrës brenda një dekade.....27

Grafiku 2.2 Reformimi i arkitekturës mbikqyrëse përgjatë viteve 1998-2008, në përqindje…….....28

Grafiku 2.3 Rezultati FICO..... 53

Grafiku 2.4 Frekuencat e shpërndarjes së kthimit ditor 55

Grafiku 2.5 Shpërndarja normale e kthimit ditor 57

Grafiku 2.6 Rezultati i Simulimit Monte Carlo.....58

Grafiku 3.1 Evoluimi Kronologjik i Raporteve Të Kërkesave të Kapitalit.....103

Grafiku 4.1 Blerjet dhe Bashkimet në nivel mondial nga 1985 deri në tremujorin e parë të 2013……..…..….155

Grafiku 4.1 Blerjet dhe Bashkimet në nivel europian nga viti 1995 deri në tremujorin e parë të 2013…….....….156

Grafiku 6.1 Arsyet e zhvillimit të rregulloreve mbikqyrëse ……..….....198

Grafiku 6.2 Rregulloret e zbatuara në nilevin kombëtar …….....220

Grafiku 6.3 Rregulloret e konsideruara si penguese të aktivitetit bankar……..….....223

Grafiku 6.4 Niveli i ndikueshmërisë mbis strategjinë e ndërkombëtarizimit……...…..228

Grafiku 6.5 Niveli i ndikueshmërisë mbis strategjinë e specializimit…….....…232

Grafiku 6.6 Niveli i ndikueshmërisë mbis strategjinë e diversifikimit…….….....236

Grafiku 6.7 Niveli i ndikueshmërisë mbis strategjinë e blerjeve dhe bashkimeve…...…286

Grafiku 6.8 Niveli i ndikueshmërisë mbis strategjinë e ekspansionit……..…….....240

Grafiku 6.9 Ndryshimet e dëshiruara mbi mbikqyrjen kombëtare…….....…...242

Grafiku 6.10 Marrëveshjet ndërkombëtare të njohura…….....290

Grafiku 6.11 Akset e pengesave të marrëveshjeve ndërkombëtare…….....…….294

Grafiku 6.12 Pesha e ndikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare mbi strategjinë bankare/1 …….....…299

Grafiku 6.13 Pesha e ndikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare mbi strategjinë bankare/2…….....302

Grafiku 6.14 Pesha e ndikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare mbi strategjinë bankare/3…….....306

Grafiku 6.15 Pesha e ndikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare mbi strategjinë bankare……...…309

Grafiku 6.16 Kufizimet që shihen në rregulloret ndërkombëtare……...…...313

Grafiku 6.17 Ndryshimet e dëshiruara mbi marrëveshjet ndërkombëtare…….….314

Grafiku 6.18 Ndikimet që priten në prespektive implementimi të Bazel III ……..…315

Grafiku 6.19 A do të preken akset strategjike kryesore nga implementimi i Bazel III? 317

LISTA E TABELAVE

Tabela 2.1 Niveli i besimit dhe devijimi standart përkatës teorik ….....57

Tabela 2.2 Niveli i besimit dhe devijmi standart përkatës konkret 58

Tabela 3.1 Peshat e Rrezikut sipas Bazel I 84

Tabela 3.2 Peshat e Rrezikut sipas Bazel II.....91

Tabela 3.3 Ponderimi i Rrezikut sipas Bazel II 92

Tabela 3.4 Krahasimi i kërkesave të kapitalit Bazel II-Bazel III.....102

Tabela 3.5 Elementët kryesor të marrëveshjes së Bazel III.....113

Tabela 4.1 Matrica General Electrik……..……...…138

Tabela 4.3 Matrica Ansoff ……...……..…..140

Tabela 5.1 Posti i të intervistuarit.....176

Tabela 6.1 Pesha specifike e secilës bankë në sistemin banakr shqiptar.....183

Tabela 7.1 Përballja teori vëzhgim mbi akset kërkimore…….342

Tabela 7.2 Përballja teori praktikë ndërkombëtare dhe rast shqiptar mbi nivelin e impaktit ……..343

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

ASF: American Securities Forum

ABF: Association des Banquiers Français

BCBS: Basel Committee on Banking Supervision

BIS: Bank for International Settlements

FSF: Financial Stability Forum

FSB: Financial Stability Board

GDP: Gross Domestic Product

IAIS: International Association of Insurance Supervision

IASC: International Accounting Standards Committee

IAPC: International Auditing Practices Committee

ICC: International Chamber of Commerce

ICBS: International Conference of Banking Supervision

IMF: International Monetary Fund

IOSCO: International Organization of Securities Commissions

JFFC: Joint Forum on Financial Conglomerates

LCR: Liquidity Coverage Ratio

NSFR: Net Stable Funding Ratio

OCT: Over the Counter

PBB: ProduktiBrendshëmBruto

QIS: Quantitative Impact Study

RWA: Risk Weighted Asset

ROE: Return On Equity

VaR: Value at Risk

WB: World Bank

Tier: Shtresë

Tabela e Përmbajtjes

KAPITULLI I HYRJE .....- 1 -

KAPITULLI II: SISTEMI FINANCIAR, SISTEMI BANKAR DHE MBIKËQYRJA; NJË PASQYRË E LITERATURËS.....- 12 -

Hyrje .....- 12 -

2.1 Tregu Financiar Dhe Tregu Bankar .....- 13 -

2.1.1 Sistemi financiar dhe rritja ekonomike, banka dhe roli i saj ..... *- 13 -*

2.1.2 Sistemi bankar nën diversitetin ndërkombëtar ..... *- 18 -*

2.1.3 Nevoja e autoriteteve mbikëqyrëse, problematikat strukturore ..... *- 21 -*

2.2 Arkitektura E Mbikëqyrjes Financiare: Unifikimi Dhe Përfshirja E Bankës Qëndrore- 26 -

2.2.1 Aspekti i ekonomisë politike ..... *- 29 -*

2.2.2 Aspekti ekonomik ..... *- 31 -*

2.2.3 Aspekti i vëzhgimeve ekonometrike ..... *- 32 -*

2.3 Sistemi Rregullator Dhe Mbikëqyrës I Bankave .....- 36 -

2.3.1 Shteti, tregu, qeverisja e korporatave dhe mbikëqyrja ..... *- 36 -*

2.3.2 Nevoja e rregullimit dhe e mbikëqyrjes bankare ..... *- 40 -*

2.3.3 Ndërkombëtarizimi i mbikëqyrjes ..... *- 60 -*

KAPITULLI III: NGA BAZEL I NË BAZEL III; DREJT ZHVILLIMIT TË DUHUR?- 65 -

Hyrje .....- 65 -

3.1 Komiteti I Bazelit Dhe Gjeneza E Mbikëqyrjes Ndërkombëtare .....- 67 -

3.1.1 Historiku i krijimit të Komitetit të Bazelit dhe funksionimi i tij ..... - 67 -

3.1.2 Rregullimi i kapitalit të bankave ..... - 75 -

3.1.3 Krijimi i Marrëveshjes së Bazel I, limitet dhe dështimi i saj ..... - 80 -

3.1.4 Krijimi i Marrëveshjes së Bazel II, limitet dhe dështimi i saj ..... - 87 -

3.2 Komiteti i Bazelit Dhe Marrëveshja Bazel III .....- 98 -

3.2.1 Nevoja e rishikimit, një përkufizim i ri i strukturës së kapitalit ..... - 98 -

3.2.2 Risitë dhe përmirësimet e Bazel III ..... - 103 -

3.2.3 Kritikat kundrejt Bazel III ..... - 113 -

3.3 Analiza E Marrëveshjes Bazel III, Impaktet Potenciale Të Saj.....- 118 -

3.3.1 Aplikimi i Bazel III dhe impaktet potenciale mbi bankat ..... - 119 -

3.3.2 Aplikimi i Bazel III dhe impaktet potenciale në ekonominë reale ..... - 122 -

3.3.3 Veprimet që duhen ndërmarrënga bankat; sfidat dhe përgjigjet e tyre ..... - 124 -

Përfundimet e kapitullit .....- 130 -

KAPITULLI IV: STRATEGJIA NË AKTIVITETIN BANKAR, PASOJAT E SAJ ..- 132 -

Hyrje .....- 132 -

4.1 Përkufizime Dhe Modelet Strategjike.....- 133 -

4.1.1 Gjenzat strategjike ..... *- 133 -*

4.1.2 Strategjia në firmë..... *- 134 -*

4.1.3 Modelet e ndryshme strategjike : ..... *- 137 -*

4.2 Strategjitë Në Sektorin Financiar Dhe Bankar.....- 143 -

4.2.1 Strategjitë kryesore të bankave dhe fushat strategjike të tyre..... *- 143 -*

4.2 .2 Alternativat strategjike të bankës..... *- 145 -*

4.2.3 Pasojat e stategjisë bankare..... *- 151 -*

4.3 Tendecat Evropiane Dhe Amerikane Të Strategjisë Bankare.....- 154 -

4.3.1 Tendancat strategjike në nivel të bankave evropiane :..... *- 157 -*

4.3.2 Tendancat strategjike në nivel të bankave amerikane ..... *- 161 -*

Përfundimet e kapitullit .....- 162 -

KAPITULLI V: METODOLOGJIA E STUDIMIT. NGA ANALIZA KONCEPTUALE TEK ANALIZA EMPIRIKE.....- 164 -

Hyrje .....- 164 -

5.1 Mbikëqyrja Sipas Bazel III Përballë Strategjisë Bankare.....- 165 -

5.2 Propozimi I Modelit Kërkimor: .....- 170 -

5.3 Metodologjia Dhe Puna Në Terren.....- 173 -

5.3.1 Kampionimi..... *- 173 -*

5.3.2 Pyetësori/ analiza e gjysëmstrukturuar ..... *- 175 -*

5.3.3 Të dhënat dhe trajtimi i tyre : ..... *- 177 -*

KAPITULLI VI: IMPAKTI I MBIKËQYRJES BANKARE MBI STRATEGJINË E BANKËS ..... - 179 -

Hyrje ..... - 179 -

6.1 Situata E Sistemit Financiar E Bankar Në Shqipëri Sipas Analizës Opinioniste Të Ekspertëve ..... - 181 -

6.1.1 Sistemi bankar shqiptar dhe mbikëqyrja e tij ..... *- 181 -*

6.1.2 Analiza opinioniste e ekpertëve ..... *- 185 -*

6.1.3 Përmbledhje deductive/inductive e ekpertëve të mbikëqyrjes mbi sistemin bankar shqiptar ..... *- 195 -*

6.2 Analiza Sasiore Sipas Akseve Kërkimore ..... - 196 -

6.2.1 Gjeneza e rregulloreve mbikëqyrëse e prudenciale bankare ..... *- 196 -*

6.2.2 Zhvillimi i rregulloreve mbikëqyrëse e prudenciale bankare ..... *- 201 -*

6.2.3 Regulloret dhe indikacionet e mbikëqyrjes dhe prudencës kombëtare ..... *- 216 -*

6.2.4 Zhvillimi i strategjisë bankare ..... *- 245 -*

6.2.5 Rregulloret dhe indikacionet e mbikëqyrjes dhe prudencës ndërkombëtare *289*

Përfundimet e kapitullit 317

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE 319

7.1 Përmbledhje E Studimit 319

7.2 Përfundime Dhe Rekomandime 339

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA 344

Shtojcë 1: Arkitektura e autoriteteve mbikëqyrëse. 364

Shtojcë 2: Organigrama e Komitet të Bazelit 370

Shtojcë 3: Vlerësimet e kredive sipas angjensive të ndryshme vlerësuese 371

Shtojcë 4: Fazat e implementimit të kërkesave të kapitalit dhe të likuiditetit të Bazel III 372

Shtojcë 5: Struktura e Bazel III sipas shtyllave 373

Shtojcë 6 : Pyetësori. 374

Shtojcë 7 : Struktura në SPSS 18 390

KAPITULLI I HYRJE

Për shumë fenomenë ekonomikë na është dashur të "gërmojmë" nëpër kronikat historike, në mënyrë që të analizojmë e testojmë. Situata ekonomiko-financiare e epokës tonë na ka ofruar mundësinë të prekim nga afër në burim, plot fenomene duke na mundësuar kështu, vëzhgime, krahasime, analiza e testime më fleksibël, koherente dhe të menjëhershme. Zhvillimi përkatës i situatës financiare përbën një interes të veçantë ekonomik për studimin dhe perfeksionimin e sistemit financiar e bankar. Në vitet 2008-2009 e gjithë bota hyri në reçension, dhe në veçanti vendet e zhvilluara që gjeneruan krizën financiare në fillim dhe më pas atë ekonomike. Spektri i depresionit turbullon vazhdimisht dhe lajmet e këqija nuk përbëjnë më një risi. Bankat e mëdha në vendet e zhvilluara treguan dobësitë e tyre dhe "rrjedhjet" e vëzhguara, na shtyjnë drejt gjetjes së domosdoshme të parametrave optimalë, të cilët do të ofrojnë anashkalimin e defiçencave në të ardhmen dhe një funksionim normal të tregut financiar e bankar më afatgjatë. Të shumta kanë qënë studimet e shkrimet mbi problematikat dhe defiçencat e sistemit finaciar e bankar, duke qënë se kanë tronditur gjithë botën ekonomike.

Duke filluar nga studimet ekonomike e ekonometrike mbi krizën e "subprime" të filluar në SHBA, të pasuara nga teoritë e efekteve domino apo ortek, mbi rrjedhet në sitemin bankar apo zinxhirin e reagimeve ekonomike dhe përhapjes së tyre (Mishkin (2001), Caprio dhe Honohan (2008)), drejtohemi mbi analizat dhe teoritë e rregulloreve dhe mbikëqyrjes së sistemit bankar. Në fakt, bazuar mbi Goodhart (1998) dhe Kaufmann, Kraay dhe Zoido-Lobaton (1999), sektori të cilit mund t'i drejtohemi për të kuptuar më në brendi panoramën e përgjithshme dhe zgjidhjet e propozuara, është pikërisht sektori i mbikëqyrjes bankare dhe akoma më specifikisht tendecat e vendosjes së standarteve e normave të unifikuara ndërkombëtare, trajtuar gjerësisht nga Abrams dhe Taylor (2000). Për nga rëndësia dhe fama e saj do të fokusohemi në marrëveshjen e mbikëqyrjes ndërkombëtarë Bazel. Teoritë dhe kërkimet e sipërpërmendura, ofrojnë një bazë solide për realizimin e një studimi mbi

komponentë të caktuar të mbikëqyrjes së sistemit financiar e bankar dhe sidomos ndikimeve potenciale të mbikëqyrjes mbi ta. Kërkimet e deritanishme mundësojnë avancimin më në thellesi të aspektit teorik të fenomenit të mbikëqyrjes bankare, e më pas ofrojnë mjetet e duhura për testimin, krahasimin, aprovimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtyre teorive ekonomike. Nëpërmjet punimeve të Barth,Caudil, Hall dhe Yago (2000) si dhe Barth, Caprio dhe Levine (2001) kemi mundësinë të analizojmë evidencat e krizës bankare dhe se si ndikon mbikëqyrja bankare në këtë sferë. Pra, parë nga vetë mangësitë e shfaqura e një sistemi rregullator bankar për të evituar krizat, duhen përmirësime. Në këtë linjë Barth, Caprio dhe Levine (2006 dhe 2007) cilësojnë se duhet të rimendojmë mbikëqyrjen bankare dhe se cilat do të duhen të jenë paketat optimale për sitemin bankar ndërkombëtar. Për thellim të spektrit të strukturës së mbikëqyrjes dhe të kërkesave të mjaftueshme apo jo, jemi orientuar nga Hermings dhe Carmasi(2008). Ndërkohë bazuar në punimet e Parker dhe Kirkpatrick (2012) si dhe Barth, Caprio dhe Levine (2012 dhe 2013) mund të analizojmë në fakt se si, përtej qëllimit të tyre primar, ndikojnë rregulloret e mbikëqyrjes bankare ndërkombëtare në nivelin e ekonomisë së një vendi, madje edhe më specifikisht, se si ato mund të ndikojnë në nivelin e aktivitetit bankar.

Objektivat e kerkimit

Qëllimi i këtij studimi qëndron kryesisht në thellimin më specifik të literaturës përkatëse mbi fenomenin e mbikëqyrjes bankare ndërkombëtare, më tej në shqyrtimin e propozimeve të bëra dhe paralelizimin e tyre në sistemin bankar shqiptar. Nëpërmjet procesit të thellimit teorik, synoj kuptimin më konçiz dhe analizimin më të avancuar të implementimit të normave mbikëqyrëse ndërkombëtare. Duke analizuar e shqyrtuar këndvështrimet dhe optikat e ndryshme ekonomike mbi këtë fenomen, studimi synon të arrijë në një tablo më të qartë dhe të manovrueshme për sa i përket mekanizmave të regullavembikëqyrëse, implementimit, prurjeve dhe ndikimeve të tyre.

Një pjesë e rëndësishme e këtij studimi janë gjetjet e influencave potenciale të mbikëqyrjes mbi aktivitetin bankar e sidomos mbi strategjinë bankare. Në fakt, për të arritur këtë do të kalohet nga një analizë e dytë teorike, ajo mbi strategjinë e bankës, e cila do të

paralelizohet me marrëveshjet mbikëqyrëse edhe të kaluara për të vëzhguar reagimet reale. Nuk do të anashkalohet as analiza dhe përmbledhja e tendecave ndërkombëtare në këtë aks për të patur mundësi t'i krahasojmë edhe për sistemin tonë bankar.

Duhen vëzhguar më me vëmendje e detaje, jo vetëm përshkrimet e historikut të ngjarjeve, por gjithashtu edhe diagnostikimet e kryera, e mbi të gjitha zgjidhet e propozuara. Eshtë shumë e rëndësishme të vihen në dukje diagnozat e ndryshme të kryera nga ekspertë të ndryshëm të fushës. Akoma më shumë e rëndësishme është analiza e propozimeve te kryera prej tyre. Paneli i këtyre zgjidhjeve të propozuara, ofron një bazë solide krahasimesh e testimesh në mënyrë që të vërtetohet efikasiteti,efiçenca dhe ndikimet e politikave të reja të propozuara.

Për sa i përket mjedisit ekonomik e financiar shqiptar, avancimet e kryera në tregjet botërore mundësojnë realizimin e një paralelizmi dhe testimin e politikave të reja, nën kuadrin e një adaptimi për rastin e ekonomisë shqiptare. Qëllimi kryesor në këtë pikë është gjetja e mënyrës së duhur të aplikimit të propozimeve të kryera për të arritur parametrat optimal të harmonisë afatgjatë financiare dhe gjenerimit të fushëveprimeve të prekura gjatë aplikimit.

Përcaktimi i problemit dhe nën-problemeve

Analiza e thelluar e mbikëqyrjes bankare, përtej përshkrimit të fakteve, eksploron arsyet e ndryshme që u poqën në mënyrë të tillë për të prodhuar këto çrregullime të mëdha të tregut financiar ndërkombëtar. Ekzistojnë, patjetër, faktorë makroekonomikë në origjinë të saj. Mund të nënvizojmë këtu laksizmin monetar që karakterizoi politikat e Alan Greenspan, të cilat luajtën një rol shumë vendimtar në krijimin e ortekut të krizës. Ortek, i cili me shpërthimin e tij zhyti gjithë botën në një krizë pa precedentë që prej fundit të luftës së dytë botërore. Bankat kanë qënë të nxitura, për shkak të normave prudenciale jo adapte, në mënyrë sistematike të nxjerrin nga bilanci rreziqet e braktisura në treg që akumuloheshin tek agjentët ekonomikë jo bankarë. Atëherë, aktiviteti jashtë bilancit u fry, duke bërë që rreziqet e bilancit të shpërhapeshin në të gjithë sistemin. Shumë institucione bankare u detyruan të rifusin në bilanc çfarë kishin përjashtuar, por kjo gjë i dobësoi akoma më

shumë, ndërkohë që kriza vazhdonte të amplifikohej. Atëhetrë, le të nisemi prej këtyre politikave e të mundohemi t'i analizojmë më në thellesi. Duke u bazuar mbi një "kuti veglash" ekonomiko-financiare solide e të shumëllojshme, do të përpiqemi të copëzojmë mekanizmat që kontribuan në transformimin e profesionit bankar. Problematika që do të trajtohet në këtë studim, do të rrjedhë natyrshëm që prej nevojës së mbikëqyrjes e deri në impaktet e saj potenciale e reale mbi ekonominë, sistemin bankar dhe akse më specifike të aktivitetit bankar. Problemi i mbikëqyrjes qëndron jo vetëm në ekzistencën e saj, por gjithashtu në thëllësinë e penetrimit, shtrirjen dhe influencat direkte e indirekte. Pikërisht për t'i analizuar më në brendi të gjithë problematikat dhe nën-problematikat qe lindin, do bazohemi në njësitë e analizës të prezantuara në vijim.

Pyetjet kerkimore dhe hipotezat

Nga analizat e ndryshme të kryera mbi mbikëqyrjen bankare, përtej rëndësisë së saj dhe efekteve direkte mbi sistemin bankar ky studim ka dashur të zgjerojë spektrin e matshmërisë së impakteve mbi ekonomine reale si dhe mbi aspekte të ndryshme të aktivitetit bankar. Duke ditur shumë mirë që sistemi bankar është i prirur të pësojë goditje, atëherë, mbikëqyrja bankare është e domosdoshme. Kjo pikënisje e studimit na mundëson këndin nëpërmjet të cilit do të trajtohet si ana teorike dhe kërkimi empirik. Nga thellimi i mëtejshëm i analizës ngrihen pyetje të tila si:

-Pse dhe mbi ç'baza ka lindur mbiqyrja bankare?

-A ka evoluar me hapin e duhur? Në ç'drejtim duhet të evoluojë?

-A është Bazel III sistemi mbikëqyrës më adapt?

-Si do të aplikohet në sistemin tonë? Në ç'masë duhet aplikuar ai?

-Çndikime gjeneron aplikimi i rregullave/normave të reja të sistemit mbikëqyrës?

-Cilat akse të aktivitetit bankar do të prekë Bazel III?

-Cilat akse strategjike do të preken?

-Cilat duhet të jenë përmirësimet apo adaptimet në përputje me sistemin tonë?

Analiza do të jetë në fakt e grupuar në dy sfera, së pari sfera e mbikëqyrjes ndërkombëtare në sistemin bankar në shqipëri, dhe së dyti strategjia e aktivitetit bankar (zgjedhur si komponent i aktivitetit të bankës). Pra, do të duhet të vëzhgojmë gradualisht në sferën e parë si dhe sa mbikëqyrja ndërkombëtare është prezente në sistemin bankar shqiptar, dhe në sferën e dytë si dhe sa do të transformonte ajo strategjinë e bankave në aktivitetine tyre bankar. Më tej do tanalizojmë e konkludojmë nëse është pikërisht marrëveshja Bazel III ajo e përzgjedhura si impaktuesja kryesore. Duke ekspoluar më në thellësi, ky studim do të mundësojë përgjigje mbi këto çeshtje të ngritura më lart, duke u bazuar në mënyrë direkte mbi këtë hipotezë dhe nën hipiteza

H: ***Nëse mbikëqyrja ndërkombëtare bankare, në bazë të marrëveshjes Bazel III, do të implementohet në sistemin bankar në Shqipëri, atëherë do të kemi një ndikim mbi strategjinë e aktivitetit të bankave tregtare shqiptare.***

Θ H1: ***Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare njihen, vlerësohen dhe konsiderohen optimale nga bankat tregtare shqiptare.***

Θ H2: ***Situatat, tregu bankar ndërkombëtar dhe mbikëqyrja ndërkombëtare kanë ndikimi mbi rregulloret e mbikëqyrjes kombëtare.***

Θ H3: ***Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare kanë ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare shqiptare.***

Θ H4: ***Marreveshja ndërkombëtare mbikëqyrëse Bazel III ka ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare.***

Vleresimi i literatures

Studimi aktual do të mbështetet mbi tre shtylla kryesore të arritjeve teorike e kërkimore të deritanishme. Pikë së pari, do të mbështetem mbi kërkimet e kornizën teorike e historike

të mbikëqyrjes bankare, më saktë të marveshjes mbi mbikëqyrjen bankare Bazel. Nëpërmjet kërkimeve dhe studimeve të ndryshme të realizuara nga Bank for International Settlements, ofrohet një panel i gjerë zgjidhjesh e rregullimesh të propozuara, të cilat duhen marrë në shqyrtim e duhen analizuar për efikasitetin e tyre. Burime të shumtadokumentacioni, shqiptare ose jo, përbëjnë objekt të këtij studimi. Qëllimi i shtyllës së parë qëndron pikërisht në krijimin e një panorame më të qartë të situatës në burim të fenomenit si dhe situatës aktuale ndërkombëtare.

Së dyti, paraqitet shtylla mbi literaturen kritike bazuar në opinione të ekspertë të ndryshëm të fushës në mënyrë që të realizohen krahasimet e duhura dhe të zgjidhet një pozicionim mbi fenomenin në shqyrtim. Së treti e së fundmi, qëndron shtylla e referimit mbi rastin shqiptar. Burime, si instutucionet shtetërore gjithashtu edhe artikuj e studime të shumtë vendas ose jo, ofrojnë një panoramë dhe diagnozë të detajuar të situatës ekonomiko-bankare shqiptare. Në plotësim të kesaj shtylle do të vijnë analiza e studime të vetë-realiziuara. Të gjithë këta komponentë, janë të mirënjohur nga zhvilluesit e zbatuesit e politikave financiare, por një kryqëzim i tillë do të ofrojë një dritare të re mbi avancimet ekzistuese të fenomenit mbikëqyrje.

Metodologjia e Kerkimit

Ky studim përmbledh metoda të ndryshme të kërkimit shkëncor, si kërkimi e krahasimi teorik por gjithashtu edhe aplikimi empirik. Për ta ndjekur hap pas hapi ecurinë e tij, ky studim do të nisë me një thellim teorik, dhe historik të fenomenit në target, mbikëqyrjes bankare si dhe komponenteve te saj. Në këtë pjesë teorike do të kryhet analiza e avancuar e literaturës dhe punimeve përkatëse në mënyrë që të kuptohet dhe paraqitet sa më e saktë panorama e burimit të problemit dhe gjenerimit të tij. Do të vazhdohet më tej me aspektin analitik, pra me shqyrtimin dhe krahasimin e informacioneve të mbledhur si dhe e analizave SËOT të realizuara. Nëpërmjet këtij hapi të kërkimit do të realizohet zbërthimi dhe copëzimi i mekanizmit të brendëshm të mbikëqyrjes bankare Bazel në mënyrë të tillë që të ofrojë indikacione mbi parametrat e aplikimit, adoptueshmërinë apo ndikimet potenciale. Pra do të bazohem mbi këto arritje për të përgjithësuar e propozuar parametrat

e momentet që duhen monitoruar dhe rregulluar, me qëllim evitimin e futjes në vorbullën e efektit ortek të defiçencave të tregut që degjenerojnë shpesh në krizë financiare.

Pas krijimit të kësaj kornize teorike dhe analitike do të kalohet në fazën e aplikimeve mbi realitetin shqiptar. Mbledhja e informacioneve cilësore e sasiore mbi mbikëqyrjen dhe sistemin bankar shqiptar, nuk do të ndalet vetëm mbi realitetin kombëtar por edhe atë ndërkombëtar për të patur mundësi realizimin e krahasimeve të ndryshme. Në sajë të burimeve të ndryshme, si Banka e Shqipërisë, banka të tjera të tregtare, raporte studimi të FMN dhe Bankës Botërore do të ofrohetnjë analizë mbi aplikimin e rregullave të reja të mbikëqyrjes në mënyrë që të analizohet efekti i tyre, për të mundësuar më tej vendimarjen mbi aplikimin e tij apo mbi ndërtimin e politikave të ndryshme mbikëqyrëse në sistemin bankar shqiptar.

Analiza cilësore

Në fakt, analiza cilësore është pjesa e parë e metodologjisë së ndjekur në këtë studim. Përmbjedhjet teorike të situatës vendase janë të vjetëruara. Mënyra e zgjedhur për të identifikuar gjendjen e situatës, aktorët, zhvillimet dhe prognozat e nevojshme është pikërisht intervistimi i ekspertëve në ballafaqim me kuadrin dhe dokumentat teorik. Do të realizohen një seri intervistash me ekspertë të ndryshëm nga mbikëqyrja bankare, që burojnë nga Banka e Shqipërisë dhe jashtë saj, me ekpertë të bankingut vendas si dhe teoricienë të fushës. Këto intervista do të ndërthuren bukur, për të shpjeguar dhe më pas analizuar situatën, në mënyrë për të hartuar dhe kanalizuar analizën empirike.

Analiza empirike

Analiza empirike e dëshiruar është në fakt identifikimi direkt dhe i kryqëzuar i influencave të çiftit mbikëqyrje-strategji. Do të realizohet një pyetësor kompleks, në bazë të të cilit do të përftohen të dhëna si informative, provokuese, që kërkojnë informacione deri diku konfidenciale, më pas do të kalohet në pjesën e kërkesave shifrore dhe ekzakte në mënyrë paralelizimi objektiv. I gjithë pyëtësori do të pasurohet nga një pjesë opinioniste, ku ekspertëve të intervistuar do t'u lihet dorë e lirë për të shprehur mendimin e tyre. Kjo

ndërthurje të dhënash do të na mundësojë plotësimin perfekt të kuptimit të çdo shifre apo alternative, për të identifikuar dhe deklaruar realitetin në mënyrë korrekte.

Metodat Deduktive dhe Induktive

Për realizimin e secilit prej këtyre modeleve apo prej secilit komponent të punimit janë ndërthurur metodat deduktive dhe induktive të cilat ndihmojnë në optimizimin e rezultateve. Në fakt, ndërtimet bazike të pyetësorëve apo strukturës së modelit janë ngritur fillimisht nga teoria e më pas janë strukturuar llogjikisht deri në vërtetimin apo hedhjen poshtë të tyre. Ndërkohë, në po të njëjtën mënyrë jemi nisur nga vëzhgime të ndryshme për t'i strukturuar dhe ballafaquar me teorinë, me qëllim arritjen e testimit dhe aporovimit apo jo të tyre.

Mundësitë dhe kufizimet

Rëndësia e madhe e tematikës së mbikëqyrjes sidomos në këtë moment krucial post krize, ku të gjithë institucionet dhe autoritetet janë të ndërgjegjësuara e interesuar në përmirësimin e situatës, përbën për studimin një mundësi shumë të madhe. Dhe kjo vjen prej faktit se do të ketë jashtë mase shumë punime paralele apo modele të testuar në vende të krahasueshme apo jo, të cilat do të na japin mundësinë të mbështetemi në analiza të realizueshme e struktura solide.

Së pari, një limit potencial me të cilin do të duhet të përballemi, do të jetë mungesa e së njëjtës bazë krahasimi midis tregut botëror dhe atij shqiptar,si nga ana e tregut financar, gjithashtu edhe të kushteve ekonomike. Eshtë shumë e qartë dhe dihet shumë mirë që tregu financiar shqiptar mund të quhet i "cunguar". Ky emertim vjen si pasojë e mungesave të shumta në të. Mund të përmendim që jo të gjithë komponentët, parametrat apo produktet që ekzistojnë në tregjet financiarë botërorë mund të gjënden edhe në tregun tonë financiar. Evidendimi i mungesës së një burse, përbën një ndryshim parësor me tregjet e tjerë. Si nga ana e ofertës, që tregu financiar shqiptar nuk ofron e nuk mundëson të gjithë komponentët e tregjeve të tjerë, po ashtu edhe nga ana e mjeteve rregullatore, ky treg nuk gëzon gjithë panelin e mjeteve ekonomik në dispozicion.

Së dyti, një limit tjetër në analizë përbëjnë mungesat e bazave të të dhënave zyrtare të aksesueshme. Në fakt, mbledhja e të dhënave përbën një problem dhe vështirësi të madhe në realitetin shqiptar. Nuk pengojnë vetëm barrierat ligjore të konfidencialitetit për sa i përket tregut bankar, por gjithashtu përmasa e tij shtyn në një rezervim të mëtejshëm të informacionit për hir të konkurueshmërisë. E pikërisht tematika e zgjedhur mbi strategjinë luan rol kryesor si në limitet e avanatazheve konkuruese, ashtu edhe në politikat e kofidencialitetit. Së treti, një limit i lidhur fort me të sipërmendurin ligj konfidencialiteti të të dhënave,janë edhe tentativat për të kërkuar bashkëpunim me bankat në rast manovrimi hipotetik me disa prej parametrave të kapitalit rregullator, të nivlit të likuiditetit, apo disa komponentëve të tjerë financiarë, ku do të duhej të kryeshin nivele bazike 'stres test'-esh të cilat gjithashtu përbëjnë material konfidencial.

Rëndësia e studimit

Realizimi i këtij studimi mund të shihet e të konsiderohet si një avancim apo thellim i mëtejshëm i kërkimeve e punimeve të kryera në fushën e analizës, diagnostikimit dhe propozimeve mbi mbikëqyrjen bankare. Do të kryhet paralelizmi i kuadrit teorik dhe empirik mbi fenomenin në fjalë, duke mundësuar kështu, një bazë teorike dhe metodologjike për një pjesë të tregut financiar që është në zhvillim dhe që po transformohet në kohën kur ne flasim.Rëndësia e studimit qëndron pikërisht mbi vendimet rreth mbikëqyrjes bankare ndërkombëtare dhe normave të reja makro prudenciale që janë duke u propozuar. Më saktë, mbi aplikimin apo jo të tyre, mënyrën se si duhet të aplikohen, deri në ç'masë duhen aplikuar dhe mbi të gjitha cilat janë ndikimet që ato do të gjenerojnë. Këto rezultate do të infuencojnë në metoda e politika të ndryshme ekonomike. Nëpërmjet këtij studimi, arritja e një hamendësimi mbi gadishmërinë e aplikimit, apo edhe komponentë të tjerë të implementimit që do të burojnë gjatë studimit, ofron një panel analize i cili do të orientonte apo infuenconte vendimmarjen e ardhshme mbi pranimin e marveshjes Bazel III për sistemin tonë bankar.

Pohimet dhe avancimet e ofruara në këtë studim, do të mundësojnë padyshim baza për studime të mëtejshmë mbi tregun financiar dhe normat e mbiqyrjes financiare e bankare,

duke ofruar këndvështrime e propozime te tjera mbi tematikën në fjalë. Ky studim do të kontribuojë gjithashtu në orientime të reja edukative për sa i përket sitemit rregullator financiar ndërkombëtar.

Struktura e punimit

Qëllimi i pjesës së parë të punimit, kapitulli dy dhe tre, qëndron në analizën e kornizës teorike jo vetëm të historikut tëmbikëqyrjes e rregullave bankare si kombëtare dhe ndërkombëtare, por gjithashtu në evidentimin e rëndësisë së këtyre rregullave ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare, pjesë nga të cilat do të mund të gjenden në kapitullin e parë. Nëvazhdimësi, do të mund të gjëndet një guidëe marrëveshjëveve të ndryshme Bazel, analiza e të cilave do të na mundësojë një pamje më të qartë tëzhvillimit të tyre si dhe të ndikimeve potenciale që ato kanë. Ne kemi sot një histori prej tre marrëveshjeve të Bazel, dhe ju do të gjeni më poshtë nëkapitullin e tretë, rrugën historike të krijimit të marrëveshjes së parë, kalimin në Bazel II dhe më në fund, me përmirësimet aktuale të marrëveshjes së rëBazel III si dhe parashikimet e influencave të saj. Në fakt, marrëveshjet ndërkombëtare bankare, kanë kaluar nëpër hapa të ndryshëm, e kanë provuar veten e tyre të gabuar ose të drejtë, dhe si rezultat i disa përmirësime dhe adoptime kanë arritur të marrin formën e sotme. Këto ndryshime përbëjnë thelbin e punës së paraqitur në këtë pjesë, duke nënvizuar problematikëne ndikimit të tyre mbi bankat. Eshtë pikërisht aksi i ndikueshmërisë potenciale mbi bankat që përbën thelbin e këtij punimi. Më tej, në një kapitull të katërt do të mund të gjejmë informacione mbi zhvillimin e modelit të biznesit, strategjisë në përgjithësi, e më pas më në veçanti për sektorin bankar, duke nënvizuar gjithashtu prirjet dhe tendecat ndërkombëtare mbi strategjinë e bankës.

Metodologjia e përdorur për këtë pjesë të parë, shtrihet në një hulumtim kualitativ për të përhapur gjerësisht, dokumentacioni zyrtar, në bazë të opinionit, të dokumentave të punës, gazetave, vëzhgimit të realitit, si dhe krahasimeve të bëra mes tyre. Kjo na ka mundësuar të thellojmë njohuritë konceptuale në mënyrë që të testojmë e të studiojmë propozimin kërkimor duke patur “mjetet” e duhura për të zbërthyer më pas anën empirike. Kuadri teorik dhe letrar na mundëson mirëkuptimin e zhvillimeve në sektorin bankar e sidomos në

rastin e mbikëqyrjes së tij. Në fakt, kemi detajuar dhe studjuar në thellësi kanalizimin e sferës ekonomike deri në mbikëqyrje e më pas këmi analizuar rëndësinë e saj.

Me guidën përmes historikut të marrëveshjeve të mbikëqyrjes ndërkombëtare është mundësuar kuptimi i nevojës së tyre, si dhe kemi mundur të analizojmë më në brendi mangësitë e përmirësimet e tyre por sidomos më e rëndësishmja, të analizojmë akset potencialisht të prekshme në sektorin bankar nga këto marrëveshje ndërkombëtare. Pra, rrugëtimi teorik na ka lejuar të hapim horizontet tona për një kërkim më cilësor e sasior për sa i përket influencave dhe ndërveprimeve të komponentëve të caktuar të një bankë, me komponentët e paketave mbikëqyrëse ndërkombëtare. Në kapitullin e pestë të këtij punimi, do të mund të gjejmë një analizë të ndikuehmërisë potenciale të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi strategjinë e ndjekur nga banka. Për këtë, do të nisemi nga ngritja e propozimit kërkimor i cili shpreh qartë akset e kërkimit me variablat përkatës, duke kaluar më tej në metodologjinë e analizës empirike të ofruar. Nëpërmjet kësaj analize empirike cilësore e sasiore në nivelin e sektorit bankar shqiptar, do të mund të paralelizojmë këto dy sfera të targetuara, pra nga një anë mbikëqyrjen bankare, nisur nga niveli kombëtar e më tej nga ai ndërkombëtar, e nga ana tjetër modeli i aktivitetit bankar përmes strategjive të zgjedhura. Analiza e ndërthurur si sasiore dhe cilësore e gjendur në kapitullin gjashtë, që përfaqëson analizën empirike, do të na mundësojë të kuptojmë materialisht, si rëndësine ashtu dhe ndikimet e marrëveshjes Bazel III në tregun bankar shqiptar. Ky pasazh empirik, do të hapë kështu rrugën për të dalë në përfundime e sugjerime në kapitullin shtatë, qëllimi i të cilave qëndron në optimizimin dhe harmonizimin e implementimit të marrëveshjes mbikëqyrëse bankare ndërkombëtare Bazel III, në bankat e tregtare në Shqipëri.

KAPITULLI II: SISTEMI FINANCIAR, SISTEMI BANKAR DHE MBIKËQYRJA; NJË PASQYRË E LITERATURËS

Hyrje

Tregjet finaciare janë "përbërësi" kryesor për të promovuar rritjen, zhvillimin dhe stabilitetin ekonomik. Në cdo shtet të shumta janë politikat e fondet e lëshuara vetëm për ti dhënë përparësi e për të rritur më tëj zhvillim e sektorit financiar e sidomos atij bankar, i cili ka një rol shumë të rëndësishëm. Bankat në fakt, nuk përfaqësojnë vetëm instrumentin e financimit por gjithashtu janë përcjellësi i politikave monetare të një shteti. Bashkë me zhvillimet e shumta financiare e ekonomike edhe roli dhe forma e prezencës bankare kanë ndryshuar gjithashtu. Në etapa të ndryshme të zhvillimit ekonomk të një shteti, bankat zënë role të ndryshme dhe kanë mutuacione të konsiderueshme. Në fakt me maturimin ekonomik të një shteti roli i bankës si kredhënëse zvanitet, ndërkohë që kemi një rritje të rëndësisë së tregjeve të kapitalit.

Ky zhvillim ka shtyrë në një rritje të konkurrueshmërisë, duke bërë që industria bankare të konsolidohet dhe të shtrijë më gjerë spektrin e produkteve dhe shërbimeve të ofruara. Ndërkombëtarizimi luan një rol të rëndësishëm gjithashtu, sepse bankat kanë tentuar të "kënaqin" edhe konsomatorët ndërkombëtar, dhe për të arritur këtë të fundit mund të shohim në ditës e sotme zinxhirë bankash nëpër glob, të cilat janë mbështetur masivisht edhe në arritjet teknologjike për të mundur të shtrihen dhe të adaptahon me kërkesat e konsomatorëve kudo qofshin. Përdorimi i teknologjive të fundit ka mundësuar gjithashtu edhe reduktimin e kostos, përmirësimin e informacionit si dhe përçimin e tij në një kohë rekord duke aftësuar bankat në një përgjigje të shpejtëë të sigurt në transaksionet e në veprimatarinë tyre. Procesimi i shpejtë dhe më i mirë i informacionit i ka ndihmuar bankat në përgjigje të konsomatorit por gjithasht edhe në një mënaxhim të rrezikut, në një mirëshpërndarjeje të produkteve e shërbimeve të tyre. Njëkohësisht me zhvillimin dhe ndryshimin e bankës, edhe sistemi mbikëqyrës e rregullator ka ndryshuar, madje mund të themi që vëzhgojmë një nevojë për ndryshimin e tij, në një adaptim sa më të shpejtë

përkundrejt mutuacioneve të shumëllojshme që ka pësuar bankat si intitucion por edhe shërbimet e produktet e saj. Ka shumë banka nëpër botë që përtej mbikëqyrjes nga autoritetet e bankave qëndrore përkatëse kanë ngritur struktura rregullatore për optimizimin e menaxhimit të rrezikut, duke shfaqur kështu një përgjegjshmëri të lartë.

Nevoja për një rregullim e mbikëqyrje më adapte nuk lind detyrimisht nga një "degjenerim" i tregut por përkundrazi nga një zhvillim eksponencial i tij. Mënyra se si janë transformuar dhe pasuruar, sidomos me konglomerate financiare që tejkalojnë disa struktura rregullatore ka shtyrë pikërisht në transformimin dhë përditësimin e mbikëqyrjes bankare dhe produkteve të saj. Ka shumë vënde të cilat kanë patur një qëndërzim shtetëror të bankave (rasti i Shipërisë deri në vitin 1996) të cilat duke privatizuar kanë tërhequr banka ndërkombëtare në blerje, bashkime e franchiza dukë përfshirë kështu në globalizim, në mënyrë indirekte, edhe tregjet e pa targetuara apo të gatshme për këtë të fundit. Pikërisht, shtrohen tashmë pyetje të shumta mbi kush duhet të ngrejë e mbajë strukturat rregullatore e mbikëqyrëse dhe si do të transmetohen, sidomos mbi bankat të cilat operojnë ndërkombëtarisht si dhe konglomerateve financiarë të cilët operojnë në shtete të shumtë. Në këtë kapitull mund të gjeni së pari terrenin i cili formon nevojën e mbikëqyrjes, duke pasuar me një pasqyrë të tregjeve financiare dhe sistemit bankar, duke përmendur rolin, funksionimin dhe pozicionin e bankave. Së treti do të mund të gjeni qëllimin dhe funksionimin e vetë strukturave e paketave mbikëqyrëse si harmonizuese e stabilizuese të tregjeve bankare e financiare edhe ndërkombëtarisht (arkitekturat e ndryshme).

2.1 Tregu Financiar Dhe Tregu Bankar

2.1.1 Sistemi financiar dhe rritja ekonomike, banka dhe roli i saj

Një treg është një vend takimi ku përballen oferta dhe kërkesa e një produkti të caktuar. Në rastin e tregut financiar apo të kapitaleve produkti në fjalë është paraja. Në tregun e kapitalit, mbajtësit e ofertës janë të ashtuquajturit agjentë me "kapacitete kursimi pozitive", kryesisht ekonomitë familjare (aq e habitshme sa mund të duket) dhe gjithashtu kompanitë,

edhe pse këto të fundit në përgjithësi preferojnë të riinvestojnë fitimet e tyre në biznesin e tyre ose të paguajë dividentin për aksionerët e tyre. Në anën tjetër kemi aplikantët, që janë së pari shteti, i cili kërkon investime të konsiderueshme dhe sigurisht kompanitë e tjera: të cilët përfaqësojnë agjentë të njohur si "kërkues të financimit". Larg nga një entitet abstract, tregu i kapitalit është në fakt motori i ekonomisë, pasi ai është vendi ku karburanti, paraja, do të përdoret për të çuar përpara makinën, që do të thotë, të gjenerojë pasuri. Ky është parimi, por zbatimi praktik i këtij të fundit është më kompleks nga ç'duket.

Si janë të shpërndarë ndikimet në terma të pasurive kombëtare nëpër planet? Logaritjet janë gjithnjë të lehta kur bëhet fjalë për shpërndarje globale, kemi rregullin e 20/80. Kemi në fakt 20% të popullësisë së globit që gjeneron 80% të GDP-së totale globale, apo akoma që zotëon mbi 80% të aseteve bankare. Po cila është kategoria e këtij 20 përqindëshi të popullësisë, janë vendet e zhvilluara. E pikërisht vëndet e zhvilluara pavarësisht peshës më të vogël që zënë në popullësinë e globit, kanë zotërimet e arritjet më të larta ekonomike. Sa më i zhvilluar vendi aq më shumë shtysë për zhvillimin e sistemit financiar, që në radhën e tij ndikon në rritjen ekonomike. Pra shfaqet dukshëm një " qark vicioz" që në këtë rast nuk ka asgjë vicioze përveç përshkrimit të amplifikimit pozitiv të rritjes e zhvillimit të sistemit fianciar e të vetë ekonomisë së një vendi. Në fakt , po të bazohemi në Levine (1999), Khan dhe Senhadj(2000), dhe Phumiwasana (2003) mund të gjejmë një literaturë të gjerë mbi rolin e sistemit financiar në rritjen ekonomike.

Këto vepra nuk janë të vetmet që shpalosin korreacionin midis sistemit financiar dhe incidencës së zhvillimit të tij më zhvillimin e rritjen e ekonomike, në tekste më të hershme mund të drejtohemi veçanërisht tek Goldsmith (1969) dhe McKinnon (1973). Kemi gjithashtu King dhe Levine (1993a), Beck, Levine, dhe Loayza (2000), të cilët bazohen në njohuri më të hershme të shfaqura që nga Joseph Schumpeter, një pioner i fillim shekullit të njëzetë në letërsinë mbi financat dhe rritjen ekonomike. Literatura e sipërpërmendur në fakt përmbledh në disa boshte rëndësinë dhe mënyrën nëpërmjet të cilës një sistem

financiar ka rrjedhoja në rritjen ekonomike. Mund të përmendim atëherë ndikimet e sistemit financiar mbi:

- Alokim dhe mobilizim më të mirë të kursimeve
- Reduktim të rrezikut për kursimtarët individual me diversifikim
- Menaxhim më të mirë të rrezikut nëpërmjet ndërmjetësve
- Etj…



Figura 2.1 Roli i sistemit financiar në zhvillimin ekonomik (përpunuar nga autori)

Kërkimet e studimet e shumta që janë kryer për këtë incidencë të sitemit financiar mbi rritjen e zhvillimin ekonomik janë fokusuar kryesisht në sistemin bankar për shkak të faktit se të gjitha vendet kanë bankat dhe të dhënat në to janë më të lehtësisht në dispozicion sesa për tregjet e kapitalit. Në fakt, tregjet e pazhvilluara të bonove dhe mungesa e të dhënave e ka përjashtuar ndonjë hulumtim empirik rigoroz në këtë fushë, përkundrejt sutdimeve me bankat dhe tregjet e aksioneve. Për shembull, kemi një studim të kryer nga King dhe Levine (1993b), të cilët kanë përdorur të dhënat për 80 vende, për një seri kohore 1960-1989, nëpërmjet të cilit kanë arritur të identifikojnë një marrëdhënie dukshëm pozitive midis komponentëve të ndryshëm të zhvillimit financiar, dhe rritjes ekonomike.

Në bazë të Arestis dhe Demestriades (1998), konkludojmë në vështirësive metodologjike të shumta për krijimin e rastesisë midis zhvillimit financiar dhe zhvillimit ekonomik. Megjithatë Bonin dhe Wachtel (2003) do të vëzhgojnë, "Një konsensus të fortë në dekadën e fundit që mire funksionimi i ndërmjetësve financiarë ka një ndikim të rëndësishëm në rritjen ekonomike. " Nuk mund të lëmë gjithashtu pa përmendur edhe studimet e bazuara vetëm në një vend si Bae, Kang, dhe Lim (2002) duke përdorur të dhëna Koreane, më tej Ongena, Smith, dhe Michalsen (2003) me të dhëna norvegjeze, dhe Gan (2003), duke përdorur të dhëna japoneze. Kohët e fundit, Levine, Loayza dhe Beck (2000), me të dhëna për 74 vende, kanë mundur të analizojnë se komponenti ekzogjen i ndërmjetësimit financiar është i lidhur pozitivisht me rritjen ekonomike. Mirëpo, edhe pse sistemi financiar i një vendi është kryesisht një aktiv jo-material që mund të lehtësojë rritjen ekonomike, ai mund të dështojnë pa një sistem të përshtatshëm rregullator e ligjor (La Porta, Lopez-de-Silanes, Shleifer, and Vishny (1998), Levine (1998)) Arsyeja është se as bankat e as tregjet kapitale nuk do të funksionojë në mënyrë efektive në situata të tilla, dhe pa sistemeve efektive financiare, ekonomitë e dobëta nuk do të jenë në gjendje për të përmirësuar pozicionin e tyre relativ në eknominë globale.

Bankat luajnë një rol kryesor në një ekonomi. Efikasiteti, integriteti dhe stabilitetit i sistemit bankar janë një para-kusht për një sistem të qëndrueshëm financiar dhe për funksionimin e duhur të një ekonomie. Pikënisja është mundësia që një shkëmbim të zhvillohet mes agjentëve me kapacitete kursimesh pozitive dhe agjentëve në nevojën e

financimit. Në të vërtetë, që të ketë funksionim të tregut nuk duhet vetëm të ekzistojë produkti, oferta dhe kërkesa, por gjithashtu që agjentët të duan ta kryejnë shkëmbimin. Por agjentët ofrues, pra individët, familjet, kanë një "neveri" të thellë ndaj rrezikut. Prandaj shumica e kursimeve të krijuara nga individët apo ekonomitë familjare është në llogaritë rrjedhëse ose në llogari kursimi, ku paraja është menjëherë në dispozicion. Në të kundërt agjentët paralel, kompanitë në nevojë për financim, janë të interesuarit në gjetjen e një plani afatgjatë financimi për zhvillimin e tyre.

Bankat janë agjentët e vetëm që kanë fuqinë për të transformuar burimet afatshkurtra, depozitat pa afat (llogaritë rrjedhëse) në kredi bankare afatmesme apo afatgjatë. Bankat, krijojë pra urën e nevojshme në mes individëve apo ekonomive familjare dhe kompanive; duke luajtur historikisht dhe vazhdojnë të luajnë një rol kyç në financimin e ekonomisë. Çdo bankë ka të drejtë të shpërndajë në formën e kredisë pothuajse të gjitha paratë e depozituara nga klientët në llogaritë. Vetëm se horizonti i agjentëve me kapacitete kursimi është zakonisht në hark kohor me bazë javore ose maksimalisht mujore, në anën tjetër horizonti i agjentëve në nevojë për financim është në hark kohor disa vjeçar. Kjo mospërputhje kohore bën që shkëmbimi efektiv të jetë disi problematik.

Bankat pra, një agjent kryesor i sistemit financiar, përfaqësojnë një shesh betejë për investitorë e fonde, duke siguruar likuiditete, informacion e duke reduktuar kostot e transaksioneve, dhe janë pikërisht këto atribute që i ndajnë bankat nga institucionet financiare duke bërë të nevojshëm mbikryrjen dhe rregullimine tyre. Le të analizojmë pjesën e reduktimit të kostos; së pari banka ofron shërbime pagesash të cilat kanë kosto e burokraci shumë të larta e të gjata për një invidid apo firmë (për shembull kontratat e së ardhmes të tipit 'forward"), së dyti eliminon kostot e verifikimit (për shembull për çeqe të emëtuara) si dhe së treti ofron transaksione nëpërmjet të cilave një bankë kryen transformimin e aseteve të një lloji në një lloj tjetër (për shembull trasformimi i depozitave në kredi) duke ofruar shërbime maturiteti, transformim rreziku e ndarje të tij.

Një rol kryesor i bankës qëndron në ndërmjetësimin e infromacionit dhe reduktimit të asimetrisë së tij duke ofruar "monitorim të deleguar " (Diamond 1984). Punimet e Bester

(1985) dhe Freixas & Laffont (1990) ilustrojnë mënyrën se si bankat reduktojnë kostot e rrisin efiçencën duke indentifikuar së pari huadhënësit potencial e duke bërë më pas "presion" mbi ta, në këtë mënyrë banka eviton sjelljen oportuniste nga ana e tyre dhe si rezultat banka përfton fonde të lira me "informacion të mirë", Fama (1985). Sipas modelit të Diamond dhe Dybvig (1983 dhe 2000) bankat janë të konsideruara një "pishinë likuiditeti" e cila i jep individëve për depozitat e tyre siguri kundrjet goditjeve "idiosinkratike" (sjellje në grup) të cilat cënojnë nevojat e tyre për konsum dhe nga ana tjetër me po këto fonde të tjera të gjeneruara banka i ofron investitorëve të investojnë në mjete jo likuide duke tentuar në një ekuilibër jo të rrezikshëm mes këtyre dy "trampolinave". Dhe ndër këto tre role të bankës ky i fundit është komponenti që sjell pikërisht më shume rrezik dhe destabilitet në ekonomi duke mishëruar thembrën e Akilit të bankave.

Pra mirë funksionimi i sistemit bankar dhe atij financiar në tërësi është trajtuar dhe trajtohet si një kusht primar i mirë funksonimit të ekonomisë së një vendi dhe veçanërisht një katalizator i rritjes ekonomike. Megjithatë, rritja eknomike nuk duhet parë si një fenomen i izoluar, pra si një atribut personal i vetëm një vendi, duhen marrë në konsideratë edhe ndërlidhjet e shumta dhe përmasat ndërkombëtare që marrin bankat dhe vetë sistemi financiar. Mund të shohim në pikën në vazhdim pikërisht pozicionimin e sistemit bankar nën kupolën ndërkombëtare.

2.1.2 Sistemi bankar nën diversitetin ndërkombëtar

Me kalimin e kohës struktura e financimit ka ndryshuar. Pikërisht pozicionet e mbajtura në financimin e firmave nga aksionet, bonot, dhe kreditë bankare kanë ndryshuar. Sistemi financiar botëror ka pësuar një mutacion duke treguar që ekonomitë janë pjekur e nuk kanë më nevojë për të njëjtën përmase të sistemit bankar. Peshën e rënë të sistemit bankar e ka rikuperuar tregu i kapitaleve. Në fakt ka një debat të ndezur mbi orientimin e sistemit financiar me bazë bankare apo me bazë në tregjet e kapitaleve (Allen dhe Gale 2000) por një konsensus në këtë mes gjëndet, pikërisht në faktin se si njëri si tjetri kontribuojnë në rritjen e konomike, ndaj nuk duhen parë si zëvëndësues por si plotësues. Sipas Demirguç-

Kunt dhe Levine (2001) që të dy llojet luajnë një rol të rëndësishëm, ndonëse të ndryshëm, në kanalizimin e fondeve nga kursimtarët deri tek investitorët.

Megjithatë vlen për tu theksuar që në ekonomitë në zhvillim (rasti i Shqipërisë) është financimi nëpërmjet sistemit bankar që dominon. Por tregjet e kapitalit fillojnë e bëhen më të rëndësishëm se sa bankat në ekonomitë që fillojnë e "piqen". Edhe pse rëndësia relative e bankave ka rënë apo mund të bjerë, ato mbeten gjithsesi mjaft të rëndësishme, madje asnjë politikë nuk duhet të favorizojë njërin lloj financimi më shumë se tjetrin. Në fakt, sipas Barth, Caudill, Hall dhe Yago, (2000) tregohen evidenca që kostot e një krize bankare janë më të lartë në vëndet e orientuara drejt sistemit financiar bankar.

Pëe nga rëndësia e industrisë bankare, ajo është e mbikëqyrur dhe e rregulluar në çdo vend rreth globit, por ekzistojnë dallime të konsiderueshme në lidhje me aktivitetet në të cilat bankat janë të lejuara të angazhohen në vendet e ndryshme të globit. Mund të dallojmë në fakt vende në të cilat bankat janë të kufizuara në një gamë të ngushtë aktivitetesh, ndërkohë që në vende të tjera bankave u lejohet që të angazhohen në një spektër më të gjerë aktivitetesh. Nga fushëveprimi i aktiviteteve që ndërmerr një bankë, mund të indentifikojmë lloje të ndryshme "bankash" rreth globit. Mund ti referohemi diskutimit të Haubrich dhe Santos (2003) mbi evoluimin e përcaktimit ligjor të termit "bankë". Ekziston gjithashtu problemi i përcaktimit të "produktit bankar" që me zhvillimin e ofruesve të produkteve të shumtë financiar, ndodh që një objekt jo bankë ta ofrojë këtë të fundit duke ndërthurur apo lënë jashtë regullimin dhe mbiqyrjen në momentet e mospërfshirjes në sistemin bankar dhe mbikëqyrjes e rregullimit të tij. Kryesisht janë autoritetet rregullatore, të cilët jo vetëm që përcaktojnë shkallën e ndryshimit të aktiviteteve të bankave në vende të ndryshme por gjithashtu përcaktojnë edhe shkallën në të cilën ndryshojnë institucionet financiare jo-banka nga institucionet jo financiare brenda vendeve.

Sipas një studimi të kryer nga Barth, Caprio dhe Levine (2001) mbi 73 shtete, mund të vëzhgohet diferencimet e bëra në lejimet apo kufizimet e disa aktiviteteve bankare (imobiliare, sigurime apo letra me vlerë) në bazë të nivelit të të ardhurave në të cilën pozicionohet vendi në fjalë (vend me të ardhura të larta, mesatarisht të larta, mesatarisht të

ulta apo të ulta). Në të vërtetë, vetëm dy prej 73 vende i ndalojnë bankat të angazhohen në aktivitete të letrave me vlerë, ndërkohë që pak më shumë se një e treta e vendeve i ndalojnë ato nga të angazhohen në aktivitete të pasurive të patundshme. Nikaragua është i vetmi vend që ndalon bankat të angazhohen në të tre llojet e aktiviteteve, ndërkohë që Estonia, Gjermania, Zelanda e Re dhe Zvicra i japin bankave fuqi të pakufizuara për të tre këto aktivitete pra si në letrat me vlerë, siguracionet dhe pasuritë e patundshme. Kohët e fundit, disa vende janë bërë më liberale në dhënien e kompetenca më të gjera për bankat. Shkalla e kufizimeve në përzierjen e bankingut dhe tregtisë, ose në krijimin e konglomerateve financiare, gjithashtu tregon variacion të konsiderueshëm midis vendeve.

Dallimet midis vendeve në trajtimin rregullator të aktiviteteve të lejueshme për bankat dhe formimin e konglomerateve financiare janë të gjera, por të gjitha vendet ndajnë të njëjtin qëllim përfundimtar rregullator dhe mbikëqyrës, nxitjen e stabilitetit. Çështje e rëndësishme është në fakt gjetja e pikës optimale të përzierjes së aktiviteteve të lejueshme dhe shkallës së konkglomerateve financiarë në mënyrë që bankat në çdo vend të botës të arrijnë të përmbushin pikërisht këtë qëllim. Arsyet kryesore për kufizimin e aktiviteteve të lejuara të bankave dhe krijimin e konglomerateve financiare janë të ndryshme. Së pari institucionet e mëdha apo konglomeratët financiarë mund të bëhen aq të fuqishme politikisht apo ekonomikisht sa mund të kthehen në të pa menaxhueshëm apo të pa disiplinueshëm. Krijimi i konglomeratëve financiare mund të ulë konkurrencën e për pasojë edhe efiçencën e sektorit financiar. Mund të lindin konflikte interesash nëse bankave ju lejohet të angazhohen në grupe të ndryshmë aktivitetesh. Sa më i gjerë të bëhet spektri i aktiviteteve aq më shumë gjasa ka që këto të fundit të kryhen nëpërmjet konglomerateve financiare të cilët janë subjekt i vështirësive mbikëqyrëse. E së fundmi nëse bankave ju lejohet një spektër i gjerë aktivitetesh ato do të kenë tendencë të rrisin marrjen e rrezikun nëpërmjet shfrytëzimit të depozitave.

Mutacioni i shpejtë i aktivitetit bankar, tendenca drejt aktiviteteve më rrezikshme për fitime më të larta si dhe shkalla e ndërkombëtarizimit të vetë bankave e ndërlidhjeve të tyre ngrejnë si çështjë primare mbikëqyrjen dhe rregullimin e sistemit bankar. Në pjesën e dytë të kapitullit do të gjejmë një guidë të çështjeve në fjalë në mënyrë që të evidentojmë

pikërisht inkuadrimin rregullator e mbikëqyrës si dhe tentativën për një stabilitet e harmoni ekonomike.

2.1.3 Nevoja e autoriteteve mbikëqyrëse, problematikat strukturore

Krizat bankare, globalizimi dhe zhvillimi e transformimi i shpejtë i indrustrisë bankare e financiare ka shtyrë politikë-bërësit të fokusohen shumë në nevojën dhe rolin e rëndësishëm të mbikëqyrjes. Përmasat e marra nga sistemet bankare e financiare bëjnë që fokusi të mos jetë vetëm kombëtar por edhe ndërkombëtar. Pjesa më e madhe e diskutimit rreth konsolidimit të mbikëqyrjes të shërbimeve financiare fillon nga përmasat dhe kompleksiteti i kompanive që ofrojnë shërbimet financiare.

Në fakt siç e pamë në pikën e mëparshme konglomeratët financiare kanë marrë një ekspansion të konsiderueshëm, ata operojnë tashmë në industrinë bankare, të siguracioneve dhe natyrisht atë të letrave me vlerë, dhe përfaqësojnë në shumë vende korporata nga më të fuqishmet. Pikërisht kompleksiteti, diversiteti, përmasat dhe gjithashtu shumë i rëndësishëm ndërkombëtarizimi i tyre kërkojnë një vëmendje të lartë për tu mbikëqyrur e inkuadruar në mënyrë të atillë për të evituar apo minimizuar rreziqet e kolapseve "gjigandë". Në fakt, nën këtë optikë ekzistojnë debatë të shumtë në ekzistencën e një mbikëqyrësi apo të shumë mbikëqyrësve sidomos në industrinë bankare. Mund ti referohemi debatit të kryer nga Barth, Dopico, Nolle dhe Wilcox (2002) apo Barth, Nolle, Phumiwasana dhe Yago (2003) mbi avantazhet dhe disavantazhet e një mbikëqyrësi apo shumë mbikëqyrësve. Në fakt analiza kryhet në tre nivele, në kostot e autoritetit mbikëqyrës, kostot e pjesmarrësve të tregut dhe të sigurisë. Secili prej këtyre nivele formulon në fakt avantazhet dhe disavantazhet e një mbikëqyrësi të vetëm. Le te shtyrtojmë fillimisht arsyet për ekzistencën e një mbikëqyrësi të vetëm:

1- <u>Kostot për autoritetin mbikëqyrës</u>.

A) Ekonomitë e shkallës dhe efiçenca: Një autoritet i vetëm mbikëqyrës do të jetë me një përmasë të madhe, dhe për këtë arsye do të lejojë specializimin e punës dhe shfrytëzim më intensiv të inputeve. Madhësia më e madhe mund të lejojë përvetësimin

e teknologjive të informacionit që bëhen me kosto-efektive vetëm përtej një shkallë të caktuar të operacioneve. Përveç kësaj, nuk do të ketë dyfishim të infrastrukturave mbështetëse. Llewellyn (1999 dhe 2001), dhe Goodhart (2002) argumentojnë se ekonomitë e shkallës janë më të aplikueshme në vendet e vogla apo në ato vende me sisteme të vogla financiare, situate e cila na vjen për shtat.

B) Alokimi i Burimeve: Një autoritet mbikëqyrës i vetëm e i madh, do të jetë më mirë në gjendje për të tërhequr, të zhvilluar, dhe për të mbajtur ekspertizën profesionale të personelit, dhe të punësojë nën një politikë të vetme e koherente burimesh njerëzore, duke përfshirë planifikimin e karrierës, programet trajnuese, dhe ofrimin e më shumë mundësive dhe sfidave profesionale. Sipas Llewellyn (1999 dhe 2001), Abrams dhe Taylor (2000) mund të evidentojmë se mungesa e burimeve mbikëqyrës është një problem serioz në një numër vendesh, veçanërisht në ekonomitë emergjente.

C) *Diversifikimi i tregut:* Fakti që produktet financiare ndryshojnë me hapa të mëdhenj apo edhe vetë institucionet financiare diversifikojnë në një numër të lartë aktivitetesh financiare, të paturit e një mbikëqyrësi të vetëm qëndërzon liçensimet, apo nivelin e kontrollit në mënyrë të tillë për të mos patur rrjedhje informacioni. Gjithashtu i menaxhueshëm po prapë në ekonomi të vogla.

2- <u>Kostot për pjesmarrësit e tregjeve</u>

A) Transparenca dhe barra rregullative: Një sistem me një autoritet mbikëqyrës të vetëm është i thjeshtë, pa vështirësi kuptimi apo burokraci të tepërta. Është më e volitshme për pjesmarrësit e tregut, konsomatorët dhe vetë bankat, të dinë që për çdo gjë të mund të drejtohen vetëm kundrejt një instituconi, pra një mbikëqyrës i vetëm siguron një pikë të vetme kontakti për institucionet e mbikëqyrura.

3- <u>Siguria dhe harmonia</u>

A) *Zgjidhja e konflikteve:* Një mbikëqyrës i vetëm mund të jetë më mirë në gjendje për të zgjidhur konfliktet që dalin mes qëllimeve të ndryshme rregullatore për shkak të "fërkimeve" që mund të rezultojnë nga zbatimi i rezolutave.

B) *Përgjegjshmëria:* Një mbikëqyrës i vetëm mund të jetë më transparent dhe i përgjegjshëm dhe e ka më të vështirë të ashkalojë një gabim.

C) *Mbikëqyrje e konsoliduar*: Sipas Goodhart (2002) një agjenci e vetme mund të shmangë mangësitë që mund të lindin me një regjim të bazuar mbi disa agjensi. Në fakt, nën një regjim rregullator të shumëfishtë, me ekspansionin e organizatave bankare që rriten dhe bëhen më komplekse, ata mund të përfshijnë institucione të anëtarësuara që janë mbikëqyrur nga autoritete të ndryshme, asnjëra prej të cilëve nuk ka përgjegjësi për mbikëqyrjen e konsoliduar të organizatës bankare në tërësi.

D) *Fleksibiliteti Rregullator*: Një mbikëqyrës i vetëm mund të ketë më shumë fleksibilitet për t'iu përgjigjur ndryshimeve në peisazhin financiar se sa do të ishte rasti për agjensitë e veçanta, secila prej të cilave ka pengesa burokratike, politike dhe ligjore për të kapërcyer, Abrams dhe Taylor (2000).

E) *Ndërkombëtarizimi*: Një autoritet i vetëm mbikëqyrës mund të ndihmojë në bashkëpunimin ndërkombëtar mbikëqyrës, sepse mbikëqyrësit e huaj do të ketë një pikë të vetme kontakti, Abrams dhe Taylor (2000).

Përsa i përket disavantazhit të një sistemi me një mbikëqyrës mund të radhisim për secilin nivel arsyet e mëposhtme :

1- <u>Kosto e autoriteteve mbikëqyrëse :</u> Rreziku i burokratizimit kompleks, ku do mund të themi që do të transformohej në një "disekonomi" të shkallës

2- <u>Kosto e pjesmarrësve të tregjeve :</u> Një mbikëqyrës i vetëm mund të bëhet shumë i fuqishëm në limitet e të terpuarit. Nga ana tjetër me disa mbikëqyrës mund të rritet konkurrueshmëria midis tyre e cila mud të shtyjë në inovacion si nga ana e rregullatoreve edhe nga ana e produkteve financiare të ofruara.

3- <u>Siguria dhe harmonia :</u> Autoritetet e shumtë mbikëqyrës mund të adoptojnë qasje disi të ndryshme për mbikëqyrjen, të cilat mund të japin informacion të vlefshëm që nuk do të ishte gjeneruar nga një qasje e mbikëqyrësit të vetëm.

Nën frymën e debateve mbi autoritete mbikëqyrëse nuk kemi vetëm aksin e sasisë së autoriteteve por gjithashtu targetit të tyre. A duhet të fokusohet mbikëqyrja vetëm mbi

bankar apo të përfshijë edhe institucionet e tjera financiare? Në fakt është shfaqur një trend gjatë dy dekadave të fundit kundrejt konsolidimit apo "integrimit" të mbikëqyrjes së shërbimeve bankare dhe shërbimeve të tjera financiare nën një autoritet të vetëm mbikëqyrës. Sipas punimeve të Masciandro (2004 dhe 2006) adoptimi i një strukture të integruar mbikëqyrjeje ka gjasa të zhvillohet si trend.

Politikëbërësit kanë ngritur pikërisht çështjen nëse duhet të këtë një entitet (autoriteteti mbikëqyrës) të vetëm për mbikëqyrjen e instituconeve banka e jo banka apo jo. Debati mbi fushëveprimin e përgjegjësive të mbikëqyrësit vjen nga dallimet mes llojeve të ndryshme të aktiviteteve financiare, nga kompleksiteti në rritje dhe madhësia e firmave të shërbimeve financiare, si dhe nga globalizimit i shërbimeve financiare. Në përgjithësi, debati ka qenë i hedhur mbi faktin nëse është apo nuk është mirë që të ketë një mbikëqyrës të vetëm, të ashtuquajtur të "konsoliduar" ose "unifikuar" i cili të mbulojë të gjitha shërbimet financiare, thënë ndryshe diskutimi fokusohet mbi bankat, tregjet e letrave me vlerë, dhe mbi kompanitë e sigurimeve. Në punimin e Abrams dhe Taylor (2000) diskutimi përfshin ekzistencën e një mbikëqyrësi të "unifikuar" që shtrin përgjegjësinë e tij në mbikëqyrjen e fondeve të pensionit, imobiliaret, dhe kompanitë e leasing-ut. Ata gjithashtu theksojnë se rasti për konsolidimin e mbikëqyrjes së bankave dhe firmave të letrave me vlerë mund të jetë më e fortë se sa përfshirja gjithashtu e kompanive të sigurimit. Kjo është për shkak të faktit se për tregjet bankare dhe të letrave me vlerë rreziqet tentojnë të dalin në anën e aktivit të bilancit, ndërsa për kompanitë e sigurimit rreziqet kryesore financiare ndodhen në anën e detyrimeve të bilancit.

Ashtu si në rastin e strukturës së mbikëqyrjes bankare, literatura në fushëveprimin e mbikëqyrjes ka qenë kryesisht konceptuale. Megjithatë, një përmbledhje e asaj literature ndihmon në identifikimin e dy argumente "pro" dhe "kundër" konsolidimit nën mbikëqyrjen e një autoriteti të vetëm mbikëqyrës për të gjithë produktet apo shërbimet financiare. Një numër i këtyre argumenteve mbulojnë terrenin e njëjtë konceptual të përshkruar më lartë për debatin pro-kundër mbikëqyrësit të vetëm, dhe në të vërtetë fokusi kryesor i disa prej studimeve të cituar aty është në çështjen nëse duhet të ketë një autoriteti mbikëqyrës të vetëm, jo vetëm për sektorin bankar, por për të gjitha produktet apo

shërbimet financiare. Pjesa më e madhe e diskutimit rreth konsolidimit të mbikëqyrjes së shërbimeve financiare e ka gjenezën nga rritja e kompleksitetit të shërbimeve financiare e konglomerateve financiare që operojnë në industrinë bankare, atë të letrave me vlerë, dhe të sigurimit. Për të mbikëqyrur subjektet e tilla në mënyrë efektive, duke siguruar që menaxhimi i rrezikut nga konglomeratet e tillë nuk është as i fragmentuar, as i pakoordinuar, apo as i paplotë, është parë e arsyeshme që të ekzistojë më mirë një autoritet i vetëm mbikëqyrës me një fushëveprim të gjerë, Abrams dhe Taylor (2000).

Kjo e fundit do të mundësonte pikë së pari kursime të konsiderueshme si për qeverinë si për pjesmarrësit e tregut, ky autoritet mbikëqyrës i vetëm me fushëveprim më të gjerë mund të jetë pra në gjendje të realizojë ekonomi të shkallës në shfrytëzimin e burimeve dhe të personelit. (Llewellyn, 1999). Ky argument mund të jetë veçanërisht i rëndësishëm për ekonomitë e vogla në zhvillim në të cilët agjensitë mbikëqyrëse të veçanta nuk mund të realizojnë ekonomitë e shkallës, Abrams dhe Taylor (2000).

Ky lloj autoriteti mbikëqyrës mund të përfaqësojnë një reduktim të barrës rregullative gjtihashtu. Arsyeja finale për përkrahjen e një aturotiteti mbikëqyrës së vetëm por më fushëveprim të gjerë janë pikërisht rreziqet sistemike. Sipas një studimi të Fondit Monetar Ndërkombëtar (International Monetary Fund (2001)), ndërthurja në rritje mes tregjeve financiare rrit shanset që një krizë sistemike mund të lind jashtë industrisë bankare, dhe shumë shpejt të ndikojë drejtpërdrejt në të. Një autoritet mbikëqyrës me fushëveprimin e gjerë mund të jetë më mirë i pozicionuar për t'iu përgjigjur përhapjes fillestare nëpër shërbimet financiare dhe është në gjëndje më të shpejtë dhe fleksibile për t'iu përgjigjur problemeve të reja financiare se sa rasti ku do të duhej koordinimi midis agjensive mbikëqyrëse të veçanta.

Ndërkohë që argumenti kryesor kundër një mbikëqyrësi të vetëm me fushëveprim të gjërë është rreziku i fuqizimit shumë të madh të këtij mbikëqyrësi të vetëm. Mund të përmendim gjithashtu që krijimi i një entiteti të tillë "gjigand" e shumë përfshirës mund gjithashtu të rrisë shkallët e hallkat e burokracisë. Gjithashtu, fakti që shumë vende kanë mbikëqyrës të

ndarë sipas produkteve/shërbimeve financiare vlen për tu përmendur kujdesi i lartë që duhet treguar për të mos anashkalaur apo keq menaxhuar ndonjërin prej sektorëve.

Mbetet gjithashtu për tu përcaktuar nëse do ti caktohen përgjegjësitë për mbikëqyrjen bankare Bankës Qëndrore. Si me çështjen e mbikëqyrësve të vetëm ose të shumëfishtë, literatura konceptuale është e ndarë në avantazhet relative dhe disavantazhet e bankës qëndrore si supervizore e aktivitetit bankar. Ndoshta argumenti më i fuqishëm theksuar në favor të caktimit të përgjegjësisë mbikëqyrëse kundrejt bankës qëndrore është sasia e cilësia e informacionit të dorës së parë për gjendjen dhe performancën e bankave. Kjo mund të ndihmojë bakën qëndrore të identifikojë dhe të përgjigjet për lindjen e një problemi sistemtik në kohën e duhur. Kundër argumeti qëndron në konfliktin e mundshëm të intersit midis të qënit mbikëqyrës dhe përpilues të politikës monetare. Ky konflikti mund të bëhet veçanërisht problematik në raste të një rënieje ekonomike ku banka qëndrore mund të joshet për te ndjekur nje politikë monetare laksiste për të shmangur efektet negative mbi fitimet e bankave dhe cilësisë së kredisë, apo për të nxitur bankat në kredi-dhënie për të kompesuar kështu politikën monetare ekspansioniste. Ndërkohë nga një studim i kryer mbi po të njëjtat 73 vendet nga Barth, Caprio dhe Levine (2001), mbi 60% e tyre ja kanë deleguar mbikëqyrjen pikërisht bankës qëndrore. Për një pasqyrë më të qartë të mbikëqyrjes do të mund të spostohemi në pjesën e dytë të kapitullit të parë, në brendi të të cilit do të mund të gjeni nformacion me në detaj mbi mbikëqyrjen e bankave.

2.2 Arkitektura E Mbikëqyrjes Financiare: Unifikimi Dhe Përfshirja E Bankës Qëndrore

Politikëbërësit sot në të gjitha vendet, të tronditur nga kriza financiare 2007-2008, kanë rikonsideruar me kujdes të madh tiparet e arkitekturës së tyre mbikëqyrëse. Gjatë dekadës së fundit arkitektura e mbikëqyrjes financiare dhe roli i bankës qëndrore në mbikëqyrjen nuk ka pësuar transformime radikale, por pas krizës shumë vende kanë rikonsideruar reformat. Më poshtë do të paraqiten një rishikim i leteraturës mbi arkitekturën si dhe

tiparet kryesore të arkitekturës mbikëqyrëse të unifikuar dhe efektet e mundshme të ndryshimeve në arkitekturën mbikëqyrëse.

Për të arritur në një panoramë më të qartë globale për situatën e mbikëqyrjes do të konsiderohet një dataset i përbërë nga një kampion heterogjen prej 102 vendesh, që i përkasin të gjitha kontinenteve, bazuar në një studim të Masciandro (2006 dhe 2008). Në Shtojcën 1 mund të gjeni Tabelën 1, në të cilën përshkruhen të gjitha karakteristikat e regjimeve mbikëqyrëse në këtë kampion. Si analizë e kësaj të fundit mund të vëzhgojmë një ndarje në një apo tre autoritete mbikëqyrëse, ku vendet me vetëm një autoritet mbikëqyrës mbizotërojnë në nivelin 70% ndërkohë që vendet me tre autoritete mbikëqyrëse, pra nga një për secilin treg (tregu bankar, tregu i letrave me vlerë dhe tregu i sigurimeve), janë vetëm në nivelin 18%. Si mund të shpjegohet prirja e konsolidimit të mbikëqyrjes jashtë bankave qëndrore? Përgjigja e parë e natyrshme është ndjekja e një analize klasike kosto-përfitim, duke bërë krahasime midis modeleve alternative nga pikëpamja e mirëqënies sociale, duke llogaritur për secilën prej tyre, nga njëra anë përfitimet e pritshme dhe, në anën tjetër e rreziqeve të pritshme. Nga studimi në fjalë mund të përmblidhet gjithashtu që duke filluar nga viti 1998, 64% e vendeve të përfshira në kampion kanë zgjedhur të reformojnë strukturën e tyre të mbikëqyrjes. Kjo e fundit duke krijuar një autoritet të ri mbikëqyrës dhe / ose ndryshimin e kompetencave të të paktën njërës prej agjensive ekzistuese (shih grafikun 1.3).



Grafiku 2.1 Numri i reformave në sistemin mbikëqyrës brenda një dekade

Trendi i reformave është edhe më i qartë kur shtojmë një perspektivë rajonale të vendit dhe të ardhurat. Nëse bazohemi mbi këto kritere mund të vëzgjojmë një ndarje me grupe në vende evropiane, BE-ja dhe vendet e OECD-së dhe përkatësisht 82%, 77% dhe 73% të tyre që kanë ndërmarrë reforma. Prandaj, forma e regjimit mbikëqyrës duket të jetë një çështje e rëndësishme në veçanti në vendet më të përparuara, dhe veçanërisht në Evropë. Ka shenja se në vendet e përparuara do të vazhdojnë valën e reformave (shih grafikun 1.4).



Grafiku 2.2 Reformimi i arkitekturës mbikëqyrëse përgjatë viteve 1998-2008, në përqindje

Të metat e arkitekturës mbikëqyrëse ishin të dukshme edhe para krizës financiare 2007-08 por kriza tregoi qartë dështimin dhe vjetërimit e argumentit për konkurrencë rregullatore, i cili shpesh përdoret si arsyetim për të justifikuar strukturën mbikëqyrëse të SHBA Për të kuptar më mirë mënyrën e formimit të arkitekturës mbikëqyrëse është e rëndësishmë të vëzhgohen tre këndvështrime, ai i ekonomisë, i ekonomisë politike dhe i ekonometrisë. Në vazhdim do mund të gjeni një pasqyrë të tillë.

2.2.1 Aspekti i ekonomisë politike

Nëse mirqënia sociale nuk është "ndjellësi" i reformimit të mbiqyrjes banakare, është e nevojshme të shqyrtohen aspekte të tjera alternative. Një bazë e gjerë e literaturës e ka trajtuar çështjen duke u fokusuar kështu në rolin e aktorëve politikë në hartimin e arkitekturave mbikëqyrëse, Masciandaro (2004 dhe 2006). Kjo letërsi vlerëson se të gjithë politikëbërësit janë politikanë. Për këtë arsye, ata vihen përpara përgjegjesisë në zgjedhjet elektorale për mënyrën se si ata i kanë kënaqur votuesit. Ekzistojnë dy lloje politikanësh të cilët mund të prodhojnë kështu rezultate totalisht të ndryshme në përcaktimin e mbikëqyrjes financiare. Nga njëra anë, kemi politikanët e tipit "ndihmues", të cilët promovojnë përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme. Nga ana tjetër, kemi politikanët e tipit " zhvatës", të cilët janë të motivuar në kënaqjen e interesave vetjake. Nëse marrim parasysh ekzistencën e dy zonave me preferenca të ndryshme, së pari qytetarët dhe së dyti industrinë financiare, mund të analizon sjelljet e këtyre dy politikëbërësve.

Nëse hartuesi i politikave vepron si një lloj "ndihmuesi", përfshirja e bankës qëndrore në mbikëqyrje mund të shikohet si një pengesë në konsolidimin e mbikëqyrjes, nëse të paktën një nga tre efektet teorike qëndrojnë, efekti i rrezikut moral, efekti i konfliktit të interesit dhe efekti i burokracisë. I ashtuquajturi efekt i fragmentimit të bankës qëndrore ka shumë gjasa të ndodhë. Nëse hartuesi i politikave zgjedh përkrahjen e industrisë financiarë dhe vepron si një lloj " zhvatësi", efekti i fragmentimit të bankës qëndrore ka më pak gjasa të ndodhë, me kusht që komuniteti financiar të pëlqeje një mbikëqyrje më të konsoliduar, dhe përfshirja e bankës qëndrore është një përfaqësim i fuqisë elektorale financiare. Në qoftë se këto supozime qëndrojnë është e mundur të veçojmë efektin e llojeve të ndryshme të politikë-bërësve mbi marrëdhënien e konsolodimit të mbikëqyrjes financiare dhe përfshirjen e bankës qëndrore në të.

Qasja e ekonomisë politike për të studiuar përcaktuesit e arkitekturave mbikëqyrëse është bazuar në tre hipoteza vendimtare. Së pari, fitimet dhe humbjet e një modeli mbikëqyrës janë variabla të llogaritura nga hartuesit e politikave që janë në detyrë, të cilët vendosin për

të ruajtur ose reformuar regjimin mbikëqyrës. Së dyti, vendimet e politikëbërësve, cilado qofshin qëllimet e tyre, ka të ngjarë të ndikohen nga variablat strukturore, që mund të ndryshojnë nga vendi në vend. Së fundmi, agjentët ekonomikë nuk kanë informacion mbi preferencat e vërteta të politikëbërësve, duke bërë që shkalla optimale e përqendrimit të mbikëqyrjes financiare të jetë një variabël i fshehur.

Në fakt një element thelbësor në konsiderimin e objektivit të hartuesit e politikave si një faktor në hartimin e arkitekturës mbikëqyrëse, është identifikimi i preferencave të këtij të fundit. Sipas Westrup (2007), për të bërë identifikimin e funksionit të politikëbërësit fillimisht kemi qasjen narrative, nëpërmjet së cilës interpretohen dokumentat zyrtare dhe deklaratat për të vlerësuar zgjedhjet e politikëbërësve. Një pengesë e kësaj qasjeje është se shpesh ekziston hapësirë diskutimi e konsiderueshme mes deklarimeve të një politikëbërësi dhe preferencave aktuale të tij. Kemi gjithashtu një mënyrë të dytë për të identifikuar prferencat e politikëbërësit, qasjen faktike, nëpërmjet së cilës marrim në konsideratë zgjedhjen aktuale të politikëbërësit dhe në mënyrë të tillë për të arritur në përcaktimin e nivelit të përqendrimit të mbikëqyrjes financiare. Në çdo hap, ne mund të vëzhgojmë e analizojmë me kujdes vendimimet e hartuesit të politikave për të ruajtur ose reformuar arkitekturën e mbikëqyrjes financiare. Me fjalë të tjera, ne konsiderojmë se politikëbërësit janë të ballafaquar me zgjedhje diskrete. Duke përdorur metodën faktike, ne mund të hetojmë nëse karakteristikat e tregjeve financiare luajnë ndonjë rol në përcaktimin e formës aktuale të arkitekturës mbikëqyrëse.

Prandaj, teoria parashikon mundësinë e shkallës së ndryshme të konsolodimit në hartimin e strukturës mbikëqyrëse, në varësi të llojit të hartuesit të politikave, dhe mbi tiparet e parametrave të modelit, të tipit variabla mjedisore, variable strukturore etj. Por në realitetit, siç u statua më lartë lloji i hartuesit të politikave bashkë me të gjitha kanalet strukturore dhe institucionale që ndikojnë sjelljen e tij paraqesin një variabël të fshehur.

2.2.2 Aspekti ekonomik

Së pari vlen për tu trajtuar përfshirja e bankës qëndrore në mbikëqyrjen financiare, për të cilën literatura ofron argumente pro dhe kundër. Argumenti kryesor në favor të përfshirjes së bankës qëndrore në mbikëqyrje lidhet me efektin pozitiv që rrjedh nga fitimet e informacionit. Duke pasur kompetenca mbikëqyrëse kjo e ndihmon bankën qëndrore në bërjen e politikës monetare më efektive dhe / ose për të bërë më të efektsëm menaxhimin e krizave. Një argument shtesë është i lidhur me kapacitetin e bankës qëndrore në tërheqjen e personelit më të kualifikuar (Abrams dhe Taylor 2000).

Nga ana tjetër një përfshirje më e thellë e bankës qëndrore në mbikëqyrje mund të jetë "e kushtueshme" për arsye të ndryshme. Sipas Llewellyn (2006) dhe Masciandaro (2006) para së gjithash, çdo zgjatje e fuqive të bankës qëndrore në fushën e mbikëqyrjes mund të rrisë rrezikun klasik moral (efekti "moral hazard"). Së dyti, shumë banka qëndrore që janë përfshirë në mbikëqyrjen e madhe gjenerojnë konflikte midis qëllimeve të ndryshme, (efekti i konfliktit të interesave). Së treti, rreziku i humbjes së reputacionit mund të rritet në qoftë se banka qëndrore është thellësisht e përfshirë në mbikëqyrje, ndërsa përfitimet e reputacionit kanë më pak mundësi të ndodhin, duke patur parasysh natyrën e politikave të mbikëqyrjes, ku dështimet janë më të dukshme se sukseset (efekti reputacionit). Së fundi, shoqëria duhet të marrë parasysh rreziqet e rritjes së kompetencave burokratike të bankës qëndrore (efekti burokratik).

Nuk duhet lënë pa trajtur gjithashtu një çështje e dytë po aq e rëndësishme në optikën e dizajnit të arkitekturës, unifikimi i saj. Në përgjithësi, argumentet e ndryshme për konsolidimin e mbikëqyrjes mund të lidhen me efektivitetin dhe efikasitetin. Arsyet kryesore për të pasur një mbikëqyrje të unifikuar mund të klasifikohen në tre kategori,

respektivisht në lidhje me qeverisjen, marrëdhëniet me sistemin politik dhe marrëdhëniet me pjesëmarrësit e tregut [1]:

2.2.3 Aspekti i vëzhgimeve ekonometrike

Se fundmi, kalojmë në aspektin e tretë në trajtimin e hartimit të arkitekturës mbikëqyrëse, pra në aspektin ekonometrik. Natyrisht më duhej marrë parasysh ky aspekt, dhe që duhej tentuar të ngrihej një strukturëë tille, e cila nëpërmjet analizës empirike të mund të na ofrojë orientime të rëndësishme mbi çështjen e konsolidimit dhe të bankës qëndrore.Në literaturën e Masciandaro (2004, dhe 2006), Masciandaro dhe Quintyn (2008) është hetuar në mënyrë empirike fuqia e marrëdhënieve ndërmjet shkallës së unifikimit të mbikëqyrjes financiare dhe përfshirjes së bankës qëndrore, duke përdorur variabla institucionale siç janë indeksi FSU (Financial Supervision Unification) dhe indeksi CBFA (Central Bank as Financial Supervisor). Kjo analizë është bazuar në një kampionim prej 102 vendesh dhe rezultatet e tij shërbejnë si një patern në orientimin e arkitekturës së mbikëqyrjes. Rezultati kryesor që del nga puna empirike është konfirmimi i një marrëdhënie të rëndësishëm të zhdrejtë mes unifikimit të mbikëqyrjes dhe përfshirjes së bankës qëndrore. Efekti i fragmentimit të bankës qëndrore dominon krahas efektit të unifikimit/konsolidimit të saj. Çdo politikëbërës, në përcaktimin e shkallës së unifikimit të mbikëqyrjes, mund të ndikohet nga përfshirja e bankës qëndrore, por nën kushte të ndryshme. Nëse hartuesi i politikave është i një lloji "ndihmues", ai duhet të kujdeset në lidhje me efektivitetin e mbikëqyrjes, në mënyrë që të kenaqë qytetarët. Pra nëse hartuesi i politikave e sheh konsolidimin mbikëqyrjes si një përmirësim të mirëqenies, atëherë përfshirja e bankës qëndrore mund të shikohet si një pengesë, por vetëm në qoftë se të paktën një nga tre rreziqet qëndrojnë (moral, konfikt interesi, burokratik). Nëse hartuesi i politikave është i një lloji "zhvatës", ai dëshiron të kënaqur elektoratin financiar. Në këtë rast efekt

[1]Ky arsyetim është trajtuar edhe më parë në seksionin 1.1.3, nga këndvështrimi i unifikimit të autoriteteve mbikqyrëse nën diversitetin ndërkombëtar, analizuar nën kosto për autoritetet, kosto për pjesmarrësit e tregut si dhe siguria dhe harmonia e tregut.

fragmentimii të bankës qëndrore qëndron nëse dhe vetëm nëse, elektorati financiar nuk pëlqen mbikëqyrjen e konsoliduar dhe banka qëndrore është një agjensi "e zënë rob".

Përveç përfshirjes në mbikëqyrje, janë përdorur përfaqësime të ndryshme të pushtetit të bankës qëndrore, si për shembull mosha e saj (sa më e vjetër të jetë banka qëndrore aq më të lartë e ka ndikimin), si dhe pavarësinë e bankës qëndrore (efektet e treguesve të tjerë të rolit të bankës rezultojnë të mos jenë statistikisht të rëndësishëm). Janë testuar variabla të tjera gjithashtu si cilësia e qeverisjes së sektorit publik dhe madhësia e vendit të cilat duket të kenë rëndësi në procesin e vendimmarrjes në shkallën e unifikimit të mbikëqyrjes. Përsa i përket rolit të qeverisjes politike në procesin e vendimmarrjes, supozohet se të tillë vende karakterizohen nga një lloj "ndihmues" i hartuesit të politikave, gjë e cila do të nxisë unifikimin e mbikëqyrjes, me qëllim përmirësimin e mirëqenies. Përfshirja e popullsisë si një faktor ekzogjen shkalle jep një parametër të rëndësishëm të vlerësuar, duke theksuar efektin e ashtuquajtur të "shtetit të vogël " Taylor dhe Fleming (1999), ku çfarëdo lloj hartuesi të politikave të kemi, jemi në rastin e individëve me relativisht shumë pak ekspertizë në mbikëqyrje financiare dhe unifikimi ka shumë gjasa të ndodhë.

Thuajse të gjithë studimet e kryer së fundmi mbi analizën e zhvillimit të kohëve të fundit në arkitekturën e mbikëqyrjes theksojnë rëndësinë e karakteristikave të tregjeve financiare. Në fakt, theks të veçantë i vihet rolit të konglomerateve financiare, si përcaktues në zgjedhjen për një unifikim total ose të pjesshëm të regjimit mbikëqyrës. Rezultatet e një sondazhi në nivelin e CEO-ve financiarë në Itali (Masciandaro dhe Quintyn 2008) konfirmojnë një preferencë të tregut për një regjim më të unifikuar të mbikëqyrjes, por nxjerrin në pah vetëm një qëndrueshmëri të dobët midis pikëpamjeve të politikëbërësve dhe ato të operatorëve të tregut.
Është testuar gjithashtu prania e mundshme e një lloj " efekt imitues " mes vendeve fqinje, ku deri diku mund të vëzhgojmë ngjashmëritë në baze të grupimeve sipas vendeve europiane, vendeve të BE-së dhe vendeve të OECD-së, të cilat mund të ndikojnë sjelljen e tyre kombëtare. Është vëzhguar gjithashtu që reformat në strukturat mbikëqyrëse kanë qenë në rritje vit pas viti, dhe ekziston në fakt edhe mundësia e një lloj efekti të modës.

Është hetuar gjithashtu efekti i mundshëm i origjinës ligjore. Literatura e ligjit dhe financave pohon se origjina ligjore është e lidhur me një shumëllojshmëri të aspekteve të performancës së politikëbërësve. Vendet folëse të gjuhës angleze, të orientuara nga tregu (market friendly) kanë një performancë ligjore më të mirë se vendet me sisteme ligjore të rrënjosura në tradita si sitemet gjermane, franceze, skandinave apo të traditave të tjera si socialiste apo myslymane. Sipas këtyre burimeve, traditat e ligjit "miqësor me tregun" ofrojnë një mbrojtje më të mirë kundër politikës së keqe publike dhe nxisin në sigurimin e të mirave publike, në fakt edhe hartuesit e politikave ka më shumë gjasa të jenë të llojit "ndihmues", të cilët e kanë më shumë për zemër mirëqënien e përgjithshme. Së fundi, dukuria e krizave financiare si një arsye për reformuar rmbikëqyrjen është për tu konsideruar në mënyrë të rëndësishme, Carmichael (2002).

Literatura që shtjellon çështjen e arkitekturës së mbikëqyrjes financiare hedh dritë mbi ndikimin e strukturës mbikëqyrës mbi performancën e sistemit bankar dhe të industrisë financiare. Dy pyetje lindin : "Eshtë një mbikëqyrësi i vetëm më i preferuar në krahasim me mbikëqyrësit e shumtë?" dhe "A duhet të përfshihet në mbikëqyrje banka qëndrore?". Analiza empirikee Barth, Nolle, Phumiwasana dhe Yago (2002) ofron një krahasim midis vendeve mbi arkitekturat e tyre të mbikëqyrjes bankare, duke përdorur testimin me diferenca mesatresh, konstaton nëse dallimet në arkitekturën mbikëqyrës lidhen në mënyrë të konsiderueshme me dallimet në strukturën e industrinë bankare[2].

Sipas këtij të fundit mund të shftrytëzojmë rezultatin mbi një lidhje reciproke në mes të numrit të autoriteteve mbikëqyrëse dhe tipareve kryesore të një sistemi bankar. Nga ana tjetër, përfshirja e bankës qëndrore në mbikëqyrje ka rëndësi. Në fakt vendet ku banka qëndrore është mbikëqyrësi i vetëm bankar kanë sisteme bankare me një madhësi mesatare ose të vogël. Lidhur me kushtet e hyrjes, një numër i madh i aplikimeve për të ngritur një bankë të re ishin mohuar dhe vëzhgohet një përqindje e ulët e bankave me pronësi të huaj.

[2]Studimi në fjalë përmbledh informacion mbi mbikqyrës kombëtarë bankar në 133 vende, për vitet 1996-1999.

Autorët arritën në përfundimin se çështja kundrejt autoriteteve të shumta mbikëqyrëse ishte më pak urgjente sesa çështja e kompetencave të bankës qëndrore në mbikëqyrje.

Në një analizë të mëvonshme Čihák dhe Podpiera(2007) kanë sugjeruar që regjimi i unifikuar është i lidhur me cilësinë e lartë dhe konsistencën e mbikëqyrjes nëpër institucionet e mbikëqyrura, ku cilësia e mbikëqyrjes matet duke përdorur shkallën e pajtueshmërisë me standardet e pranuara ndërkombëtarisht në rreglloret bankare, të sigurimeve dhe të sigurisë. Në të njëjtën kohë regjimi i unifikuar nuk është i lidhur me një reduktim të ndjeshëm në personelin mbikëqyrës. Së fundmi, nëse mbikëqyrja e unfikuar është e vendosur brenda ose jashtë bankës qëndrore nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në cilësinë e mbikëqyrjes.

Nga një hulumtimi i Arnone dhe Gambini (2007), shkalla e pajtueshmërisë me Parimet Themelore të Bazel për Mbikëqyrjen Bankare Efektive (Bazel Core Principles for Effective Banking Supervision, BCP) është përdorur për të hetuar lidhjen e mundshme midis kapacitetit të përputhshmërisë së çdo vendi dhe mënyrës se si këto vende e kanë të organizuar arkitekturën e tyre mbikëqyrës[3]. Analiza përshkruese lë të kuptohet se ndodhemi në favor të integrimit të kompetencave mbikëqyrëse. Kur merren parasysh dy modele më të përhapura të arkitekturës mbikëqyrëse, autorët gjejnë një korrelacion të fort pozitiv mes regjimeve të integruara mbikëqyrëse jashtë bankës qëndrore dhe pajtueshmërisë me BCP, në krahasim me regjimet e dominuar nga banka qëndrore me agjensi të shumta mbikëqyrëse. Për më tepër dy teste ekonometrike, bazuar në një specifikim OLS me gabime standarde robuste heteroskedastike, tregojnë një shkallë të lartë të pajtueshmërisë nga ato vende që aplikojnë një model të unifikuar, me disa dëshmi në të bërin kështu në brendësi të bankës qëndrore.

Të gjithë këto analiza ekonometrike dhe sidomos vëzhgimet e arritura prej tyre ndihmojnë studiuesin ta shohë përpilimin e arkitekturës në një spektër më të gjerë së vetë ekonomia apo politika, por të bazohet në efektshmërinë dhe incidencat reale të vrojtura, për arritjen e

[3]Artikulli në fjalë ofron një përshkrim të organizimit institucional të mbikqyrjes bankare për një kampion prej 116 vendeve për vitet 1999-2004.

një arkitekturë optimale në bazë të variablave shtetërore, mjedisore, ekonomike, rajonale etj.

2.3 Sistemi Rregullator Dhe Mbikëqyrës I Bankave

2.3.1 Shteti, tregu, qeverisja e korporatave dhe mbikëqyrja

Marrja e rrezikut është një pjesë thelbësore e sistemit financiar që ndihmon rritjen ekonomike e të gjithë globit. Por kjo marrje e rrezikut duhet të bëhet në kontekstin e një mirë menaxhimi të rrezikut. Kompanitë/bankat duhet të menaxhojnë me kujdes rreziqet e tyre, dhe për të asistuar në këtë pjesë lind nevoja e mbikëqyrësit financiar, i cili duhet të menaxhojë me kujdes rreziqet që vijnë nga vetë sistemi financiar. Pasoja direkte e menaxhimit të pamjaftueshëm të rrezikut mund të jetë një krizë financiare që përhapet shumë shpejt në ekonominë reale. Pra autoritetet mbikëqyrëse kërkojnë të zbululojnë dhe të vlerësojnë aktivitetet dhe praktikat që ekspozojnë bankat dhe institucionet e tjera financiare kundrjet një rreziku të lartë, rrezik i cili prek nivelin e tyre të kapitalit, duke ju kërkuar këtyre të fundit të menaxhojnë në mënyrë sa më të përshtatshme ekspozimet ndaj rreziqeve të ndryshme.

Për të matur efikasitetin e mbikëqyrjes në vetvete apo të autoriteteve mbikëqyrëse ka disa dimensione kryesore të cilat përfshijnë: fuqinë e zbatimit, shkallën e dhënies së informacionit, dhe pavarësinë e autoriteteve mbikëqyrëse. Thënë ndryshe vetë shteti apo qeveria e një vendi ka në interesin e saj të plotë, për të realizuar një mbikëqyrje korrekte dhe cilësore, të ndërtojë autoritete të pavarura, imponuese të ligjit (autoriteti mbikëqyrës ka nevojë për një fuqi vendimarrjeje e sanksionuese) dhe natyrisht transparente e informuese. Secili dimension përbën një aks mbi të cilin çdo vend duhet të investojë në mënyrë për të formësuar një autoritet mbikëqyrës të mirëfilltë duke tërhequr nga vetja mundësitë e stabilitetit dhe shëndetit të sistemit bankar.

Sipas studimeve të Davis dhe Obasi (2009) mbikëqyrja bankare është një aspekt i qënësishëm i zhvillimeve të sistemit financiar, i cili kërkon të monitorojë bankat rrezik-marresë në mënyrë që të mbrojë depozitorët, sigurinë e qeverisë si dhe vetë ekonominë nga

pasojat drastike të një krize financiare potenciale në rast dështimi të bankave. Pikërisht nga rëndësia e rolit të një mbikëqyrësi në sistemin bankar autorët kanë ngritur një model me të dhëna në panel për të kryer matjen e efektivitetit të mbikëqyrjes nëpërmjet relacionit midis disa indikatorësh reziku nga ana e bankave dhe nga ana tjetër qasjeve mbikëqyrëse të ndryshme të përdorura nëpër vende të ndryshme. Madje, dimensioneve të përmendura më parë i shtohen gjtihashtu edhe struktura, personeli dhe praktikat e ndjekura, ku të gjithë së bashku kanë influenca të konsiderueshme mbi mënyrën se si operonë bankat dhe mbi "shëndetin" e tyre.

Një faktor gjithashtu shumë i rëndësishme për sitemin bankar është influenca potenciale e pronësisë së bakave mbi efektivitetin e mbikëqyrjes. Në fakt, shkalla e pronësisë së qeverisë apo e pronësisë së huaj në sistemin bankar luajnë një rol të rëndësishëm sidomos në pavarësinë e mbikëqyrjes. Për një debat të tillë në punimin e tyre Barth, Nolle, Phumiwasa dhe Yago (2002) kanë shprehur shkallën në bazë të së cilës autoriteti mbikëqyrës është subjekt i influencës politike. Për më tepër, nëse kemi një balancë të lartë të pronësisë nga ana e qeverisë, kjo e fundit mund të veprojë për të nënvlerësuar mbikëqyrjen efektive të bankave. Në të vërtetë, është e pritshme që mbikëqyrësit qeveritar të bankës të mos i mbikëqyrin korrektësisht bankat me pronësi të po qeverisë. Një praktikë mjaft frekuente në të tillë raste është përdorimi i bankave nga ana e qeverisë si një mjet për financimin e kompanive në pronësi të qeverisë apo të favorizuara nga qeveria, autoriteti mbikëqyrës nuk luan një rol mbështetës dhe gjeneron kështu probleme të mundshme.Në të kundërt kur bëhët fjalë për një pronësi të huaj, mund të jetë një shpatë me dy tehe. Së pari prania e një grupi të huaj bankar mund të sjellë lindjen e keqkuptimeve ligjore, burokratike apo operacionale por në të njëjtën kohë prezenca e një grupi bankar të huaj mund të importojë sjellje e modele mbikëqyrëse më efektive e të zhvilluara duke i ofruar një plus vendit në rritjen e standartit mbkqyrës. Apo akoma më tej, presioni që këto të fundit mund të bëjnë. Në fakt mund të mbështetemi në punimet e Quintyn dhe Taylor (2002) të cilët përqafojnë tezën se mbikëqyrësit janë subjekt presioni nga ana e industrisë bankare. Globalizimi i bankave, për më tepër, ngre pyetje nëse do të ishte më frytdhënës një sistem mbikëqyrës"transkombëtar" apo kombëtar, por për këtë do të rikthehemi më vonë.

Problemi i marrjes së rreziqeve të larta buron nga dikotomia midis pronësisë dhe klasës manaxheriale të një banke. Në fakt edhe pse të gjitha vendet rregullojnë dhe të mbikëqyrin bankat, (madje shumë vende kanë institucionalizuar edhe sistemet e sigurimit të depozitave për të promovuar sigurinë dhe shëndetin e sistemit bankar), konflikti themelor mbetet midis pronarëve të bankave dhe menaxherëve e drejtuesve të bankave. Bliss (2003) e trajton gjerësisht këtë problem të njohur nën emrin problemi "kryesues-agjent" , ku kryesuesit përfaqësojnë pronarët dhe agjentët përfaqësojnë menaxherët e drejtuesit.

Problemi qëndron në objektivat e palëve, pronarët nga një anë kërkojnë maksimizim të fitimit ndërkohë që nga ana tjetër menaxherët përndjekin veprime dukshëm më të ndryshme nga objektivat e pronarëve duke shtuar nevojën e disiplinës në treg. Këto konflikte munden shumë mirë të gjejnë zgjidhje në rregullimin kontraktual, por kostot e larta për çdo kontratë dhe mos arritja në mbulimin e çdo veprimi që mund të devijojë nga disiplina e tregut shtyn në ndërmarrjen e rreziqeve të ndryshëm. Boshlliqet e krijuara nga mbulimi kontraktual në fakt tashmë përmblidhen në qeverisjen e koorporatave, në të cilat mund të gjejmë guidën për të drejtat dhe detyrimet mbi vlerën e një kompanie. Çështja e qeverisjes së korporatave për bankat është shumë e rëndësishme,sic argumentojnë Macey dhe O'Hara (2003) bankat dhe ndërmjetësit financiarë ushtrojnë qeverisjen e korporative mbi kompanitë, edhe si kreditorëve të tyre por mund të ndodh edhe si zotërues të kapitalit të tyre. Caprio dhe Levine (2002) theksojnë që veçanërisht në vendet në zhvillim, ku bankat dominojnë si ndërmjetës financiarë, këto të fundit janë burimi më i rëndësishëm në qeverisjen e kompanive. Akoma më tej, ata cilësojnë se me një mirë menaxhim të bankave, shpërndarja e kapitalit do të jetë efiçente ndërkohë që në rastin e një qeverisjeje të varfër korporate të bankave, menaxherët e bankave mund të shtyjnë menaxherët e kompanive të sillen në mënyrë të tillë për të favorizuar interesat e tyre, por ndërkohë do të kishim një performancë të dobët të bankës në vetvete. Duke dëmtuar kështu edhe performancën e vetë ekonomisë së vendit ne fjalë.

Në këtë pikë ribashkohemi me fillimin e analizës së ndërlidhjes së rritjes ekonomike dhe ndërmjetësve financiarë. Nevoja për një qeverisje korporative korrekte në nivelin bankar është jo vetëm e domosdoshme por edhe e menjëhershme, dhe një nevojë tillë do të

përthithet nga autoritetet mbikëqyrëse aktuale, (do të mund ta shikojmë në vazhdim). Sipas Levine (2003) ka katër burime për qeverisjen e bankave:

1- Zotëruesit e kapitalit
2- Mbajtësit e borxhit
3- Disiplina e tregjeve
4- Qeveritë

Secili prej këtyre përbërësve ka një interes në qeverisjen korporative efektive të bankave. Një dimension i rëndësishëm i qeverisjes korporative është shkalla e transparencës në nivelin e operacioneve të një firme. Një rol shumë të rëndësishëm për të arritur një transparencë të lartë dhe një informacion në sasi e cilësi të mirë lujanë pikërisht standartet kontabël. Në fakt, në varësi të sistemit të zgjedhur, që mund të jetë lokal por edhe një sistem ndërombëtar i huazuar (nga ku vëzhgojmë sërish nevojën e unifikimin në nivel ndërkombëtar) do të varet edhe mënyra e sasia e marrjes së informacionit.

Sipas një studimi të kryer nga Banka Botërore (World Bank Regulation and Supervision Survey, BRSS 2011-2012) ilustrohet qartë diversiteti në aplikimin e standardeve të kontabilitetit nëpër vende të ndryshmë të globit. Sa më i plotë dhe i saktë të jetë informacioni se si menaxherët e operojnë, aq më të mëdha janë shanset që aksionerët të monitorojnë në mënyrë efektive performancën e menaxherëve. Për këtë sigurim transparence është e nevojshmë të kryhen kontrolle mbi transparencën e pasqyrave financiare të bankës, efektivitetit të auditit të jashtëm të bankës, si dhe vlerësimit në rang të bankës nga agjensitë e jashtme.

Nga studime të shumtë të kryer nga autorët pararendës në përgjithësi mund të dallojmë një marrëdhënie pozitive midis aplikimit të masave të qeverisjes së korporatave dhe nivelit të të ardhuravë të një vendi. Për hir të matjes së të tillë fenomeneve është krijuar një index i quajtur “Indeksi i Qeverisjes së Koorporatave” i cili sa më i lartë të jetë tregon një nivel të mirë të qeverisjes, dhe e kundërta. Në rastin e kategorizimit të vendeve sipas nivelit të tyre të të ardhurave për vendet me të ardhura të larta, ky indeks është vëzhguar në vlerat e tij më të larta. Në përputhje me këtë vëzhgim, kërkime të Caprio dhe Honohan (2008)

shqyrtojnë idenë e mbajtur gjerësisht se vendet me të ardhura të ulëta nuk do të kenë në përgjithësi kushtet e nevojshme për disiplinën efektive të tregut efektiv.

2.3.2 Nevoja e rregullimit dhe e mbikëqyrjes bankare

Bankat luajnë një rol kryesor në një ekonomi. Efikasiteti, integriteti dhe stabiliteti i sistemit bankar janë në këtë mënyrë një para-kusht për nje sistem të qëndrueshëm financiar dhe për funksionimin e duhur në një ekonomi. Prandaj, sektori bankar është i tillë që dështimi në një bankë mund të ndikojë shpejt në bankat e tjera të shëndetshme nëpërmjet asaj që njihet si efekti i përhapjes ose kontaminimit, apo termi më popullor i "efektit domino".

Mbikëqyrja bankare është e një rëndësie të madhe për qeverinë e një vendi. Sipas Iyade (2006) mbikëqyrja është procesi i monitorimit të bankave për të siguruar që ato janë duke kryer aktivitetet e tyre në një mënyrë të sigurt dhe të shëndoshë dhe në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret. Mbikëqyrja është një mjet për përcaktimin e gjendjes financiare dhe sigurimin e pajtueshmërisë me rregullat dhe rregulloret e përcaktuara në çdo kohë të dhënë. Bench (1993) pohon se mbikëqyrja efektive e bankave të çon në një industri të shëndetshme bankare. Fillimisht është e nevojshme të kuptohet edhe vetë dobia e qeverisë nga sistemi bankar që bën që rregullimi e mbikëqyrja të jetë një mjët indirekt qeveritar për një sistem bankar e financiar të shëndetshëm.

Në fakt në fazat e hershme të vendeve të industrializuara, shumë qeveri i shohin bankat si një burim në dispozicion të financimit, veçanërisht gjatë periudhave të luftës. Për të shërbyer si një burim i besueshëm i financimit, ndoshta edhe nën normat e interesit të tregut, qeveritë shpesh ishin të gatshme t'iu jepnin bankave kompetenca monopolistike ose gati-monopolistike në rajone të caktuara gjeografike, ose në linja të caktuara prodhimit. Kjo u arrit duke kërkuar nga qeveria privilegje të veçanta për bankat dhe kufizimin e palëve për të cilin janë dhënë këto privilegje. Kjo ishte *quid pro quo*-ja, për shembull, për privilegjimin e Bankës së Anglisë në 1694, para se ajo të bëhëj një bankë qëndrore moderne. Me kalimin e kohës, burimi i përkushtuar i kredisë u zgjerua përtej qeverisë në

vetvete, për miqtë, aleatët e saj dhe për industritë dhe sektorët e favorizuara nga qeveria për arsye ekonomike, politike apo sociale.

Disa qeveri i shikuan gjithashtu bankat si një burim i dobishëm i të ardhurave dhe vendosën taksa të veçanta për aktivitetet e tyre apo fitimet e tyre. Në vazhdimësi të interesimit qeveritar kundrejt bankave, qeveritë morrën pronësinë e plotë ose të pjesshme të bankave. Por shumë vende e ruajtën pronësinë apo kontrollin e pjesshëm të qeverisë në formën e bankave shtetërore apo bankave të kontrolluara nga shteti. Këtu përfshirë Franca, Italia, dhe Gjermania, në të cilët këto lloje bankash konkurojnë me bankat private të përmasave të mëdha ose afërsisht të barabarta, si Kina dhe Rusia, ku bankat më të mëdha janë banka me pronësi qeveritare. Në Japoni, në pronësi të qeverisë Sistemi Postal i Kursimeve është një konkurrent i madh i bankave private, disa prej të cilave aktualisht janë të paafta të paguajë dhe mbahen në mënyrë efektive nga qeveria dhe kështu paraqesin një formë të pronësisë qeveritare apo të kontrollit qeveritar mbi bankat.

Përveç kësaj, edhe nëse jo në mënyrë eksplicite në pronësi apo e kontrolluar nga qeveria, qeveritë janë shpesh në gjendje të përdorin bankat private për të ndikuar në qoftë se jo në mënyrë direkte përmes rregullimit. Për shembull, në SHBA, nga 1930 deri në1980, qeveria federale ka përdorur bashkimet e kursimit dhe të kreditit në pronësi private për të kanalizuar fonde në tregun e hipotekave duke inkurajuar institucionet të bëjnë kredi hipotekore afatgjata 20 deri 30 vite me normë fikse të financuara nga depozita afatshkurtra federale të siguruara. Si rezultat, këto institucione kanë ekspozime shumë të mëdha të normave të interesit dhe ishin "një bombë me kohëmatës" nëse normat e interesit rriteshin ndjeshëm, gjë që ndodhi në fund të viteve 1970. Në mungesë të sigurimit të depozitave, nuk ka gjasa që depozituesit do të kishin ruajtur fondet e tyre në institucione të tilla të rrezikshme, ose, në qoftë se ata do ta kishin ndërmarrë këtë rrezik, do të kishte norma interesi ndjeshëm më të larta për të kompensuar rrezikun e lartë. Kjo mund të ketë dekurajuar institucionet nga bërja e kredive të tilla afatgjata me normë fikse. Në të vërtetë, në periudhën para futjes së sigurimit të depozitave federale në vitin 1934, shoqata e kursimeve dhe kreditit rrallë lëshonte kredi me normë fikse përtej pesë vjet pjekurie dhe

ofroi depozitat afatgjata më pak likuide. Struktura të ngjashme ekzistojnë në shumë vende të tjera dhe janë mbajtur në veprim vetëm nga garancitë qeveritare për depozituesit.

Një formë tjetër e alokimit të kredisë që imponohet nëpërmjet bankave është që të drejtojë kredi për tu shërbyer grupeve me të ardhura të ulëta dhe grupeve minoritare, grupe të cilët janë perceptuar t'iu mohohet padrejtësisht krediti ose të pësojnë norma më të larta interesi nga çmund të përballojnë. Kështu, rregullatorët ndjehen të justifikuar në përdorimin e rregulloreve për të ndihmuar në kredi të drejtpërdrejtë ndaj këtyre komuniteteve derisa pengesat e perceptuara për të hapur tregjet e kreditit janë eliminuar. Në SHBA, këto rregullore janë klasifikuar nën rubrikën e rregulloreve të "Ri-investimit të Komunitetit".

Llewellyn (2006) thekson se rregullimi bankar është një grup i rregullave specifike ose rënie dakord mbi sjelljen e detyrueshme ose nga qeveria ose nga agjenci të tjera të jashtme ose të vetë imponuar nga marrëveshje eksplicite apo implicite në kuadër të industrisë që kufizon aktivitetet dhe operacionet e biznesit. Më tej ai vuri në dukje katër objektiva kyçe të rregullimit të bankave të cilat janë në radhë të parë stabilitetin e sistemit, e ndjekur nga sigurinë dhe qëndrueshmërinë e institucioneve financiare, së treti është të garantojë mbrojtjen e konsumatorëve ndaj sjelljeve të rrezikshme të institucioneve financiare individuale dhe së fundi është për të ruajtur besimin e konsumatorit në sistemin financiar dhe të integritetit të institucioneve financiare dhe tregje.

Edhe pse bankat operojnë për fitimin e tyre dhe bankierët janë të lirë të marrin vendime të shumta në operacionet e tyre të përditshme, bankingu trajtohet zakonisht si një çështje e interesit publik. Dështimet bankare në fakt janë perceptuar si më të dëmshme për shoqërinë sesa dështime të tjera dhe kanë më shumë gjasa për t'u përhapur për bankat e tjera. Dështimet e bankës jo vetëm që imponojnë humbjet e kredisë së depozituesit, por edhe humbjet e likuiditetit nga depozituesit, pasi bankat e dështuara nuk janë në gjendje t'i kthejnë vlerën e mbuluar të depozitave derisa aktivet e bankës të jenë shitur dhe fondet të mbulohen. Kjo procedurë zakonisht kërkon një kohë shumë të gjatë për t'u përfunduar. Natyra jolikuide që rezulton çon në rritjen e frikës së dështimeve të bankës dhe redukton në masë të madhe ofertën e parasë në treg, pasi depozitat afatshkurtra do kenë tendencë të

shëndërrohen papritmas, padashur në depozita afatgjata. Në qoftë se banka në fjalë ishte e përmasave të mëdha, efikasiteti i sistemit të pagesave ka shumë gjasa për t'u prekur në mënyrë të konsiderueshme.

Në shumë vende në fakt, bankat funksionojnë më shumë nëpërmjet sistemit të pagesave nga mundësimi i kartave të kreditit dhe debitit, transfertave elektronike ndërbankare si dhe shërbimi i çeqeve. Një sistem i pagesave që vepron në mënyrë efikase është një parakusht për një ekonomi efikase, dështime në sistemin e pagesave reduktojnë ndjeshëm tregtinë dhe në këtë mënyrë edhe të ardhurat agregate. Në mungesë të një sistemi efikas, kërkohet ndërhyrja e qeverisë për të nxitur zhvillimin e infrastrukturës bazë për këtë të fundit. Pas një dështimi, natyrisht edhe marrëdhëniet e kredisë kanë gjasa të infuluencohen, duke e ulur apo shtyrë kredidhënien e re deri në daljen në sipërfaqe të bankave të tjera të afërta gjeografikisht të cilat mund t'i marrin përsipër. Rregullimet për bankat pritet që të ndodhin më ngadalë sesa në rastin e dështimit të shumë llojeve të tjera të firmave.

Megjithatë, dëshmitë nga historia sugjerojnë se çdo efekt anësor nga dështimet e bankave në nivel makroekonomik janë më pak të rëndësishme se efektet negative të performancës së dobët makroekonomike të dështimeve të bankës. Dështimi i një banke është perceptuar të përhapet me lehtësi dhe shpejtësi edhe për bankat e tjera, sepse bankat priren të jenë të ndërlidhur ngushtë përmes depozitave dhe kredive ndërbankare dhe për shkak se bankat mund të duket të jetë më homogjene, kështu që nëse një bankë apo një grup i bankave hasin probleme, depozituesit në bankat e tjera mund të fillojnë të dyshojnë për shëndetit financiar të bankave të tyre dhe të shpejtojnë të veprojnë. Kështu, një ekspozim ndërbankar nga një bankë mund, nga ana tjetër, të shkaktojë mbi ekspozimet e saj ndërbankare dhe kështu me radhë çon në dështime zinxhir të tipit "domino effect". Pjesa më e madhe e sistemit rregullator është zhvilluar në përgjigje të krizave financiare dhe ngjarje të tjera historike dhe politike, ndaj rregullimi bankar ka evoluar për t'u shërbyer qëllimeve të shumtë, qëllimet të cilat kanë ndryshuar me kalimin e kohës edhe në raste kur kanë qenë në konflikt me njëri-tjetrin.

Justifikimi për çdo rregullim bankar buron zakonisht nga dështimet e tregut të tilla si eksternalitetet, pushteti i tregut apo asimetria e informacionit midis blerësit dhe shitësit. Në rastin e shërbimeve bankare, ka ende debat nëse bankat duhet të rregullohen apo jo dhe, nëse është kështu, se si duhet të rregullohen ato. Sipas Dowd (1996), Benston dhe Kaufman (1996), ky debat pasqyron pjesërisht mungesën e konsensusit mbi natyrën e dështimit të tregut që e bën shërbimin bankar falas jo optimal. Megjithatë, ka dy justifikime që janë të paraqitura shpesh për rregullimin e bankave: rreziku i një krize sistemike dhe pamundësisë së depozituesve për të monitoruar bankat, Goodhart (1998).

Sipas Diamond dhe Dybvig (1983) ofrimi i shërbimeve të likuiditetit nga bankat i lë ato të ekspozuara nga seritë potenciale të kërkesave urgjente dhe të papritura nga depozituesit. Arsyeja është se një bankë ka nevojë të operojë me një bilanc, ku vlera e likuidimit të aseteve të saj është më e vogël se vlera e depozitave likuide në mënyrë që të sigurojë shërbimet e likuiditetit. Nën këto rrethana, duke qënë se pritshmëritë e depozituesve rreth vlerës së depozitave të tyre varet nga vendi i tyre në rradhë në kohën e tërheqjes për shkak të principit “ i pari i paraqitur i pari i shërbyer”, një seri kërkesash urgjente mund të ndodhin pa nxjerrjen e informacionit të pafavorshëm rreth aktiveve të bankës dhe madje edhe kur informacioni në lidhje me asetet e bankës është i përsosur. Për shembull, në qoftë se depozituesit janë në panik, ata mund të përpiqen të tërheqin fondet e tyre nga frika se depozituesit e tjerë do të bëjnë po kështu sëpari, duke e detyruar një bankë, edhe pse të “shëndoshë” në falimentim.

Nëse nuk ka pasur paqartësi agregate dhe në qoftë se investimi i secilës bankë në aktivin afatshkurtër është i dukshëm publikisht (transparencë mbi aktivet bankare) atëherë depozituesit mund të ndihen plotësisht të sigurut ndaj rrezikut të likuiditetit me të cilin përballet banka e tyre. Megjithatë, kur ekziston asimetria e informacionit rreth aktiveve të bankave, siç ndodh kur bankat zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të aseteve të tyre në formë huash jo likuide, tregu ndërbankar nuk do të jetë në gjendje të sigurojë depozituesit me likuiditet të plotë. Asimetria e informacionit në lidhje me asetet e bankave i bën ato të ndjeshëme ndaj serive të kërkesave urgjente. Një seri kërkesash urgjentë që është shkaktuar nga lirimi i një informacioni që tregon performancën e dobët nga banka mund të

jetë e dobishme për shkak se ajo është një burim disipline sipas Colomoris dhe Gorton (1991)[4]. Në të kundërt, një seri kërkesash urgjente shkaktuar nga paniku i depozituesve ose nga nxjerrje informacioni kur ka asimetri të informacionit ndërmjet depozituesve rreth kthimeve bankare, nuk do të jetë e dobishme. Në këtë rast, seria e kërkesave urgjente është e kushtueshme për shkak se ajo detyron likuidimin e parakohshëm të aseteve, duke ndërprerë kështu procesin e "prodhimit". Për më tepër, sipas Allen dhe Gale (2000)[5], ajo mund të shkaktojë efekte zinxhir të këtyre serive kërkesash urgjente, të cilat mund të përfundjojnë në një dështim të sistemit. Është ky rreziku i dështimit të sistemit që formon bazën e argumentit klasik që propozon mekanizma për të siguruar bankat kundër goditjeve të likuiditetit, pavarësisht ndërhyrjes së tyre në funksionimin e lirë të tregjeve.

Sigurimi i depozitave nga ana e qeverisë është provuar si një mjet shumë i suksesshëm në mbrojtjen e bankave nga kërkesat urgjente apo paniku bankar, por me një kosto, sepse ajo të çon në "rrezik moral". Duke ofruar një garanci që depozituesit nuk janë subjekt i humbjes, ofruesi i sigurimit të depozitave mbart rrezikun që përndryshe do t'i duhej bankave të përballonin. Si rezultat, ky sigurim i depozitave ul nxitjen depozitorëve për të monitoruar bankat dhe për të kërkuar prej tyre një pagesë të interesit në proporcion me rrezikun e bankës. Për më tepër, kur skema e sigurimeve i ngarkon bankës një prim të sheshtë, banka nuk arrin të brendësojnë koston e plotë të rrezikut dhe për këtë arsye ajo nxitet për të marrë më shumë rrezik.

Sipas autorëve të shumtë (Keeley (1990), Hellmann, Murdock dhe Stiglitz(2000)) oreksi i një banke për rrezik ka tendencë të rritet mëtej me një rritje të konkurrencës në sektorin bankar dhe me një reduktim të vlerës së statutit të bankës. Shkëmbimi i kontratave "futures" nga sigurimi i depozitave kundrejt serive të kërkesave urgjente në banka shkon në kurriz të rrezikut moral. Ndaj ka propozime të shumta të motivuara për të ndryshuar dizajnin e skemës së sigurimit të depozitave apo të kontratave "futures" që synojnë zvogëlimin e rrezikut moral, duke ruajtur mbrojtje për depozitorët. Propozimet më të

[4] Për një përmbledhje mbi panikun bankar.
[5] Mbi teoritë e kontaminimit financiar.

shpeshta për t'u marrë me rrezikun moral të shkaktua rnga sigurimi i depozitave janë ngarkimi i bankave me primet e sigurimit të lidhura me rreziqet dhe nxitja në rregullimin e struktures së tyre të kapitalit. Për të eliminuar nxitjen e transferimit të rrezikut, sigurimi i depozitave ka nevojë të ketë një sistem të drejte vendosjeje të çmimit. Megjithatë, asimetria e informacionit mund të bëjë llogaritjen e primeve të drejta të pamundur apo të padëshirueshëm nga pikëpamja e mirëqenies. Duke filluar me Merton (1977), një literaturë e gjerë ka përdorur metodën e arbitrazhit për të përcaktuar primin e çmimit të sigurimit në mënyrë të drejtë.

Metoda e arbitrazhit supozon se, ndër të tjera, tregjet financiare janë të plota, ofruesi i sigurimit të depozitave ka informacion të përsosur në lidhje me rrezikun e aseteve të bankave, mund të vlerësojmë atëherë në mënyrë të saktë asetet e bankave, dhe rreziku moral përjashtohetnë mënyrë eksplicite ose implicite. Nën këto kushte, sigurimi i depozitave nuk është i nevojshëm për shkak se nuk ka asnjë rrezik për panik bankar. Për këtë arsye, studiuesit filluan të hulumtojnë mbi mundësinë e sigurimit të depozitave me një çmim të drejtë atje ku ekziston asimetria e informacionit. Freixas dhe Rochet (1998) e konsiderojnë çështjen e çmimeve të drejtë të sigurimit të depozitave në një kuadër të përgjithshëm, ku bankat janë të vlefshme për shkak se ata menaxhojnë depozitat. Ata tregojnë se çmimi i drejtë është i realizueshëm, por nuk është i dëshirueshëm nga pikëpamja e mirëqenies. Arsyeja është se kjo vendosje çmimi përfshin një subvencionim të bankave më pak efikas nga ato më të efektshme. Ky subvencionim kryq parandalon bankat më pak efikase nga imitimi i atyre më efikase, duke përmirësuar shpërndarjen e depozitave, por kemi një deformim për shkak se ajo çon në vendime joefikase të hyrjeve dhe daljeve.

Argumenti i rrezikut sistemik ngrihet mbi paqëndrueshmërinë që lind nga masat e monitorimit të bankave dhe të shërbimeve të tyre të likuiditetit, të cilati lënë bankat me një bilanc që kombinon një pjesë të madhe të detyrimeve në formën e depozitave pa afat me një pjesë të madhe të aseteve në formën e huave jolikuide. Dewatripont dhe Tirole (1994)

propozojnë një arsyetim për rregullimin bankar, që ndërtohet mbi problemet e qeverisjes së korporatave të krijuara nga ana e ndarjes së pronësisë nga menaxhmenti dhe mbi pamundësinë e depozituesve të bankave për ti monitoruar. Pika e nisjes e argumentit të tyre është se bankat, si shumica e bizneseve, i janë nënshtruar rrezikut moral dhe problemeve të përzgjedhjes negative. Prandaj, është e rëndësishme që investitorët ti monitorojnë ato. Monitorimi është i kushtueshëm dhe kërkon, ndër të tjera, akses cilësor ndaj informacionit. Për më tepër, është kot kur dublohet nga disa palë. Në rastin e shërbimeve bankare, kjo është e komplikuar nga fakti se borxhi bankar është mbajtur kryesisht nga depozitues të pa sofistikuar, pa informacionin e nevojshëm për të kryer monitorimin efikas.

Në fakt, kuptimi i financave nuk është i lehtë. Kështu, ekziston frika se bankierët "shumë të sofistikuara" mund të përfitojnë nga klientët e bankës "më pak të sofistikuara" dhe t'i detyrojnë ata në angazhime dhe kontrata që nuk do nënshkruhen nga palë të barabarta. Për aq kohë sa kjo është e vërtetë, dhe nuk ka asnjë dëshmi se bankierët janë apo nuk janë " më të zgjuar" në mbrojtjen e interesat e tyre se sa janë klientët e bankës, rregullorja u fokusuar në arsim, thjeshtimin e termave, dhe zbulimi mund të shërbejë për të rritur mirëkuptimin e konsumatorëve dhe për të përmirësuar efikasitetin dhe korrektësinë e tregjeve të financimit. Rregulloret e tilla gjithashtu mund të mbrojnë kundër mashtrimit dhe keqinterpretimeve. Përveç kësaj, për shkak se shumica e tyre mbajnë vetëm një depozitë të vogël ata nuk kanë nxitje për të kryer ndonjë nga funksionet për të monitoruar një bankë. Ky problem krijon nevojën për një përfaqësues publik ose privat të depozituesve. Kjo nevojë mund të plotësohen nga një rregullore që imiton kontrollin dhe monitorimin që depozituesit do të ushtrojnë në qoftë se ata do të kishin informacionin e duhur. Me pak fjalë, dhe për shumë arsye, ky hulumtim dhe të tjerët e përmendur tregojnë arsye për rregullimin e bankave.

Përveç shqetësimit për depozituesit individuale, rregullimi bankar kërkon gjithshtu një kuadër të qëndrueshëm për kryerjen e pagesave. Me vëllimin e madh të transaksioneve të kryera çdo ditë nga individët dhe bizneset, mjetet e pagesës janë kritike për shëndetin e ekonomisë së një vendi. Në fakt, është e vështirë të parashikohet se si një sistem kompleks ekonomik mund të funksionojë dhe të shmangë ndërprerje serioze në qoftë se totaliteti i

transaksioneve të përditshme nuk mund të kompletohet me një shkallë të lartë sigurie. Idealisht, rregullimi bankar duhet të kontrollojë luhatjet në aktivitetin e biznesit dhe problemet në bankat individuale për të mos ndërprerë rrjedhën e transaksioneve në të gjithë ekonominë, ndërprejre e cila kërcënon besimin e publikut në sistemin bankar.

Për të siguruar stabilitetin, rregullimi bankar duhet të nxisë zhvillimin e bankave me likuiditete të forta adekuate dhe duhen dekurajuar praktikat bankare që mund të dëmtojnë depozituesit dhe prishin sistemin e pagesave. Në fakt, pasojat e menaxhimit të pamjaftueshëm të rrezikut janë ndjerë në vitet e fundit me krizën financiare globale. Ndaj dhe sektori bankar është një nga sektorët target për tu mbikëqyrur e rregulluar ekonominë e një vendi. Rregullimi bankar i referohet zakonisht rregullave që rregullojnë sjelljen e bankave, kurse mbikëqyrjen e ushtrojnë autoritetet mbikëqyrëse që sigurojnë që bankat të përputhen me këto rregulla. Roli i veçantë dhe i rëndësishëm që luajnë bankat në sistemin ekonomik nënkupton se këto të fundit duhet të rregullohen dhe mbikëqyren jo vetëm për të mbrojtur investitorët dhe konsumatorët, por edhe për të siguruar stabilitetin e sistemit ekonomik në tërësi, nën këtë aspekt mund ti referohemi punimeve të Parker dhe Kirkpatrick (2012). Më konkretisht, sic është shprehur edhe më lart, rregulloret bankare ekzistojnë për ruajtjen e industrisë ndaj rrezikut sistemik, duke mbrojtur konsumatorët nga çmimet e tepërta apo sjellje oportuniste dhe më në fund për të arritur disa objektiva sociale, duke përfshirë këtu edhe stabilitetin, Llewellyn (2006).

Rregulloret bankare shërbejnë gjithashtu për të stimuluar e siguruar efikasitetin e industrisë bankare. Në këtë aspekt, është e dukshme se kur rregullorja është zbatuar me qëllim të kufizimit të aktiviteteve bankare, sjellja e biznesit të bankave dhe efikasiteti me të cilin ata veprojnë do të preken. Dhe pikërisht këtu, qëlllimi i mirë i mbikëqyrjes transformohet në një shtysë "negative" për bankat të cilat mund të nxiten e të angazhohen në aktivitete më me rrezik dhe / ose të investojnë në mënyra për të anashkaluar rregulloren. Nga ana tjetër, sipas disa studimeve të Jalilian, Kirkpatrick dhe Parker (2007), kjo në fund të fundit mund edhe të ndikojë në rritjen ekonomike.

Pra rregulloret bankare, si çdo kufizim, kanë kosto, si dhe përfitimet. Këto kosto për çdo rregullore të veçantë duhet të kuantifikohen dhe peshohen kundër përfitimeve që sjellin në mënyrë për të përcaktuar përfitimin neto ose koston neto të rregullores në fjalë dhe kështu vendoset nëse ajo duhet të imponohet apo jo. Për shkak se rregulloret janë të imponuara në përgjithësi për të ndihmuar sektorët e veçantë, është e rëndësishme që analiza kosto-përfitim të përfshijë edhe implikime për sektorët e tjerë dhe ekonominë në tërësi, si edhe për sektorët e synuar. Në analizën e tij të kostove dhe përfitimeve të rregullimit të tregjeve financiare, Benston (1999) bën dallimin midis dy llojeve të shpenzimeve : atyre të "paqëllimshme" dhe atyre të "qëllimshme". Ky dallim është i dobishëm. Kostot ndodhin për shkak se mbështetësit dhe hartuesit e rregullores ose nuk parashohin ose kanë dështuar të zbulojë të gjitha përgjigjet e mundshme të sjelljes së të "rregulluarve" apo të të prekurve të tjerë nga rregulloret. Pjesërisht, kjo reflekton kompleksitetin e tregjeve dhe tendencën e njësive individuale për të gjetur mënyra që të anashkolojnë pengesat e imponuara të cilat kanë incidenca direkte me aftësinë e këtyre të fundit për maksimizimin e mirëqenies së tyre.

A. <u>Kostot e qëllimshme</u>

Rregulloret ekonomike janë imponuar për të ndryshuar sjelljen ekonomike të njësive të targetuara prej tyre. Kemi potencialisht dy grupime kryesore të kostove të qëllimshme të mundshme: 1) shpenzimet administrative për rregullatorët në hartimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe zbatimin e rregulloreve si dhe 2) kostot për sektorët individualë dhe ekonomisë agregate nga reduktime në mirëqenien ekonomike të mundshme që rezultojnë nga ndryshimet në sjelljen e sektorëve të synuar. Disa qeveri kanë kërkuar kohët e fundit nga rregullatorët bankar për të llogaritur edhe shpenzimet administrative për agjencitë e shpalljes, përhapjes, monitorimit, dhe zbatimit të rregulloreve të tyre si dhe kostot administrative për industrinë bankare që bashkëvepron në përputhje me rregulloret. Këto kosto janë vlerësuar të jenë të rëndësishme. Ndërkohë, shumë reduktime në mirëqenien ekonomike agregate klasifikohen si shpenzime të paqëllimshme që rezultojnë nga mbikëqyrja në vetvete apo edhe nga neglizhenca me paramendim.

B. Kostot e paqëllimshme

Pasoja të padëshiruara dhe kostot e rregullimit ndodhin kur politikë-bërësit nuk i parashohin të gjitha përgjigjet ndaj çdo rregulloreje të veçantë ose lindin nga bashkëveprimi me rregulloret e tjera të imponuara për qëllime të tjera. Kjo ndodh ose për shkak se politikë-bërësit nuk i kanë dhënë kohë të mjaftueshme analizës së implikimeve të plota të kësaj rregulloreje të veçantë, ose për shkak të mungesës së njohurive ose mungesës së përkushtimit nga rregullatorët. Përveç kësaj, kur qeveritë i ofrojnë bankave sigurimin e depozitave apo formave të tjera të një rrjeti sigurie, shohin si përfitojnë bankat nga kjo dhe ndihen të justifikuar në mbledhjen e "pagesave" për këtë përfitim. Ata mund ta bëjnë këtë duke imponuar rregulla të cilat janë të destinuara për kredi të drejtpërdrejtë kundrejt sektorëve shoqëror apo politikisht "të dëshirueshëm" apo kufizojnë çmimet që mund ti ngarkoheshin të tilla llojeve të kredive. Kjo shoqërohet me një alokim të keq të resurseve ekonomike dhe me një humbje në mirëqenien ekonomike agregate.Por të gjithë objektivat e rregullimit të sapo diskutuara nuk mund të jene edhe të qëndrueshme edhe reciprokisht të arritshme. Për shembull, duke inkurajuar institucionet që të japin kredi për sektorë të favorizuar nga qeveria ose të rrezikshëm, ky "shërbim" kundrejt këtyre sektorëve mund të rrezikojë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e institucioneve, veçanërisht në qoftë se kredia është dhënë me interes nën normat e tregut, në sasi të tepërt, dhe pa kapital të mjaftueshëm të mbajtur nga banka. Kostot e paqëllimshme janë përgjithësisht të vështira të përcaktohen, por vëzhgimet sugjerojnë se ato janë relativisht të larta.

Sipas Nosal dhe Rupert, (2002) dhe Sapienza (2002) vendet me banka me pronësi nga qeveria apo të kontrolluara nga qeveria dhe rregullore të forta kanë përjetuar, mesatarisht, një rritje të ngadalshme ekonomike dhe kosto të larta të dështimeve të bankës, megjithëse këto shpenzime nuk ishin gjithmonë të dukshme në periudhën afatshkurtër. Është e mundshme që shpenzimet e paqëllimshme të rregulloreve bankare e tejkalojnë koston e qëllimshme dhe kanë një efekt shumë më të qëndrueshme kundrejt mirëqenies ekonomike agregate. Kjo nuk do të thotë se ndonjë rregullore apo të gjitha janë të pajustifikuara, por , theksohet rëndësia e kunatifikimet dhe peshimit me përfitimet potenciale që lidhen me një rregullore të veçantë të propozuar para miratimit të rregullores në fjalë.

E parë nga ana e qeverisë paketat rregullatore dhe mbikëqyrja e tyre janë shumë të rëndësishme, edhe për vetë faktin e tendencës së marrjes së rrezikut të lartë nga bankat apo shmangjes së rregullave, dhe për të siguruar kështu një sistem bankar të shëndetshmëm. Por nuk duhet të lihet gjtihçka vetëm në dorën e autoriteteve qeveritare, ndaj edhe vetë bankat operojnë skrupolozisht për të mbrojtur entitetin e tyre. Në vitet e fundit, kanë ndodhur ndryshime"dramatike" në mënyrën se si rreziku bankar është matur dhe menaxhuar. Përparimet në telekomunikacion dhe në përpunimin e informacionit, si dhe shfaqja e "inxhinierive financiare" të sofistikuara kanë lejuar bankat dhe institucionet e tjera financiare të rrisin aftësinë e tyre për të vlerësuar dhe vendosur një çmim mbi rrezikun.

Menaxhimi i rrezikut financiar është një nga aktivitetet më thelbësore që çdo bankë duhet të marrë në konsideratë, duke qënë se ky lloj rreziku përfshin humbje financiare. Rreziqet financiare mund të klasifikohen në lloje të ndryshme të tilla si rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë, rrezikun e likuiditetit dhe rrezikut operacional. Për më tepër, rreziku i tregut është klasifikuar në rrezik i drejtuar dhe i jo-drejtuar, rreziku i kredisë në rrezik sovran dhe rrezikut të shlyerjes, rrezikut të likuiditetit në të rrezikut të likuiditetit aseteve dhe financimit të likuiditetit dhe rrezikun e operacionit në rrezikun e mashtrimit, rrezikun e modelit dhe rrezikun ligjor.

Pas kuptimit se çfarë është rreziku financiar dhe llojet e tij, shqetësimi tjetër i madh për bankat është për të kryer vlerësimin e rrezikut financiar. Për menaxhimin e rrezikut financiar janë përdorur mjete të ndryshme, dhe në vazhdimësi do mund të përshkruhen shkurtimisht modelet e vlerësimit të rrezikut të brendshëm bankar, ku mund të përmendim sistemin tradicional "credit scooring", modelin VaR (value at risk)[6] dhe me zhvillimin e produkteve të reja financiare ka edhe metodata të reja për matjen e rrezikshmërisë së tyre, bëhët fjalë pra për derivativët dhe kreditë derivat.

[6] i vlerës në rrezik

i. Rrezultati i kredisë (credit score)

Sistemi i cili bazohet në rezultatin e kredisë është shumë i përhapur dhe gjëndet në pothuajse të gjitha llojet e analizave të kredisë, duke filluar që nga kredia konsumatore e deri në kredinë tregtare. Ideja në thelb është të identifikohen faktorët kyç që përcaktojnë probabilitetin e pagueshmërisë, pra peshojnë në rezultate sasiore sjelljen e klientit. Në disa raste, rezultati mund të interpretohet fjalë për fjalë si një probabilitet për parazgjedhje, në të tjerë raste, rezultati përdoret si një sistem të klasifikimit i cili vendos nëse një huamarrës potencial bën pjesë në një grup të mirë apo të keq duke u bazuar në "rezultatin" dhe nga një pikë kritike e cila e përjashton. Ka katër modele ekonometrike që janë përdorur në sistemet e rezultatit të kredisë:

a) Modeli i probabilitetit linear,
b) Modeli logit,
c) Modeli probit, [7]
d) Modeli i analizës diskriminante

Dokumentohet sipas autorëve të ndryshëm që përdorimi i modeleve të rezultatit të kredisë nga bankat e ndryshme është i përhapur në nivelin 97% për sa i përket miratimit për aplikimet e kartës së krediti dhe në nivein 70% të bankave që e përdorin në analizën e kreditimit të biznesit të vogël. Për të konkretizuar më shumë funksionimin e tij mund të marrim shembullin e modelit FICO, i cili përdoret gati nga 90% e bankave në Shtetet e Bashkuara. Rezultati FICO është llogaritur nga disa pjesë të ndryshme të të dhënave të kreditit në raportin e një klienti të bankës. Të dhënat janë të grupuara në pesë kategori, të paraqitura në grafikun më poshtë, krahas çdo kategrie kemi edhe gjithashtu peshën e rëndësisë së secilës prej tyre në përcaktimin e rezultatit FICO.

[7] Të tre këta modele më lart bazohen nga analiza regresive.



Grafiku 2.3 Rezultati FICO

Historia Pagesave zë 35% të të gjithë rezultatit sepse statistikisht tregon shumë për mënyrën e pagueshmërisë në vazhdim. Ky është një nga faktorët më të rëndësishëm. Shumat e marra hua zënë 30% të rezultatit sepse mund të përcaktojnë nëse klienti vë në rrëzik aftësitë e tij për të paguar apo jo. Gjatësia e historisë së kredisë zë 15% të rezultatit sepse tregon statistikisht një patern më të besueshëm dhe konsekuent. Sa me gjatë të jetë historia aq më mirë ndikon në rezultat. Rezultati Fico merr parasysh sa kohë kanë llogaritë e kreditit që janë themeluar, duke përfshirë moshën e llogarisë më të vjetër, moshën e llogarisë më të re dhe një moshë mesatare të të gjitha llogarive, si llogaritë specifike të kreditit janë themeluar, për sa kohë janë përdorur llogaritë e caktuara. Llojet e kredive në përdorim dhe kredia e re zënë secila nga 10% të rezultatit, kanë një peshë më të vogël por japin gjithashtu informacione të detajuara mbi kientin. Llojet e shumta të llogarive tregojnë mbi aftësinë e menaxhimit të financave e fondeve në dispzicion, ndërkohë që kredia e re, kur është në periudha shumë të shkurtra tregon dobësi të menaxhimit nga klienti e ndaj rrezikut.

Rezultati Fico vlerëson informacionin në raportin e kredisë në pozitiv dhe negativ. Pagesat e vonuara do të ulin rezultatin Fico, ndërkohë që pagesat në kohë do të rrisnin ndjeshëm rezultatin në fjalë. Përqindjet që gjënden në grafikun e mësipërm janë të bazuara mbi

rëndësinë e pesë kategorive për popullatën e përgjithshme. Për grupet e veçantë, për shembull, njerëzit të cilët nuk kanë përdorur kredi rëndësia e këtyre kategorive mund të jetë e ndryshme. Pra rëndësia e kategorive ndryshon për çdo person. Rëndësia e çdo faktori në llogaritjen rezultatin të kreditë varet mbi informacionin e përgjithshëm në raportin personal të kreditit. Për disa njerëz, një faktor mund të ketë një ndikim më të madh se çdo mund të ketë për dikë me një histori shumë të ndryshme të kredisë.

Prandaj, është e pamundur për të matur ndikimin e saktë të një faktori të vetëm në mënyrën se si rezultati i kredisë është llogaritur pa marrë parasysh raportin e plotë, pra duhet të krahasojmë me baza të njëjta për të dalë në përfundime të incidencës së faktorëve. Huadhënësit mund të shikojnë në shumë gjëra te një klient për të marrë një vendim, marrim rastin e një kredie personale, informacioni i kërkuar mund të përfshijë të ardhurat, sa kohë personi ka punuar në punën aktuale, sa punë ka ndërruar, llojin e kredisë që që ka patur më parë, llojin e kredisë që kërkon, e plot të tjera.

ii. Vlera në rrezik, modelet VaR

Në thelb Modelet VaR kërkojnë për të matur humbje minimale (në vlerë) të një aktivi apo të portofolit gjatë një periudhe të caktuar kohore me një nivel besueshmërie të caktuar (p.sh., 95 %, 97.5 %, dhe 99 %). Me të tillë modele kapërcejmë shumë kufinj duke e avancuar llogaritjen tradicionale nëpërmjet rezulatatit të kredisë, e cila vlerëson rrezikun e një aktivi të vetëm, ndërkohë që modelet VaR janë të fuqishëm në vlerësimin e ekspozimit ndaj rrezikut për një portofol të tërë aktivesh sepse merr parasysh edhe korrelacionin midis aktiveve të ndryshme. VaR ose ndonjëherë i shkruar edhe VAR (kujdes të mos ngatërohemi me modelet vektoriale autoregresive) është quajtur "shkenca e re e menaxhimit të rrezikut", por nuk duhet të jesh një shkencëtar për të përdorur modelet VaR.

Masa më tradicionale e rrezikut është paqëndrueshmëria. Për investitorët, rreziku përfaqësohet nga shanset e humbjes së parave, dhe modeli VaR është i bazuar në këtë fakt. Duke supozuar se investitorët kujdesen në lidhje me shanset e një humbje të madhe, VaR i përgjigjet pyetjes, "Çfarë është skenari më i keq i rastit im?" ose "Sa unë mund të humb në një muaj me të vërtetë të keq?". Një statistikë VaR ka tre komponentë: një periudhë kohe,

një nivel të besimit dhe një sasi humbje (ose përqindje humbjeje). Ekzistojnë tri metoda të llogaritjes VaR: metoda historike, metoda variancë-kovariancë dhe simulimi Monte Carlo.

A) Metoda Historike

Metoda historike thjesht ri-organizon kthimet aktuale historike, duke i vënë ato në mënyrë nga më e keqja te më e mira. Ajo pastaj supozon se historia do të përsëritet, nga një perspektivë e rrezikut.



Grafiku 2.4 Frekuencat e shpërndarjes së kthimit ditor

Marrim një shembull më një kompani, ku kemi listuar në grafikun e mësipërm frekuencat e kthimit ditor prej pesë vitesh aktiviteti të kompanisë. Në aksin X kemi të listuara vlerat në përqindje të kthimit ditor dhe në aksin Y kemi te listuara frekuencat në ditë. Për shembull, në pikën më të lartë të histogramës, kemi më shumë se 250 ditë, kur kthimi ditor është në mes të 0% dhe 1%. Kemi vetëm një ditë të vetme ku kthimi ditor kap nivelin 12.5%. brenda një periudhe prej pesë vitesh. Mund të vëzhgojmë se pjesa e shtyllave të kuqe përfaqëson 5 përqindëshin e poshtëm të shpërndarjes, pra duke qënë se i kemi rreshtuar

nga kthimi me i ulët deri në më të lartin ato janë 5% kthimet më të ulta. Duke deduktuar kështu që në 95% të rasteve humbja nuk do të tejkalojë vlerat 4% . Le të ri-frazojmë statistikën në përqindje dhe në terma monetarë:

-Me besim 95%, ne presim që humbja më e keqe e përditshme nuk do të kalojë 4%.

-Nëse investojmë 10000 ALL, ne jemi 95% të bindur se humbja më e keqja jonë e përditshme nuk do të tejkalojnë 4 00ALL.

Kjo nuk shpreh siguri absolute, por bën një vlerësim probabilistik. Nëse ne duam të rrisim nivelin e besimit, duhet vetëm të "lëvizim në të majtë" të histogramës, ku dy shtyllat e para tregojnë-8% -7% dhe përfaqësojnë 1% e kthimit ditor më të keq:

-Me besim 99%, humbja më e keqe e përditshme nuk do të kalojë 7%.

-Në qoftë se investojmë 10 000 ALL, ne jemi 99% të bindur se humbja e keqja e përditshme nuk do të tejkalojnë 700 ALL.

B)Metoda Variancë-Kovariancë

Kjo metodë supozon se kthimet aksioneve janë të shpërndara normalisht. Me fjalë të tjera, kjo metodë kërkon që të vlerësojmë vetëm dy faktorë - një kthim të pritshëm (ose mesatar) dhe një devijim standard, i cili do të na lejojë të ndërtojmë një kurbë të shpërndarjes normale. Marrim të njëjtën paraqitje grafike të mëparshme dhe i ndërtojmë përsipër një kurbë shpërndarjeje normale me parametrat e llogaritur nga vetë shpërndarja e kthimeve ditore:



Grafiku 2.5 Shpërndarja normale e kthimit ditor

E ngjashme me metodën historike përveç faktit që përdoret kurba normale në vend të të dhënave aktuale. Avantazhi i kurbës normale është që automatikisht e dimë ku shtrihen në kurbë pjesa 5% dhe 1% më e keqe. Ata janë një funksion të nivelit të besimit të dëshiruar dhe të devijimit standard:

Nivei i besimit	**Numri i devijimeve standarte të marra**
95% (i lartë)	**- 1.96 x σ***
99% (shumë i lartë)	**- 2.58 x σ***

Tabela 2.1 Niveli i besimit dhe devijimi shtandart përkatës teorik

Kurba e blu është e bazuar në devijimin standart actual për kthimin ditor të komapnisë X i cili është llogaritur në nivelin 2.64%. Kthimi mesatar ditor është mjaft afër zeros, kështu që ne do të marrë një kthim mesatare prej zero për qëllime ilustruese. Në bazë të llogaritjeve atëherë do të kishim :

Nivei i besimit	Numri i devijimeve standarte të marra	Pritshmëria e kthimit më të keq
95%	**- 1.96 x σ***	**1.96 x (2.64%) = -5,17%**
99%	**- 2.58 x σ*** [8]	**- 2.58 x (2.64%) = -6,81%**

Tabela 2.2 Niveli i besimit dhe devijimi shtandart përkatës konkret

C)Simulimi Monte Carlo

Metoda e tretë përfshin zhvillimin e një modeli për kthimet e ardhshme të çmimeve të aksioneve dhe kryerjen e shumë provave hipotetike përmes modelit. Për shumicën e përdoruesve, një simulim Monte Carlo përbën një "Black Box" si gjenerator të rezultateve të rastit. Pa hyrë në detaje të mëtejshme, një simulim me 100 prova të zhvilluara me të dhëna tashmë mujore do të na japë 100 prova për pritshmërinë e kthimeve tashmë mujre. Nëse e përsërisim sërish simulimin do të përftojmë rezultate të ndryshme, edhe pse me dallime shumë të ngushta. Paraqesim më poshtë në një histogramë rezultatet e simulimit Monte Carlo për kompaninë e shembullit tonë.



Grafiku 2.6 Rezultati i Simulimit Monte Carlo

* Në bazë të Teoremës Qëndrore Limite

U zhvilluan 100 prova hipotetiketë kthimit mujor. Midis tyre, ishin dy rezultate në mes -15% dhe -20%; dhe tre ishin midis -20% dhe 25%. Kjo do të thotë pesë rezultatet më të këqinj (që është, 5% më i keq) ishin më pak se -15%. Simulimi Monte Carlo çon pra në përfundimin e tipit VaR, ku mund të themi se me një nivel besimi prej 95%, ne nuk presim që të humbasin më shumë se 15% në një muaj të caktuar.

iii. Derivativët

Le të diskutojmë tani derivativët si një mjet i menaxhimit të rrezikut financiar. Termi "derivativ" sugjeron kontratat private që derivojnë vleren nga asetet themelore si obligacionet, indekset e monedhës, dhe kështu me radhë. Ka lloje të ndryshme të derivateve që përdoren si mjete të menaxhimit të rrezikut financiar. Menaxhimi i rrezikut është procesi i identifikimit të nivelit të dëshiruar të rrezikut, identifikimit të nivelit aktual të rrezikut dhe duke ndryshuar këtë të fundit për të barazuar të mëparshmin. Ky proces mund të futet në kategoritë e "hedging" dhe të spekulimeve. Hedging ka qenë tradicionalisht përkufizuar si një strategji për reduktimin e rrezikut në mbajtjen e një pozicioni tregu, ndërsa spekulimet i referohen marrjes së një pozicion në mënyrën e levizjeve të tregjeve. Sot, strategjitë hedging dhe spekulimet, së bashku me derivativët, janë mjete të dobishme ose teknika që mundësojnë kompanitë për të menaxhuar rrezikun në mënyrë më efikase.

Në vitet e fundit ka pasur një rritje eksplozive në përdorimin e derivativëve, sidomos derivativëve të kredisë. Derivatet e kredisë janë të konceptuar për të transferuar rrezikun e kredisë mbi portofolet e kredive bankare ose letrave me vlerë nga bankat drejt jo-bankave, sidomos drejt kompanive të sigurimit. Ekzistojnë katër instrumenta, kredit swaps, kredit option, kredit forward dhe kredit në letra me vlerë. Sipas Allen dhe Saunders (2002) nga fillimet e përdorimit e më tej, pjesëmarrësit e tregut vlerësojnë se tregu botëror në derivativë dyfishohet në madhësi çdo vit. Revolucioni në financë dhe menaxhimi i rrezikut i ka imponuar sfida të reja autoriteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse. Duke pasur parasysh sofistikimi në rritje dhe kompleksitetin e aktiveve të bankës dhe teknikave të menaxhimit

të rrezikut, autoritetet mbikëqyrëse duhet të zhvillojnë dhe të mbajnë ekspertizë të mjaftueshme për të vlerësuar praktikat e bankave. Shpërndarja e lartë e përdorimit të derivativëve mund të ketë pasoja pozitive dhe negative për stabilitetin e tregut financiar global. Duke i lejuar bankat të mbajnë portofole më të larmishëm të kredisë, përdorimi i derivativëve të kredisë redukton prekshmërinë bankare ndaj goditjeve sistemike. Për më tepër, huadhënësit përdorin derivativët për të transferuar rrezikun e kredisë së huave. Megjithatë, kjo mund të krijojë një pykë midis huamarrësit dhe huadhënësit, duke penguar kështu monitorimin dhe ristrukturimin e aktivitete. Përveç kësaj, duke e shpërndarë rrezikun e kredisë në të gjithë sistemin financiar, ndikimi i këtyre goditjeve ndihet më gjerësisht, duke rritur ekspozimin e rrezikut sistemik, Rule,(2001).

Nga paraqtja e situatës bankare dhe nevojës së saj për rregullore e mbikëqyrje të këtyre të fundit do të mund të gjejmë në pjesën e ardhshme debatin për nevojën e ndërkombëtarizimit të mbikëqyrjes nisur nga vetë ndërkombëtarizimi i aktivitet bankar.

2.3.3 Ndërkombëtarizimi i mbikëqyrjes

Bankat kanë qenë tradicionalisht të rregulluara dhe mbikëqyrura nga vendet e tyre. Në vitet e fundit, përparimet në teknologji dhe komunikime kanë ulur koston e shërbimeve bankare për distancat e mëdha, duke përfshirë shërbimet bankare edhe përtej kufijve kombëtarë. Me rritjen e kërkesës për shërbime të tilla, bankat janë zgjeruar si fizikisht përtej kufijve kombëtarë edhe pa praninë fizike duke kryer biznes përtej kufijve. Në përgjigje të këtij trendi, shumë nga shqetësimet e njëjta që çuan qeveritë të rregullojnë bankat vendase kanë shtyrë në rritjen e presionit për rregullimin dhe harmonizimin ndërkombëtar bankar.

Bankat janë lloji më i vjetër i institucionit financiar dhe kanë qenë të rregulluara në një mënyrë ose në tjetrën, por natyra e rregullores ka ndryshuar me kalimin e kohës me ndryshimet në zhvillimin ekonomik dhe në formën e organizimit ekonomik të vendit në fjalë. Liberalizimi dhe çrregullimi i tregjeve financiar ndërkombëtar ka ekspozuar sistemet financiare kundrejt një rritjeje të rrezikut të dështimit sistemik. Në fakt, ndërlidhjet në rritje

mes tregjeve financiare në botë kanë çuar në një zgjerim të konsiderueshëm në numër, madhësi dhe lloje të aktiviteteve e produkteve, duke shtyrë në një kompleksitet organizativ të institucioneve financiare shumëkombëshe. Edhe pse këto lidhje ndërkufitare sjellin në përgjithësi efikasitet të tregjeve të kapitalit, rritja e fushëveprimit të aktivitetit bankar ndërkombëtar ka theksuar vështirësinë e sigurimit të një mbikëqyrjeje efektive, duke patur kështu në disa raste rritjen e rrezikut sistemik, ku humbjet në një grup bankar mund të kontaminojnë të gjithë sistemin financiar. Në këtë situatë rreziku sistematik bëhet një eksternalitet negativ që imponon kosto mbi shoqërinë në përgjithësi për shkak se firmat financiare dështojnë për faj të aktivitetet të tyre spekulative që lidhen me sjelljet e tyre të rrezikshme, (Eatwell dhe Taylor 1999).

Bankat kanë pranuar gjithnjë e më shumë se metodat tradicionale të menaxhimit të rrezikut janë bërë të vjetëruara dhe se nevojiten masat e reja të nevojshme për të vlerësuar rrezikun e instrumenteve të reja financiare. Objektivi i reduktimit të rrezikut në tregjet financiare komplekse ka çuar në diversifikimin e të ardhurave të bankës, që kanë rritur aktivitetin bankar ndërkombëtar duke bërë që shumë banka të përdorin instrumente të reja financiare për të diversifikuar të ardhurat midis disa vendeve në mënyrë që, në çdo vit të dhënë, një rezultat negativ si pasojë e një investimi të papërshtatshëm në një vend mund të kompensohet nga një rezultati pozitiv të investimeve të përshtashme në një vend tjetër. Operacionet e zgjeruara dhe të larmishme bankare ndërkombëtare kërkojnë aderimin në një bazë të përbashkët të standardeve mbikëqyrëse dhe rregullatore të cilat të jenë të njohura e të pranuara nga rregullatorët e mëdhenj financiar botëror. Për më tepër, këto standarde kryesore ndërkombëtare kërkojnë mbikëqyrje efektive ndërkombëtare për të zvogëluar rrezikun sistemik. Hapi i parë për arritjen e mbikëqyrjes ndërkombëtare efektive është prezenca e një autoriteti ndërkombëtar për të lehtësuar koordinimin efektiv të përgjegjësive kombëtare rregullatore dhe për të promovuar standardet minimale dhe normat e praktikës së mirë për mbikëqyrjen e veprimtarive bankare ndërkombëtare.

Me transformimin e bankingut drejt ndërkombëtarizimit dhe çrregullimeve, autoritetet kombëtare rregullatore mbeten mbikëqyrësit kryesor për monitorimin ndërkufitar të aktiviteteve bankare. Prezenca e një kuadri rregullator ndërkombëtar për tregjet financiare

është e nevojshmë për koordinim efikas të mbikëqyrjes bankare ndërkombëtare. Bankat që operojnë në mënyrë ndërkufitare lokalizojnë më shumë operacione jashtë juridiksioneve të tyre kombëtare për të ofruar shërbime ndërkufitare në të cilat kredidhënësi dhe huamarrësi banojnë në vende të ndryshme. Siç e gjejmë të shprehur edhe me parë në këtë punim ndërkombëtarizimi i shërbimeve financiare ka ndryshuar natyrën bankare tradicionale komerciale përmes themelimit të organizatave komplekse, të njohura si "konglomerate financiare". Një konglomerat financiar ndërkombëtar është një grup i integruar i kompanive që ofron një gamë të gjerë të shërbimeve financiare. Ndërsa konglomeratte financiare ofrojnë përfitimet e aseteve të larmishëm, rreziqeve, si dhe burimet e të ardhurave, struktura e tyre paraqet disa probleme për rregullatorët.

Mbikëqyrja e plotë e konglomerateve financiare kërkon që mbikëqyrësit të zhvillojnë standarde të lartë të transparencës brenda organizatës si dhe vendosjen e përgjegjësisë së përgjithshme mbikëqyrëse. Siç u përmend më lart, ndërlidhja e grupit shumëkombësh financiar rrit mundësitë e efekteve domino, pra përhapjen e dështimit të likuiditetin nga një degë në një juridiksion nëpër filialet e tjera apo subjektet e një tjetër juridiksioni. Për më tëpër, natyra ndërkufitare e rrezikut sistemik kërkon që autoritetet kombëtare rregullatore të koordinojnë përpjekjet e tyre në mbikëqyrjen e aktiviteteve të institucioneve bankare ndërkombëtare, dhe që ata të miratojnë standardet minimale ndërkombëtare bazuar në parimet e një mbikëqyrjeje të konsoliduar.

Për shkak se rreptësisa e rregullave kombëtare ndryshon nga vendi në vend dhe për shkak të globalizimit të bankingut, bankat shumëkombëshe janë subjekt i niveleve të ndryshëm të rregullimit që mund të ofrojnë stimuj për aktivitete me rrezik në juridiksione më pak të rrepta. Kjo mund të rrisë rrezikun sistemik. Me bankat shumëkombëshe kërkohet pra një administrimin efektiv i rrezikut sistemik në një nivel global duke bërë të pavitueshme nevojën e një mbikëqyrësi global fusha e të cilit është e njëjtë me atë të subjekteve shumëkombëshe që rregullon. Një mbikëqyrës efektiv globale duhet të ketë ekspertizën dhe autoritetin për vendosjen e standardeve minimale dhe rregullat për mbikëqyrjen e përgjithshme dhe rregullimin e aktivitetit bankar ndërkombëtar. Natyra e sistemit politik

ndërkombëtar, i pengon të tillë mbikëqyrës global në vëndosjen e standardeve dhe rregullave brenda juridiksionit territorial të shteteve.

Prandaj, shtetet të cilat i përmbahen këtyre parimeve ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare duhet të bien dakord për të ndërmarrë zbatimin e standardeve ndërkombëtare në nivel kombëtar. Në këtë mënyrë, mbikëqyrësi global do të peshojë më shumë në sigurimin se institucionet shumëkombëshe bankare do të brendësojnë kostot sociale të operacioneve të tyre, dhe në këtë mënyrë të zvogëlojnë rrezikun sistemik. Përveç kësaj, përdorimi i instrumentet financiare të ndërlikuar si hedge fonds në nivel ndërkufitar mund të rrisë rrezikun e dështimit sistemik. Prandaj, rregullatorët bankarë pajtohen me faktin se monitorimi i këtyre instrumenteve financiare do të jetë një sfidë që kërkon koordinim të ngushtë ndërkombëtar nga autoritetet kombëtare. Për shkak të dallimeve në ekspertizën e autoriteteve kombëtare rregullatore, një mbikëqyrës global është i nevojshme për të siguruar informacion dhe ekspertizë por mbi të gjitha për të koordinuar përpjekjet ndërkufitare rregullatore në mënyrë të tillë për të siguruar përfitimet e standardeve ndërkombëtare të efektshme për pjesëmarrësit në të gjitha tregjet financiare. Kolapsi i parë i madh bankar që tërhoqi vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar financiar mbi nevojën për të zgjeruara mbikëqyrjen ndërkombëtare bankare ka ndodhur në vitin 1974 dhe ka përfshirë banka të mëdha nga Britania e Madhe, Gjermania Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara.

Kur sistemet bankare në një numër të madh të vendeve të industrializuara u dobësuan në fund të viteve 1980, u rrit presioni për rregullimin bankar dhe harmonizimin të paktën mes këtyre vendeve për bankat e mëdha ndërkombëtare aktive në to. Harmonizimi ishte menduar si për të rritur sigurinë, duke ulur gjasat e dështimeve individuale që mund të përhapnin efektet negative përtej kufijve kombëtarë,edhe për të siguruar një nivel konkurueshmërie të drejtë, në mënyrë që bankat në vende të ndryshme të mos përfitojnë nga çdo avantazh konkurrues për shkak të subvencioneve nga qeveritë e tyre (të tilla si raportet e kapitalit të ulëta në një mjedis të sigurimit të depozitave eksplicite apo implicite apo ndonjë mbështetje tjetër qeveritare). Thirrja për një rregullimin të tillë ndërkufitar pasqyron disiplinën e kufizuar të tregut për bankat në shumicën e vendeve, për shkak të

ekzistencës së garancive të qeverisë, si dhe vështirësitë e mëdha në monitorimin e bankave jo rezidente nga të dyja palët, aksionerët privat dhe rregullatorët qeveritar. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse rregullat ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme përgjatë juridiksioneve. Rregulloret ndërkombëtare do të ngjajnë me rregulloret e brendshme prudenciale, por duhet marrë parasysh qe dallimet në strukturat institucionale dhe ligjore në vende të ndryshme do të ndikojnë në cilësinë e mbikëqyrjes rregullatore dhe disiplinës së tregut dhe për këtë do të zgjerohemi më poshtë.

KAPITULLI III: NGA BAZEL I NË BAZEL III; DREJT ZHVILLIMIT TË DUHUR?

Hyrje

Një sistem i fortë dhe elastik bankar është themeli për rritje të qëndrueshme ekonomike, pasi bankat janë në qendër të procesit të ndërmjetësimit të kreditit midis kursimtarëve dhe investitorëve. Për më tepër, bankat ofrojnë shërbime kritike për konsumatorët, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, firmat e korporatat e mëdha dhe qeveritë që mbështeten mbi ta për të kryer biznesin e tyre të përditshëm, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Që nga viti 1974, me rënien e Bankës Gjermane Herstatt dhe Bankës Kombëtare Franklin me bazë në Nju Jork, përhapja e shpejtë e krizës financiare tregoi qartë nevojën e menjëhershme të një koordinimi dhe një sistemi rregullimi ndërkombëtar. Kriza ishte bërë me të vërtetë e pakontrollueshme dhe shumë e rrezikshme për tregjet ndërkombëtare. Banka për Rregullime Ndërkombëtare (Bank for International Settlements,BIS), u bë atëherë, vendtakimi ku u krijua Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (Basel Comittee on Banking Supervision, BCBS). Në mënyrë për të shmangur një tjetër krizë financiare Komiteti i Bazelit filloi hartimin e mbikëqyrjes bankare ndërkombëtare, disa marrëveshjeve apo paketave mbikëqyrëse, të cilat shihen si rekomandime për rregulloret bankare bazuar në konvergjencën e standarteve ndërkombëtare.

Në të vërtetë, çdo krizë financiare që bota ka pësuar ka sjellë problemet e saj, por gjithashtu, pas studimeve të gjata, ka sjellë disa përgjigje dhe zgjidhje. Në vitet 1975-1988, krijimi dhe zbatimi i marveshjes së parë të Bazelit, ka plotësuar nevojat e tregut dhe ka mundur të sigurojë një harmoni financiare, e cila zgjati për fat të keq vetëm deri në krizën e pasardhëse. Ngjarjet e 1990-2000 pasuar nga falimente të shumë bankave prezantuan kohën për një përmirësim të paketave rregullatore të sistemit bankar ndërkombëtar. Me marrëveshjen Bazel II në vitin 2004, “rrjedhjet” e paketës së parë Bazel I u mbushën, por

ende sistemi ishte i paplotë. Kriza financiare e vitit 2008 provoi që akordi Bazel II dështoi sërish në sigurimin e harmonisë fianciare ndërkombëtare.

Qëndron pyetja, çfarë do të sigurojë marrëveshjen e Bazel III? A do të mund të gjejë mjedisi financiar ndërkombëtare më në fund ekuilibrin e duhur? Në mënyrë për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, puna e paraqitura në këtë kapitull do të ofrojë një "turne udhërrëfyes" nëpërmjet përbërësve në tre shtylla të marrëveshjes Bazel III, por gjithashtu do të mund të gjeni një panel krahasues që do të ballafaqojë marrëveshjet me synimin për të nënvizuar zhvillimin, e tendencat e përmirësimit të kësaj pakete rregullatore mbikëqyrëse.

3.1 Komiteti I Bazelit Dhe Gjeneza E Mbikëqyrjes Ndërkombëtare

3.1.1 Historiku i krijimit të Komitetit të Bazelit dhe funksionimi i tij

Shumë individë me orientim drejt botës financiare e dinë shumë mirëse termi "Basel" është i njohur për faktin e të qënit një marrëveshje për mbikëqyrjen bankare sesa për bukurinë e vetë qytetit (Basel, Zvicër). Në fakt, nën Bankën për Rregullime Ndërkombëtare jeton Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, i krijuar dhe i mbikëqyrur nga guvernatorët e vendeve të G10 (në ditët e sotme ne gjejmë implikime dhe aplikacionet larg përtej anëtarëve origjinal). Që nga viti 1974 ky Komitet ka arritur disa konvergjenca dhe bashkëpunim ndërkombëtar lidhur me rregullimin e sistemit bankar. Në fakt, në vitet 1970, globalizimi dhe ndërmjetësimi financiar ndërkombëtar ishte në ekspansionin e tij. Ipso facto, së bashku me avantazhet bankare ndërkombëtare, erdhën edhe problemet. Siç mund të imagjinojmë lehtë, "fshirja" e kufijve dhe tendenca për ndërkombëtarizim vjen në pako me "efektet domino" në rast të një kolapsi të vetëm. Nëse një bankë "bie", të gjitha bankat do ta "ndjekin" nga pas.

Në fund të vitit 1974 si pasojë e trazirave serioze në valutë ndërkombëtare dhe tregjet bankare (sidomos dështimi i Bankhaus Herstatt në Gjermaninë Perëndimore) u krijua Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare, si Komiteti për Rregullimin Bankar dhe i Praktikave Mbikëqyrëse nga ana e guvernatorëve të bankave qëndrore nga Belgjika, Kanadaja, Franca, Gjermania, Italia, Japonia, Hollanda, Suedia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara së bashku me Zvicrën, (G10)[9]. Takimi i parë u mbajt në shkurt të vitit 1975, duke vazhduar me një frekuence të rregullt tre-katër mujore. Anëtarët e Komitetit tashmë janë zgjeruar dhe kemi përfaqësim nga Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar Italia, Luksemburgu, Belgjika, Zvicra, Spanja, Suedia, Argjentina, Australia, Brazili, Kanadaja, Kina, Hong Kongu, India, Indonezia, Japonia, Korea, Meksika, Hollanda, Rusia, Singapori, Turqia, Afrika e Jugut, dhe Arabia Saudite. Organi

[9] www.bis.org/list/g10publications/index.html

drejtues i Komitetit është i përbërë nga pjesëtarë të bankave qëndrore të shteteve anëtare dhe, në disa raste, mbikëqyrësit e sektorit bankar.

Komiteti kryesohet nga njëri prej bankierëve qëndrorë apo mbikëqyrësve të shteteve antare, që vepron kryesisht jashtë vendit të tij apo të saj origjinar. Ndërkohë, Sekretariati i Komitetit është i vendosur në Bankën për Rregullime Ndërkombëtare dhe përfshin stafin nga institucionet anëtare që janë në detyrë të përkohshme. Puna e komisionit ka qënë e ndarë fillimisht në katër nënkomitete kryesore: Grupi për Implementimin e Standardeve, Grupi i Zhvillimit të Politikave, Task Force e Kontabilitetit, dhe Grupi Konsultativ i Bazel, tashmë janë shtuar edhe Grupi i Mbikëqyrjes Makroprudenciale dhe Forumi i përbashkët. Kryetari aktual i Komisionit,që prej vitit 2011,është Z. Stefan Ingves, Guverntor i Bankës së Suedisë.[10].

Komiteti i Bazel mundëson një forum për bashkëpunim të rregullt mes vendeve të saj anëtare për çështjet e mbikëqyrjes bankare, në fakt, pranë tij diskutohen fillimisht modalitetet për bashkëpunimin ndërkombëtar, me qëllim për të mbyllur boshllëqet në rrjetin mbikëqyrës, por objektivi i tij i gjerë ka qenë për të përmirësuar mirëkuptimin mbikëqyrës dhe cilësinë e mbikëqyrjes bankare në të gjithë botën. Për arritjen e këtij qëllimi Komiteti i Bazel mbështetet mbi 1- shkëmbimin e informacionit mbi rregullimet mbikëqyrëse në nivel kombëtar; 2-përmirësimin e efektivitetit të teknikave për mbikëqyrjen bankare në nivel ndërkombëtar dhe 3- vendosjen e standardeve minimale mbikëqyrëse në zonat target.

Komiteti i Bazel mishëron në qëllimet e tij të reduktojë boshllëqet në mbulimin mbikëqyrës ndërkombëtar për të patur një shtrirje korrekte dhe një mbikëqyrje të përshtatshme. Në vitin 1975 dhe më pas i rishikuar në vitin 1983 Komiteti i Bazel përpiloi dhe dorëzoi një dokument nën titullin "Parimet për Mbikëqyrjen e Institucioneve të Huaja të Bankave", dokument i cili përcakton në mënyrë të qartë parimet për ndarjen e përgjegjësisë mbikëqyrës për degët e bankave të huaja, nëndegët dhe sipërmarrjet e përbashkëta mes autoriteteve mbikëqyrëse të entiteteve "mëmë" dhe "femijë', pra e thënë

[10] Për të parë organigramën zyrtare mun të drejtoheni në Shtojcën numër 2.

ndryshe të parimeve të mbikëqyrjes së konsoliduar të grupeve bankare ndërkombëtare. Si çdo dokument i lëshuar nga Komiteti i Bazel, ka rishikimeve dhe shtojca të shpeshta për të modeluar dhe përmirësuar principet bazë të dokumentave në fjalë. Në fakt, dokumenti që po diskutojmë është qajtur një " Concordat" (marrëveshje), dhe ka patur shtesa në prill të vitit 1990, me qëllimin e përmirësimit të rrjedhjes së informacionit prudencial midis mbikëqyrësve bankarë në vende të ndryshme dhe më pas në qershor 1992, parimet e përcaktuara prej marrëveshjes në fjalë u riformuluan si "Standartet Minimale". Pas publikimit të tyre, të gjithë autoritetet mbikëqyrëse në mbarë botën janë të ftuar ti miratojnë ato.

Por duhet ditur që rezultatet e diskutimeve të Komitetit nuk kanë fuqi ligjore, dhe në fakt as nuk e kanë patur këtë qëllim, pra Komiteti i bazel nuk posedon ndonjë autoritet mbikëqyrës formal mbikombëtar. Komiteti formulon standarde dhe udhëzime mbikëqyrëse dhe rekomandon praktikat më të mira në pritje që autoritetet individuale të ndërmarrin hapa për ti zbatuar ato nëpërmjet rregullimeve të tipit statutore të cilat mund të jënë më të përshtatshme për sistemet kombëtare përkatëse. Në këtë mënyrë, Komiteti inkurajon konvergjencën drejt qasjeve të përbashkëta dhe standardeve të përbashkëta pa u përpjekur për te detajuar harmonizimin e teknikave të vendeve anëtare mbikëqyrëse. Të panumërta janë sot dokumentet që ofrojnë udhëzime mbi një gamë të gjerë temash mbikëqyrëse të propozuara nga Komiteti i Bazelit.

Si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm me vende të ndryshme e autoritete të shumtë mbikëqyrës, Komiteti ka patur mundësinë të mbledhë një sasi të mirë informacioni në shumicën e sistemeve kombëtare për mbikëqyrjen e krijimeve të degëve apo filialeve të huja të bankave. Ka shqyrtuar pengesat për mbikëqyrje efektive që rrjedhin nga rregullat e sekretit bankar në vende të ndryshme, dhe ka studiuar procedurat e autorizimit për entitetet e reja bankare të huaja. Në tetor të vitit 1996, Komiteti ka lëshuar një raport të përpiluar nga një grup i përbashkët pune i cili i paraqiti propozimet për tejkalimin e pengesave të përjetuara nga ana e mbikëqyrësve bankarë në kryerjen e mbikëqyrjes efektive të konsoliduar të operacioneve ndërkufitare të bankave ndërkombëtare. Ky raport u miratua nga ana e mbikëqyrësve nga 140 shtete të cilët morën pjesë në Konferencën

Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve Bankar (ICBS. Qershor 1996) duke ofruar kështu një përparim të konsiderueshëm në një numër të vendeve për sa i përket heqjes apo kapërcimit të pengesat efektive të mbikëqyrjes së konsoliduar.

Tematika me përkushtimin më të madh nga ana e Komitetit është padyshim mjaftueshmëria e kapitalit, por për këtë do të zgjerohemi më poshtë. Shqetësimi mbi këtë teme ka lindur në fillim të viteve 1980, kur raportet e kapitalit të bankave kryesore ndërkombëtare po keqësoheshin, në një kohë kur edhe rreziqet ndërkombëtare ishin në rritje. Ndaj, grupi i guvernatorëve mbështeti anëtarët e Komitetit për ti dhënë zgjidhje erozionit të standardeve të kapitalit në sistemet e ndryshme bankare dhe për këtë i shtyu të punojnë drejt konvergjencës së mjaftueshmërisë së kapitalit. Kjo rezultoi në lindjen e një konsensusi të gjerë mbi një qasje të ponderuar për matjen e rrezikut, për asete të përfshira apo të papërfshira në bilanc.

Me këto zhvillime doli në pah shumë qartë nevoja e një marveshjeje shumëkombëhe për të përforcuar stabilitetin dhe harmoninë e sistemit bankar ndërkombëtar, duke sheshuar burimet e pabarazive konkuruese që ngrihen si arsye e ndryshimeve në nivelin e mbikëqyrjes dhe rregullreve kombëtare, sidomos nga ndryshimet në kërkesat e kapitalit. Pas diskutimesh e komentesh mbi një dokument konsultativ të publikuar në dhjetor të vitit 1987, u miratua e famshmja Marveshje e Kapitalit të Bazel e cila u publikua dhe u bë e prekshme për bankat në korrik 1988. Që nga viti 1988, kjo "kornizë" rregullatore është në mënyrë progresive në zhvillim e adaptim, jo vetëm për vendet anëtare, por edhe pothuajse për të gjitha vendet e tjera me banka aktive ndërkombëtare. Në shtator 1993, u lëshua një deklaratë që konfirmon se të gjitha bankat në vendet e G10 të përfshira në biznesin bankar ndërkombëtar plotësonin kërkesat minimale të përcaktuara në Marrëveshjen e 1988. Në nëntor 1991, kjo marrëveshje është ndryshuar për të dhënë saktësi më të madhe në përcaktimin e dispozitave të përgjithshme të cilat mund të përfshihen për qëllime të llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit. Në prill 1995, Komiteti lëshoi një amendament të Marrëveshjes së Kapitalit, i cili hyri në fuqi fund të vitit, për njohjen e efekteve bilaterale nga ekspozimet e bankave të kreditit në produktet derivative dhe për të zgjeruar matricën e faktorëve suplementarë.

Në morinë e përmirësimeve apo ndryshimeve Komiteti gjithashtu ka ndërmarrë përmirësimin e kuadrit të rreziqeve të tjera përveç rrezikut të kredisë. Në janar të vitit 1996, pas dy proceseve konsultative, Komiteti lëshoi të ashtuquajturin Amendamentin e Rrezikut të Tregut, i projektuar për të inkorporuar në kuadër të Marrëveshjes së Kapitalit rreziqet e tregut që rrjedhin nga pozicionet e bankave të hapura në valutë të huaj, të tregtimit të borxhit nën letra me vlerë, etj. Pjesa më e madhe e punës përgatitore për paketën e rrezikut të tregut është ndërmarrë së bashku me rregullatorët e letrave me vlerë dhe Komiteti beson se është i aftë për aplikimin për institucionet financiare jo-bankare.

Roli më i gjerë i Komitetit në promovimin e standardeve mbikëqyrëse të shëndosha në mbarë botën është intensifikuar. Komunikata e lëshuar nga Krerët e Qeverive të G7 pas Samitit të Lionit në qershor 1996 i bëri thirrje Komitetit për të marrë pjesë në përpjekjet në përmirësimin e standardeve të mbikëqyrjes në tregjet në zhvillim. Si rezultat, Komiteti në vitin 1997 ka zhvilluar një sërë parimesh thelbësore për Mbikëqyrje Efektive Bankare, e cila ka dhënë një plan gjithëpërfshirës për një sistem mbikëqyrës efektiv. Një numër hapash janë ndërmarrë për të inkurajuar vendet që të zbatojnë "parimet bazë", duke përfshirë ngritjen e një grupi Ndërlidhës të përbërë nga të dyja grupimet si nga vendet e G10 edhe nga vendet jashtë grupimit në fjalë.

Në qershor të vitit 2004, Komiteti lëshoi një propozim për një kuadër të ri mbi mjaftueshmërinë e kapitalit për të zëvendësuar Marrëveshjen e vitit 1988, të realizuar në 26 qershor 2004 me prezantimin e Kornizës së re të Kapitalit. Korniza e re është projektuar për të përmirësuar mënyrën se si kërkesat rregullatore të kapitalit pasqyrojnë rreziqet në themel dhe për të adresuar më mirë risitë financiare që kanë lindur gjatë viteve të fundit. Këto ndryshime synojnë përmirësimin në matjen e rrezikut dhe kontrollit. Gjatë gjashtë viteve përgjatë të cilave është punuar për të arritur në Marrëveshjen Bazel II, Komiteti i Bazelit është konsultuar gjerësisht me bankat dhe grupet e industrisë në përpjekje për të zhvilluar në mënyrë për të përpiluar kërkesa të kaitalit të cilat të jenë më të ndjeshme kundrejt rrezikut në mënyrë për të siguruar shëndetin e sistemit.

Në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO, International Organization of Securities Commissions), organi ndërkombëtar i rregullatorëve të letrave me vlerë të cilët monitorojnë aktivitetet e letrave me vlerë dhe të firmave investuese, Komiteti botoi në korrik 2005 një dokument konsensual që rregullon trajtimin e librave të bankave tregtare sipas Kornizës së re. Për lehtësi të referimit, ky tekst i ri u integruar me tekstin e qershorit 2004 në një dokument gjithëpërfshirës të lëshuar në qershor 2006.

Një tjetër sfidë për Komitetin është natyrisht shtysa dhe terheqja e sa më shumë vendeve në adoptimin e këtyre rregullave të përpiluara. Në fakt, jo vetëm vendet anëtare po edhe vende të tjera kanë pajtuar marrëveshjen në shumë pika të saj. Për të inkurajuar më tej bashkëpunimin dhe qasjet e përbashkëta, Grupi Standard i Komitetit të Zbatimit (SIG, Standart Implementation Group) shërben si një forum për çështjet e implementimit dhe diskuton çështjet me interes të ndërsjellë me mbikëqyrësit jashtë anëtarësisë së Komitetit përmes kontakteve të tij me shoqatat rajonale. Ndërkohë përmes pengesave të shumta në nivelin e e juridiksioneve të ndryshme janë sistemet e matjes së rrezikut, pikat që janë trajtuar edhe në Amendamentin e Rrezikut të Tregut të vitit 1996, por nën marrëveshjen Bazel II, këto koncepte u zgjeruan akoma më shumë dhe kërkojnë një bashkëpunim akoma më të gjerë midis vendeve. Pikërisht për të realizuar këtë sfidë të rradhës Komiteti përpilio një guidë mbi ndarjen e informacionit dhe bashkëpunimit në nivelin mbikëqyrës në kontekstin e Qasjeve të Avancuara të Matjes përkatësisht në vitin 2006 dhe 2007.

Për arritjen e objektivave konsolidues dhe primar të tij Komiteti, sidomos nën presionin e efekteve të krizës që e tejkalojnë sferën bankare, ka patur bashkëpunim edhe me entitete të tjera financiare si Forumi i Stabilitetit Financiar (FSF, Financial Stability Forum). Komiteti ka punuar ngushtë me mbikëqyrësit e letrave me vlerë dhe të sigurimeve për të studiuar sfidat e paraqitura nga zhvillimi i konglomerateve financiare të larmishëm. Fillimisht ky bashkëpunim realizohej nëpërmjet një grupi joformal trepalësh të mbikëqyrësve nga secili nga tre sektorët. Ky grup u pasua në vitin 1996 nga Forumi i Përbashkët mbi Konglomerate Financiare (JFFC, Joint Forum on Financial Conglomerates), nën patronazhin e Komitetit të Bazelit, nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO,

International Organization of Securities Commissions) dhe Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS, International Associations of Insurance Supervision). Forumi i Përbashkët është i mandatuar për të përpunuar mënyra për lehtësimin dhe shkëmbimin e informacionit midis mbikëqyrësve, për të rritur koordinimin mbikëqyrës, dhe për të zhvilluar parimet drejt mbikëqyrjes më efektive të konglomerateve financiarë.

Përveç kësaj, Komiteti, së bashku me IOSCO, ka lëshuar dhjetë raporte të përbashkëta që nga viti 1995, të cilat kanë të bëjnë me raportimin, menaxhimin dhe zbulimin e aktiviteteve të derivativëve të bankave dhe firmave të letrave me vlerë. Komiteti dhe IOSCO kanë punuar së bashku në mjaftueshmërinë e kapitalit të aktiviteteve tregtare, si dhe gjithashtu kanë ndërmarrë punën për një numër çështjesh teknike bankare dhe të kontabilitetit në lidhje me organet e jashtme. Këtu kemi të përfshirë Komitetin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASC, International Accounting Standarts Committee), Komitetin e Praktikave të Auditimit (IAPC, International Auditing Practices Committee) dhe Dhomën Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC, International Chamber of Commerce).

Dëshira e Komitetit për të inkurajuar gjithmonë kontaktet dhe bashkëpunimin midis anëtarëve të tij dhe autoritete të tjera mbikëqyrëse bankare është forcuar më tej nga Konferencat Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve Bankar (ICBS, International Conference of Banking Supervisors). Kjo konference organizohet çdo dy vjet, kemi patur 17 konferenca të tilla që janë mbajtur deri më sot, e para e zhvilluar në Londër në vitin 1979, dhe e fundit e zhvilluar në Stamboll në 2012[11]. Komiteti i Bazelit mban marrëdhënie të ngushta me një numër të madh të grupimeve bankare mbikëqyrëse. Këto përfshijnë Grupin e Mbikëqyrësve Bankar Offshore, me anëtarë nga qendrat kryesore bankare offshore, dhe grupet mbikëqyrëse nga Amerika, Karaibet, nga shtetet arabe, nga vendet SEANZA të sub-kontinentit indian, Azinë Jug-Lindore dhe Australisë , nga Europa Qëndrore dhe vendet e Evropës Lindore, nga kontinenti afrikan dhe nga Azia Qëndrore dhe Transkaukazia. Komiteti i ndihmon këto grupe në mënyra të ndryshme, duke iu siguruar dokumentacionin

[11]Për më shumë informacion për konferencën në fjalë mund të drejtoheni në http://icbs2012istanbul.org/index.php?module=CON

e përshtatshëm, pjesmarrje në takime, duke ofruar asistencë të kufizuar Sekretariati dhe mbajtjen e takimeve mes drejtorëve për të koordinuar punën e ardhshme.

Parimet e miratuara nga Komiteti i Bazelit janë shpërndarë gjerësisht nëpër këto konferenca ndërkombëtare dhe grupimet mbikëqyrëse. Një numër i madh i vendeve jashtë grupit të G10-ës kanë dhënë mbështetjen e tyre me objektivin themelor për të siguruar që asnjë aktivitet ndërkombëtar bankar të mos i shpëtojë mbikëqyrjes. Si rezultat, tashmë mbeten vetëm disa territore në glob ku kompanitë bankare janë të licencuara dhe lejohen të veprojnë pa përpjekje serioze për mbikëqyrje efektive dhe bashkëpunim me autoritetet ndërkombëtare mbikëqyrëse. Komiteti gjithnjë ka punuar për të ngritur nivelin e vetëdijes së mbikëqyrësve mbi ndërvarësitë e tyre të përbashkët, si rrjedhojë e aktiviteteve ndërkombëtare të bankave.

Zhvillimet ekonomike ndërkombëtare dhe efektet negative të tyre, si kriza e "sub-prime" në Shtetet e Bashkuara e efektet domino të shpërndara ndërkombëtarisht rizgjuan nevojën e rishikimit dhe pasurimit të bazës rregullatore e prudenciale të marrëvshjës së Bazelit me përditësimin në paketën e reformave Bazel III, në nivel të përmirësimit të sigurisë dhe të pasurimit të paketës me opsione tashmë të domosdoshme.

Paketa e plotë e reformuar nga Komitetit adreson mësimet e krizës financiare. Nëpërmjet paketës së reformave, Komiteti synon gjithashtu të përmirësojë administrimin e rrezikut dhe qeverisjes, si dhe forcimin e transparencës së bankave dhe shpërndarjes së informacionit. Paketa e reformave përfshin përpjekjet e Komitetit për të forcuar bashkëpunimin e bankave ndërkufitare sistematikisht të rëndësishme. Këto përpjekje përfshijnë rekomandime të Komitetit të Bazelit për të forcuar pushtetin kombëtar mbikëqyrës dhe zbatimin ndërkufitar të tyre. Komiteti i Bazelit ka përmbledhur kështu mësimet nga kriza, ndryshimet e fundit dhe përshtatjet e kornizave kombëtare për marrëveshjet ndërkufitare si dhe elementet më efektive të kornizave kombëtare aktuale[12], për të krijuar paketat e rregulloret në fjalë, por do të zgjerohemi më poshtë për komponentët e të treja paketave Bazel.

[12] Për inforacion më të detajuar mund të drejtoheni në raportin dhe rekomandimet e Grupit të Rezolutës së Bankave Ndërkufitare (mars 2010), në http://www.bis.org/publ/bcbs169.pdf

3.1.2 Rregullimi i kapitalit të bankave

Siç e diskutuam edhe më lartë pjesa më e rëndësishme e marrveshjeve mbetet padiskutim rregullimi i kapitalit, ndaj në vazhdim të këtij seksioni do mund të futemi në brendi të tij. Që nga kontributi i Modigliani dhe Miller (1958) ku tregohet se në një botë pa "fërkime" me informacion të plotë dhe tregje të plotë vlera e një firme është e pavarur nga struktura e kapitalit të saj, studiuesit kanë studiuar implikimet e devijimeve nga bota për strukturën optimale të kapitalit të një firme. Taksat, shpenzimet e rreziqeve financiare, papërsosmëritë në tregjet e produkteve, kostot e transaksioneve dhe problemet e asimetrisë së informacionit janë vetëm disa shembuj të fërkimeve që hulumtuesit kanë konsideruar për të shpjeguar strukturën e kapitalit të firmës. Në rastin e bankave, ata kanë konsideruar edhe dy faktorë të tjerë: qasjen e bankave kundrejt rrjetit të sigurisë, në veçanti për sigurimin e depozitave, dhe faktin që investitorët e vegjël, përgjithësisht të painformuar, mbajnë shumicën e borxhit të bankës.

Siç e kemi parë pargjatë kapitullit të parë, sigurimi i depozitave, i jep bankave një nxitje për të rritur rrezikun, të cilat mund ta rrisin, për shembull, duke rritur rrezikun e aseteve të tyre ose levave të tyre. Kjo nxitje në kalimin e rrezikut, së bashku me faktoret potenciale që rrjedhin nga dështimet e bankave, kanë qenë një nga justifikimet kryesore për rregullimin e kapitalit të bankës. Literatura më e herët e rregullimit të kapitalit bankar, fokusohet në studimet e efektivitetit të standardeve të kapitalit në kontrollimin e aftësisë paguese të bankave.

Disa studiues kanë adoptuar qasjen e portofolit, Pyle (1971) dhe Hart dhe Jaffee (1974), e cila modelon bankën si një portofol të letrave me vlerë. Bankierët zgjedhin përbërjen e portofoleve të tyre në mënyrë për të maksimizuar fitimin e pritshëm për një nivel të caktuar të rrezikut, duke marrë rendimentet e të gjitha letrave me vlerë të dhëna. Koehn dhe Santomero (1980) dhe Kim dhe Santomero (1988) adoptojnë këtë qasje dhe supozojnë se bankierët janë rrezik-shmangës dhe prandaj maksimizojnë funksionin e utilitetit të pasurisë financiare neto të bankës. Një justifikim për këtë është rasti kur banka është në pronësi dhe

menaxhohet nga i njëjti agjenti, gjë e cila bën që rreziku nuk mund të diversifikohet plotësisht.

Futja e një kërkese kapitali të sheshtë kufizon kufirin e kalimit të rrezikut të bankës, duke e detyruar atë për të zvogëluar levat dhe për të rikonfiguruar përbërjen e portofolit të saj për sa i përket mjeteve me rrezik. Kjo mund të çojë në një rritje të probabilitetit të dështimit të bankës për shkak se bankieri mund të zgjedhë si kompensim për humbjen në utilitet, nga ulja e levave, një portfol më të rrezikshëm. Rregullatorët mund ta eliminojnë këtë efekt negativ duke kërkuar nga bankat për të përmbushur kërkesa të kapitalit të bazuara mbi rrezik.

Debate të shumtë mbi këto baza arrijnë në përfudnimin se dhe disa standarde të rrepta të kapitalit mund të çojnë në një rritje të rrezikut të dështimit të bankës. Për shembull në rastin kur kemi detyrime të limituara dhe kapitali i bankës është i vendosur në mënyrë ekzogjene deri në një nivel të caktuar, mysëtia e preferencave për shkak të detyrimeve të kufizuara mund të çojë në dominimin e një neverie kundrejt rrezikut, dhe banka, nëse është më pak e kapitalizuar seç duhet, do të jetë e tërhequr ndaj rrezikut. Në këtë rast, edhe një rregullim i kapitalit i bazuar mbi rrezik që përdor peshimin e rrezikut "të bazuar në treg" (që është, pesha proporcionale ndaj rreziqeve sistematike të aktiveve) mund të mos jetë e mjaftueshme për të frenuar bankën nga oreksi për të ndërmarrë veprime me rrezik të lartë. Atëherë, mund të jetë e nevojshme për të imponuar një rregullore shtesë, që të kërkojë nga bankat për të operuar me nivelin minimal të kapitalit.

Një aspekt kyç që duhet trajtuar është gjithashtu ekzistenca e asimetrive të informacionit. Këto janë të rëndësishme sepse janë të lidhura direkt me ekzistencën e bankave. Siç e pamë më parë, një funksion i rëndësishëm i bankave është të shqyrtojnë e të monitorojnë kreditë. Kthimet e këtyre kredive pastaj bëhen informacion privat për menaxherët e bankave, duke u dhënë atyre liri në zgjedhjen e intensiteteve të shqyrtimit dhe monitorimit të kredive. Kjo liri mund të çojë në forma të ndryshme të rrezikut moral, kur stimujt e menaxhimit të bankës janë të shtrembëruar, siç ndodh kur ka sigurim të depozitave. Bankat financojnë

vetveten me anë të depozitave të siguruara dhe kështu kanë shtrembëruar stimujt e tyre drejt marrjes së rrezikut.

Literatura shqyrtuar për këtë tematikë përdor një analizë të ekuilibrit të pjesshëm dhe për këtë arsye nuk kap kostot në sektorët e tjerë të ekonomisë të një rritje në kërkesën për kapital për shkak të standardeve të kapitalit. Këto kosto mund të çojnë rregullatorët për të vendosur një standard kapitali më të ulët se ai i bazuar vetëm për stabilitet. Bankat në modelin e tyre sigurojnë likuiditet duke ofruar depozitat pa afat dhe prodhojnë informacion në lidhje me huamarrësit e tyre, informacion i cili është i humbur nëse ata dështojnë ose largohen nga industria. Në zgjedhjen e standardeve të kapitalit, rregullatorët përballen me dy probleme:

1-problemet që rrjedhin nga stimujt e bankave pjesëmarrjese (ekternalitetet negative nga dështimet e bankave e bëjnë vlerën e tyre sociale më të lartë se vlera private, duke i dhënë aksionerëve më pak nxitje për të rritur kapitalin më shumë se vlera e kapitalit rregullator)

2-problemet që rrjedhin nga papërsosshmëria e zëvendësueshmërisë midis kapitalit dhe depozitave. Rritja e standardeve të kapitalit zvogëlon rrezikun e dështimit (gjë e cila është edhe privatisht edhe shoqërisht e dëshirueshme për shkak se vlera e bankës humbet më rrallë), por ajo redukton depozitat (kjo gjë është e kushtueshme për shkak se këto letra me vlerë janë më pak të ndjeshme në nivelin e informacionit sesa kapitali i bankës dhe për këtë arsye kursehet në " koston e limonit"[13] që agjentët pësojnë kur i tregëtojnë më vonë).

Në mungesë të rrezikut moral, nëse ofruesi i sigurimit ka informacion të përsosur në lidhje me rrezikun e aseteve të bankave ajo mund të arrijë qëndrueshmërinë në mënyrë të barabartë edhe me një prim sigurie të bazuar në rrezik ose me standarte kapitali të lidhura me rrezikun. Por, kur ofruesi i sigurimit është në gjendje të vëzhgojë rreziqet bankare vetëm me gabime, atëherë këto mekanizma alternative çmimi më nuk janë ekuivalente. Kjo sugjeron se kur ekzistojnë fërkime informacioni është më e dobishme që të shqyrtohen paralelisht edhe dizajnimi i sigurimit të depozitave dhe ai i kërkesave të kapitalit. Në këto kushte asimetrie, bankieri i njëh mirë përbërësit e portofolit të tij, pra e njëh cilësinë e tij,

[13] www.investopedia.com/terms/l/lemons-problem.asp

ndërkohë që rregullatori nuk e njeh, ndaj bankieri mundet në këtë rast të influencojë cilësinë për interesat e fitimit personal ndërkohë që objektivi i rregullatorit është që të ofrojë sigurim të depozitave, ndërsa maksimizon mirëqenien sociale.

Sipas sistemit të sigurimit të depozitave, nën optikën e një sistemi optimal në nivelin e shoqërisë, primi i sigurimit duhet të rregullohet për cilësinë e portofolit të kredive të bankës, dhe bankat e cilësisë së lartë kanë të lejuar një bazë relativisht të madhe të aseteve dhe përballen me kërkesa më të ulta të kapitalit. Nga ana tjetër bankat e cilësisë së ulët, marrin një subvencion të nënkuptuar, sepse ato paguajnë një çmim të lartë të sigurimit, por nuk e kanë të nevojshme të përmbushin standardet e kapitalit. Bankat e cilësisë së lartë, në të kundërt, duhet të plotësojnë standardet minimale të kapitalit, por do të paguajnë një çmim më të ulët të sigurimit. Rëndësia e të pasurit primin e sigurimit të lidhura me standardet e kapitalit në këtë mjedis rrjedh nga fakti se, për shkak të informacionit të papërsosur, paguhet për të ofruar një rregullore me një shkëmbim mes standardeve të kapitalit dhe primit të sigurimit në mënyrë për nxjerrjen e informacionit dhe për të minimizuar koston e induktimit të imitimit të sjelljes së bankave me cilësi të lartë nga bankat me cilësi të ulët.

Së fundi, mund të solicitojmë rolin e standardeve kapitale bazuar në problemet e qeverisjes së korporatave në bankat të cilat kanë të ndarë pronësinë nga menaxhmenti. Fakti që depozituesit nuk janë në një pozicion për të monitoruar menaxherët bankar, ata duhet të jenë përfaqësuar nga rregullatorët. Standardet kapitale mund të jetë një instrument i rëndësishëm për të zbatuar qeverisjen optimale të bankave, sepse ato mund të përdoren për të përcaktuar pragun për transferimin e kontrollit nga aksionerët për rregullatorin.

Lë ta shtjellojmë më thjeshtë , pse na duhet pra kapitali rregullator i bankave? Përgjigja është evidente, për të kufizuar rrezikun dhe për të reduktuar humbjet potenciale të papritura. Ndryshe nga kompanitë normale, bankat, duke qënë në biznesin e dhënies së kredive për individët dhe bizneset, që do të thotë se në qoftë se këta të fundit dështojnë në përmbushjen e detyrimeve të tyre, banka do të humbasë paratë. Mendoni se çfarë ndodh në aspektin e kontabilitetit nëse një aktiv, në këtë rast kredia, bie, atëhere duhet të bjerë në

bilanc edhe diçka nga ana e detyrimeve dhe të kapitalit aksioner. Në rastin më të mirë, ky do të jetë kapitali aksioner i bankës i cili vepron si një "jastëk" për të mbuluar humbjet nga aktivet. Por në qoftë se bankës "i mbaron" kapitali aksioner, diçka tjetër do të duhet të ulet, që do të thotë do të preken depozita ose burimet e tjera të financimit, pra konsumatori, do të humbasë depozitat. Kjo është arsyeja pse kërkesat rregullatore të kapitalit ekzistojnë, dhe sigurojnë kështu që një bankë të mund të përthithë humbjet nëpërmjet kapitalit aksioner të saj sesa nëpërmjet depozitave të klientëve ose burime të tjera të financimit.

Me një kompani normale, llogaritjet e raporteve e jastëkëve prudencial nuk janë aq të nevojshmëm dhe jetik për mirëfunksionimin e saj. Ndërkohë që me bankat, çdo gjë në modelin e tyre është e lidhur shumë fort me kërkesat rregullatore të kapitalit. Së pari nuk mund të supozojmë verbërisht se të ardhurat ose pasuritë janë në rritje me një normë të caktuar, ato vetëm mund të rriten në lidhje me se sa "jastëk" kapitali keni në dispozicion. Së dyti, nuk mundet thjesht të supozojmë një raport pagimi për dividendët apo të zgjedhim rastësisht një vlerë riblerjeje për aksionet, duhet të kontrollojmë se sa kapital ka më parë, dhe pastaj të vendosim se sa mund të shkojnë për dividentët ose riblerjen e aksioneve. Së treti kapitali i kërkuar ka një ndikim në vlerësim, për faktin se kërkesat e larta induktojnë një sasi më të vogël dividentësh. Pra, ne nuk mund vetëm të konsiderojmë kapitalin rregullator si një element modern për tu konsideruar por, duhet ta njohim në mënyrë perfekte nëse duam të modelojmë bankën. Ka dy koncepte kyçe për sa i përket kapitalit rregullator:

1- aktivevet e ponderuara me rrezik (RWA, risk-weighted assets)

Jo të gjitha aktivet janë njësoj të rrezikshme, për shembull, paraja në dorë, është më e sigurt se një hua sub-prime. Kur ne mendojmë për kapital rregullator, kemi nevojë për të vendosur kërkesat në lidhje me rrezikshmërinë e aktiveve dhe jo thjesht aktivet në vetvete. Akordet e ndryshme të Bazelit vendosën pesha të përcaktuara të rrezikut për lloje të ndryshme të aktiveve në bilancin e një banke. Secilën peshë e shumëzojmë me vlreën e aktiveve dhe me pas kryejmë një shumatore për të patur vlerën totale të aktiveve të ponderuara me rrezik të një banke. Këto aktive të ponderuara me rrezik përdoren më pas si

emërues për llogaritjen e raporteve të kapitalit (për më shumë detaje do të fokusohemi në seksionet në vijim).

2- nivelet e kapitalit (tiers of capital)

Ashtu siç të gjitha aktivet nuk janë njësoj të rrezikshme, jo të gjithë llojet e kapitalit janë po aq të aftë të na mbrojnë . Në fakt ka disa nivele kapitali:

Kapitali i përbashkët Tier 1: Kapitali aksioner i përbashkët, vlera e "Goodwill", aktive të patrupëzuara që nuk vijnë nga të drejtat e shërbimeve imobiliare.

Kapitali Tier 1 : Kapitali aksioner i përbashkët, vlera e "Goodwill", aktive të patrupëzuara që nuk vijnë nga të drejtat e shërbimeve imobiliare plus letrat me vlerë hibride të kuafikuara dhe interesat jo-kontrolluese.

Kapitali Tier 2: Borxhi i varur + letrat me vlerë hibride të jo-kuafikuara + ndihma për humbjet nga huatë e kualifikuara

Ku, kapitali i përbashkët Tier 1 është më strikti sepse është ai që edhe në rastet më ekstreme mund të absorbojë humbjet.

Tashmë me zotërimin e këtyre koncepteve dhe mbi të gjitha rëndësisë së kapitalit rregullator nën marrëveshjet e mbikëqyrjes dhe prudencës bankare do mund të kalojmë në shtjellimin e strukturës e targetit të tyre si një guide historikë e kronologjike.

3.1.3 Krijimi i Marrëveshjes së Bazel I, limitet dhe dështimi i saj

Para krijimit të marrëveshjes së vitit 1988, nën emrin e Bazel I, ka pasur një rregullore të kapitalit bankar në bazë të së cilës kërkohej një sasi minimale e kapitalit. Megjithatë, kjo rregullore nuk ishte e mjaftueshme për faktin se përbënte një problem shtrirja dhe harmnonizimi gjeografik si dhe mbarte një rrezik të mospërfilljes. Rregulloret përcaktojnë fillimisht kapitalin dhe japin një raport minimal të tij për të cilin bankat de zotohen ta plotësojnë. Përcaktimi i kapitalit dhe raporti i tij ishin në fakt shumë të ndryshme nga njëri vend në tjerin. Në disa vende rregullimi nuk kishte një strukturë të mirfilltë, dhe kishte

mungesa të thella mbikëqyrëse, mungesa të cilat i sillnin një avantazh konkurrues bankave të këtyre vendeve, duke disavantazhuar bankat e vendeve të tjera të cilat i zotoheshin një sistemi rregulltor më strikt. Në të vërtetë, zhvillimi i shpejtë i tregut të derivateve ka rezultuar në një rritje të rrezikut të kredisë për bankat. Megjithatë, ky rrezik është i përfaqësuar më tepër në aktivitetet jashtë bilancit dhe ato nuk merreshin parasysh për llogaritjen e raportit të kapitalit, ku shuma e këtyre fondeve atëherë ishte e pamjaftueshme për të mbuluar gjithë ekspozimin real kundrejt rrezikut. Kjo situatë bëri atëherë të domosdoshme përpilimin e një marrëveshjeje më të sofistikuar për të marrë masa më të mira kundrejt rreziqeve të ndryshmeme nga të cilat ekspozohen bankat.

Marrëveshjet e bëra nga Komiteti janë të destinuara kryesisht për të promovuar një sistem bankar konservator dhe për të forcuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar duke evokuar rregullimin e kapitalit të mbajtur nga bankat. Marrëveshjet e bëra nga Komiteti janë të destinuara kryesisht për të promovuar një sistem bankar konservator dhe për të forcuar sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar duke evokuar rregullimin e kapitalit të mbajtur nga bankat. Akordi i Kapitalit të Bazelit i vitit 1988 ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në favor të rregullores së kapitalit të bankës. Marrëveshja ka qenë nismëtare për promovimin e konvergjencës ndërkombëtare të standardeve të kapitalit dhe për përmirësimin e këtyre standardeve në shumë vende. Me kalimin e kohës, megjithatë, kufizimet e saj konceptuale së bashku me risitë financiare kanë krijuar stimuj dhe mundësi për arbitrazh rregullator të kapitalit, dhe si pasojë kanë çuar në një reduktim të efektivitetit të saj. Kjo ka nxitur një debat mbi hartimin e standarteve të kapitalit dhe ka ushtruar një presion mbi autoritetet rregullatore për të rishikuar marrëveshjen.

Marrëveshja e 1988, e transformoi kështu Komitetin e Bazelit mbi Mbikëqyrjen Bankare në një lider në bërjen e politikave të bankave, kryesisht për rregulloren e tij mbi kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit, të cilat targetojnë pikërisht mbulimin e rreziqeve të lidhura me rreziqet e bilancit (të mjeteve si paraja dhe ari, obligacionet, bonot e thesarit, letra me vlerë, real estate etj), rreziqet jashtë bilancit (si derivativët, këmbimet në mondhë të huaj etj) dhe rreziqet jashtë bilancit nga mjete të pa tregëtueshme (asete borxhi, blerje forëard aktivesh etj). Pas situatës së rëndë financiare ndërkombëtare, qëllimi i marrëveshjes ishte i

qartë, për të forcuar stabilitetin e sistemit bankar ndërkombëtar, dhe të përpiqej për të reduktuar pabarazinë konkurruese mes bankave ndërkujfitare dhe ndërkombëtare.



Figura 3.1 Struktura e implementimit të marrëveshjes së Bazelit (Burimi: Bank for nternational Settlements

Siç mund ta vëzhgojmë në figurën e mësipërme marrëveshja Bazel ka një implementim vertikal të saj. Duke filluar që nga vijëzimi (1) kuadri i Bazelit është aplikuar në këtë nivel në një bazë të konsoliduar. Në nivelet (2), (3) dhe (4) kuadri nxitet që të aplikohet në të gjitha bankat ndërkombëtar aktive mbi një bazë të konsoliduar.

Për tju përmbajtur synimeve të saj marrëveshja e 1988 prek katër tematika të menaxhimit bankar të cilat kanë nevojë të inkuadrohen nga rregullatorët. Së pari bankat pozicionohen më mirë nëse nuk financiojnë një pjesë të aktiveve të tyre nga borxh i cili do të maturohet brenda vitit, por në qoftë se e financojnë nga kapitali. Me fjalë të tjera, banka është në një pozitë më të mirë nëse aktivet e saj qarkulluese janë të financuara nga burimet që banka i mban në afat më të gjatë. Së dyti, qeveritë e disa vendeve që ofrojë sigurim të depozitave për bankat për të mbrojtur depozituesit, shkaktojnë një mundësi për rrezik moral, ku në të

vërtetë, bankat kanë tendencë për tu drejtuar nga aktivet me rrezik dhe kjo pa humbur depozitat e mbrojtura nga sigurimi i tyre. Prandaj ishte e nevojshme të kërkohej një sasi minimale e kapitalit për të reduktuar rrezikun moral. Së treti, roli i bankës është për të mbledhur informacion për të reduktuar asimetrinë e informacionit në tregun e kredisë. Në mënyrë që depozituesit të jenë të bindur që banka e kryen më së miri këtë detyrë i duhen dhënë disa stimuj. Këto stimuj janë pikërisht të përfaqësuar nga kërkesat e kapitalit duke i ndihmuar bankat me kredibilitet në sy të depozitusve. Së katërti, bankat përdorin levat. Në të vërtetë, pjesa e kapitalit të vet është relativisht i ulët. Kjo është për të rritur kthimin mbi kapitalin (ROE, Return On Equity), synimi i rregulloreve të kapitalisht është të reduktojnë këtë efekt dhe rreziqet që lidhen me të.

Arritja e parë e kësaj marrëveshjeje ka qenë sigurisht përkufizimi i kapitalit të bankës dhe i raportit të kapitalit të bankës që synonte reduktimin e mjaftueshmërisë së kapitalit të bazuar në rrezik. Prandaj, marrëvshja e Bazel I ka filluar me përkufizimin e termit "Kapital". Me radhë, kapitali ishte klasifikuar në nivele (Capital Tiers). I pari, lidhur me "Capital Core", përfshin kapitalin aksioner dhe rezervat e deklaruara. Grupin e dytë, në lidhje me "Supplementary Capital"[14], përmbledh të gjitha format e tjera të kapitalit të tilla si borxhi afatgjatë, fitimet mbi aktivet e investimeve, duke lënë jashtë kapitalit borxhin e pagarantuar afatshkurtër.

Marrëveshja e 1988 është sinonimi i garancisë së një aftësise paguese të caktuar të institucioneve të kreditit. Për ta bërë këtë, Komiteti i Bazelit prezantoi raportin Cooke, i njohur gjithashtu si raporti i solvabilitetit ndërkombëtar. Raporti Cook llogarit shumën e kapitalit që një banke duhet të ketë si një përqindje e totalit të aktiveve të saj të peshuara nga rreziku. Llogaritja është përdorur për të përcaktuar një standart minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit që duhet të mbahet nga bankat në rast të humbjeve të papritura. Ky raport kërkon një nivel të kapitalit proporcional në vlerën e aktiveve të bankës, ku kapitali duhet të jetë të paktën 8% e totalit të aktiveve të bankës dhe të aktiviteteve jashtë bilancit të ponderuara me koeficientët e rrezikut. Raporti i kërkon bankës një nivel të kapitalit të vet proporcional me rrezikun e kredisë kundrejt të cilit

[14]Shtjelluar në seksionin e mëparshëm faqe 57.

banka është e ekspozuar. Në tabelën e mëposhtme mund të gjeni sistemin e ponderimit me rrezik të aktiveve bankare sipas marrëveshjes së Bazel I.

Peshat e Rrezikut sipas Bazel I	
Pesha	**Aktivi (shembull)**
0%	Para në dorë / Bono thesari
10%	Disa lloje borxhi publik
20%	Hua ndërbankare
50%	Hua hipotekore rezidenciale
100%	Borxh i sektorit privat

Tabela 3.1 Peshat e Rrezikut sipas Bazel I

Raporti Cooke inkurajon në këtë mënyrë bankën për të kufizuar ndjeshëm marrjen e tepërt të rrezkut. Si? Duke e venë përpara zgjedhjes së bllokimit të një kuote shumë më të lartë nësë merr rrezik të lartë, në të kundërt nëse banka nuk angazhohet në aktive shumë të rrezikshme eviton bllokimin e lartë të kapitalit duke patur më shumë fonde në dispozicion. Ky raport, i cili hyri në fuqi në të gjitha bankat në Bashkimin Evropian në vitin 1992, ilustrohet me:

$$\boldsymbol{Raporti\ Cook} = \frac{\boldsymbol{Totalin\ e\ Kapitalit\ t\ddot{e}\ Vet}}{\boldsymbol{Aktivet\ e\ Ponderuara\ nga\ Rreziku}} \geq \mathbf{8}\%$$

Kështu, problemet e adresuara kundrejt bankave para marrëveshjes së 1988 zgjidhen në këtë pikë. Në të vërtetë, prezantimi i këtij raporti në Bashkimin Europian zgjidh problemin e harmonizimit, dhe përfshirja e rreziqeve jashtë bilancit zgjidh problemin e rreziqeve që

nuk merreshin parasysh. Në vitin 1996 u bë një rishikim i marrëveshjes së Bazel I në të cilin u shtura edhe mundësia e propozimit të një shtese/grupimi të tretë kapitali i cili përmbledh borxhet afatshkurtra të pagarantuar ose të pasiguruara. Në po të njëjtin vit, u prezantua një amendament për të marrë parasysh edhe rrezikun e tregut i cili ishte në rritje. Rritja e rrezikut të tregut është kryesisht për shkak të zhvillimit të produkteve. Raporti Cook u transformua më pas në:

$$\textbf{Raporti Cook} = \frac{\textbf{Totali i Kaitalit të vet}}{\textbf{Risku i tregut} + \textbf{kapitalin e nevojshëm për të mbuluar rrezikun e tregut}} \geq \mathbf{8}\%$$

Nëpërmjet këtij ndryshimi, amendamenti në fjalë kërkon ruajtjen e kapitalit për aktivevet dhe pasivet e mbajtura për aktivitetet e tregëtimit, aktivitete të karakterizuara nga një rrezik i lartë tregu. Amendamenti i referohet një metode standarde për matjen e ngarkesës së kapitalit për rrezikun e tregut. Banka të caktuara, të cilat kategorizohen si më të sofistikuara, zotërojnë përparime në qasjet e menaxhimit të rrezikut, ndaj kanë modelet e tyre të brendshme për llogaritjet e duhura (si për shembull modelet VaR[15], apo modelet e hendekut të pritshëm). Në këtë mënyrë këto bankat kryejnë një mbrojtje më adapte kundrejt rrezikut potencial. Me përdorimin e këtyre metodave, bankat arrijnë gjithashtu të sigurojnë një diversifikim më optimal duke përfituar kështu nga kërkesa më të ulta të mjaftueshmërisë së kapitalit. Në përfundim, kapitali i përgjithshëm që banka duhet të zotërojë vlerësohet nga shuma e 1- mbulimit të rrëzikut të kredisë me aktivet e ponderuara me rrezik (RWA) dhe 2- mbulimit të rrezikut të tregut.

Këto përparime bën që Bazel I të ishte një hap i madh në zhvillimin e mbikëqyrjes bankare ndërkombëtare dhe strukturat e kapitalit. Totaliteti i specifikimeve dhe nën-ndarjet e marrëveshjes ilustrojnë një metodologji standarde në llogaritjet e kërkesave për kapital, duke synuar krijimin e kërkesave të kapitalit të ngjashme mes bankave ndërkombëtare për të shmangur avantazhe të padrejta që disa banka mund të kenë si rezultat i kërkesave të kapitalit inekzistente në vendet që ata veprojnë. Bazel I arriti qëllimin e tij kryesor, pra, me nxitjen e stabilitetit financiar ndërkombëtar dhe zbatimin e konkurrencës së ndershme dhe

[15]E shtjelluar si qasje në seksioni 2.3.2, faqe 40.

të paanshme mes bankave aktive në tregjet ndërkombëtare. Pavarësisht nga fakti që marrëveshja mendohej të ishte kuruar në detaj, ajo dështoi në sigurimin e harmonisë financiare pas vitit 2000. Falimentet e shumtë të asaj kohe treguan nevojën e një përmirësim apo më saktë, një përditësimi të marrëveshjes së Bazelit në raport me zhvillimet në produktet e shërbimet bankare, por gjithashtu edhe me teknikat e evitimit të vetë rregullores.

Kritikat kryesore që iu drejtuan marrëveshjes ishin:

- Mungesa e strukturave me afat të njohjes së rrezikut të kreditit që induktojnë detyrime të njëjta pa marrë parasysh pjekurinë e ekspozimit të kredisë.
- Masa fikse të rrezikut të rastësishëm në nivelin 8% që konsiderohet të jetë i përshtatshëm për të shmangur dështimin e bankës duke mos marrë në konsideratë natyrën e rrezikut të rastësishëm.
- Llogaritje të thata të rrezikut të palës tjetër, duke mos marrë në konsideratë rrezikun e monedhës dhe rrezikun makroekonomik.
- Diferencime të reduktuara të rrezikun të kredisë, duke i bashkëngjitur të njëjtën sasi rreziku për të gjithë komponentët e kapitalit.
- Mungesa e diversifikimit të portofolit, që ofron një llogaritje të gabuar të rrezikut të portofolit.

Marrëveshja e 1988 dhe amendamenti i bërë në vitin 1996 e udhëhoqën Komitetin e Bazelit për të dalluar disa kufizime të kësaj marrëveshje. Së pari, llogaritja e vlerës në rrezik (VaR) është konsistente vetëm nëse janë plotësua katër kushtet 1- uniformiteti, 2- invarianca e përkthimit, 3- homogjeniteti, dhe 4- nën-mbledhja (ndikimi në matjen e rrezikut kur bashkojmë dy portofole, nuk duhet të jetë më e madhe se shuma e masave të rrezikut të çdo portofoli). Llogaritjet nëpërmjet VaR i plotësojnë tre kushtet e para, por jo të katërtin, kusht ky në rastin e portofolëve të larmishëm të letrave me vlerë. Përveç mos-respektimit të kushtit të katërt, metoda VaR nuk merr parasysh paqëndrueshmërinë historike apo mundësinë e të pasurit një "tharje" të likuiditetit. Pra, VaR nuk ofrojnë një masë të qëndrueshme të rrezikut, kutu ka vend për diskutim, duke bërë që Bazel të injorojë

në mënyrë të qartë teorinë moderne të portofolit dhe paraqisë një vlerësim të pamjaftueshëm të rrezikut. Së dyti, kjo paketë rregullimi bankar peshon mbi kthimin mbi kapitalin e bankës (Rezultati Neto = të ardhurat neto / kapitalin: nëse kapitali është rritur, ulet Rezultati Neto). Për të kompensuar këtë ulje të rendimentit të aksionerit, banka e riorganizon portofolin e saj duke respketuar kushtin mbi kapitalin. Duke patur kështu një probabilitet dështimi më të madh. Marrëveshja gjithashtu u përqëndrua kryesisht në rregullat mikro-prudenciale në vend që të përfshinte edhe rregullat makro-prudenciale.

3.1.4 Krijimi i Marrëveshjes së Bazel II, limitet dhe dështimi i saj

Komiteti i Bazelit, në vazhdimësi të analizave të kryera përpiloi dhe propozoi një marrëveshje të re nën emrin Bazel II, të cilët e njohim gjithashtu si qasja me "Tre Shtylla". Mund ti referohemi Figurës 2.2. më poshtë. Shtylla e parë përbën në fakt përbërjen e plotë të marrëveshjes së parë të modernizuar me disa ndryshime, sepse siç e kemi cituar si më parë, rregulloret lidhur me kërkesat e kapitalit janë më të rëndësishmet. Rreziku i kredisë dhe rreziku i tregut janë gjithashtu pjesë e marrëveshjes Bazel II, dhe ata mishërojnë thelbin e marrëveshjes. Në të kundërtën, ka pasur një përmirësim të bërë për këtë shtyllë në krahasim me marrëveshjen e Bazel I, është shtuar rreziku operacional.



Figura 3.2 Struktura e Marrëveshjes së Bazel II (Bank for International Settlements)

Rreziku operacional harton humbjen e provokuar nga operacione të tilla si rreziku i dështimit të brendshëm, si dhe sistemi i jashtëm, procesi apo edhe dështimi i individit. Përjashtime janë bërë për rrezikun e reputacionit apo rreziqet strategjike. Shtylla e dytë, "Procesi i Rishikimit të Mbikëqyrjes", ka si objektiv kryesor për të siguruar zbatimin korrekt të kërkesave të kapitalit bazuar në rrezik dhe për të motivuar gjallërisht bankat për kërkimin dhe përmirësimin e menaxhimit të rrezikut në institucionet e tyre. Katër parimet kryesore të shtyllës janë:

- ➔ Parimi 1: Bankat duhet të ketë një proces për vlerësimin e përgjithshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit të tyre në lidhje me profilin e tyre të rrezikut dhe një strategji për ruajtjen e niveleve të tyre të kapitalit.
- ➔ Parimi 2: Mbikëqyrësit/rregullatorët duhet të shqyrtojnë dhe vlerësojnë vlerësimet e brendshme të bankës për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe strategjive, si dhe aftësinë e tyre për të monitoruar dhe për të siguruar përputhjen e tyre me raportet e kapitalit rregullator. Mbikëqyrësit/rregullatorët duhet të marrin masat e duhura mbikëqyrëse në qoftë se ata nuk janë të kënaqur me rezultatin e këtij procesi.
- ➔ Parimi 3: Mbikëqyrësit/rregullatorët duhet të presin që bankat të veprojnë mbi raportet minimale rregullatore të kapitalit dhe duhet të ketë aftësinë për të kërkuar nga bankat që të mbajnë kapitalin në tepri përtej kapitalit minimal.
- ➔ Parimi 4: Mbikëqyrësi/rregullatori duhet të kërkojë për të ndërhyrë në një fazë të hershme për të parandaluar kapitalin nga rënia nën nivelet minimale të kërkuara për të mbështetur karakteristikat e rrezikut të një banke të veçantë dhe duhet të kërkojë veprime korrigjuese të shpejta në qoftë se kapitali nuk është i mirëmbajtur ose i rivendosur. "

Sipas këtij procesi mbikëqyrës, vlerësimi i e kapitalit të bankës është monitoruar rreptësisht për shkak të korrelacion direkt midis, nga njëra anë kapitalit të bankës në lidhje me rrezikun e saj dhe nga ana tjetër mirësisë së menaxhimit të rrezikut. Fushat kryesore të ndjeshme nga monitorimi nën shtyllën e dytë janë rrjedhjet e shtyllës së parë të tilla si, faktorët dhe rreziqet nuk merren në konsideratë nga shtylla e parë, por edhe disa faktorë të jashtëm të tilla si efektet e ciklit të biznesit etj.

Shtylla e fundit por jo më pak e rëndësishmja, është shtylla e tretë, ku qëllimi i saj është që t'i plotësojë e përmbushë dy të parat. Objektivi i kësaj shtylle qëndron në mirë sigurimin e informacionit nga pjesëmarrësit në treg nëpërmjet dhënies së informacioneve shpjeguese nga tregjet që sigurojnë disiplinën e tregut. Këto dhënie informacionesh shpjeguese (zbulime) janë të aplikuara gjerësisht; ato mund të jenë në strukturën e kapitalit ose mjaftueshmërinë, mbi rrezikun e kredisë të nivelit të portofolit ose në nivel të një banke, në zbutjen e rrezikut të kredisë, ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë të palës tjetër, për sigurimin e kredive, rrezikun operacional ose rrezikun e tregut, në letrat me vlerë apo rreziqet e normave të interesit. Më poshtë ju mund të gjeni një template të strukturës së zbulimit të informacionit nën Figurën 2.3.



Figura 3.3 Struktura Zbulimit të Informacionin nën Marrëveshjen e Bazel II (Burimi: BIS)

Duke u mbështetur mbi komponentin më të rëndësishëm por gjithashtu target të këtij studimi, do t'i kushtohet kryesisht vëmendje Shtyllës së parë, e cila është shtylla më e drejtpërdrejtë që prek çështjen e llogaritjes së mjaftueshmërisë së kapitalit, dhe është gjithashtu shtylla që tenton në mënyrë specifike për të korrigjuar mangësitë e identifikuara

në Bazel I. Para se të eksplorojmë Shtyllën e parë në thellësi, është e rëndësishme të vëmë në pah komponentët e Bazel I që nuk janë ndryshuar në përditësimin e marrëveshjes. Bazel II ende kërkon që përqindja e totalit të kapitalit të një banke të jetë e barabartë të paktën me 8% të aktiveve të bankës të ponderuara me rrezik, duke ruajtur po prapë të njëjtën mënyrë të llogaritjes së kësaj përqindjeje. Bazel II nuk ka ndryshuar përkufizimin e kapitalit nga Bazel I, dmth, numëruesin e raportit. Megjithatë, siç do të shihet më poshtë, Bazel II, ose më konkretisht, Shtylla e parë e saj, do të ndryshojë mënyrën se si një bankë llogarit emëruesin, dmth llogaritja e aktiveve të ponderuara me rrezik. Kështu, kërkesat e kapitalit mbulojnë një gamë të gjerë të rreziqeve: rrezikun e kredisë, rrezikun e tregut dhe rrezikun operacional. Konsiderimi i rrezikut operacional është pikërisht një risi. Komiteti i Bazelit vendosi të përfshijë në llogaritjen e raportit të kapitalit këtë lloj rreziku sepse ka një numër në rritje i gabimeve infromatike dhe bankat janë më të ndjeshëm ndaj problemeve të operacioneve të brendshme. Përveç kësaj, Bazel II i lejon dhe madje i nxit bankat të zhvillojnë, nën kushte të caktuara, modele të brendshme për të vlerësuar rrezikun e tyre të kreditit, duke ditur që qasja e Vlerës në Rrezik është shumë popullore për arsyet e përmendura më lart model. Me këto ndryshime prezantohet raporti i ri nën emrin "Raporti Mc Donough". Ky raport përfshin tashmë rrezikun operacional dhe të masave të reja të rrezikut të kredisë (më moderne nën optikën e evoluimit të teknologjisë). Raporti shprehet nga:

$$\textbf{\textit{Raporti Mc Donogh}} = \frac{\textbf{\textit{Totalin e Kapitalit të Vet}}}{\begin{array}{c}\textbf{\textit{Rrezikun e kredisë}}(\mathbf{85}\%) + \\ \textbf{\textit{Mbulimi me kapital nga rreziku i Trefur}}\ (\mathbf{5}\%) + \\ \textbf{\textit{Mbulimi me Kapital nga Rreziku Operacional}}\ (\mathbf{10}\%)\end{array}}$$

Siç u përmend më lart, Shtylla e parë trajton mënyrën nëpërmjet të cilës banka llogarit aktivet e saj të ponderuara me rrezik. Shtylla I u projektuar posaçërisht për të korrigjuar mangësitë e identifikuara në Bazel I. Si e tillë, Shtylla I fokusohet kryesisht në reformimin e metodës së matjes së rrezikut të kredisë, pra, të rrezikut në aktivet e bankës. Qëllimi i këtyre reformave është të sigurojë se llogaritja e rrezikut të një aktivi të bankës pasqyron sa më saktë rrezikun aktual të aktivit në fjalë, duke zvogëluar mundësinë për bankat që të angazhohen në arbitrazh rregullator, i cili ishte një nga problemet më të mëdha me Bazel I .

Në tabelën e mëposhtme, Tabela 2.2, mund të vëzhgojmë ndryshimet nën mrrëveshjen Bazel II për sa i përket ponderimit të rrezikut përpara risive shtësë në llogaritjen e këtij ponderimi.

Pesha	**Aktivi (shembull)**
0%	Para në dorë dhe mjete ekuivalente
35%	Hua hipotekore
75%	Hua për automjete
100%	Real estate komerciale
100%	Asete të tjera
Sipas vlerësimit	Bono thesari
Sipas vlerësimit	Hua ndërbankare
Sipas vlerësimit	Hua të korporatave

Tabela 3.2 Peshat e Rrezikut sipas Bazel II

Qasja e Shtyllës I për matjen e rrezikut të kredisë në të vërtetë përbëhet prej tre qasjesh: Qasja e Standardizuar, Qasja e bazuar në Vlerësimet të Brendshme Bazë (FIRB, Foundation Internal Ratings-Based), dhe Qasja e bazuar në Vlerësimet e Brendshme të Avancuara (AIRB, Advanced Internal Rating-Based). Kështu, Bazel II ofron një menu opsionesh për përcaktimin e rrezikut e të kreditit në banka. Qasja e standardizuar është qasja më pak kompleke prej të trejave, e cila është më e afërta edhe me qasjen e Bazel I. Qasja e standardizuar ruan përdorimin e "kovave" të rrezikut për të përcaktuar vlerën e rregulluar nga rreziku të një aktivi. Ajo çka ndryshon me Bazel I është mënyra e peshimit/ponderimit nga rreziku. Së pari, qasja e standardizuar e Bazel II zgjeron numrin e kovave të rrezikut nga katër në gjashtë. Përveç kategorive 0%, 20%, 50%, dhe 100% të rrezikut të përdorura nën Bazel I, qasja e standardizuar gjithashtu përfshin një kategori të rrezikut 150%, si dhe një kovë të rrezikut me 35% të drejtuar në mënyrë specifike për kredi banesash të siguruara nga hipotekat . Dallimi tjetër me Bazel I është procesi i përcaktimit se në cilën kovë një aktiv duhet vendosur. Duke pranuar se nuk ka dy aktive me profile identike rreziku, qasja e standardizuar e Bazel II përpiqet të bëjë përcaktimin e koefiçient të ponderimit të rrezikut të bazuar mbi rrezikun e profilit unik të secilit aktiv të bankës. Për

këtë, qasja e standardizuar shfrytëzon agjensitë e e vlerësimit të kredive (credit-rating), të tilla si Standard & Poor dhe Moody[16]. Prandaj, nën qasjen e standardizuar, pasuritë janë vendosur në kova të rrezikut të bazuar në klasifikimin e kredive të caktuara të palës tjetër të përfshirë në këtë aktiv, duke patur kështu klasifikimin në kove rreziku të ulët kur kemi një vlerësim (rating) të lartë të palëve të treta. Për shembull, nëse një huamarrës komercial merr një vlerësim AAA nga Standard & Poor, kredia e tij do të vendoset në kovën me 20% rrezik, ndërkohë që me qasjen e Bazel I, kjo lloj kredie do të klasifikohej automatikisht në kovën me rrezik 100% nga fakti i të qënit një huamarrje në sektorin privat. Në të kundërt nëse vlerësimi i agjensisë është i ulët, kredia do të peshohet më një rrezik më të lartë. Qasja e standardizuar bën një përjashtim në metodën e klasifikimit të kredive për kreditë për banesa, të cilat marrin automatikisht një peshë të rrezikut prej 35%. Ponderimi i rrezikut të një aktivi nuk varet vetëm nga vlerësimi por edhe nga fakti nëse huaja adresohet nga qeveria. Duke i renditur kështu në kovën me 0% rrezik, ndërkohë që për huanë e sektorit privat, qoftë edhe me një vlerësim shumë të lartë do të kemi një kategorizim në kovën e rrezikut 20%. Më poshtë në tabelën 2.3 do mund të orientohemi mbi shembuj të ponderimit të rrezikut nga vlerësimet e përcaktuara të aktiveve (duke përdorur shkallën e vlerësimit të) dhe nëse ata përfaqësojnë pretendime mbi qeveritë ose palëve private[17].

Vlerësimi i kredive (nga Standard & Poor)	**Ponderimi me rrezik kundrejt qeverisë**	**Ponderimi me rrezik kundrejt sektorit privat**
Aaa deri në Aa1-	0%	20%
Aa2 deri në A1	20%	50%
A2deri në Ba1	50%	100%
Nën Ba2	150%	150%
Të pa vlerësuara	100%	100%

Tabela 3.3 Ponderimi i Rrezikut sipas Bazel II

[16] Në Shtojcën 3 mund të gjeni një përmbledhje tabelare të vlerësimeve sipas këtyre dy agjnsive të konsideruara më të rëndësishmet.
[17] Në tabelë përjashtohet kova e rrezikut 35% duke qënë se i përket ekskluzivisht huave hipotekore.

Qasja e standardizuar duke qënë se është edhe me e thjeshta nga të tre qasjet është më e përshtatshme dhe e shpejtë në aplikim sidomos për bankat e vogla. Të dy qasjet e mbetura, janë të përshtatshme për bankat më të mëdha dhe më të sofistikuara. Dallimi kryesor mes qasjes së standardizuar dhe dy qasjevetë tjera është fakti që bankat mund të mbështeten në modelet e tyre të brendshme të ponderimit me rrezik të aseteve të tyre, ndërsa në qasjen e standartizuar ato mund të mbështeten vetëm në kategoritë e paracaktuara që pamë më lart. Për shkak të natyrës së sofistikuar të dy qasjeve të tjera bankat duhet të demonstrojnë aftësinë e tyre teknike për implementimin e tyre dhe gjithashtu duhet të marrë miratimin nga rregullatorët e tyre nëse dëshirojnë t'i përdorin ato.

Metodologjia e dy qasjeve të mbetura mbështet mbi konceptin e humbjeve "të papritura". Këto humbje të papritura përafrojnë në fakt rrezikun e kredisë së bankës, pra vlerësojnë humbjet potenciale në nivelin e aktive të bankës, humbje të cilat nuk priteshin, në mënyrë për të vlerësuar nivelin e kapitalit që duhet bllokuar për të mbuluar këto humbje. Humbjet në një aktiv të bankës janë një pjesë normale e biznesit bankar, dhe për pjesën më të madhe, bankat mund të parashikojnë dhe të përgatiten për këto humbje "të pritshme" në të ardhmen duke u mbështetur në normat e humbjeve në të kaluarën. Megjithatë, ka raste kur një bankë pëson humbje më të mëdha se zakonisht. Këto humbje mbi nivelet mesatare janë pikërisht humbjet e papritura të një banke. Fakti që nga vetë përkufizimi humbjet e pritshme priten, banka i mbulon ato (provigjonimet), ndaj janë nivelet e humbjeve të papritura të cilat duhen vlerësuar dhe mbuluar me nivele "jastëkësh" kapitali.

Për të arritur në vlerësimin e humbjeve të papritura, janë përdorur katër lloje hyrjesh (të katërta të përbashkëta si për qasjen FIRB edhe për atë AIRB). E para është probabiliteti i parazgjedhur, i cili mbështetet në historikun e kaluar për vlerësimin e një niveli probabilitar për ngjarjen e dështimit të një huamarrësi në shlyerjen e huasë së tij. Hyrja tjetër është Humbja e Dhënë Parazgjedhur, e cila bazohet në llogaritjen e vlerës së humbur nëse një huamarrës falimenton. Hyrja e tretë është Ekspozimi i Rastësishëm, i cili përcakton vlerën shtesë që mund të humb banka nëse një huamarrës falimenton, (rasti i overdraft-eve të papërdorura plotësisht). Së fundi, hyrja e katërt është Maturimi i Aktivit, i cili përmbledh rritjen e rrezikut potencial të një humbjeje kur kemi maturim të lartë të

aktivit (pra të kohëzgjatjes së kredisë). Sa më e lartë të jetë kohëzgjatja aq më shumë gjasa ka të ndodhë diçka që mund ti provokojë humbje bankës zotëruese të këtij aktivi. Pasi përcaktohet secila prej këtyre hyrjeve për secilin prej aktiveve të bankës, integrohen në modelet komplekse matematikore që arrijnë në një vlerësim të humbjeve të papritura të bankës (pra kuantifikohet rreziku i kredisë së bankës). Bankat nga ana tjetër duhet tanimë të sigurohen që të kenë kapital të mjaftueshëm të paktën në nivelin e 8% të kësaj shume të ponderuar me rrezik.

Ashtu si me Bazel I, edhe Bazel II ka përjetuar pjesën e vet të kritikave. Së pari, në lidhje me qasjen e standardizuar, ku të shumtë qenë ata që e vunë në dyshim përdorimin e agjensive të vlerësimit për të përcaktuar rrezikun e një aktivi. Fakti që agjensitë e vlerësimit paguheshin nga ata të cilët ata do të vlerësonin, u ngritën shqetësime në lidhje me besueshmërinë dhe objektivitetin e vlerësimeve të parashikuara. Ndoshta shembulli më i qartë i të metave në modelin e agjensive të vlerësimit të kredisë ishte dështimi i tij për të vlerësuar kreditë e momentit që ka ndodhur para dhe gjatë krizës financiare globale, sidomos nënvlërësimi i aktiveve sub-prime. Së dyti kërkesat e reja të kapitalit rregullator çojnë në një konflikt interesi për bankat. Nga njëra anë, rregullatorët duan që bankat të përmbushin kërkesat e aftësisë paguese dhe nga ana tjetër, dhuruesit e fondeve,aksionerët, duan rentabilitet të fondeve për të siguruar një kthim të lartë mbi kapitalin, dhe në kushtet e reja kanë frikë se kërkesat e kapitalit do të zvogëlojnë rentabilitetin e tyre nga ulja e mundësisë së përdorimit të levave. Një zgjidhje që bankat ndërmorën ishte të mos e mbanin një pjesë të mirë të rrezikut duke preferuar ta transferojnë rrezikun nëpërmjet titrizimit të kredive (kalimit të mjeteve jo shumë likuide në mjete më shpejt të negociueshme në treg), nëpërmjet transaksioneve të derivativëve të kreditit ose të strukturonin produktet nëpërmjet ndërmjetësve të tjerë financiarë që nuk janë subjekt i kërkesave të kapitali. Prandaj, zbatimi i Bazel II ka patur një ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e përdorimit të titrizimit të kredive nga ana e bankave. Për më tepër, rreziku moral këtu ka një efekt amplifikues të titrizimit të kredive. Si? Duke titrizuar kreditë bankat kryen transferimin e rrezikut të kredive të ndryshme. Banka që shet këto kredi, të cilat i ka lëshuar ajo vetë, mund të vazhdojë veprimtarinë e saj me kapital të paprekur.

Ky model i quajtur "originate and distribute" (krijo dhe shpërnda), shpjegon veprimin e bankës e cila mbledh një paketë produktesh të ndryshme dhe i shet tek një agjent tjetër. Titrizimi pra, ka qënë një amplifikator i krizës. Gjendja qe e tillë që bankat kishin paketa kredish të vëna në aktive SPV (Special Purpose Vehicle) [18], dhe kredi të tjera hipotekore. Rreziqet u nënvlerësuan pjesërisht për shkak të investitorët pas rënies së sektorit të Informacionit dhe Telekomunikacionit, nxituan ti drejtoheshin tregut të pasurive të patundshme, i cili konsideroj si më i sigurti dhe më fitimprurësi. Kështu, rreziku i dështimit të këtyre paketave u supozua të ishte më i ulët se sa rreziku i kredive përbërëse të marra veçmas, ndërkohë kjo është e vërtetë vetëm nëse kreditë janë të lidhura me njëra-tjetrën, gjë që nuk ishte e vërtetë, sepse ato ishin të lidhura me tregun e pasurive të patundshme në Shtetet e Bashkuara. Për pasojë, rënia e çmimeve të banesave në SHBA shkaktoi një kolaps në vlerat e aseteve SPV.

Titrizimi i kredive hipotekore gjithashtu përbën problem pasi bankat në këtë rast targetojnë sasi e jo cilësi sepse sapo paguajnë komision e tyre, ato kryejnë mënjëherë shitjen. Kështu, problemi i rrezikut moral amplifikon mekanizmin e letrave me vlerë (titrizimin). Për më tepër, ne mund të përmendim edhe faktorë të tjerë që e përkeqësuan krizën si deklarimi i të ardhurave të pritshme shumë të larta nga ana e investitorëve, gjë që bëri që bankat ti drejtoheshin titrizimit duke marrë më pak rrezik ose duke e transferuar atë dhe për pasojë ato u ballafaquan me kërkest më të ulëta në krahasim me kapitalin e tyre.

Për të konkretizuar këto mekanizma mund të përmendim rastin e kolapsit të Lehman Brothers. Në fakt, para rënies së çmimeve të shtëpive, bankat ishin të gatshme të bënin gjithçka për të rritur rentabilitetin e tyre, Lehman Brothers nuk bëntë përjashtim nga ky "ves". Nëpërmjet teknikave të kontabilitetit, kompania mundi të fsheh nivele shumë të larta të borxhit duke përdorur një efekt shumë të lartë të levave. Me një nivel borxhi shumë të lartë dhe nivel kapitali të vet shumë të ulët, kompania nuk mundi ti bëjë ballë detyrimeve të veta përgjatë krizes. Ndaj dhe në shtator 2008 ajo deklaroi falimentin e saj. Rregullorja

[18]Gjithashtu të referuara si një "entitet largim-falimentimi" operacionet e të cilëve janë të kufizuara në blerjen dhe financimin e aseteve specifike. SPV është zakonisht një kompani ndihmëse me një strukturë aktivi / detyrimesh dhe statusi juridik që i bën obligacionet e saj të sigurta edhe në rastin e falimentit të kompanisë mëmë.

pra, i "nxiti" bankat të përdorin në masë mekanizmat e letrave me vlerë në mënyrë që ti shmangeshin pikërisht detyrimeve apo kufizimeve në lidhje me nivelin e kapitalit rregullator. Në situatën e një krize si pasojë e përdorimit të lartë të levës dhe të "shpërthimit" të flluskës imobiliare, mekanizmat e titrizimit e rënduan më tej situatën e krizës.

Një tjetër kritikë e adresuar për Bazel II është efekti pro-ciklik mbi kapitalin. Në fakt, rregullimi i kapitalit e ka për qëllim të ketë një karaktet pro-ciklik kur ekonomia është në një fazë recesioni. Gjatë një rënieje ekonomike, rritet rreziku i dështimit, aktivet e marra nga bankat nëpërmjet kredidhënies janë më të rrezikshme, ndaj për një sasi të caktuar të kapitalit, bankat do të reduktojë ndjeshëm kredidhënien e tyre. Me uljen e leshimit të kredisë në vetvete tendenca e recesionet rritet akoma më shumë duke rritur efektin e vorbullës "spin"[19]. Mund ti drejtohemi Figurës 2.4 për një pamje më vizuale të këtj rrethi vicioz.



Figura 3.4 Skema efektit pro-ciklik të kapitalit të vet

[19]Sistemi i një rrethi vicioz ku pasoja behët shkak dhe vazhdohet pambarimisht në këtë vorbull.

Komiteti i Bazel kreu disa përmirësime, madje u përpilua edhe një version i rishikuar i quajtur Bazel 2.5, por përsëri, marrëveshja e dytë e provoi veten të pamjaftueshme. Objektivat kryesore të fiksuara dështuan. Në fakt, marrëveshja, pa dashur, favorizoi bankat e mëdha ndërkombëtare dhe uli nivelet e konkurrencë së barabartë. Ajo siguroi një menaxhim më të mirë të rrezikut, por në anën tjetër ka dështuar modelin e brendshme bankar. Kriza tregoi në fakt rrjedhjet e marrëveshjes së Bazel II, ku mund të rreshtojmë këtu edhe disa kritika të tjera:

- Mungesa e të dhënave adekuate që provokojë asimetri të informacionit.
- Mungesa e kapaciteteve për shkak të përgjegjësisë së lartë të rregullatorëve.
- Mungesa e hipotezave efiçente të tregut nga besimi në të kaluarën e mungesa e largpamësisë.
- Menaxhimi i dobët i krizës për shkak të mungesës së liderëve evropianë të "shpresës së fundit"[20].
- Mungesa e zbatimit të rrezikut sistemik dhe të likuiditetit.
- Implementimi i vështirë i rrezikut operacional.

Të gjithë këto kritika të cituara tregojnë në mënyrë të qartë nevojën e një strukture më të detajuar dhe specifike në nivelin e mbikëqyrjes dhe rregulloreve prudenciale. Edhe me rishikimet e disa nën-ndarjeve të caktuara, situata në tregjet financiare në vitin 2008-2009 kishte nevojë për një trajtim më të mirë.Kriza financiare e vitit 2008, shihet gjithashtu si kriza më e rëndë financiare që nga Depresioni i 1930-s. Në fakt, "gabimet" apo më shumë mungesat e Bazel II filluan të bëhen të dukshme për anëtarët e Komitetit të Bazelit edhe para fillimit të krizës financiare globale. Kur filloi kriza, bisedimet mbi se si të përmirësohet Bazel II ishin tashmë në proces, një proces i cili u konkretizua në vjeshtë të vitit 2010, ku pas shumë debatesh dhe negociatave, Komiteti i Bazelit publikoi përditësimin e fundit të marrëveshjes, dhe arriti në Bazel III.

[20] Last resort institutions

3.2 Komiteti i Bazelit Dhe Marrëveshja Bazel III

3.2.1 Nevoja e rishikimit, një përkufizim i ri i strukturës së kapitalit

Krizat e egër që preku tregjet financiare ndërkombëtare tregon nevojën e "egër" për përmirësime të sistemit rregullator të mbikëqyrjes së tregut. Në fakt disa nga "rrjedhjet" e tregut të vërejtura me kalimin e kohës, të përsëritura ose jo, i orientojnë autoritetet mbikëqyrëse për të përcaktuar korniza më të rrepta dhe të qarta ndërkombëtare lidhur me harmoninë e tregjeve financiare. Marrëveshja Bazel III u ndërtua mbi skeletin ekzistues të kuadrit rregullator të Bazel II dhe përmirësimet e bëra gjatë versionit 2.5 të tij. Bazel II, lëshuar në vitin 2004, ishte i njohur për përmirësimet e bëra në matjen e rrezikut të kredisë, me një implementim të plotë në fund të 2006, përmirësimi Bazel 2.5 i vitit 2009, u konceptua për të përmirësuar matjet e rreziqeve të mekanizmave të letrave me vlerë dhe ekspozimeve tregëtare, e menduar të implementohet në fund të vitit 2011.

Por në dhjetor të vitit 2010, Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare u takuan përsëri për ta zgjidhur me marrëveshjen e tretë, Bazel III, e cila prezantoi risinë e një kuadri likuiditeti dhe kishte për qëllim kryesor që të kënaqte nivele më të larta për kërkesat e kapitalit. Bazel III përbën një paketë të ndryshimeve që u planifikuan të fillojnë më 1 janar 2013 dhe, bazuar në skemën kohore, periudha e zbatimit do të mbahet deri në vitin 2022. Mund të hedhim një vështrim në Figurën 2.5 më poshtë për të parë datat kyç të kësaj marrëveshje.



Figura 3.5 Datat kyçe të marrëveshjes Bazel III

E diel, 12 shtator 2010, Komiteti i Bazelit votoi "Bazel III", e marrëveshje u konfirmuan në Samitin e G20 në Seul në 11 dhe 12 nëntor. Si marrëveshjet paraardhëse mbi rregullimin bankar, qëllim është të sigurojë që në të ardhmen, bankat mund të përthithin humbjet dhe të shmangin dështimet e tilla si të bankës Lehman Brothers. Marrëveshjet e Bazelit mund ti shohin si kukullat ruse, të cilat në rast pamjaftueshmërie plotësohen e me një kukull më të madhe e cila përmban më të voglat. Në këtë formë kjo rregullore është më gjithë përfshirëse se e mëparshmja dhe plotëson kufizimet e rrjedhjet e Bazel II, kështu, Bazel III paraqet një strukturë të re të kapitalit. Qëllimet kryesore të marrëveshjes së re Bazel III ishin pikërisht 1- Forcimi i strukturës së kapitalit dhe 2- Prezantimi i standarteve globale të likuiditetit.

Komiteti i Bazelit synon forcimin e kornizës së kapitalit rregullator duke u mbështetur mbi tri shtyllat e marrëveshjes Bazel II por natyrisht duke i përmirësuar dhe shtuar ato. Bazel III përbëhet atëherë nga shtyllat e kapitalit si dhe risinë e përshirjes së likuditetit si njësi më vete për tu inkuadruar.[21]. Shtylla e parë përmban kuadrin rregullator mbi kapitalin, mbulimin e rrezikut dhe raportet e levës, shtylla e dytë përmban menaxhimin e rrezikut si dhe mbikëqyrjen dhe shtylla e tretë përmban kuadrin e disiplinës së tregut (do të zgjerohemi në vazhdim).

Reformate reja targetojnë rrtijen edhe në cilësi dhe në sasi të bazës së kapitalit rregullator si dhë rritjen e mbulimit të rrezikut të strukturës së kapitalit. Komiteti u mbështet gjithashtu në raportet e levave që shërbejnë si një ndihmë kundër rrezikut me qëllim të kufizojnë levat e tepërta në sistemin bankar dhe të sigurojnë një shtresë shtesë të mbrojtjes kundër rrezikut të modelit dhe gabimeve në matje. Së fundi, Komiteti ka përfshirë edhe një numër elementesh makro në kuadrin e kapitalit për të ndihmuar të përmbajë rreziqet sistemike që dalin nga natyra ciklike dhe ndërlidhëshmëria e institucioneve financiare.

Detaj i parë i rëndësishëm është ripërkufizimi i kapitalit, në fakt Bazel III ripërcakton kapitalin rregullator. Për të rritur qëndrueshmërinë, cilësinë dhe transparencën e kapitalit rregullator, komisioni përcaktoi se kapitali nën kategorinë "Tier 1" duhet të përbëhet nga kapitali i përbashkët dhe fitimet e pashpërndara. Sipas standardeve aktuale, ekzistojnë dy lloje të kapitalit në përmbushjen e rregullave për mjaftueshmërinë e tij: kapitali bazë dhe kapitalit shtesë. Sipas ndarjes së fundit të kapitalit kemi këto klasa :

- Tier 1: përbëhet nga dy pjesë. Së pari, kapitali bazë (i quajtur edhe Core Tier 1), i cili në vetvete është i përbërë nga aksione të zakonshme dhe fitimet e pashpërndara. Së dyti, kapitali i cili ndodhet midis kapitalit bazë dhe borxhit të varur.
- Tier 2 Borxhi i varur i cili ka një aftësi më të ulët për të përthithur humbjet .
- Tier 3 instrumentet kapitale që janë përdorur për të mbuluar rrezikun e tregut për të siguruar se rreziku është menaxhuar me kualitetit të barabartë në krahasim me rreziqet operacionale dhe të kreditit.

[21] Mund të gjeni në ankesin 5 një diagramë të shtyllave dhe përbërsve të tyre në detaj sipas BIS.

Bazel III i ruan kategoritë Tier 1 dhe Tier 2, por kufizon përbërjen e tyre me cilësi më të lartë të kapitalit i cili është akoma më shumë në gjendje për të përthithur humbjet. Sipas Bazel III, kapitali Tier 1 duhet të jetë kryesisht i përbëra nga "kapitali bazë", i cili përbëhet nga kapital aksioner dhe fitimet e pashpërndara. Përveç kësaj, shumë instrumente të kapitalit që ishin të përfshira më parë në llogaritjen e kapitalit të një banke sipas Bazel II, duke përfshirë edhe disa forma të borxhit të varur, do të përjashtohen nën Bazel III. Këto instrumente të kapitalit që nuk do të kualifikohen si "kapital" nën Bazel III do të zbehen nga llogaritja e kapitalit të bankës gjatë një periudhe dhjetë-vjeçare duke filluar nga viti 2013. Kjo periudhë tranzicioni do ti ndihmojë bankat që aktualisht nuk posedojnë sasi të mjaftueshme apo lloje të kapitalit që të mund të përputhen me kërkesat e reja.

Në të vërtetë, ka disa instrumente të kapitalit që nuk plotësojnë më përkufizimin e kapitalit. Ky është “emri i mirë”, interesat e pakicave, furnizimet e deficitit dhe aktivet tatimore të shtyra dhe në fund investimet në institucionet e tjera financiare të tilla si aksionet e veta ose ato që banka ka në një kompani të sigurimit. Qëllimi i këtyre përjashtimeve është për të shmangur numërimin e dyfishtë të kapitalit. Vini re gjithashtu se nën Bazel III do të eliminohet kategorizimi tre shtresor ikapitalit duke eliminuar kështu Tier 3-shin.

Lidhur me sasinë e kapitalit, Bazel III bën kalimin e Tier 1 nga niveli 4% ne nivelin 6% dhe do të kalojë kapitalin bazën nga niveli 2% në nivelin 4.5% të totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik. Sa për kategorinë Tier 2, ajo mund të jetë deri në 2% duke patur parasysh se shuma totale e kapitalit të kërkuar mbetet në nivelin 8%. Si me Bazel II, bankat edhe nën Bazel III duhet të mbajë një raport minimal të totalit të kapital prej të paktën 8% të aktiveve të ponderuara me rrezik. Në shikim të parë, kërkesa minimale e kapitalit mbetet 8%, gjë qëmund të sugjeroj se nuk ka rritje në kapital.

Në realitet, ka një rritje të kërkesës së kapitalit nga futja e dy “jastekëve”të kapitalit, jastëku i konservimit të kapitalit dhe jastëku kundër-ciklik i kapitalit (për të cilët do të zgjerohemi më poshtë), të cilët kanë për qëllim të sigurojnë që bankat të kenë nivele të mjaftueshme të kapitalit për të thithur humbjet e aktiveve, veçanërisht gjatë periudhave të stresit financiar dhe ekonomik. Deri në aplikimin dhe implementimin e plotë të Bazel III

në 2022[22], bankat pritet të mbajnë një raport total kapitali prej 10.5%, një rritje nga kërkesa në nivelin 8% nën Bazel II. Lidhur me cilësinë e kapitalit, mund të shohim shumë lehtë dhe qartë se ajo është përmirësuar në masën ku pjesa e kapitalit të vet është më e mirë.

Në përfundim, bankat jo vetëm që do të sigurojnë një pjesë më të madhe të kapitalit të bilancit të gjendjes së tyre, por gjithashtu duhet të marrin parasysh faktin se marrëveshja e re përfshin në llogaritje shumë më pak instrumenta të kapitalit. Në tabelën e mëposhtme, Tabela 2.3, paraqitën ndryshimet në krahasim me marrëveshjen Bazel II, dhe gjithashtu mund të vëzhgohen risitë e prezantuara nga marrëveshja e re.

Kërkesa apo raporti	**Nën Bazel II**	**Nën Bazel III**
Raporti i Tier 1	4%	6%
Raporti i Tier 1 në kapital të përbashkët	2%	4.5%
Raporti Total i Kapitalit	8%	8%
Raporti i Levës	3% (vetëm për SHBA)	3%
Jastëku i Konservimit	N/A	2.5%
Jastëku Kundr-ciklik	N/A	2.5%
Raporti i Mbulimit me Likuiditet	N/A	Asete të mjaftueshme likuide për të mbuluar me para neto daljet mbi 30 ditë
Raporti Neto i Financimeve të Qëndrueshme	N/A	Financimi i qëndrueshëm duhet të tejkalojë nevojën në periudhë stresi të zgjatur mbi 1 vit

Tabela 3.4 Krahasimi i kërkesave të kapitalit Bazel II-Bazel III

[22]Në shtojcën 4 mund të gjeni të gjitha fazat e implementimit të kërkesave të kapitalit dhe likuiditetit të strukturës së Bazel III

Në grafikun e mëposhtëm mund të shohim një prezantim kohor dhe përshkrues të gjithë komponentëve të raporteve të kërkesës së kapitalit. Duke filluar nga viti 2012 e deri në vitin 2019, ku është planifikuar edhe implementimi i plotë i marrëveshjes, kemi rritjen progresive të secilit përbërës, përkatësisht nivelit të mjaftueshmërisë të kapitalit bazë nën Tier 1, nivelit të mjaftueshmërisë në kapitalin e mbetur të kategorisë Tier 1, nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit nën Tier 2, si dhe dy jastekët mbrojtës të kapitalit.



Grafiku 3.1 Evoluimi Kronologjik i Raporteve Të Kërkesave të Kapitalit

3.2.2 Risitë dhe përmirësimet e Bazel III

Në seksionin e mëparshëm mundëm të prezantonihemi me qëllimet e rishikimit të marrëveshjes së Bazel III dhe pjesës më kryesore të saj, siç ishtë ripërkufizimi dhe rillogaritja e kapitalit dhe kërkesave minimale të kapitalit. Por këto të fundit nuk janë e vetmja pjesë e marrëveshjes. Për të arritur qëllimet kryesore të saj, për stabilitet dhe harmoni në tregjet financiarë ndërkombëtarë, marrëveshja e Bazel III fokusohet gjtihashtu në disa elementë të rinja si:

A) *Krijimi i jastëkëve të konservimit të kapitalit*

B) *Krijimi i jastëkëve kundër-ciklik të kapitalit*

C) *Krijimi i Raporteve të Likuiditeit dhe Raportit të Levës*

D) *Mbulimi i rrezikut*

Le të fillojmë nga prezantmi i të parit.

A) Krijimi i jastëkëve të konservimit të kapitalit , *Capital Conservation Buffers*

Jastëku i konservimit është i përbërë nga aksionet e zakonshme dhe i bashkangjitet, duke e shtuar kështu, kapitalit të përbashkët. Në pikëpamje të dy rregullave të para prudencile (përcaktimi i kapitalit dhe jastëku i konservimit), ky i fundit rritet tashmë në nivelin e 7% , i përbërë 4.5% nga përllogaitjet e derimëtanishme nga kapitali i përbashkët i kategorisë Tier 1 dhe 2.5% nga jastëku i konservimit. Në sajë të këtij të fundit, mund të vëzhgojmë një rritje të qartë në cilësi e sasi të mjaftueshmërisë së kapitalit. Jastëku i konservimit të kapitalit do të implementohet mes 1 janarit 2016 deri në fund të vitit 2018 duke u bërë plotësisht efektive më 1 janar 2019. Ky nivel do të fillojë me vlerën 0,625% të aktiveve të ponderuara më 1 janar 2016 dhe do të rritet çdo vit pasues me nga një shtesë 0,625%, duke arritur në nivelin e saj përfundimtar prej 2.5% të aktiveve të ponderuara më 1 janar 2019[23].

Vendet që përjetojnë rritje të tepruar të kreditimit duhet të konsiderojë përshpejtimin e ndërtimit të këtyre jastëkëve. Autoritetet kombëtare kanë diskrecion të vendosin afate më të shkurtra tranzitore dhe duhet të bëjnë kështu në rastet kur është më e përshtatshme. Bankat që tashmë plotësojnë kërkesat minimale, por që mbeten nën 7% të kapitalit të përbashkët duhet të marrin masa e të përpilojnë politika të ruajtjes së fitimeve në mënyrë që të përmbushin sa më shpejt që të jetë e mundur kërkesat e plota. Në fakt, ky jastëk është përpiluar për të siguruar që bankat mund të mbajnë një nivel minimal të kapitalit gjatë recesionit ekonomik (në rast të humbjeve). Bankat që nuk plotësojnë këtë masë nuk mund të paguajnë dividentë apo shpërblime për punonjësit e tyre.

[23]Mund të drejtoheni në tabelën 3.3 për të parë ndryshimet me marrëveshjen Bazel II

Siç kemi vënë re, ka një periudhë tranzicioni për zbatimin e kërkesave të reja të kapitalit në mënyrë që ato të mos pengojnë rimëkëmbjen ekonomike globale. Në të vërtetë, kërkesat për rritjen e kapitalit për bankat kanë një ndikim mbi disa aktorë ekonomikë si në ekonominë reale edhe në sektorin financiar. Do të përqëndrohemi në efektet e kësaj marrëveshjeje më vonë.

B) Krijimi i jastëkëve kundër-ciklik të kapitalit, Capital Countercyclical Buffer

Humbjet e shkaktuara në sektorin bankar mund të jenë jashtëzakonisht të mëdha kur një rënie ekonomike paraprihet nga një periudhë e rritjes së tepërt të kredisë. Këto humbje mund të destabilizojë sektorin bankar dhe të "vënë në punë" një rreth vicioz, ku problemet në sistemin financiar mund të kontribuojnë në një rënie në ekonominë reale që pastaj ushqen përsëri një rënie në sektorin bankar e kështu me radhë duke u përsëritur. Këto ndërveprime nxjerrin në pah rëndësinë e veçantë të ndërtimit të mbrojteve në kapital shtesë të sektorit bankar përgjatë periudhave ku rreziqet e sistemit janë në rritje të dukshme. Marrëveshja e re Bazel III parashikon pra zbatimin e disa masave kundër-ciklike. Jastëku kundërciklik synon të sigurohet që kërkesat e kapitalit të sektorit bankar do të marrin parasysh mjedisin makro-financiar në të cilën operojnë bankat. Bankat do të duhet të krijojnë këta "jastëkë kundër-ciklik", të cilët do ti sigurojnë likuiditet bankës në rast të humbjeve të mëdha, duke shmangur nevojën për të ngritur menjëherë kapital të ri. Ky jastëk është i përbërë nga aksionet e përbashkëta dhe gjithashtu forma të tjera të kapitalit. Ky jastëk "kujdesi" do të variojë nga 0% deri në 2.5% të totalit të aktiveve. dhe i përgjigjet kështu problemit të pro-ciklit që rridhte nga marrëveshja Bazel II[24].

Për të aplikuar përfitimin ekonomik të këtij jastëku marrim një rast të një ekonomie në recesion. Koncepti i pro-ciklit sipas Bazel II thotë: "Në një recesioni, kërkesat e kapitalit janë pro-ciklike, që do të thotë që ato amplifikojnë recesionin". Le të drejtohëmi në Figurën 2.6 për të ilustruar më qartë ciklin e këtij fenomeni.

[24]Mund të drejtoheni në tabelën 3.3 për të parë ndryshimet me marrëveshjen Bazel II

Figura 3.6 Efekti i jastëkut kundër-ciklike në periudhë recesioni

Gjatë një recesioni, vlerësimet e palëve të treta ulen ndjeshëm. Pra, ekziston rreziku i mospagimit, i cila mbart një rrezik akoma më të madh, atë të dështimit. Pikërisht në këtë pikë jastëku kundër-ciklik i Bazel III hyn në lojë dhe është tejet i dobishëm. Me rregullat e Bazel II, bankat do të jepnin më pak kredi duke qënë se këto të fundit ishin transformuar në shumë të rrezikshme. Për një sasi të caktuar të kapitalit (shuma e barazvlefshme me 8% të aktiveve të ponderuara me rrezik), në qoftë se kreditë janë shumëme rrezik bankat do të japin natyrisht më pak. Kjo ulje në huadhënien nuk lejon ringjalljen ekonomike, dhe kështu, jemi në rastin e pro-ciklit. Ndërkohë, me rregullat e reja, jastëku kundër-ciklik përbën një mjet kudër mekanizmit të pro-ciklit (qëllim i identifikueshëm nga vetë emri i tij). Kështu, duke patur më shumë marzh bankat në priudhë recesioni do ti ulin më pak se zakonisht huadhëniet. Në fakt, rritja e rrezikut të dështimit nuk kërkon që bankat të marrin masa të shtrëngimit të kreditit, apo të mos rrisin sasinë e kapitalit për të përthithur humbje, por ato mund të furnizohen nga jastëkët. Në këtë mënyrë individët dhe kompanitë mundet të kenë akses në huamarrje edhe ne rast rënie ekonomike duke bërë kështu të mundur ri-lançimin e ekonomisë. Si rezultat futja e këtij jastëku zgjidh problemin e pro-ciklit, problem i cili nuk gjeti paqe nga marrëveshja e Bazel II.

C) Krijimi i Raporteve të Likuiditeit dhe Raportit të Levës

Kërkesat e forta të kapitalit janë një kusht i domosdoshëm për stabilitetin e sektorit bankar, por, të vetme nuk janë të mjaftueshme. Një bazë e fortë likuiditeti i përforcon në mënyrë më të fuqishme standardet mbikëqyrëse dhe ky komponent është madje shumë i rëndësishëm. Deri më sot, nuk ka pasur standardet ndërkombëtare të harmonizohen për sa i përket raporteve apo normave të likuiditetit. Komiteti i Bazelit për këtë arsye ka menduar që është koha për të prezantuar të tillë përbërës mbikëqyrës të standardeve ndërkombëtare. Ashtu si me standardet ndërkombëtare të kapitalit, standardet e likuiditetit do të krijojnë kushtet minimale dhe do të promovojnë një konkurence të drejtë ndërkombëtar. Përgjatë krizës financiare shumë banka, pavarësisht niveleve të tyre të kapitalit, përjetuar shumë vështirësi për shkak se ata nuk arritën të menaxhojnë më kujdes likuiditetin e tyre. Kriza e ngre seriozisht rëndësinë e likuiditetit për funksionimin e duhur të tregjeve financiare dhe sidomos të sektorit bankar, sepse ndryshimi i shpejtë i provokuar në tregun e aktiveve përgjatë krizës tregoi se sa shpejt mund të zhduket likuiditeti dhe sa mund të zgjasë periudha jolikuide. Sistemi bankar kaloi një moment shumë të vështirë likuiditeti dhe u pa e domosdoshme mbështetja e bankave qëndore jo vetëm në funksionimin e tregjeve të parasë por edhe në funksionimin e institucioneve individuale. Vështirësitë e përjetuara nga disa banka ishin për shkak të gabimeve në parimet themelore të administrimit të rrezikut të likuiditetit.

Në përgjigje, Komiteti i Bazelit hartoi "Parimet për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe mbikëqyrjes së shëndetshmë". Këto të fundit ofrojnë udhëzime të hollësishme për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e rrezikut të likuiditetit dhe të financimit. Për të plotësuar këto parime, Komiteti ka forcuar më tej kuadrin e likuiditetit duke zhvilluar dy standardet minimale për financimin e likuiditetit. Këto standarde janë zhvilluar për të arritur dy objektiva të ndara por komplementare. Objektivi i parë është që të promovojë elasticitetin afatshkurtër e profilit të rrezikut të likuiditetit të bankës duke siguruar se ka burime të mjaftueshme likuide me cilësi të lartë për të mbijetuar një skenar stresi akut që zgjat për një muaj, dhe për të arritur këtë objektik, Komiteti ka zhvilluar **Raportin e Mbulimit të Likuiditetit** (LCR, Liquidity Coverage Ratio). Objektivi i dytë është për të promovuar

elasticitetin gjatë një horizonti kohor më të gjatë duke krijuar stimuj shtesë për një bankë për të financuar aktivitetet e saj me burime më të qëndrueshme të financimit mbi një bazë të vazhdueshme strukturore. Kështu Komiteti përiloi **Raportin e Financimit të Qëndrueshëm Neto** (NSFR, Net Stable Funding Ratio) i cili zotëron një horizont kohor prej një viti dhe është zhvilluar për të siguruar një strukturë të qëndrueshme të maturimit të aktiveve dhe të pasiveve. Këto dy standarde janë të përbërë kryesisht nga parametra të veçanta të cilat janë ndërkombëtarisht të "harmonizuar" me vlerat e përshkruara.

1- Raporti i Mbulimit të Likuiditetit, LCR

Së pari, LCR është një raport afatshkurtër që i kërkon bankave të zotërojnë asete pa rrezik lehtësisht të tregtueshme (konvertuar në cash shumë shpejtë) në mënyrë për të përballuar një krizë përgjatë një periudhe 30 ditore. Këto asete të sigurta përfshijnë bonot e thesarit dhe obligacionet e korporatave me cilësi të lartë. Raporti LCR është si vijon:

$$LCR = \frac{Aktive\ t\ddot{e}\ cil\ddot{e}sis\ddot{e}\ s\ddot{e}\ lart\ddot{e}}{Flukset\ dal\ddot{e}se\ neto\ n\ddot{e}\ cash\ brenda\ 30\ dit\ddot{e}ve} \geq 100\%$$

Ku "aktiv i cilësisë së lartë" mund të përfshijë pasuritë të korreluara, në mënyrë të dobët me aktivet me rrezik, dhe "flukset dalëse neto" përbëjnë diferencat ndërmjet hyrjeve dhe daljeve të parave në dorë, pra mjeteve cash.

2- Raporti i Financimit të Qëndrueshëm Neto,NSFR

Së dyti, NSFR është një raport afatgjat që përmbush në fakt të njëjtin qëllim si raporti afatshkurtër. Ai synon të nxisë bankat që të financojnë vetveten me burime më të qëndrueshme. NSFR kërkon një sasi minimale të burimeve të qëndrueshme të financimit në një bankë relative me profilet e likuiditetit të aktiveve, si dhe potencialin për nevojat e kushtëzuara për likuiditet që rezultojnë nga detyrimet jashtë bilancit, gjatë një horizonti një vjeçar. NSFR synon të kufizojë mbështetjen e tepërt në financim afatshkurtër, dhe të inkurajojë vlerësimin më të mirë të rrezikut të likuiditetit për të gjithë zërat jashtë dhe brenda bilancit. Këtu, banka duhet të jetë në gjendje të përballojë një krizë për një periudhë kohore një vjeçare. Raporti NSFR është si vijon:

$$NSFR = \frac{Financimet\ e\ Qëndrueshme\ Disponibël}{Financimet\ e\ Qëndrueshme\ të\ Nevojshme} \geq 100\%$$

Ku financimi i qëndrueshëm përfaqëson totalitetin e Tier 1 dhe Tier 2 si dhe aksionet e preferuara me maturitet mbi një vit të pa përfshira në Tier 2. Financimi i qëndrueshëm i nevojshëm apo i kërkuar është i bazuar në bilancin dhe në ekspozimin e zërave jashtë bilancit. Në mënyrë të veçantë, ai përfshin paratë në dorë dhe letra me vlerë me maturitet brenda një viti.

Udhëzimet e Komitetit të Bazelit për "Parimet e Menaxhimit të Rrezikut të Likuiditet të Shëndetshëm dhe Mbikëqyrjes" (Principles for Sound Liquidity Risk Management and Supervision), marrin parasysh mësimet e marra përgjatë krizës dhe janë të bazuara në një rishikim rrënjësor të praktikave të shëndosha për administrimin e rrezikut të likuiditetit në organizatat bankare. Kuadri i likuiditetit përfshin një grup të përbashkët të masave monitoruese për të ndihmuar mbikëqyrësit në identifikimin dhe analizimin e tendencave të rrezikut të likuiditetit si në nivelin e bankave ashtu edhe në te gjithë sistemin financiar.

Një nga karakteristikat themelore të krizës ishte grumbullimi i tepruar i levave jashte dhe brenda bilancit në sistemin bankar. Në shumë raste, bankat ndërtuan leva të tepërta, ndërsa ishin ende me raportet të forta të kapitalit bazuar në rrezik. Gjatë pjesës më të rëndë të krizës, sektori bankar u detyrua nga tregu për të reduktuar levën, i cili ndikoi në rënie e çmimeve të aktiveve, duke rënduar më tej ë humbjet, në rënien e kapitalit të bankës, dhe në tkurrjen në disponibilitetin e kredisë. Prandaj, Komiteti ra dakord për të futur një raport mbi përdorimin e levave. **Raporti i Levave** që është kalibruar për të vepruar si një masë shtesë e besueshme mbi kërkesat bazë të kapitalit me rrezik. Ky raport ka për qëllim për të arritur objektivat e mëposhtme:

- Të kufizojë grumbullimin e levave në sektorin bankar, duke ndihmuar për të shmangur procesin e "delevaraging" që është destabiliziues dhe mund të dëmtojë sistemin financiar dhe vetë ekonominë.
- Të përforcojë kërkesat e bazuar në rrezik me një masë parandaluese të thjeshtë jo bazuar në rrezik.

Ky i fundit është një raport jo i bazuar në rrezik që përfshin ekspozimet jashtë bilancit e do të shërbejë si një ndihmë shtesë mbi kërkesat e kapitalit të bazuar në rrezik. Raporti levave është përdorur për të vlerësuar madhësinë e detyrimeve të një banke në krahasim me madhësinë e bilancit të saj. Bazel III paraqet një funksion të ri për raportin e levave, i cili ekzistonte edhe në marrëveshjeve e mëparshëm, raporti nuk do të masë ekspozimin ndaj rrezikut të bankës (shtylla 2), por do të shërbejnë si një mjet për të llogaritur kërkesat për kapital (shtylla 1). Pozicioni i tij i ri do t'i mundësojë atij për të parandaluar shfrytëzimin e tepërt që çon në shtrëngimin e kredisë në situata të krizës.

Ky është në fakt një raport i thjeshtë i bazuar në kapitalin Tier 1 me trajtimin në nivelin 100% të të gjitha ekspozimeve të rrezikut të dispozitave neto. Baza e llogaritjes është mesatarja e raportit të levave mujore gjatë tremujorit të bazuar në përcaktimet e kapitalit dhe ekspozim total. Më 26 korrik 2010, u njoftua nga Komiteti i Bazelit mbi këtë raport por, nuk u miratua një raport i veçantë i levave, duke e lënë atë fleksibël në secilin vend anëtar. Periudha e monitorimit mbikëqyrës ka filluar në 1 janar 2011, ku Komiteti do të testojë një raport minimum të levave prej 3%, dhe raporti minimal i levave do të përcaktohet dhe të zbatohet më 1 janar 2018.

D) Mbulimi i rrezikut

Një nga mësimet kryesore të krizës ka qenë nevoja për të forcuar rrezikun e mbulimit të strukturës së kapitalit. Dështimi për të kapur rreziqet e mëdha brenda dhe jashtë bilancit, si dhe ekspozimet e lidhura me derivativët, ishte një faktor kyç destabilizimi gjatë krizës. Në përgjigje të këtyre mangësive, Komiteti përpiloi një numër reformash që rrisin kërkesat e kapitalit për aktivitetet e tregëtimit dhe të derivativëve (nën paketën e Librit Tregtar) dhe ekspozimet komplekse të letrave me vlerë, një burim i madh i humbjeve për shumë banka aktive në tregjet ndërkombëtare. Reformat prezantojnë një kërkesë të kapitalit sipas modelit të vlerës në rrezik (VaR) të bazuar në një periudhë të konsiderueshme financiare të vazhdueshme 12-mujore.

Marrëveshja paraqet masa për të forcuar kërkesat e kapitalit për ekspozimet e palëve të treta në kredit që lindin nga derivativët e bankave, repo-t dhe financimet e aktiviteteve me

letra me vlerë. Këto reforma do të rrisin rezervat e kapitalit që mbështesnin këto ekspozime, do të zvogëlojnë pro-ciklin dhe të ofrojnë stimuj shtesë për të lëvizur kontratat derivative OTC të palëve qëndrore, duke ndihmuar në zvogëlimin e rrezikut sistemik të gjithë sistemit financiar. Marrëveshja ofron gjithashtu stimuj për të forcuar menaxhimin e rrezikut të ekspozimeve të kredisë të palës tjetër. Komiteti ka përpiluar atëherë reformat e mëposhtme:

- Me kalimin e kohës, bankat duhet të përcaktojnë kërkesat e tyre të kapitalit për rrezikun e kredisë së palës tjetër. Kjo do ti drejtohet shqetësimeve rreth detyrimeve të kapitalit duke u bërë shumë të ulët gjatë periudhave të luhatshmërisë së tregut dhe zgjidh pro-ciklin. Qasja, ngjason me mbuim e rrezkut të tregut, gjithashtu promovon menaxhimin e integruar të rrezikut të tregut dhe rrezikun e kredisë së palëve të tjera.
- Komiteti po fortëson standartet për menaxhimin e kolateralit dhe marzhin fillestar. Bankat me ekspozimet e mëdha dhe jolikuide derivative kundrejt një pale tjetër do duhet të aplikojnë periudha më të gjata të marzheve fillestare si bazë për përcaktimin e kritereve të kapitalit rregullator. Gjithashtu janë miratuar standardet shtesë për të forcuar rrezikun e kolateralit dhe praktikat e menaxhimit.
- Komiteti ka ngritur gjithashtu standarde të menaxhimit të rrezikut të kreditit nga palët e tjera në shumë fusha, duke përfshirë edhe trajtimin e të ashtuquajturave "drejtime të gabuara", dmth rreziku në rastet ku ekspozimi rritet kur cilësia e kredisë së palës tjetër përkeqësohet.

Reformat gjithashtu rrisin standardet e Shtyllëse dytë që i përket menaxhimit të rrezikut dhe mbikëqyrjes dhe Shtyllës së tretë që i përket disiplinës së tregut. Shtesa mbi Shtyllën e dytë i drejtohet qeverisjes së firmave dhe menaxhimit të rrezikut; kapjes së rrezikut jashtë bilancit dhe ekspozimeve të aktiviteteve të letrave me vlerë; manaxhimit të përqëndrimeve të rrezikut; ofrimit të stimujve për bankat për të menaxhuar më mirë rrezikun dhe kthimin në periudha afatgjata; stimulit për praktika të shëndosha kompensimi; ofrimit të praktikave të vlerësimit; stress-testing; ofrimin e standarteve të kontabilitetit për instrumentet financiare; si dhe mbështetje nëpërmjet kolegjeve mbikëqyrëse. Për sa i përket shtyllës së

tretë, pra risisë së disiplinës së tregut, kërkesat prezantuan ekspozimet në letrat me vlerë dhe sponzorimet me mjete jashtë bilancit; dhënien e informacionit të zgjeruar mbi detaje të përbërësve të kapitalit rregullator dhe pajtimin e tyre në llogaritë e raportuara që do të jenë të detyrueshme, duke përfshirë këtu edhe një shpjegim të plotë se si një bankë përllogarit raportet rregullatore të kapitalit të saj. Në tabëlën e mëposhtme, Tabelën 3.4 mund të gjeni të përmbledhur elementët kryesor të marrëveshjes së Bazel III ndërkohë, për një pamje më të qartë të të gjithë strukturës të reformave të Bazel III, mund të drejtohëni në Ankesin 5, i cili përmbledh pak më gjerë marrëveshjnë në fjalë.

Përbërësit e Bazel III	**Aspektet Kryesore**
Kapitali Rregullator	• Ngritja e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe transparences së kapitalit bazë • Lloji dominant i kapitalit duhet të jenë aksionet e zakonshme dhe fitimet e mbajtura (Kapitali përbashkët nën Tier 1) • Ka përjashtime brenda kategorisë së Tier1, duke synuar cilësi më të lartë • Harmonizohen përbërësit e kapitait Tier 2 • Eliminohet ktegoria e kapitalit Tier 3
Raporti i Levës	• Prezantimi i raportit të levave financiare si një masë shtesë mbi strukturën e bazuar në rrezik të Bazel II
Pro-cikli	• Promovimi i provigjonimeve më të mira largpamëse • Prezantimi i jastëkëve të konservimit • Prezantimi i jastëkëve kundër-ciklik • Targetimi i rrezikut sistemik dhe ndërlidhjeve financiare bankare/jo-bankare
Standartet e Likuiditetit	• Prezantimi i Raportit të Mbulimit të Likuiditetit,

	(LCR) • Prezantimi i Raportit të Financimit të Qëndrueshëm Neto, (NSFR) • Prezantimi i një sërë mjetesh monitorues
Mbulimi i Rrezikut	• Ngritja kërkesave të kapitalit për librin tregtar dhe letrat me vlerë komplekse • Prezantimi i kërkesës për kapital për rrezikun e kredisë të palës tjetër (CCR) i bazuar në inputet e "stresuara" • Prezantimi i rregullimit të vlerësimit të kredisë ,(CVA) • Ngritja standartve të menaxhimit të rrezikut të palës tjetër • Forcimi i standardeve për menaxhimin e kolateralit dhe marzheve fillestare

Tabelën 3.5 Elementët kryesoër të marrëveshjes së Bazel III

3.2.3 Kritikat kundrejt Bazel III

Ndikimi i vërtetë ekonomik i kërkesave të Bazel III është, natyrisht, i diskutueshëm. Duke pasur parasysh peridhën e shkurtër kohore që ka kaluar që nga miratimi i paketës Bazel III, është padyshim shumë herët për të thenë me siguri se çfarë do të jetë ndikimi i vërtetë. Sidoqoftë, raportet paraprake kanë parashikuar se çfarë mund të jetë potencialisht ky ndikim. Një raport i hartuar nga Instituti Ndërkombëtar i Financave (IIF, International Institute of Finance), një organizatë që përfaqëson bankat, arriti në përfundimin se kërkesat e Bazel III do të rezultojnë në një rënie 3.1% në produktin e brendshëm bruto të një vendi, PBB-në (GDP) për çdo rritje prej 1% në raportin e kërkesës së kapitali të një banke. Në

kontrast, një raport i ngjashëm i përpiluar nga Banka për Rregullime Ndërkombëtare (BIS,) arriti në përfundimin se PBB-ja do të ulet me vetëm 0.09% për çdo rritje prej 1% në raportin e kërkesës së kapitalit. Ndërkohë të dy raportet rakordohen në një pikë të përbashkët ku bien dakort se Bazel III do të ketë të paktën disa ndikime negative në rritjen ekonomike, rezultate të ndryshme të këtyre raporteve nënvizojnë pasigurinë që rrethon shtrirja e ndikimit negativ të kërkesave të Bazel III.

Bazel III është ende në procese shqyrtimi dhe fazat e aplikimit janë të largëta, ndaj të parashikoshk që tani "fatin" e tij është pak shpejt. Megjithatë, kritikët e kanë filluar tashmë të shprehin mendimet e tyre mbi marrëveshjen Bazel III. Një nga kritikat e dukshme të Bazel III i drejtohet nivelit të kapitalit që marrëveshja i kërkon bankave të mbajnë. Kritikët thonë që vlera e mbajtur është shumë e lartë dhe ndikimi që do të ketë në kredidhënie do të jetë edhe ai relativisht i lartë. Duke i kërkuar bankave të mbajnë nivele të larta të kapitalit, Bazel III zvogëlon sasinë e parave që një bankë mund të japë.

Kritikët theksojnë se një reduktim në kredidhënie do të pengojnë rritjen ekonomike. Bankat dhe aftësia e tyre për të injektuar para në ekonomi me anë të kreditimit, janë një komponent i rëndësishëm në rritjen ekonomike. Prandaj, duke imponuar kufizime të kreditimit në formën e kërkesave të larta të kapitalit, Bazel III kufizon efektivisht bankat që të bëjnë pjesën e tyre në promovimin e një ekonomie të fortë dhe të shëndetshme. Lidhur me argumentin ekonomik një shqetësim i ngritur nga bankat është se nivelet e larta të kapitalit do të dëmtojnë fitimet bankare. Kritikët argumentojnë se bankat do të tentojnë të kompensojnë kështu të ardhurat e humbura nga aftësia e tyre e kreditimit tashmë e zvogëluar duke rritur normat e interesit së kredive, duke i bërë kështu më të shtrenjta kreditë për huamarrësit. Për të arritur këtë, bankat do të ndërmarrin aktivetete më të rrezikshme, pavarësisht nga kërkesat e larta të kapitalit. Prandaj, me këto kërkesa të larta, jo vetëm që do të ketë më pak kreditim, por kreditimi që do të zhvillohet do të jetë më i shtrenjtë ose ndoshta më i rrezikshëm. Në fakt, mund të gjeni në figurën 2.7 këtë dikotomi pikëpamjesh (negative-pozitive), ku çështja qëndron se në cilën anë anon peshorja, pra ku mund të kemi më shumë përfitime.



Figura 3.7 Dikotomia e pikëpamjes pro-ndër nën spektrin e huadhënies

Bankat evropiane janë më kritike kundrejt propozimit, duke argumentuar se Bazel III favorizon bankat e Shteteve të Bashkuara duke u nisur nga fakti që këto të fundit historikisht kanë mbajtur një nivel të lartë të kapitalit dhe do të mund ti përmbushin më lehtë kërkesat për rritjen sasiore në kapital. Forumi Amerikan i Letrave me Vlerë (ASF, American Securities Forum) tha se mbulimi i Raportit të Likuiditetit të Bazel III "mund të ketë një efekt katastrofik mbi tregjet kapitale globale afatshkurtra". Arsyeja kryesore është se raporti i likuiditetit do të kërkojë nga bankat në çdo kohë të mbajnë një stok të aktiveve likuide minimalisht të barabarta apo që të tejkalojnë flukset dalëse neto të parave, kjo e llogaritur për një periudhë 30 ditore. Ky likuiditet do të reduktojë ndjeshëm fondet e nevojshme afatshkurtra për të nxjerrë borxh afatshkurtër në letra me vlerë, të tilla si instrumente të tregut të parasë dhe të obligacioneve të korporatave. Komenti i Deutsche Bank shprehert se afati kohor është i shkurtër për të rritur kapitalin e përbashkët. Shoqata e Bankierëve Francez (ABF, Association des Banqiers Fraçais) vlerëson se rregullimet e Bazel III janë të pazbatueshme për shkak se do të rezultojnë në një mungesë të kapitalit Tier 1 në nivelin 2.7 deri 4.7 trilion dollarë vetëm për vendet e Euro zonës.

Komiteti i Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare (BCBS) është përgjigjur dhe deklaroi vlerësimin e tij të ndikimit të marrëveshjes së Bazel III mbi ekonomitë ndërkombëtare.

Gjetjet e këtij të fundit janë raportuar në dokumentin "Një vlerësim i ndikimit afatgjatë të kapitalit të fortë dhe kërkesat e likuiditetit", (An Assessment of the Long-term Impact of Stronger Capital and Liquidity Requirements) më 18 gusht 2010. Gjetjet e këtij vlerësimi të Komitetit të Bazelit tregojnë se kërkesat e larta në kapital dhe në likuiditet mund të reduktojnë ndjeshëm probabilitetin e një kriza bankare. Rrjedhimisht, përfitimet janë relativisht të mëdha, kur raportet e kapitalit janë rritur nga nivele të ulëta dhe bien në mënyrë progresive pasi standardet shtrëngohen. Për shembull, Komiteti gjeti se rënia e probabilitetit të një krize është tre herë më e madhe kur kapitali është rritur nga 7% deri 8% se kur kapitali është rritur nga 10% në 11%. Vlerësimi arriti në përfundimin se kapitalizimi më i mirë redukton gjasat e krizave dhe rreptësinë e krizave kur ato ndodhin.

Zbutjen e shqetësimeve se kërkesat e larta të kapitalit të Bazel III do të dëmtojnë ekonominë dhe do të ulin ndjeshëm fitimet e realizon afati kohor i zbatimit, i cili nuk bën thirrje për zbatimin e plotë të të gjitha kërkesave të Bazel III deri në vitin 2019, por zbatimi gradual u jep mundësinë bankave për tu përshtatur me kërkesat dhe i lejon një tranzicion gradual dhe të strukturuar. Nga ana tjetër, kemi gjithashtu kritikët të cilët mbajnë një qëndrim të kundërt, duke mbështetur faktin se kërkesat e kapitalit të vendosura nga Bazel III janë shumë të ulëta për të siguruar që një bankë të mund të absorbojë humbje të tilla si ato të përjetuara gjatë krizës financiare së fundit. Në mbështetje të argumentit të tyre, bëjnë thirrje që kërkesat e kapitalit të bëhen edhe më të larta, sidomos për bankat e prekura nga kriza financiare, e veçanërisht për ato në Shtetet e Bashkuara. Disa studime madje sugjerojnë se është e nevojshme që raporti minimal i kapitalit duhet të jetë më në nivelet 15% deri në 20%, që rezulton në fakt në dyfishimin e kërkesave aktuale të Bazel III.

Ndoshta kritika më e madhe e Bazel III janë pikërisht komponentët që nuk janë rishikuar. Shumë nga kritikat e Bazel II në fakt nuk rishikohen nga Bazel III. Për shembull, Bazel III nuk ka rivlerësuar problemet që lidhen me metodat e Bazel II në peshimin dhe ponderimin e aktiveve të një banke, ajo nuk bën asgjë për të ndryshuar llogaritjen e aktiveve të ponderuara me rrezikun dhe e lë në vend përdorimin e agjensive të vlerësimit të jashtëm për të përcaktuar pikërisht rrezikun. Kështu, ndërsa Bazel III është përpjekur për të përmirësuar numëruesin e raportit të kapitalit, ajo nuk ka bërë asgjë për të përmirësuar

emëruesin, i cili në bazë të kritikëve e agrumentëve të shumtë, ishte komponenti që kishte më shume nevojë të reformohej.

Pra, vlerësimi i rrezikut pretendohet të jetë jo i besueshëm. Metoda e përllogaritjes së kapitalit është e deformuar dhe e turbullt. Vini re se ky problem ishte tashmë i pranishëm edhe gjatë marrëveshjes së parë në vitin 1988. Niveli i kapitalit të kërkuar përcaktohet duke llogaritur profilin e rrezikut të aktiveve të bankës. Nëse rreziqet mbi aktivet e bankës janë nënvlerësuar, ajo do të ketë më pak kapital për të mbuluar këto rreziqe. Rreziqet janë të nënvlerësuar në përgjithësi kështu që bankat mund të përballojnë të ketë më pak kapital se sa ai që në fakt duhet të përputhet me rreziqet reale, duke lënë ekspozimin e lartë në rast kolapsi. Masa e matjes së rrezikut është metoda VaR[25]. Ajo i jep një peshë në rënie të ngjarjeve më të vjetra në mënyrë që ngjarjet që ndodhin një ose dy muaj më herët kanë një peshë të papërfillshme. Modeli VaR nuk parashikon ngjarjet e rënda (si kriza financiare), duke na lënë të mendojmë që modeli nuk është në gjendje të parashikojë krizën financiare. Për fat të keq, nuk ka asnjë mënyrë që të ketë një masë të mirë të rrezikut. Në të vërtetë, ngjarjet jo shumë probabël janë të vështira të kuantifikohet, përveç kësaj, flluskat dhe krizat kronike shfaqen dhe ne nuk e dimë ti parashikojmë. Zgjidhje me adapte për këtë problem të matjes së rrezikut dhe kapitalit minimal është pikërisht rritja e kapitalit të bankave dhe mos mbështetja në ponderimin e rrezikut, sepse matja e këtij të fundit është e deformuar.

Bazel III nuk ka adresuar vëmendjen e tij kundrejt bankave të ashtuquajtura "fantazma" të tilla si bankat e investimeve, fondet spekulative, aktivet SPV etj. Këto institucione nuk janë subjekt i kërkesave kapitale të Bazel III, sepse ata nuk pranojnë depozita nga publiku. Megjithatë, këto aktivitete janë aktivitete që përfshijnë rreziqe sistemike, duke qënë se këto institucione marrin hua afatshkurtra në tregjet likuide dhe blejnë më vonë mjete afatgjata në tregjet jolikuide. Rritet shumë rreziku i kredisë, tregut dhe likuiditetit, dhe prezanca e të tillë rreziqesh njëherësh çon në një rrezik të falimentimit në qoftë se institucioni në fjalë nuk mund të ri-financojë borxhin afatshkurtër. Në përfundim, është e nevojshme që kërkesat e kapitalit të ndikojnë në tërë sektorin bankar dhe jo vetëm bankat që kanë

[25]Shpjeguar në seksionin 2.3.2

depozita. Siç e dimë, nëse ekzistojnë institucione të cilat nuk janë subjekt i kërkesave të kapitalit, institucionet e kreditit do të tentojnë të "titrizojnë" borxhet e tyre për këto institucione. Siç është cilësuar edhe nga Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB, Financial Stability Board), ka ende shumë punë për të bërë në fushën e stabilitetit financiar në nivelin global.

Kemi gjithashtu edhe të ashtuquajturat banka sistemike të cilat njihen nën nofkën "too big to fail" (shumë të mëdha që të dështojnë). Kjo kategori bankash me dështimin e saj bën që dështimi të minojë sistemin bankar dhe financiar. Për shkak se dështimi i tyre mund të ketë pasoja me përmasa te rënda e shumë të mëdha, edhe rregullimi duhet të jetë po i përmasave të mëdha. Duke njohur këtë problem, Bordi i Stabilitetit Financiar ka përparësi për të përcaktuar një kornizë veprimi dhe një afat kohor të rregulimit për këto banka "too big to fail", si dhe për bankat paralele pra institucionet "fantazëm".

Si përfundim mund të statohet që regjimi ndërkombëtar për rregullimin e bankës ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme që nga themelimi i BCBS në vitin 1974. Megjithatë, kriza financiare globale bëri të qartë, se pas dy marrëveshjeve Bazel I dhe Bazel II, marrëveshja ka ende vend për përmirësim në rregullimin e kapitalit të bankës. Ndërsa është ende shumë herët të shprehemi me siguri, por, *Bazel III duket të jetë një hap në drejtimin e duhur*.

3.3 Analiza E Marrëveshjes Bazel III, Impaktet Potenciale Të Saj

Të diskutosh targetin e marrëveshjes së Baesl III, përmirësimet apo veprimet e saj është e thjeshtë, sepse në fund të fundit qëllimi mbetet pozitiv, nobël dhe unanim për një harmoni e stabilitet ekonomik e finaciar në mbarë globin. Në anën tjetër është e nevojshme dhe e këshillueshme ta shohim nga një këndvështrim pak më skeptik dhe dhe skenaristik në mënyrë që të dimë ç'na pret apo cilat janë realisht reagimet potenciale si në sferën financiare edhe në ekonominë reale. Në këtë seksion, do të paraqiten pra efektet e zbatimit të këtyre rregullave të reja mbi bankat,aksionerët dhe mbi ekonominë reale duke e parë

edhe në dikotominë e efketeve kualitative apo kuantitative. Gjithashtu, do të ndërtohen skenaret e mundshëm të mënyrës së përgjigjjes e së adaptimit të bankave kundrejt strukturës së re mbikëqyrëse e rregullatore.

3.3.1 Aplikimi i Bazel III dhe impaktet potenciale mbi bankat

Rregullat e reja të mjaftueshmërisë së kapitalit të Bazel III përforcojnë rezultatet e bankave në mënyrë të ndjeshme. Për të përmbushur këto kërkesat e mjaftueshmërisë së kapitalit, bankat do të duhet të rrisin kapitalin e tyre. Në të vërtetë, bankat do të mbajnë kapital jo vetëm në sasi më të mëdha por gjithashtu do tju kërkohet të mbajnjnë një kapital me cilësi më të mirë. Në këtë mënyrë, bankave i mundësohet një pozicion më i qëndrueshëm dhe robust për të përballuar krizat më lehtë e pa shume efekte negative kontaminuese nëpër sistemet bankare ndërkombëtare duke siguruar kështu stabilitet më të lartë financiar. Bazel III do të ketë ndikime në sistemin financiar duke ulur pikë së pari rrezikun e krizave sistemike të bankave por ka edhe efekte të padëshirueshme si ulja e kapacitetit kredidhënës, ulja e etjes së investitorëve për kapital dhe borxh bankar si pasojë e uljes së dividentëve, si dhe rreziku i arbitrazhit ndërkombëtar në rast implementimesh të ndryshëm nga entitete të ndryshme. Nga ana tjetër këto rregullime e ndryshime do të pasqyrojnë impaket e tyre direkte mbi banka si : zbrasjen e bankave të dobëta; presionin e rëndësishëm në profitabilitetit dhe ROE, ndryshimin në kërkesë për financim nga afatshkurtër në afatgjatë si dhe riorganizim juridik të entiteteve. Për të mundësuar rritjen e kapitalit rregullator, bankat posedojnë alternativa të ndryshme. Për të pasqyruar më qartë alternativat që mund të ndërmarrin bankat mund të mbështetemi mbi teorinë e hierarkisë së mënyrave të financimit. Në fakt pikënisja e këtyre të fundit do të jetë rritja e kapitalit nëpërmjet financimit të brendshëm duke transformuar apo kaluar fitimet në rrezerva të kapitalit (fitimet e pashpërndara), së dyti duke emetuar aksione të reja.

Financimi i brendshëm nëpërmjet “bllokimit” të fitimeve është mënyra më e mirë e financimit në bazë të teorisë së hierarkisë. Megjithatë, duhet patur parasysh se si pasojë e

këtij bllokimi të fitimeve të pashpërndara nuk mund të kryen investime në përmirësimin e sistemit kompjuterik, kërkimin e informacionit të konsumatorit, etj. Nga ana tjetër, zgjedhja e emëtimit të aksioneve paraqet një problem të madh. Ky veprim është një sinjal negativ dhe kondesim i kapitalit të aksionerëve aktual në fuqi.

Në fakt, rritja në kapitalin neto ka një ndikim mbi aksionerët. Kur zmadhimi i kapitalit kryhet nga financimi i brendshëm, aksionerët e shohin këtë me një sy mosbesues për shkak se fitimet e pashpërndara nuk do të përdoret për të paguar dividentët. Megjithatë, politika e pagesave të dividentëve duhet të jetë e qëndrueshme. Kur zmadhimi i kapitalit kryhet duke emetuar aksione, ka një trukrrje të kapitalit. Nga emetimi i aksioneve, banka do të kërkojë një çmim më të ulët se çmimi aktual i tregut për të tërhequr investitorët e rinj. Ndaj e vetmja gjë që shihet nga aksionerët kur përdoret kjo alternativë e rritjes së kapitalit rregullator është rënia e vlerës së aksioneve të tyre. Marrëveshja Bazel III implikon rritjen e peshës së kapitalit në bilanc, ndërkohë aksionerët shohin një rënie të performancës. Në fakt, Kthimi Mbi Kapitalin (ROE, Return On Equity) përpara krizës ishte rreth 15% ndërkohë sipas llogaritjeve të pas implementimit të marrëveshjes së fundit ky tregues pritet të ulet ndjeshëm.

Përsa i përket analizës së implikimeve mbi aksionerët, duhet bërë dallimi midis bankave të investimeve dhe bankave komerciale. Bankat e investimeve ndërmarrin operacione si financimet afatgjata, fondet e pensioneve etj të cilat janë shumë më të rrezikshme se operacionet e bankave komerciale, të cilat ndërmarrin bazikisht huamarrjen e huadhënien në periudha afatshkurtra (aktivitete të veshura me nivele të ulta rreziku). Ndërkohë që niveli i kapitalit rregullator duhet të jetë në përputhje me rreziqet e ndërmarra, bankat e investimeve do të përballen me rritje shumë më të fortë, e cila do të reduktojë kthimet e aksionerëve shumë më tepër. Që rezulton në prekjen e ndjeshme të fitimeve të aksionerëve të bankave të investimeve në krahasim me fitimet e aksionerëve të bankave komerciale. Por nuk duhet harruar që ka edhe implikime pozitive për aksionerët. Duke qënë se bankat duhet të kenë nivel kapitali rregullator në proporcion me rrezikun e operacioneve të ndërmarra, këto të fundit do të mundohen ti eliminojnë aktivitetet tejet të rrezikshme, duke

ulur ndjeshëm probabilitetin e humbjes dhe të falimentit, fakt i cili është i dobishëm për aksionarët.

Sa i përket emëtimit të aksioneve, është e rëndësishme për të prezantuar Teorinë Sekuenciale, sipas të cilës emëtimi i aksioneve duhet të bëhet kur tregut i aksioneve është ende fitimprurës. Që do të thotë që banka duhet të zgjedhin kohën e duhur për të emëtuar aksione të reja. Në shikim të parë, mund të mendohet se kërkesat e kapitalit do të detyrojnë bankat të emëtojnë aksione në imediat dhe nuk do të mund të "luajnë" kur tregu është i fitimprurës. Por ky problem mbulohet nga periudha e tranzicionit të implementimit të marrëveshjes mbi kapitalin rregullator, që i lë kohën e duhur bankave për të vepruar në mënyrë sa më adapte për situatat individuale të secilës prej tyre.

Ky ndikim i madh mund të shihet edhe në Studimin e Impaktit Kuantitativ të fundit (QIS, Quantitative Impact Study)[26] të botuar nga Komiteti i Bazelit në shtatortë vitit 2012. Studimi është i bazuar në proceset e raportimit rigoroz të përcaktuara nga Komiteti për të rishikuar periodikisht implikimet e standardeve të Bazel III për tregjet financiare. Në studim morën pjesë një total prej 209 bankave, duke përfshirë 102 banka të "Groupit 1" (kategorizim për bankat që kanë kapital Tier 1 më të lartë se 3 miliardë euro dhe janë ndërkombëtarisht aktive) dhe 107 banka të "Groupit 2" (pra të gjitha bankat e tjera). Ndërsa struktura e Bazel III përcakton rregullimet tranzitore për implementimin e standardeve të reja, rezultatet e këtij studimi monitorues supozojmë zbatimin e plotë të paketës finale Bazel III bazuar në të dhënat e datës 31 Dhjetor 2011.

Sipas analizës së pritshmërive, mendohet të gjenerohen defiçite kapitali të rëndësishme si për tregun bankar evropian edhe për atë amerikan. Ndërkohë duhet bërë dallimi midis bankave të mëdha e atyre të vogla duke pranuar qartë që grupet e mëdha do ta kenë më të lëhtë të gjenërojnë kapital shtesë për të përmbushur kërkesat e kapitalit. Defiçiti në fjalë është pjesërisht për shkak të kërkesave të rritura të kapitalin dhe futjes së raporteve të likuiditetit të reja si dhe pjesërisht për shkak të mospërfshirjes së disa mjeteve të kapitalit nën kategoritë Tier 1 dhe Tier 2. Sipas studimeve të shumtë të kryer nga McKinsey

[26]Për të parë raportin e plotë mund ti drejtoheni dokumenteve të BCBS në www.bis.org

përgjatë vitit 2010 zgjidhjet e adoptuara nga bankat duhet të jenë tredimensionale : menaxhim më i mirë i kapitalit dhe likuiditetit, ristrukturim i bilancit si dhe modele të reja të përshtatshmërisë.

Në lidhje me menaxhimin më të mirë të kapitalit dhe të likuiditetit, bankat do të zhvillojnë dy veprime. Së pari, ata mund të përmirësojnë efektivitetin e kapitalit të tyre në librin tregtar (trading book), së dyti, mund të zbatojnë praktikat e menaxhimit të likuiditetit dhe të financimit përmes tri leva alternative; 1-zhvillimit të menaxhimit të fondeve dhe të likuiditetit në nivelin e ndërmarrjeve, 2-krijimit të një tabele përmbledhëse të detajuar për një pamje më të saktë të pozicionit të likuiditetit të bankës dhe 3-zbatimit të një plani të integruar financiar për kompaninë. Në lidhje me ristrukturimin e bilancit, bankat do të optimizojnë bilancet e tyre dhe do të tentojnë ti kenë më të balancuar se më parë. Si mund të realizohet kjo? E thjeshtë, duhen vendosur aktivet e financimet e tyre në një nivel reciprok të afateve të tyre, aktivet afatshkurtra të financohen me detyrime afatshkurtra dhe aktivet afatgjata të financohen me detyrime afatgjata. Së fundi, bankat do të zhvillojnë modele të reja duke marrë parasysh rishikimin e rentabilitetin të operacioneve të tyre të biznesit dhe kostot e financimit për shkak të mungesës së kapitalit dhe kostos së tij në të ardhmen. Kështu, bankat mund të zhvillonjë gama produktesh dhe rishikim të shpenzimeve bazike dhe çmimeve të aseteve.

3.3.2 Aplikimi i Bazel III dhe impaktet potenciale në ekonominë reale

Eshtë totalisht normale që impakti dhe ndikimet e rregullores Bazel III të shtrihen edhe në sferën reale. Për të analizuar këtë optikë mund të vëzhgojmë dhe komentojmë impkatin potencial mbi agjentët kreditorë dhe agjentët debitorë. Efekti i shpalljes së marrëveshjes së re dhe zbatimi i saj do të rivendosë, në fakt, besimin e investitorëve në sistemin bankar. Si rezultat, ata kanë më shumë gjasa për të vënë shuma të mëdha të kursimeve në një bankë. Megjithatë, investitori mund të vendosë në pikëpyetje edhe çështjen e pagesës së depozitave, dhe në të vërtetë, banka mund të reduktojë normën e kthimit të depozitave për

të rritur marzhin e saj. Banka e ndërmerr këtë veprim në mënyrë që të rrisë fitimin e saj që do ti duhet ta vendosë në rezervë në mënyrë që të rrisë kapitain e vet. Në përfundim, për kreditorët e bankave mund të vërejmë se ka edhe aspekte pozitive dhe negative.

Ndërkohë që siç e trajtuam gjerësisht më lart, kërkesat e kapitalit të vendosura në bankat do të çojnë, sipas bankës, në një krizë të kredive. Ky shtrëngim vjen si pasojë e dy mekanizmave. Së pari, rritja në kapitalin neto është një masë e kushtueshme për bankat. Ata do të kalojnë këto kosto mbi normat e interesit me kreditorët dhe debitorët. Bankat do të zvogëlojnë më pas normat e kreditimit dhe normat e depozitave do të rriten, duke i lejuar ata që të ketë një diferencë të madhe. Duke qënë se normat e interesit për kreditë për individët dhe për firmat do të rritet, ata do të kërkojnë më pak kredi, situatë e cila do të çojë në një zvogëlim të ndjeshëm të kreditimit. Në të vërtetë, normat e depozitave afatgjata janë të vendosura tashmë dhe është e pamundur të ndryshohen menjëherë, ndaj zgjidhje edhe për këtë problem është periudha e tranzicionit e propozuar nga Komiteti i Bazelit.

Së dyti, bankat do të duhet të rrisin fondet e tyre, duke shkaktuar një rënie në aktivet aktuale në bilancet e bankave. Shuma e kapitalit varet nga sasia dhe niveli i rreziqeve të ndërmarra, pra nëse bankës do ti duhet të rrisë kapitalin e saj nga rritja e rreziqeve, ajo do të ketë më shumë tendencë të ulë rrezikun, ndaj të ulë krditimin. Vëzhgohët pra një shtrëngim i kredidhënies nga bankat, me frikën e një krize kredie.

Ne dallojmë kështu një ndikim të rëndësishëm mbi ekonominë reale. Në të vërtetë, ekonomitë familjare dhe bizneset do të kenë më pak qasje në kredi gjë që mund të pengojë rimëkëmbjen ekonomike. Në nivelin e konsumit familjar, duke ditur se ata do të marrin më pak hua në të ardhmen, do të kursejnë më shumë sot për të financuar konsumin e ardhshëm duke u bazuar në supozimin që individët e "shtrijnë" konsumin e tyre përgjatë kohës. Në nivelin e firmës, në qoftë se ne mbështetemi në teorinë e hierarkisë, ata do të gjejnë mënyra të tjera për të financuar. Ata mund të financohen nga emetimi i aksioneve ose letrave komerciale. Opsioni i parë do të lejojë që ata të rrisin kapitalin e tyre në rrezik. Ajo është e preferuar nga menaxherët sepse veprimet nuk japin detyrimet strikte të pagesave për ta. Megjithatë, ky financim është i rezervuar vetëm për kompanitë e mëdha.

3.3.3 Veprimet që duhen ndërmarrënga bankat; sfidat dhe përgjigjet e tyre

Implementimi i marrëveshjes Bazel III do të përballet padyshim me sfida të ndryshme duke qënë se kërkon vemendjen dhe bashkëpunimin e gjerë në nivel ndërkombëtar. Bazel III, me kërkesat e saj, detyron bankat që të marrin një numër veprimesh për të përmbushur raportet e reja rregullatore dhe për të rivendosur, së paku pjesërisht, rentabilitetin e tyre. Para se të ndërmarrin veprime të tilla, bankat duhet të jenë në gjendje të llogarisin dhe të raportojnë raportet e reja, që kërkojnë një përpjekje të madhe në zbatim. Bazel III mbulon një numër të madh fushash, arkitekturë IT, metodologji të rrezikut, strukturë qeverisëse, sistemet e raportimit, si dhe proceset për të kryer një zbatim të suksesshëm. Bankat duhet të jenë plotësisht në dijeni të këtyre sfidave sa më shpejt të jetë e mundur para se të fillojnë zbatimin e Bazel III. Për të marrë një pamje më të mirë të sfidave të mundshme mund ti kategorizojmë sfidat implementuese si funksionale, teknike dhe organizative (shih figurën 2.8).

Figura 3.8 Sfidat që i paraqiten bankave nga implementimi i Bazel III

Sfidat funksionale përfshijnë zhvillimin e specifikimeve për kërkesat e reja rregullatore, të tilla si piketimi i pozicioneve (aktivet dhe detyrimet) ndaj likuiditetit të ri dhe kategoritë e financimit në llogaritjen e raportevë LCR dhe NSFR, si dhe për kategoritë e rrepta të kapitalit. Sfidat e mëtejshme funksionale referojnë specifikimin e kërkesave të reja për pozitat në librin tregtar dhe brenda kuadrit të rrezikur të palës tjetër, si dhe përshtatjen e sistemeve në lidhje me kapitalin e ri dhe raportet e likuiditetit. Vendimtar është integrimi i kërkesave të reja rregullative në menaxhimin e rrezikut.

Sfidat teknike të zbatimit të Bazel III përfshijnë disponueshmërinë e cilësinë e të dhënave si dhe qëndrueshmërinë e të dhënave me qëllim llogaritjen e raporteve të reja. Sfidat e mëtejshme teknike rezultojë nga rregullimet e sistemit të raportimit financiar në lidhje me raportet e reja dhe krijimin e ndërfaqes efektive me sistemet ekzistuese të menaxhimit të rrezikut. Krahasuar me Bazel II, me fokus të saj madhor në kredi dhe rreziqet operacionale, kërkesat e Bazel III mbulojnë një gamë më të gjerë fushash tematike, duke përfshirë kapitalin e bankave, likuiditetin dhe menaxhimin e rrezikut, ndaj për një implementim të suksesshëm është i nevojshëm krijimi i një grupi pune i cili do të konsiderojnë varësitë ndërmjet tematikave të ndryshme dhe do të koordinojë njësitë e ndryshme funksionale, teknike dhe operative.

Sfidat organizative nga ana tjetër duhet të menaxhohen për të zhvilluar një përgjigje të gjerë dhe të përfshijnë edhe caktimin e përgjegjësive si brenda kornizës së implementimit, dhe më tej në përpjekjet për të rindërtuar përfitueshmërinë dhe të lejojë një menaxhim të integruar, të kapitalit, likuiditetit dhe rrezikut. Në arritjen e këtyre objektivave, identifikimi dhe sigurimi i burimeve duhet të kryhet për të përmbushur gamën e plotë të iniciativave të kërkuara.

Ndikimi i Bazel III mbi bankat bën thirrje për veprime të koncentruar dhe të arsyetuara. Përveç thjesht arritjes së pajtueshmërisë me rregullat e reja, bankat do të shkojnë edhe përtej pajtueshmërisë minimale dhe do të marrin masa për të rivendosur përfitueshmërinë. Bankat do të vlerësojnë linjat e tyre të biznesit, nivelet e profilet e rrezikut dhe të ardhurat kapitale, si dhe strategjitë e tyre të financimit për të marrë hapat e duhur drejt

pajtueshmërisë sa më të shëndetshme. Le të hedhin një vështrim nga përgjigjet e ndryshme potnciale që bankat do të kenë.

A) Përgjigjet Operacionale

Bazel III krijon stimuj për bankat për të përmirësuar proceset e tyre operative jo vetëm për të përmbushur kërkesat, por për të rritur efikasitetin dhe shtyrë në kosto më të ulëta. Bankat kanë filluar të shqyrtojnë fusha të tilla si:

- Optimizimin e Aktiveve të Ponderuara me Rrezik (RWA), duke përfshirë modele më të sofistikuara, përmirësimin e procesit, përmirësimin e cilësisë së të dhënave, dhe të shtrirjes së kornizës mbikëqyrëse
- Reduktimin ekspozimit ndaj kredisë dhe humbjet potenciale të kredisë nëpërmjet proceseve të rrepta të miratimit të kredisë dhe, potencialisht, përmes kufijve të ulët, veçanërisht në lidhje me ekspozimet e bankave
- Përmirësimin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, duke përfshirë proceset e "stress testing" dhe zhvillimin e planeve të financimit të paparashikuara
- Nxitjen e integrimit më të ngushtë të rrezikut dhe funksionet e financave
- Integrimin e të gjitha filialeve në procesin e analizës së menaxhimit të rrezikut në përputhje me pamjen e gjerë të të gjithë grupit si dhe të standardeve të menaxhimit të kapitalit

B) Përgjigjet Taktike

Përveç përgjigjeve operacionale tepër afatshkurtra bankat kanë një numër më të gjerë të veprimeve taktike që mund të ndërmarrin sidomos për tju drejtuar shqetësimeve të përfitueshmërisë. Këto lloj veprimesh përfshijnë çmimin e financimit dhe ristrukturimin e

aktiveve. Nisur nga përkufizimi, përgjigjet taktike nuk prekin çështje strategjike afatgjata, por mund të jenë jashtëzakonisht të dobishme në lehtësimin e presionit mbi përfitueshmërinë. Midis përgjigjeve taktike në dispozicion për bankat mund të rreshtojmë:

- Përshtatja e normave të kreditimit, në varësi të konkurrencës brenda segmenteve të veçanta dhe të rëndësisë strategjike qëçdo segment ka për bankën
- Reflektimi i kapitalit më të lartë dhe kostossë likuiditetit nëpërmjet çmimeve më të ndjeshme dhe të matjes së perfomancës nëpërmjet rrezikut.
- Zhvendosja në segmente më pak të rrezikshme në portofol, me uljen e ekspozimeve tregtare dhe aktiviteteve sidomos si derivativët.
- Rritja e nivelit e të cilësisë së lartë të aktiveve likuide
- Ndryshimi i përzierjes së financimit për shembull duke zëvendësuar me financim ndërbankar afatgjatë borxhin dhe rritjen e pjekurisë së depozitave
- Reduktimi i ekspozimit total, si brenda e jashtë bilancit

C) Përgjigjet Strategjike

Në shqyrtimin të përgjigjeve për tu adaptuar me Bazel III bankat kanë mundësinë për të sjellë ndryshime të mëdha në të gjitha fushat e institucionit. Këto përfshijnë iniciativa të drejtpërdrejta, si mbajtja e fitimeve për të rritur kapitalin nën Tier 1, por gjithashtu të përfshijë një gamë të gjerë mundësish si:

- Lëshimi i kapitalit të ri si pasojë e kritereve të reja të përshtatshmërisë së marrëveshjes
- Ndryshimin në strategjinë e financimit për të mbuluar rrezikun e likuiditetit
- Duke marrë një qasje më aktive për të balancuar menaxhimin e bilancit

• Angazhim më aktiv në menaxhimin e klientit

• Ndërmarrja e reduktime strategjike të kostos, duke përfshirë racionalizimin e strukturave të degëve, racionalizimin e produktit apo implementimin e një modeli të përbashkët të shërbimeve

• Ndryshimin e modelit të biznesit, i cili mund të sjellë shpërndarjen e rrezikut të lartë në njësitë e biznesit, duke hyrë në segmente, produkte apo biznese të rinj

• Ndryshimi i strukturës së grupit, për shembull, duke shitur interesat e pakicave në institucionet financiare

Kërkesave të reja bankat mund ti përgjigen në mënyrë të ndryshme. Të kategorizuara sipas kërkesave përkatëse le të bejmë një guidë të mundësive potenciale të bankave.

<u>Përgjigjet në përputhje me kërkesat e menaxhimit të kapitalit:</u>

Bankat duhet të kryejnë planifikimin e duhur nëpërmjet skenareve dhe të vlerësojnë saktë impaktin për të siguruar zhvillimin e një strategjie të suksesshme të kapitalit. Banka duhet të marrë kohën e saj e ti japë rëndësi të lartë vendosjes dhe aplikimit të objektivave të përbashkëta të kapitalit në të gjithe grupin (bëhët fjalë për grupet e mëdhenj ndërkombëtar por jo vetëm, mund të ulemi edhe në nivel koherence mes filialesh). Gjithashtu duhet të identifikojë nevojat për ndryshim të nivelit të kapitalit apo konsumit të tij. Bankat duhet të identifikojnë bizneset të cilat janë më fitimprurëset e më tërheqëset nën Bazel III, dhe kështu të bëjnë një ndarje midis bizneseve të cilat duhet ti përjashtojnë, atyre që duhet ti rrisin dhe bizneseve qe duhen devijuar disi. Sigurimi dhe mbështetja e menaxherëve në të gjithë këto procese është mjaft e rëndësishme sepse nëse këta të fundit kanë nxitje të mjaftueshme mund të sigurojnë më me rigorozitet optimizimin e përdorimit të kapitalit. Duhet konsideruar një sistem i mirëkopsitur për propozimin e çmimeve apo produkteve të reja që nevojiten si pasojë e implementiit të kërkesave të reja. Banka duhet të sigurohet nëse është më adapt i njëjti model biznesi apo jo, dhe duhet përgatitur për të në gjendje që të përmbushë edhe kërkesat kohore të implementimit.

Përgjigjen në përputhje me kërkesat e menaxhimit të likuiditetit:

Fillimisht bankat duhet të kuptojnë pozitën aktuale të nivelit të likuiditetit që ato zotërojnë. Në momenitin e një vizioni më të qartë në përputhje me dëshirat apo objektivat e bankës apo grupit ato mund të menaxhojnë më mirë optimizimin e përdorimit të kapitalit duke u paralelizuar gjithashtu me kërkesat e rregullores së re. Bankat duhet të konsiderojnë ndikimin e rregullave të reja të likuiditetit në përfitueshmërinë e tyre. Duhet kontrolluar nëse planifikimi i likuiditetit, qeverisjes, dhe modelimit janë në përputhje me praktikën e industrisë kryesore në treg. Bankat duhet të përcaktojnë një seri stress test-esh për të targetuar përshtatshmërinë e likuiditetit dhe evoluimin e tij përgjatë kohës. Së fundi, banka duhet të vlerësojë strategjinë e firmës në lidhje me likuiditetit e strukturës ligjore dhe rregullative ekzistuese të organizatës dhe të indentifikojë nëse sistemi, të dhënat, apo raportet e menaxhimit janë adapte për tu përputhur me kërkesat e reja të marrëveshjes së Bazel III.

Përgjigjen në përputhje me kërkesat e planifikimit të kapitalit:

Nën përgjigjen e planifikimit të kapitalit jemi në një nivlet të ngjashëm me veprimet strategjike sepse këto të fundit burojnë direkt nga vendosja e piketave të përdorimit të kapitalit. Në fakt, bankat duhet te sigurojnë që bizneset në të cilat ato janë të ekspozuara janë të ngarkuar në mënyrë të saktë për kostot e kapitalit të aktivitetit që ata janë duke bërë. Bankat duhet të sigurojnë që implikimet e Bazel III në nivelin e kapitalit janë marrë parasysh për biznesin e ri. Nevojitet spastrimi dhe rregullimi nëpërmjet ristrukturimit apo shitjes së bizneseve, nëndegëve apo institucioneve të ndryshme nën grupin bankar. Duhet të knsiderohet futja e kapitalit të jashtëm në modelet strukturore të specializuara për të zbutur kështu ndikimet kapitale që lindin. Duhen gjithashtu shqyrtuar seriozisht performancat e metodologjive të vlerësimit ekzistues si dhe rishikimi i të dhënave ekzistuese të cilësisë.

Pa marrë parasysh se çfarë veprimesh bankat marrin për të arritur përputhshmërinë me Bazel III dhe për të rivendosur përfitueshmërinë e tyre, të gjitha veprimet duhet të jenë të harmonizuara për të krijuar një qasje efikase dhe për të arritur rezultatet më të mira të mundshme. Sipas analizave të shumta, shumica e bankave do të përjetojnë një përfitueshmëri të ulët në mjedisin post-Bazel III me gjithë gamën e përgjigjeve të mundshme, por implementimi sipas fazave të ndryshme, në mënyrë korrekte e ndërkombëtare do të tregojë shpejt frytet e objektivit të harmonizimit e stabilitetit ekonomiko-financiar global.

Përfundimet e kapitullit

Në pjesën e parë të këtij kapitulli, u paraqitën rregulloret bankare, të cilat kanë qënë subjekt i ndryshimeve e përmirësimeve perpetuale e të vazhdueshme. Që prej marrëveshjes se vitit 1988, qëllimi i së cilës ka qënë adresimi i kufizimeve dhe problemeve me të cilat ballafaqohej sistemi bankar. Marrëveshja Bazel I pati si qëllim përgjigjen kundrejt problemit të harmonizimit të rregullatorëve si dhe të rreziqeve të marrë në konsideratë për të llogaritur vlerën e kapitalit për tu konservuar. Por kjo marrëveshje ka patur kufizimet e veta, e thjeshtë për tu provuar kjo gje sepse sistemi dështoi. Në fakt matja e rrezikut kishte mangësi të dukshme. Për këtë fakt, lindi Bazel II që mori në konsiderate mangësitë e të parit, por fatkeqësisht as kjo marrëveshje nuk ishte e mjaftueshëm. Edhe kjo marrëveshje mbështetej në përdorimin e metodave të vlerësimit të rrëzikut bazuar nga vlerësimi i sasië së kapitalit, që sillte një mbivlerësim të zërave të kapitalit, pra cilësisë së tij. Kriza e rradhës riçoi në nevojën e rishikimit të marrëveshjes, e jemi sot në marrëveshjen Bazel III, e cila adresoi të gjithë kritikat e të mëparshmeve dhe ka ofruar plot risi si cilësore edhe sasiore.

Kjo marrëveshje është karakterizuar kryesisht nga një ripërkufizim i kapitalit, si dhe futjen e jastëkëve dhe raporteve të likuiditetit. Megjithatë, kjo marrëveshje është larg nga të qënit e përsosur. Është për t'u vlerësuar që rregullimi bankar ka evoluar, në bazë të këtij trendi,

bankat janë përshtatur dhe kanë gjetur mënyra të reja për të shmangur rritjet e konsiderueshme në kapitalin e tyre, duke përfshirë sigurimin e kredive. Pavarësisht nga teprimet në sigurimin e kredive, rregullimi bankar ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë i dobishëm për të zgjidhur problemet e identifikuara në sistem.

Gjithashtu, del një tjetër pyetje: a do ta "vriste" mbikëqyrjen një mbi dozë rregulloreje ? Pjesa e dytë e kapitullit përshkruan efektet e Bazel III, efektet potenciale që ajo do të ketë në ekonomi, si në ekonominë reale edhe në nivelin bankar. Pas analizimit të dy efekte pozitive dhe negative, ne mund të konkludojmë se Bazel III është i kushtueshëm në afat të shkurtër, por në afat të gjatë ajo do të "paguajë", pra do t'ja vlejë. Megjithatë, që kjo marrëveshje të jetë më efektive, duhen zhvilluar masa për bankat sistemike dhe institucionet "fantazmat". Së fundi, theksohet se efektet e paraqitura janë vlerësime të bazuara në arsyetim ekonomik, kjo është sigurisht e pamundur momentalisht për nga vetë koha e implemetimint të Bazel III e cila sna ka dhënë mjaftueshëm material mbi ndikimin e vërtetë të reformës. Kështu, Bazel III është një kuadër shumë më i rreptë dhe më i qëndrueshme rregullator në nivelin global, dhe ajo çka na intereson është pikërisht se si do të pritet e si do të impaktojë Bazel III sitemin bankar nga aspekti i strategjik dhe i aktivitetit bankar?

KAPITULLI IV: STRATEGJIA NË AKTIVITETIN BANKAR, PASOJAT E SAJ

Hyrje

Lind pyetja, cili do të ishte një aks më specifik në aktivitetin bankar potencialisht i influencueshëm prej mbikëqyrjes?! Për të indentifikuar këtë infuencë është zgjedhur pikërisht strategjia e një banke. Si do të transformohet apo ridrejtohet një model biznesi i bankës nën këto risi mbikëqyrëse të marrëveshjes së Bazel III? Si do të ndikohet orientimi strategjik i bankës? Për ti dhënë përgjigje këtyre pyetjeve e shumë të tjerave që do të gjenerohen gjatë rrugëtimit të kapitullit tre do të kalojmë nëpër tre pjesë përbërëse të tij :

Së pari do të kryhet një analizë mbi bazën e strategjisë e mundësive të saj. Së dyti do të të targetojmë strategjinë bankare duke evidentuar modelet kryesore, përshtatjen bankare si dhe pasojat e strategjisë bankare. Së treti do të analizojmë tendencat strategjike kryesore të Evropës dhe të Shteteve të Bashkuara në mënyrë të tillë për të targetuar infulencat potenciale si dhe për të fokusuar analizën empirike duke e paralelizuar me trendet globale.

Në fakt kjo do të na mundësoje analizën e ndërthurur (cross-anlysis) midis mbikëqyrjes dhe strategjisë e cila na ndihmon në ndërtimin e kornizës empirike për të realizuar studimin në fjalë.

4.1 Përkufizime Dhe Modelet Strategjike

4.1.1 Gjenzat strategjike

Strategjia e ka origjinën ushtarake. Ndërkohë, koncepti i strategjisë së firmës është një koncept jo fort i vjetër, megjithatë, ajo është duke u shkrirë në mënyrë shumë harmonike në objekte apo fusha të ndryshme teorike. Në fakt, mund të vëmë rë se kufijtë midis strategjisë dhe menaxhimit zbehen. Fjalori i tanishëm pasqyron humbjen e kuptimit të termit strategji, term i cili tashmë përdoret për të përshkruar të gjitha llojet e vendimeve, veprimeve, proceseve ose burimeve të firmës, ndërkohë që strategjia paraqet disa propozime dhe mënyra të të menduarit.

Këto propozime janë të bazuara në konceptin e proceseve strategjike. Strategjia e zbatuar nga procesi strategjik përkthehen në veprime synimet përfundimtare . Proceset strategjike janë krijues vlerash dhe kanë për qëllim futjen e firmës në treg duke përdorur burimet dhe aftësitë që, nën kushte të caktuara, kanë të ngjarë që të gjenerojnë avantazhe konkurruese të qëndrueshme. Për një ushtarak, strategjia është gjithmonë subjekt i politikës. Ushtaraku i shërben të mirës publike, duke ndërhyre vetëm kur politika nuk ka qenë në gjendje për të zgjidhur një çështje të caktuar. Në fakt, lufta është vazhdimi i politikës, por, me mjete të tjera. " Foch " ishte një nga mësuesit e mëdhenj të luftës, dhe ka formuluar tri parimet e luftës : Përqendrimi i forcës, Ekonomia e Mjeteve dhe Lëvizshmëria.

Parimi i përqendrimit të forcave duhet zgjedhur për të sulmuar pikat e dobët të armikut nëpërmjet mobilizimit të forcave. Duhet të jesh më mirë se kundërshtarët mbi një terren të kufizuar në vend të qënit mediokër kudo. Ky parim i bën referencë shpërndarjes së burimeve në fronte të shumtë.

Parimi i ekonomisë së burimeve do të thotë që ne duhet të vëmë në veprim vetëm burimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për të arritur objektivat. Kjo nënkupton se veprimi zhvillohet në një kontekst të burimeve të pakta dhe të shtrenjta.

Parimi Lëvizshmërisë ka për qëllim të tij ruajtjen e lirisë së veprimit, që do të thotë, zgjedhjen e vendndodhjes, kohës dhe mundësisë për të luftuar. Anasjelltas, duke kufizuar lëvizshmërisë e veprimit të kundërshtarit, gjë që e privon atë nga zgjedhje të tilla të mundshme, në mënyrë që veprimi i kundërshtarit të jetë plotësisht i parashikueshëm dhe ne të zotërojmë një përgjigje kundër tyre.

4.1.2 Strategjia në firmë

Strategjia e biznesit ka qenë e formalizuar si një fushë e mendimit dhe e veprimit përgjatë viteve 60. Modeli strategjik i njohur i Harvardit është i bazuar kryesisht në strategjinë ushtarake. Puna është e frymëzuar nga ndjekja e interesave më të mira të quajtura "Objektivat strategjike", ku vendimet strategjike i përkasin zgjedhjes së zonave të aktivitetit dhe natyrës së intensitetit të angazhimit në fjalë. Po ta shohim paralelisht nga fjalori ushtarak, kemi të bëjëm pra me zgjedhjen e kunërshtarit, aleatëve, vendit dhe kohës së luftës. Në arritjen e këtyre vendimeve, procesi i analizës strategjike identifikon, vlerëson dhe krahason anët e forta dhe dobësitë në krahasim me kundërshtarët për të analizuar ndryshimet e mundshme në mjedis për të zbuluar kushtet e favorshme ose të pafavorshme për të vepruar. Siç tregohet nga Lorino dhe Tarondeau (2006), duke u mbështetur në strategjitë ushtarake dhe parimet e luftës, strategjia e kompanisë ishte përcaktuar fillimisht si :"Arti i të luftuar në fushën e konkurrencës".

Ansoff na ofron kufijtë e menaxhimi strategjik duke bërë dallimin midis vendimeve strategjike dhe vendimeve operacionale. Vendimet strategjike konsiderohen si vendime në thelb të jashtme, lidhur me marrëdhëniet midis firmës dhe mjedisit të saj, që kanë të bëjnë posaçërisht me zgjedhjen e produkteve që kompania synon të ofrojë në tregun që ajo dëshiron të shesë. Në të kundërt, vendimet operacionale janë të një natyre të brendshme. Qëllimi i tyre është maksimizimi i efikasitetit të procesit të konvertimit të burimeve të firmës dhe në veçanti për të adresuar problemet e alokimit të burimeve të linjave të ndryshme të produktit apo të njësive funksionale si dhe të kontrollojnë përdorimin e këtyre

burimeve. Ndërkohë vendimet administrative lidhen me blerjen, zhvillimin, dhe organizimin e burimeve të firmës në mënyrë që objektivat e saj mund të arrihen. Për Ansoff këto tri fusha vendimesh janë të hierakizuara. Vendimet e jashtme strategjike diktojnë politikat administrative dhe operacionale, pra struktura ndjek strategjinë.

Dalë prej Shkollës së Harvardit , konsulentët e BCG u bënë pasuesit e strategjisë ushtarake më të zhvilluar, strategjisë së "rulit ngjeshës". Për të fituar, duhet të jesh më i madh dhe më i fuqishëm se kundërshtari. Nuk e mat raporti i fuqisë nëpërmjet numrit të ndarjeve në një fushë të veçantë, por në pjesën relative të tregut. Natyra e vendimeve strategjike nuk ndryshon . Janë segmentet apo fushat e aktivitetit që janë strategjike si dhe vargu i metodave të përdorura për të hyrë, qëndruar ose për t'u tërhequr prej tyre. Ne mund të flasim kështu për strategjitë e pozicionimit në treg dhe të krahasimit me konkurrentët. Paralelizmi ushtarak, bën që të konsiderojmë tregun si fushë beteje, dhe firma më e suksesshme në një segment të caktuar është një firmë madhësia e të cilës është dominante mbi konkurrentët e saj. Porter rafinon analizën duke futur logjikë tjetër mbi dominimin dhe raportet dominues-i dominuar. Ai konsideron se konkurrenca nuk është e kufizuar për kompanitë që janë të pranishme në segmente të njëjta strategjike. Kjo përforcohet nga kërcënimet e hyrjes së firmave të reja apo shfaqjen e produkteve zëvendësuese nga industritë e tjera. Këtu ne mund të shohim konkurrencën e zhvilluar në vitet e fundit midis bankave dhe pseudo-bankave.

Analiza e strategjisë së biznesit ka dy faza kryesore. Së pari kemi "Analizën e jashtme", ku janë hulumtuar faktorët strukturorë e mjedisorë. Së dyti kemi "Analizën e brendshme", ku burimet vetjake të firmës janë vlerësuar dhe krahasuar me ato të konkurrentëve të saj kryesor. Për teoricienët e burimeve, secila firmë ka një portofol të veçantë të burimeve që ofrojnë përfitime në zbatimin e strategjive të caktuara. Nëse për teoricienë të konkurrencës të gjitha firmat që operojnë në një industri janë konsideruar si subjekt homogjen ndaj faktorëve strukturorë të njëjtë që do të diktojnë sjellje të njëjta, në anën tjetër teoricienët e burimeve i konsiderojnë industritë heterogjene sepse janë të përbëra prej firmave të veçanta me kombinime të veçanta të burimeve dhe aftësive. Në këtë kontekst, zhvillimi i

një strategjie, për një firmë të caktuar, është zgjedhja e një sërë veprimeve për shfrytëzimin më të mirë të karakteristikave të portofolit të burimeve dhe ekspertizës së firmës në fjalë. Homogjeniteti i firmave nxjerr në pah strategji të kushtëzuara nga strukturat e industrisë ndërkohë që heterogjeniteti rregullon hapësira monopolesh ku çdo firmë përcakton sjelljen e saj më lirshëm (Në këtë mënyrë e ka përshkruar Chamberlain (1933) konkurrencën monopolistike). Sipas kësaj pikëpamjeje, firma duhet të kërkojë të dallojë veten nga konkurrenca për një pozitë të dominimit të tregut, e cila i jep lëvizshmëri më të madhe dhe liri veprimi, ndaj ajo duhet të përpiqet të ndërtojë një portofol të burimeve, të rikuperueshme në mjedisin konkurrues në të cilën vepron, prortofol i cili në të njëjtën kohë i siguron dallimet e dëshiruara dhe i garanton qëndrueshmërinë e avantazheve të fituara.

Strategjia e firmës ushtrohet në një mjedis jo të qëndrueshëm dhe të pasigurt, që bën që edhe pse një firmë mund të prodhojë produkte të mira me proceset më të mira kjo nuk i garanton mbijetesën për një kohë të gjatë. Arma më e mirë në këtë mjedis është inovacioni, sepse për të mbijetuar, kompania ka nevojë të përtëritet . Inovacioni është një nga mënyrat për të dalluar veten nga konkurrentët dhe për të ndryshuar rregullat e lojës në një industri . Strategjia e firmës padyshim varet nga burimet dhe aftësitë ideosinkratike[27] të cilat ajo zotëron. Përveç kësaj, strategjia e firmës bazohet në zhvillimin e një portofoli të burimeve me vetitë e mëposhtme :

- Të ketë një potencial të lartë për të kontribuar në strategjitë e pozicionimit që mund të zgjidhë firma
- Të gjenerojë një përparësi ndaj konkurrentëve
- Të sigurujë qëndrueshmëri të këtyre përparësive.

Në vitet e fundit, strategjia shihet më së shumti si një bashkësi vendimesh dhe qëllimesh të paramenduara, të artikulueshme dhe të identifikueshme të cilat përcaktojnë mënyrën për blerjen dhe kontrollin e burimeve dhe aftësive të firmës për të dalluar veten nga konkurrentët e saj. Gjithashtu për të zhvilluar aktivitetet e saj, për të inovuar ose për të

[27] Një karakteristikë strukturore ose e sjelljes karakteristike për një individ ose grup.

zotëruar një fleksibilitet të mjaftueshëm për tu përshtatur me ndryshimet në mjedis apo me strategjitë e konkurrentëve .

4.1.3 Modelet e ndryshme strategjike :

Ekzistojnë disa modele strategjike të zhvilluar nga autorë të ndryshëm, e modelet kryesore që kanë karakterizuar jetën e shoqërisë do mund ti prekim paksa nëpërmjet një guide të prezantuar në këtë nën-seksion.

Së pari do të kalojmë nëpër duar të njohurin ***Model LCAG të Harvardit***. Siç e përmendëm edhe më parë ky model frymezohet nga strategjia ushtarake dhe bazohet në analizën e jashtme për të përcaktuar mundësitë dhe kërcënimet e mjedisit, si dhe nga një analizë e brendshme e cila shërben për përcaktimin e pikave të forta e të dobëta të vetë firmës. Në bazë të kësaj analize vendoset peshorja e krahasimit me konkurencën për të përcaktuar kushtet e favorshme apo jo për veprim. Pas përcaktimit të situatës më adapte ndërtohet strategjia që i përshtatet dhe që i siguron firmës arritjen e qëllimeve të saj. Pasi zgedhjes së strategjisë do të konkretizohen politikat financiare , të marketingut, të prodhimit etj.



*Figura 4.1 Modeli LCAG i Harvardit, (*Learned, Christenen, Andrews dhe Guth)

Së dyti kemi ***Modelin e 5 P-ve të Mintzberg***. Henry Mintzberg sugjeron pesë elementë thelbësorë për të zhvilluar një strategji të biznesit, planin, pozicionin, prespektivën, kurthin

dhe modelin[28]. Kontributi i Mintzberg është procedura e parashikuar nga strategu dhe rrugën që lejon për të realizuar një strategji të firmës.

Figura 4.2 Modeli 5P i Mintzberg

Së treti kemi ***Matricën " General Electric "***që bën një kryqëzim midis firmës dhe mjedisit që e rrethon për të përcaktuar strategjinë për tu ndjukur. Ky model bazohet si në analizën e brendshme edhe në atë të jashtme. Matrica është si vijon:

Firma / **Mjedisi**	**Pikat e forta**	**Pikat e dobëta**
I favorshëm	Strategji e rritjes (a)	Strategji e ripozicionimit (b)
I pafavorshëm	Strategji e diversifikimit (c)	Strategji e braktisjes ose likuidimit (d)

Tabela 4.1 Matrica General Electric

a) Kur firma ka anët e forta mbi konkurrentët e saj dhe mjedisi është i favorshëm, një strategji e rritjes është e rekomanduar.

[28]Nga frëngjishja: Plan, Position, Perspective, Piège, Pattern. Në frëngjish sepse Mintzberg është nga Kuebeku i Kanadasë.

b) Në qoftë se mjedisi ekspozon kushte të favorshme dhe firma ka disa dobësi që e mohojnë nga avantazhet konkurenciale, strategët janë të këshilluar në një ripozicionim.

c) Në rastet kur firma ka anët e brendshme të forta dhe mjedisi karakterizohet nga kushte të pafavorshme, një strategji diversifikimi duhet të zbatohet, pra aktivitete të reja që lidhen me produktet e reja dhe tregje të reja bazuar në pikat e forta ekzistuese.

d) Ky është kryqëzimi kritik kur situata është shumë e keqe në tërësi. Kemi dobësi të brendshme dhe situatë të jashtme negative ndaj është më mirë për ta lënë industrinë në fjalë apo edhe likuidimin e kompanisë për të mos përkeqësuar situatën.

Së katërti kemi të famshimin ***Model BC***G, që është quajtuar gjithashtu matrica BCG. Secila zonë strategjike e biznesit të firmës ka karakteristika të ndryshme në aspektin e normës së rritjes së sektorit dhe pjessës së tregut apo pozicionit konkurrues. Më poshte kemi paraqitjen e modelit.



Figura 4.3 Modeli BCG

Kemi katër drejtime strategjike të prezantuara në këtë model:

Star: strategjia do të jetë për të ruajtur këtë pozitë dominuese dhe të përfitohet në maksimum.

Dilema: dyfishimi i investimit, segmentimi, braktisja e segmenteve të vjetër dhe kërkimi i përfitimit nga rritja e fortë e sektorit.

Lopa për tu mjelë: përpjekje për të rentabilizuar dhe riinvestuar në një aktivitet fitimprurës dhe premtues, duke u përpjekur për të maksimizuar pjesën e tregut.

Pika e vdekur: strategjia e përshtatshmë në këtë situatë është braktisja ose mbajtja e pozicionit të tregut por pa investuar.

Ekziston një rregull i përgjithshëm që matrica BCG ia këshillon çdo firme, ky rregull thekson se kompania duhet të sigurojnë se ka një portofol të balancuar dhe në rritje. Për të bërë kështu ajo duhet të ketë "lopë" për të financuar "dilemat" dhe për të siguruar transformimin e tyre në "yje".

Së pesti kemi ***Matricën Ansoff*** e cila i konsideron vendimet strategjike si vendime të jashtme, që janë kështu të lidhura me marrëdhëniet midis firmës dhe mjedisit. Nga ky këndvështrim Ansoff ofron një model strategjik që kryqëzon produktet dhe shërbimet e ofruara nga kompania me teknologjinë dhe klientin ose me fjalë të tjera me tregun. Matrica Ansoff është si vijon:

Produktet/Shërbimet / Teknologjia/Klienti	Situata aktuale	Situata të reja
E/i vjetër	Penetrim (a)	Diferencim (b)
E/i ri	Segmentim (c)	Diversifikim(d)

Tabela 4.3 Matrica Ansoff

a. Për firmën çdo gjë është e vjetër, produkti është i njohur, klientela dhe teknologjia gjithashtu, strategjia e firmës e propozuar është që të hyjnë në " betejë" dhe të luajnë me konkurrencën.
b. Me një klientele dhe një teknologji fikse dhe një produkt apo shërbim të ri, strategjia më e mirë është diferencimi. Kjo strategji synon ofrimin e produkteve të ndryshme për të krijuar një avantazh të qëndrueshëm konkurrues të çdo strategjie të biznesit.
c. Me një klientelë të re por me produktet dhe shërbimet të vjetra, ofrohet në këtë rast një strategji segmentimi. Kjo strategji përfshin "prerjen" e konsumatorit në nën-grupe të dallueshme, ku secili prej nën-grupeve mund të zgjidhet si objektiv më vete për t'u arritur.
d. Në këtë pikë gjithcka është e re. Strategjia më adapte në këtë rast është diversifikimi. Ky është një opsion strategjik për të zgjeruar fushën e aktivitetit dhe imponon përdorimin e një serie të re të aftësive të kërkuara nga teknologji të reja.

Së fundi do të prezantohet **Modeli Porter**, të cilin e gjejmë gjithashtu nën kategorizimin si një "rrjetë organike". Sipas Porter, ne mund të përfaqësojmë strategjitë gjenerike duke u nisur nga një pikë reference që përfshin avantazhin komercial dhe shtrirjen e tregut të firmës. Avanatazhi komercial është origjina e përparësisë konkurruese që mund të vijë ose nga një avantazh në aspektin e kostos (oferta) ose nga një avantazh në vlerën e perceptuar (kërkesa). Nga ana tjetër shtrirja e tregut të firmës mund të jetëtregu i përgjithshëm (industria), ose një treg lokal (segment i industrisë). Për këtë Porter përshkruan modelin e tij si vijon :



Figura 4.4 Modeli Porter

Sipas Porter, ekzistojnë pra tre strategji kryesore në "luftën" kundrejt konkurencës:

1) Strategjia e dominimit nga kostot: arritja e kostos më të ulët përbën një ndër armët strategjike më të trajtuara. Nëse arrihet kosto më e ulët se mesatarja e sektorit përkatës, këto marzha të fituara mund të përdoren për fitime më të larta apo riinvestime në përmirësimin e rentabilitetit.
2) Strategjia e diferencimit: krijimi i një ose më shumë avantazheve që perceptohen si unike nga blerësit.
3) Strategjia e fokusimit: ndryshe e njohur me emrin strategjia e përqendrimit. Kjo strategji është e nevojshme kur firma nuk mund ose nuk do të trajtojë një industri të tërë, ndaj fokusohet në segmentin e dëshiruar.

Këto modele strategjike janë të përkthyera në sektorë të ndryshëm. Për secilën fushë, ka shumë opsione të politikave që do të thotë se përshtaten me karakteristikat sektoriale. Ndër këta sektorë kemi gjithashtu edhe përfshirjen e sektorit bankar. Cilat janë pra strategjitë kryesore të sektorit bankar?

4.2 Strategjitë Në Sektorin Financiar Dhe Bankar

4.2.1 Strategjitë kryesore të bankave dhe fushat strategjike të tyre

Sektori bankar ka pësuar zhvillime të shumtë, zhvillime të cilat janë ndjekur detyrimisht edhe nga drejtimet strategjike, ndaj, kërkimi i një avantazhi konkurues nuk sjell më të njëjtat rezultate si në fillimet e të tregut bankar. Për këtë, në ditët e sotme mund të vëzhgojmë dy strategji kryesore. Së pari mund të përmendim shfrytëzimin e avantazheve të bankës së marrëdhënieve[29]. Kjo është një strategji tradicionale në industrinë bankare, e cila mbështetet mbi ofertën e diferencuar, pra përshtatja e ofertës bankare sa më pranë kërkesave të klientelës. Në këtë mënyrë mardhënia dhe të dhënat e klientelës shfrytëzohen për të nxjerrë informacione mbi drejtimin potencial të kërkesës. Bankierët në këtë rast pocesojnë informacionin sasior apo cilësor prej klientëve të tyre (kryesisht target janë huamarrësit që nuk kanë akses në tregjet financiare) për të prodhuar shërbime të diferencuara të përshtatura për nevojat e këtyre të fundit.

Të ardhurat që përftohen duke u bazuar në këtë strategji vijnë nga marzhat e intersit të depozitave apo kredive. Kjo strategji është relativisht e shtrenjtë, sepse ajo nuk mundëson përfitimin nga ekonomia e shkallës. Dhe pikërisht për këtë, kemi edhe strategjinë e dytë, më e re, që mbështetet në shfrytëzimin e ekonomisë së shkallës dhe të fushëveprimit. Ajo reflekton rritjen e funksionit të shpërndarjes dhe është e bazuar në modelin e bankës së transaksionit apo bankës në veprim. Kjo strategji synon shfrytëzimin e ekonomisë së shkallës dhe të gamës në fushën e marketingut, prodhimit, shpërndarjes së kredive dhe produkteve të tjera të standardizuara, të tilla si kredia konsumatore apo imobiliare. Për të zbatuar këtë strategji, bankat duhet të jenë në gjendje të përdorin teknikat e përpunimit të informacionit sasior dhe publik, të tilla si teknikat e scooring dhe të titrizimit. Kjo strategji pra supozon një institucion me përmasa të mëdha që minimizon "koston e prodhimit". Të ardhurat që gjenerohen me zbatimin e kësaj strategjie janë të fraksionuara por nga ana tjetër të shumëzuara me sasinë e lartë duke patur si burim komisionet bankare.

[29]Bankë e mardhënieve: për të personifikuar orientimet ndaj mardhënies së klientelës.

Siç u përmend më parë është vetë zhvillimi i tregut bankar që ka çuar në ndryshimet e vetë strategjive, është pikërisht krijimi dhe tendenca drejt bankës universale që i jep kuptim dhe përfitim përdorimit të ekonomisë së shkallës dhe gamës për bankat. Në ndjekjen e këtyre dy lloje të strategjive, bankat janë duke u përpjekur për të shfrytëzuar karakteristika të teknologjisë bankare që krijojnë fuqinë e tregut dhe siguron përfitueshmëri mbi mesatare. Bankat kanë kuptuar prej shumë vitesh nevojën për të përcaktuar një strategji, si për shkaqe të brendshme të prezantimit të qartë të objektivave dhe detyrave edhe për shkaqet e komunikimit të jashtëm në raport me klientët dhe aksionerët. Për këtë është e nevojshme të prezantojmë fushat e strategjive bankare dhe alternativat strategjike për bankat. Strategjitë bankare duhet ti bashkëngjiten një fushe, e cila ka kufij të mirëpërcaktuar në mënyrë që të ketë qartësi dhe transparencë të veprimtarisë dhe në mënyrë për të shmangur shpërndarjen e tepërt. Për përcaktimin e fushës strategjike të një banke kemi variabla të shumta indikatore nga ku variablat kryesore janë: zona gjeografike, teknologjia, klientela dhe produktet.

1- Zona gjeografike si fushë strategjike e bankës:

Zona gjeografike përfaqëson influencë të konsiderueshme. Duke u vendosur në nivelin ndërkombëtar ne mund të konsiderojmë afërsinë fizike dhe ngjashmëritë kulturore. Ajo karakterizohet veçanërisht nga konceptet e rrezikut të kontrollit dhe të nevojave të konsumatorit . Në sektorin bankar, ky aspekt ka qenë prej kohësh një variabël kyç në përcaktimin e fushës strategjike, e cila është ndoshta pak më e zbehur në periudhën e tanishme. Por një reflektim mbi madhësinë dhe kufijtë e zonës së ndërhyrjes është e domosdoshme. Vendimet në aspektin e madhësisë optimale dhe artikulimit midis dimensionit lokal dhe global në drejtim të shërbimit të kontaktit me klientët dhe organizimin, shpesh përcaktojnë suksesin e bankave më të mëdha.

2- Teknologjia si fushë strategjike e bankës:

Teknologjia përfaqëson një dimension që është kudo dhe rëndësia e saj është gjithnjë e më shumë në rritje. Në fakt, teknologjia ndikon në të gjitha dimensionet që përcaktojnë fushën

strategjike nga ndikimi që ka në fushën e konceptimit, marketingut dhe shpërndarjessë produkteve dhe shërbimeve. Teknologjia ofron shumëllojshmërinë e kanaleve të transmetimit të produkteve, mund të ndikojë edhe në operacione të tjera të tilla si ruajtja e informacionit, transmetimi, ose trajtimi i operacioneve të ndryshme. Pikë shumë e rëndësishme është gjithashtu koha shtesë që i jepet klientit, dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve e informacioneve të tij.

3- Klientela si fushë strategjike e bankës :

Klientela është shumë e rëndësishme. Siç e pamë më lartë një ndër strategjitë kryesore të bankës është pikërisht shfrytëzimi i mardhënies së klientelës. Në fakt, dimensioni klientelë ka një numër të ndryshueshëm elementësh në bazë të mënyrës së segmentimit të tregut (që nga ndarjet krysore individ, firmë, organazita dhe nënndarjet e tjera në grupime me interesa të njëjtë). Pesha e çdo segmenti apo raportet e përfitueshmërisë për secilin prej tyre mund të orientojnë bankën në strategji apo target të ndryshëm.

4- Produktet si fushë strategjike e bankës:

Produktet reflektojnë përfaqësimin e bankës. Banka është një aktivitet që ofron një shumëllojshmëri produktesh. Ajo shihet si një firmë multi-produkt, ku çdo gamë produkti i përket një funksioni të bankës, dhe një ose më shumë segmenteve të klientelës. Oferta e një banke rreshton produktet e inxhinierisë financiare (konsulencë dhe menaxhim pasurie), shërbimet e menaxhimit të rrezikut (rrezikut të kursit të këmbimit, të normës së interest, të kredisë etj), shërbimet e lidhura me menaxhimin e depozitave dhe operacionet e kreditit, shërbime me vlerë të shtuar të tilla si shkëmbimi i informacionit të fondeve apo letrave me vlerë.

4.2 .2 Alternativat strategjike të bankës

Në varësi të situatave, të dëshirave dhe mbi të gjitha të mundësive të bankës aktiviteti bankar i nënshtreohet disa alternativave të ndryshme strategjike. Në fakt mund te grupojmë

dy kategori analize strategjike, së pari sipas produktit, klientelës, zonës gjeografike dhe teknologjisë së dyti sipas një analize katër dimensionesh si pika të forta, pika të dobëta, mundësi dhe kërcënime (analiza SWOT).

A) Fushat strategjike që burojnë nga produkti, klientela, zona gjeografike dhe teknologjia

Siç i shqyrtuam edhe me parë, këto dimensione të aktivitetit bankar janë shumë të rëndësishme për përpilimin dhe zhvillimin e strategjisë banakre. Këto dimensione, në fakt, i lejojnë bankës të përshtasë njërën prej alternativave strategjike të mëposhtme.

1- Segmentimi

Segmentimi nga vetë emërtimi personifikon fraksionimin, prerjen apo copëzimin e tregut në grupe dhe nëngrupe të dallueshëm nga njëri-tjetri. Kriteret e segmentimit janë tregu, produkti dhe teknologjia. Në bazë të tyre banka i ofron secilit segment produkte e shërbime të ndryshme specifike për secilin prej tyre. Edhe nëse produkti në bazë është i njëjtë banka do të ketë mënyra të ndryshme të të ofruarit në bazë të nëngrupit target, duke synuar të kënaqë nevojën e klientelës në çdo segment të përcaktuar. Strategjia e segmentimit lejon çdo bankë të jetë në gjendje t'i shërbejë më mirë klientëve të saj sesa konkurrentët, të identifikohet në mënyrë të qartë nga objektivi dhe të zbatojnë më mirë profesionalizmin e saj. Përvoja tregon gjithashtu se përqendrimi në një numër të kufizuar të segmenteve të çon në një monitorim dhe kontroll më të mirë të rreziqeve. Megjithatë, përcaktimet e dobët të kritereve të segmentimit mund të rrezikojnë suksesin e kësaj alternative strategjike.

2- Diversifikimi

Diversifikimi shërben për të zgjeruar fushën e aktivitetit të bankës dhe kërkon të përdorë një seri të re të aftësive të nevojshme për hapësirën e re konkurruese në të cilën banka prezantohet nëpërmjet vetë diversifikimit. Kjo nënkupton atëherë të jepen aktivitete të reja që i korrespondojnë produkteve të reja dhe tregjeve të reja.

Për një bankë, alternative e diversifikimit personifikohet gjithashtu nga hyrja në sektorë të tjerë përmes rritjes së brendshme (si prezantimi i një lloji të ri produktesh financiare) ose nga rritja e jashtme (blerja e një kompanie që tashmë ofron këto produkte).

Diversifikimi bazohet nga modifikimi i fushës strategjike të institucionit në drejtim të produkteve, konsumatorëve, teknologjisë apo zonës gjeografike. Në sektorin bankar mund të vëzhgojmë një diversfikim mbi tregut e individëve me produktet e reja të kursimit, globalizimit të formave të kredisë apo shtimit të produkteve të sigurimit. Në anën e tregut të firmave mund të vëzhgohet një rritje e madhe në gamë dhe në sasi produktesh, sidomos në format e ofertës së investimeve dhe menaxhimit të fondeve. Shtimet në këto dy tregje bejnë që banka të rrisë madhësine e gamës së saj të produkteve duke patur kështu produkte të mirëdiversifikuara. Strategjia e divesifikimit i sjell bankës avantazhe nëpërmjet uljes së rrezikut (nga diversifikimi i portofolit) si dhe uljes së kostos (ndarja e burimeve dhe aktiveve midis produktesh të ndryshme). Në të kundërt, pavarësisht përfitimeve të diversifikimit, kjo strategji mund të çojë në zhgënjim dhe shqetësim si shkalla e investimit që kërkohet për ta zbatuar, shpërndarja e burimeve, vështirësia për kontrollin e të gjitha aktiviteteve, humbja e identitetit të bankës dhe dobësimi i kulturës së saj.

3- Diferencimi

Një përkufizim i strategjisë së diferencimit është kërkimi i një avantazhi konkurues të ndërtuar rreth karakterit unikal të ofertës së perceptuar nga klientët. Është pikërisht ndërtimi i një elementi unik që e bën ofertën e një banke të paimitueshme apo zëvendësueshme nga konkurenca e ndaj e diferencon si institucion nga bankat e tjera. Pra kemi të bëjmë me një strategji e cila buron nga vecantia e ofertës, veçanti e cila vlerësohet nga tregu, dhe bën që banka të evitojë konkurencën direkte. Një bankë e cila zgjedh strategjinë e diferencimit, zgjedh të luftojë konkurentet nëpërmjet mjetesh të tjera nga çmimi, ajo synon perceptimin e saj unik e të veçantë nga ana e klientelës për ta direfencuar e vlerësuar më shumë

në pikën e pranimit edhe të një çmimi më të lartë. Diferencimi mund të konkretizohet në forma të ndryshme, mund të "ngacmohen" karakteristikat e bankës (marka, kanelet e shpërndarjes, reputacioni), karakteristikat e produktit (pozicionimin e produktit në gamë, prezantimin e tij, shërbimet e bashkëngjitura, certifikimin e produktit) apo anën teknologjike. Strategjia e diferencimit forcon akoma më shumë lidhjen e bankës me klientlën e saj, rrit transferimin e informacionit, dhe vlerësimin nga ana e klientelës nëpërmjet realizimit të kërkesave të tyre sipas "masës". Këto përparësi në sytë e klientelës e lejojnë bankën të fiksojë çmime më të larta dhe të ndërtojë një imazh të dalluar. Ndërkohë që kostot e difersifikimit me raste mund të tejkalojnë nivelin që klienti është i gatshëm të paguajë, mund të ndodhë që banka të zgjedh produktin e gabuar për të diferencuar apo akoma më shumë që të mos ketë më ekspertizën e duhur të produkteve të reja.

4-Fokusimi

Kur banka zgjedh të targetojë një segment të caktuar të klientelës atëherë kemi zgjedhjen e një strategjie fokusimi. Zhvillimi nëpërmjet këtij aksi strategjik është inovimi në ofertën e targetuar sipas ritmit të zhvillimit të segmentit të zgjedhur. Mund t'i referohemi gjithashtu, të mirënjohurit term të "strategjisë së folesë", pra ku banka zgjedh një copëz dhe i dedikohet asaj në mënyrë të përqëndruar. Kjo ndodh kur banka nuk do të "luftojë" apo të "atakojë" totalitetin e tregut, por zgjedh copëzën e saj dhe i përmbahet. Fokusimi mund të marrë forma të ndryshme të tipit fokusim mbi vetë produktin (specializim mbi produktin duke u bazuar mbi aftësitë dalluese), fokusim mbi klientelën (rigrupim i klientëve me nevoja të njëjta e specializim në ta) si dhe fokusimi mbi zonën gjeografike (fokusim mbi një shtet, rajon apo qytet). Edhe pse kjo strategji sjell një nivel të lartë të performancës teknike dhe komerciale të segmentit të përzgjedhur, nuk është pa rrezik. Në fakt mund të identifikohen rreziqe si përkeqësimi i avantazhit të kostos, humbja e faktorëve të diferencimit apo nënsegmentimi që mund te bëjnë konkurentën në po fokusin e bankës.

B) Fushat strategjike që burojnë nga analiza SWOT

Analiza SWOT, përmblidhet në të ashtuquajturën matricë SWOT. Kjo matricë është kryqëzimi i pikave të forta dhe të dobëta të firmës si dhe oportuniteteve dhe kërcenimeve që i prezantohen asaj. Pra është gërshetimi i mjedisit të jashtëm me atë të brendshëm në skajin pozitiv dhe negativ. Si pjesë e një matrice "SWOT" objektivat e kompanisë në një fushë strategjike duhet të kenë origjinën në njohurinë e pozitës konkurruese të zënë dhe të pjesës së tregut në çdo kohë të dhënë. Matrica SWOT rezulton nga konfrontimi në mes të karakteristikave të firmës dhe kushtet e reja të strategjive mjedisore bankare të cilat i gjeni të paraqitura në figurën e mëposhtme:



Figura 4.5 Analiza SWOT dhe alternativat strategjike që burojnë prej saj

1- Pushtimi

Kjo është një strategji sulmuese që është shprehje e një vullneti force të mishëruar në kohë. Kjo alternativë duhet të shprehet në çdo nivel të organizatës. Strategjitë e pushtimit janë të shprehura në fusha të ndryshme. Së pari mund të shohim pushtimin e individëve dhe profesionistëve. Ka filluar në vitet 80 me pushtimin e individëve. Këto të fundit siguruan furnizimin e depozitave bankare dhe tregjet janë të qëndrueshme për një gamë të shërbimeve dhe produkteve. Kjo klientelë u braktis në fillim të viteve 90 në favor të aktiviteteve më shumë fitimprurëse si aktivitetet e tregut të financimit. Së fundmi, bankat kanë konsideruar me kujdes specifikat e tregut të profesionistëve për identifikimin e

mundësive të zhvillimit. Të gjitha kategoritë e profesionistëve nuk kanë tërheqje të njëjtë dhe të njëjtat rreziqe. Disa banka kanë hyrë në strategjitë e pushtimit për kategoritë më tërheqëse, të tjerët kanë zhvilluar një qasje në drejtim të produkteve të specializuara.

Së dyti kemi pushtimin e biznesit, si një element i rëndësishëm i çdo ekonomie kombëtare, sidomos në ekonomitë në zhvillim.

Zhvillimi i portofolit të biznesit bëri të nevojshme futjen e metodave të menaxhimit industrial si në organizimin e punës, në planifikimin afatgjatë, si dhe në miratimin e teknikave të reja të marketingut .Së treti kemi pushtimin e aktiviteteve të tregut. Këto aktivitete kërkojnë krijimin e ekipeve dhe teknologjive të nivelit të lartë që duhet të kontrollohen dhe të koordinohen. Në qoftë se madhësia nuk është një faktor përcaktues për zhvillimin e strategjive të pushtimit të individëve dhe bizneseve për aktivitetet e tregut kjo dëshmon një marzh fushëveprimi në drejtim të pushtetit të ndërhyrjes dhe të aftësisë për të rritur kapitalin. Ky fenomen ka rezultuar në zhvillimin e filialeve të menaxhimit të aseteve, përvetësimin e firmave të brokerimit dhe zbatimin e tregjeve financiare ndërkombëtare.

2- Riorientimi

Ashtu si çdo firmë, banka operon në cikle dhe rastis që të ketë momente të zhvillimit të bankës, që të ketë rënie që shtyjnë në ndryshime pa prekur apo kërcënuar mbijetesën e aktivitetit të bankës. Objektivi në këtë rast është i qartë, kjo strategji ka për qëllim të rivendosë marzhat e fushëveprimit dhe mundësitë alternative të ndryshme. Pika e asfiksimit të aktivitetit është financiare, atëhere kemi shkatërrimin e investimeve (çinvestim), eliminimin e sektorëve me humbjeve etj. Vendimet konsistojnë në përgjithësi në përqëndrimin në aktivitetet në të cilat banka ka pika të forta. Një tjetër zgjedhje është për të zhvilluar produkte të veçanta ose për të shfrytëzuar produkteve ekzistuese por ende të pazhvilluara mirë.

3- Konsolidimi

Një strategji konsolidimi vjen në ndihmë vetëm pas një nevoje ndryshimi të madh. Prioriteti i saj është të forcojë dhe ngrejë pikat e forta të bankës për të frenuar rënien dhe duke tentuar në ruajtjen e pavarësisë së institucionit. Strategjitë e konsolidimit janë një miks midis strategjisë së pushtimit dhe të riorientimin në bazë të ciklit të zhvillimit në të cilin ndodhet banka. Nga vetë emri i saj strategjia implikon faktin e mbështetjes në pikat e forta pra e konsolidimit të saj në momente ku situatat e mjedisi i jashtëm janë të pafavorshme e akoma më tepër paraqesin kërcenim për bankën. Kompanitë mund të pësojnë konsolidime si pjesë e procesit të tyre të shkurtimeve. Kjo lejon kompanitë për të ulur operacionet për të përmbushur kërkesën e konsumatorit, në këtë mënyrë likuidohen disa operacione që nuk gjenerojnë shitje e për të shmangur falimentimin.

Për të përmbledhur qasjen e formulimit të strategjisë mund të mbështëtni në figurën e mëposhtme.



Figura 4.6 Qasja e vendosjes së strategjisë

4.2.3 Pasojat e stategjisë bankare

Duke pasur parasysh theksin mbi aktivitetin bankar dhe ndryshimin e zhvillimin e mjedisit bankar (liberalizimi, risitë financiare, konkurrenca, globalizimi, etj.), bankat kanë

ndryshuar vlerësimet e tyre për mundësitë në dispozicion dhe për kërcënimet me të cilat përballen. Këta faktorë padyshim që e kanë ndryshuar e që do vazhdojnë ta ndryshojnë mjedisin dhe rolin e bankave. Në fakt, bankat janë gjendur përpara detyrimit të integrimit të profesioneve të reja të tilla si inxhinieria financiare, dhe të rivendosjes përpara ndryshimeve në mjedisin e bankës dhe në fund të zgjedhin midis dilemës bankë universale apo bankë e specializuar.

Pas ndryshimeve që kanë goditur sektorin bankar, profesioni bankar ka ndryshuar në çdo bankë, duke bërë që profesioni i bankierit të bëhet gjithnjë e më shumë inovator. Cdo bankë është e detyruar sot të zhvillojë inxhinierinë e saj financiare. Ky term "inxhinieri financiare", i referohet zotërimit të një aktiviteti kërkimor për të gjetur produktin origjinal për t'i ofruar konsumatorëve që më pas do të targetohen dhe besnikërohen.
Për bankën e investimeve ky aktivitet qëndron në zhvillimin e ekipeve të specializuara dhe të afta për ti dhënë këshilla dhe për të siguruar kryerjen tenike të operacioneve të blerjes dhe shkrirjeve të kompanive. Strategjitë bankare të bazuara mbi profesione të reja i japin një rëndësi të madhe inxhinierisë financiare, e cila është bërë tashmë jetike dhe mënyrë e domosdoshme për të kënaqur klientelën e cila është në ditët e sotme qëndra e çdo përpilimi e orientimi strategjik të bankës.

Bankat, dhe në mënyrë specifike bankat komerciale po përballen me kërcënime të ngjashme dhe duhet të organizohen për t'iu përgjigjur mundësive të cilat gjithashtu pak a shuë të njëjta gjë për të gjithë. Bankat, pra, nuk kanë asnjë shans për të shmangur ndryshimin. Por çelësi i suksesit është zgjedhja nëse bankat do të ripozicionohen duke zgjeruar gamën e produkteve të tyre ose ndryshe duke ulur gamën e duke zgjedhur kështu specializim. Kjo është me të vërtetë një zgjedhje strategjike. Shqetësim kryesor për bankat janë klientët e tyre, edhe pse ato zotërojnë informacionin e nevojshëm për ta kuptuar klientelën e tyre. Në fakt, informacioni mbi klientelën e bankës është një armë për të fituar luftën e konkurrencës dhe kjo është arsyeja pse bankat përpiqen për të përmirësuar marrëdhëniet me klientelën e tyre që është në të njëjtën kohë burimi kryesor i të dhënave cilësore. Industria bankare është në proces të riorganizimit rreth klientit të saj. Qëllimi i

kësaj konkurence është aftësia për të identifikuar, parashikuar nevojat e klientit dhe për të zhvilluar më pas si produktet e nevojshme edhe modelet e shpërndarjes që plotësojnë çdo kërkesë klientele. Pra, çdo bankë është e detyruar të shqyrtojë strategjinë e vet dhe të përqëndrohet mbi të gjitha mbi besnikërinë e konsumatorit. Sfida që banka mund të përballet është zgjedhja e duhur e strategjisë .

Në mënyrë që të rrisin shërbimet e tyre, disa banka janë të orientuara drejt modeleve të bankave "universale" ose të njohura ndryshe edhe si "supermarket financiar". Ky trend është shfaqur si një interes strategjik për institucionet më të mëdha financiare. Një strategji e tillë mund të jetë e suksesshme në tregjet që nuk kanë asnjë pengesë ligjore ose administrative për këtë sipërmarje bankare. Bankat e tjera kanë zgjedhur një strategji të quajtur "Boutique". Ajo synon të shfrytëzojë avantazhet krahasuese të bankës në një numër të kufizuar të ofertës, duke ofruar produkte të cilësisë që përmbushin nevojat specifike të një klientelë të kërkuar. Kjo strategji mund të rezultojë ose në uljen e kostove ose në diferencim, gjithashtu banka mund të realizojë nëpërmjet kësaj zgjedhjeje ti shërbejë klientit më mirë se konkurenca. Këto dy zgjedhje shënuan strategjinë bankare në vitet e fundit. Në fakt, si rezultat i konkurrencës në rritje, të gjitha grupet bankare kanë nisur një përpjekje të madhe për të racionalizuar. Në aspektin e strukturave, ky veprim ka marrë forma të ndryshme :

- Disa institucione që dëshirojnë të specializohen në lloje të caktuara të veprimtarive, shitën portofolet e operacionet e të tyre në zonat ku ata nuk dëshironin të ndërhynin, si dhe burimet e lidhura me këto aktivitete.
- Në anën tjetër, disa grupe kanë kërkuar për të forcuar praninë e tyre në profesionet e aktivitetet bazike ose kanë zgjeruar ofertën e tyre për klientët e tyre tradicionale. Për shembull, ata kanë kryer blerjen e objekteve ekzistuese.

Pas kësaj guide të shpejtë të strategjisë bankare, është interesante për t'u parë dhe studiuar gjithashtu tendencat strategjike kryesore në nivelin europian.

4.3 Tendecat Evropiane Dhe Amerikane Të Strategjisë Bankare

Vitet e fundit janë karaketizuar nga veprime e operacione të ndryshme përqëndrimi në shumë sektorë, sidomos në sektorin bankar. Mjedisi ekonomik dhe social në zhvillim të vazhdueshëm i ka shtyrë të gjithë të ristrukturojnë dhe të adaptojnë ofertën e organizimin e tyre në mënyrë që të ruajnë pozicionin në treg dhe të mbeten kompetititv. Ristrukturimi bankar ka në origjinën e tij jo vetëm ndryshimet e mjedisit ekonomik por gjithashtu elementë të teknologjisë në zhvillim, të inovacionit etj. Tendanca e ristrukturimit ka përfshirë shumë vende të rajonit e të botës, me ndryshime njëri nga tjetri natyrisht. Kemi vëzhguar strategji të ndryshme si ristrukturimet e jashtme (pjesmarrje në kapitalin e një kompanië konkurente si koncepti i bankë-sigurimeve) ose strategji të rritjes së jashtme (blerjet dhe bahkimet)

Gjatë periudhës së fundit, ka pasur një rritje në numrin dhe madhësinë e bashkimeve dhe blerjeve. Sektori bankar është i dyti më madh ndër sektorët e tjerë ekonomik që i nënshtrohet këtyre orientimeve. Sipas të dhënave të ofruara nga Instituti i Bashkimeve, Blerjeve dhe Aleancave[30] bashkimet dhe blerjet kanë patur një trend rritës ndër vite. Mund të shikojmë më poshtë në dy grafikët e marrë për të dhënat agregat ndërkombëtare dhe agregat europiane se si këto verpime kanë evoluar me kohën, në numër apo në vlerë.

[30] Institute of Mergers Aquisitions and Alliances



Grafiku 4.1 Blerjet dhe Bashkimet në nivel global nga 1985 deri në tremujorin e parë të 2013, Burimi IMAA[31]

Mund të shikohet qartë se që prej vitit 1985 e deri ne vitet 2000 ka një shumëfishimm si në vlerë si në numër te veprimeve blerje-bashkime. Pas viteve 2000 numri i tyre ka rënë lehtësisht ndërkohëështë vlera e këtyre veprimeve është përgjysmuar. Nga vitet 2000 deri në 2007 mund të vëzhgojmë një ritje të fortë në vlerë dhe numër, ndërkohë që efekti i krizës ka vepruar vetëm në rënien e vlerës së transaksioneve. Pra dalim në përfundimin që kjo strategji është shumë dominuese në mbarë botën pavarësisht krizave apo zhvillimeve të tjera ekonomike (siç u përmend më lartë) .

[31] http://www.imaa-institute.org/statistics-mergers-acquisitions.html#TopMergersAcquisitions_worldwide



Grafiku 4.2 Blerjet dhe Bashkimet në nivel europian nga viti 1995 deri në tremujorin e parë të 2013 Burimi IMAA[32]

Në grafikun e mësipërm për pjesën evropiane jemi spostuar me 10 vite nga nisja e llogaritjeve ndaj fillojmë më vlera më të lartë por ndërkohë vëzhgojmë të njëjtat tendenca me nivelin ndërkombëtar. Ndërkohë që mund të shprehim për sa i përket vendit që zënë blerje-bashkimet evropiane në totalin e tyre përafrohen gati në gjysmën e tyre.

Një tjetër tipar dallues i bashkimeve është edhe fushëveprimi, në fakt ndër sektorët më të prekur mund të rendisim: sektorin e teknologjisë, medias dhe telekomunikacionit, sektorin financiar, bankar, të sigurimit dhe firmat e investimeve, sektorin e farmaceutikës, sektorin e energjisë, si dhe sektorin e industrive. Aktualisht, pothuajse 60 % e bashkimeve të kryera në mbarë botën vijnë nga këta katër sektorë, ai fianciar,i tekonologjisë, medias dhe telekomunikacionit. Bashkimet dhe blerjet bashkëkohore nuk kanë më për arsye të vetme strategjinë e diversifikimit ndërsektorial, të tipit conglomerate financiare, por prioriteti i tyre qëndron në forcimin e konkurueshmërisë së kompanive në stategjinë e përqëndrimit të

[32] http://www.imaa-institute.org/statistics-mergers-acquisitions.html#TopMergersAcquisitions_Ëorldëide

aktivitetit duke u fokusuar në “core business”, pra në aktivitetet baze. Le të hedhim një sy ndaj tendencave kryesore evropiane dhe amerikane.

4.3.1 Tendancat strategjike në nivel të bankave evropiane :

A) Startegjia e bashkimeve dhe blerjeve bankare

Disa faktorë motivojnë institucionet financiare që do të vijnë së bashku si ekonomia e shkallës, mbikapaciteti, intesfikimi i konkurencës, ofertë sa më e mirë për klientët, aplikimi i bashkimit monetar, shkrirje për reduktim kostosh por natyrisht edhe për të përfituar burime të reja kapitalesh e të ardhurash. Në një ambient të tillë, bashkimet dhe blerjet mund të formulojnë një strategji fituese. Evropa e ka rritur gradualisht praktikën e këtij drejtim strategjik. Sipas analistëve të blerje-bashkimeve ndërkombëtare, nuk është për t'u habitur por në Evropë ndodh një shkrirje ose blerjes strategjike pothuajse çdo ditë.

Përveç bashkimeve dhe blerjeve midis bankave, vëzhgohet në vitet e fundit, një rritje e konsiderueshme në bashkimet dhe blerjet me sektorët e tjerë, veçanërisht me sektorin e sigurimeve. Shumë institucione bankare kërkojnë të zhvillojnë burime të reja të ardhurash duke rritur gamën e ofertës së tyre nëpërmjet zhvillimit të aktivitetit të sigurimeve por edhe menaxhimin e aseteve. Këto operacione kanë shënuar pikërisht lindjen e konceptit të “bankë-sigurime”.

Shumica e bankave evropiane duket se favorizojnë një strategji të bashkimeve dhe blerjeve në dy akse. Së pari ata kanë për qëllim të mbrojnë pozitat e tyre në tregjet vendase kundër konkurrentëve potencialë të huaj, gjë e cila i shpie ata që të bashkohen me konkurrentët vendas. Së dyti, në një mënyrë më agresive, ata kërkojnë që të bëhen krye në të gjithë tregun evropian duke përvetësuar interesa në institucionet e huaja. Këto interesa mund të përbëhen nga pozicione të rëndësishme të pakicave, por mund të shkojnë edhe në pozicion kontrolli apo blerje totale. Qëllimi i lëvizjeve të tilla është përparësimi kundrejt konkurrencës që frymëzohen nga të njëjtat qëllime, dhe në këtë mënyrë për të rritur pjesën e tyre të tregut. Ndërkohë përqendrimi në thelbin e aktivitetit ka qënë një trend i

përgjithshëm, në mënyrë për të mbajtur nivelin e përfitimit, i cila ka rezultuar në një ngadalësim të ndërkombëtarizimit të grupeve të mëdha.

Edhe pse statistikat konvergojnë në konstatimin se shumica e bashkimeve dhe blerjeve evropiane janë bërë në nivel kombëtar, që synon në parim forcimin e operatorëve vendas, ku madhësia e tyre mund ti lejojë që të përballojnë konkurrencën evropiane, në këtë moment vërejmë transaksionet ndërkufitare. Në të vërtetë, deri në fund të viteve 90, transaksionet ndërkufitare kanë qenë të rralla në botën bankare. Theksohet se numri më i vogël i transaksioneve ndërkufitare ka qënë i kufizuar kryesisht nga vështirësitë e shkrirjes së kulturave të ndryshme dhe nga potenciali relativisht i ulët për uljen e shpenzimeve dhe përmirësimin e treguesit të efikasitetit. Megjithatë, ka pasur një përshpejtim në numrin e transaksioneve ndërkufitare, që vjen si nga dëshira e tregut të përbashkët edhe nga lehtësimet e unifikimit rregullator e prudencial.
Në Evropë, ne kemi blerjet e shumta ndërkufitare të interesave të minoriteteve në institucionet e mëdha apo të interesave të mazhoritarëve kundrejt institucioneve të vogla. Interesat e pakicës të përfituara në institucionet e mëdha nganjëherë janë vlera shumë të ulëta. Ka disa arsye për të çuar këtë normë të ulët të transaksioneve ndërkufitare. Në fakt, siç është verifikuar në transaksionet ndërkufitare, uljet e kostove janë më të vështira për t'u arritur sepse sistemet kompjuterike, tatimet dhe linjat e prodhimit kanë tendencë të mbeten kombëtare. Përparësitë kryesore të bashkimeve ndërkufitare janë më shumë efekti i madhësisë, rritja e pjesës së tregut dhe diversifikimi i burimeve të të ardhurave.

B) Strategjia e bankës universale

Strategjia e bankës universale në Evropë, është një strategji e përdorur kryesisht nga bankat e mëdha. Diversiteti i legjislacionit bankar kombëtar ka pasur një ndikim të thellë mbi strukturat bankare. Zhvillimet e fundit në Evropë dhe Amerikë në legjislacionin bankar kombëtar, kanë anuar në drejtim të diversifikimit të madh të aktiviteteve bankare, të tilla si modeli referues i bankingut universal. Konglomeratet financiare (bankat, sigurimet, letrat me vlerë) ose institucionet e tipit bankë-sigurime përfaqësojnë formën më të plotë të strategjive të diversifikimit. Përtej faktorëve thjesht rregullator, duket se zhvillimi i

bankingut universal është i justifikuar edhe nga arsyet ekonomike që lidhen në mënyrë specifike për të mirat e diversifikimit si ekonomitë e gamës, përmbushja e kërkesave specifike të zgjeruara të klientelës dhe reduktimi i reziqeve.

Arsyeja e strategjive të diversifikimit për bankat mund të vërehet gjithashtu në anën e kërkesës, atëherë bankat do të ofrojnë një gamë të larmishme të produkteve të tyre për të kënaqur karakteristikat e diversifikuara të kërkesës. Për besnikërinë e konsumatorit kundrejt konkurrencës në rritje, grupet kryesore bankare duhet të ofrojnë një gamë të plotë të shërbimeve, duke u përfshirë në fushat e financimit, të menaxhimit të parave të kompanive dhe aktivete të tjera financiare për individët. Forma më e plotë e strategjisë së diversifikimit është konglomerati financiar. Në aktivitetet e zhvilluar në tri fusha kryesore të financave, në fushën bankare , të letrave me vlerë dhe të sigurimit, kjo lloj strategjie mund të shihet si një politikë e përdorur nga bankat evropiane dhe kompanitë e sigurimit për të arritur madhësinë kritike që i mundëson atyre kalimin në të vërtetë në universale. Shembuj të bankingut universal në Evropë janë të shumtë dhe më të mëdhenjtë në fushë janë Credit Lyonnais, Barclays Bank dhe Deutsche Bank.

C) Strategjia e specializimit bankar

Ky drejtim strategjik është zbatuar nga bankat evropiane përmes dimensionit gjeografik. Kanë qënë kryesisht bankat e vogla apo të mesme, të cilat janë përfshirë në këtë lloj strategjie, siç është përmendur më lartë nën emrin "strategji e folese". Pra një bankë zgjedh folenë e saj dhe preferon të ndihet "ngrohtë" dhe sigurt në të sesa të "aventuriohet" nëpër treg. Ky trend i specializimit u përhap më pas edhe nëpër bankat universale evropiane, duke krijuar kështu njësi të specializuara për secilën nga fushat e biznesit që përbëjnë diversifikimin e tyre, në këtë mënyrë i përgjigjen dilemës diversifikim -specializim.

Straegjia e bankës universael për arsye te efikasitetit, anohet pak edhe nga strategjia e specializimit. Kjo dopjo strategji është e nevojshme në mënyrë që banka t'i ofrojë klientit të saj jo vetëm të gjithë mundësitë por edhe t'ua ofrojë në nivelet më të larta të cilësisë për secilën prej tyre. Në fakt për të arritur këtë dopio strategji banka ka nevoë për një

riorganizim të brendshëm që çon në formimin e grupeve bankare të strukturuar në dy nivele. Në nivelin më të ulët, bankat janë të organizuara si njësi të prodhimit të specializuar dhe marrin autonomi menaxheriale. Në nivel të lartë, lokalizohen aktivitete që përfitojnë nga ekonomitë e gamës dhe janë të grupuara në njësi më të mëdha. Edhe pse ekzistojnë arsye themelore për të justifikuar zhvillimin e modelit të bankingut universal në Evropë, ai nuk mund të jetë mundësia e vetme strategjike. Në të vërtetë, modeli i bankës së specializuar është gjithashtu krejtësisht praktik, edhe pse i nënshtrohet kushteve të caktuara si segmentimi i aktivitet apo madhësia.

Bankat universale dhe bankat e specializuara do të vazhdojnë të bashkëjetojnë në Evropë, secila me karakteristikat e veta dhe për të përmbushur nevoja specifike. Një nga objektivat kryesore të ristrukturimit të bankës duhet të jetë pikërisht arritja e kombinimit të avantazheve të diversifikimit, të bankave universale ose jo, duke kërkuar një specializim më të mirë që përmirëson ndjeshëm efikasitetin e bankës. Ndërkohë mund të konstatojmë shumë qartë që tendacat Evropiane përfshijnë tendencat më të përgjithshme të vëzhguara në mbarë botën.

Bankat Evropiane do të zhvillojnë kryesisht strategji sipas akseve të mëposhtme:

- Blerjet ndërkufitare aty ku sinergjitë mund të arrihen, duke përfshirë një racionalizim të rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, por edhe aty ku tregjet fitimprurëse mund të arrihen, si për shembull në vendet në zhvillim ku sektorët bankarë ende kanë boshllëqe
- Partneritetet ku është më efikase të përdoren rrjetet ekzistuese për të ofruar shërbime për të cilat një nga partnerët ka një avantazh konkurrues
- Aktivitetet online, ku mund të bashkohet një kompani që ofron shërbime ICT apo ISP bashkë me një bankë për të ndërtuar shërbime online më të mira e të specializuara.
- Tendaca për një të kaluar në bankë globale në termat e bankës së investimeve, pasi arrihen disa faktorë kyç nga rritja e brendshme apo e jashtme.

4.3.2 Tendancat strategjike në nivel të bankave amerikane

Sa i përket Shteteve të Bashkuara, përshpejtimi i procesit të ristrukturimit ka qenë shumë i rëndësishëm. Midis viteve 1980 dhe 2000, më shumë se 6300 afrime bankare kanë ndodhur, për një investim total të kumuluar prej më shumë se 1200 miliardë dollarësh. Kjo shpjegohet pjesërisht nga lehtësimi i rregullave, të cilat i lejojnë bankat e SHBA të ndërhyjë jashtë vendit të tyre të origjinës, dhe të kombinojnë disa aktivitete e fushëveprime të ndryshme.

A) Strategjia e bashkimeve dhe blerjeve:

Një valë e madhe e bashkimit dhe blerjeve u zhvillua në Shtetet e Bashkuara në fillim të viteve 80. Qëllimi i kësaj vale të madhe ka qënë pikërisht arritja e fuqisë dhe madhësisë optimale për të realizuar ekonomi të shkallës si dhe për të fituar fuqi e pozicion të lartë në treg. Të gjitha afrimet e vëzhguara kanë rezultuar në dy kategorive të reja të institucioneve:

Së pari kemi krijimin e një supermarketi botëror të shërbimeve financiare, prej konvergjimeve të aktiviteteve bankare dhe të aktiviteteve të letrave me vlerë. Së dyti kemi krijimin e bankës së parë amerikane komerciale kombëtare. Përveç bashkimeve dhe blerjeve midis bankave amerikane që do të vazhdojnë të ndodin, nuk ka gjithashtu transaksione me bankat e huaja si dhe me firmat e brokerimi. Ashtu si Evropa edhe Shtetet e Bashkuara u drejtuan nga strategjitë e bashkimeve dhe blerjeve për të konsoliduar sistemin e tyre bankar dhe për t'i lejuar bankave të kryejnë një konkurrencë më të mirë lokale dhe ndërkombëtare.

Bashkimet dhe blerjet që kanë karakterizuar sistemin bankar amerikan që çojnë në një përqendrim nuk implikojnë detyrimisht që institucionet e mëdha të bëhen banka universale që ofrojnë njëkohësisht produkte dhe shërbime të shumta financiare. Shembuj amerikanë kanë treguar se duke u fokusuar në një numër të kufizuar sektorësh shërben në mënaxhimin më të mirë të rreziqeve. Bazuar në analizën e strategjive të zbatuara, ne mund të përmendim se bashkimet dhe blerjet kanë dominuar drejtimin strategjik të sektorit bankar

në vitet e fundit. Po kështu, zgjedhja midis bankës universale apo të specializuar është trendi i dytë që shënon drejtimet strategjike. Megjithatë, kohët e fundit është e vënë në dukje shfaqja e tregut të bankës në distancë, dhe bankës virtuale, të mundura përmes diversifikimit.

B) Strategjitë e diversifikimi apo specializimit:

Bankat amerikane u gjendën përballë një dileme, të qënit një bankë ndërkombëtare në të gjithë fushëveprimet apo të specializoheshin në disa fusha të caktuara? Po të shikojmë interesin e besnikërimit të klientelës së bankës interesi primar ka qënë zhvillimi i gamave të diversifikuara të produkteve dhe shërbimeve të tyre, sidomos në aksin e financimeve, të menaxhimit të thesarit dhe të aktiveve financiare. Për shkak të vështirësisë së trajtimit dhe të arritjes së suksesit në të gjitha linjat në dispozicion, disa banka kanë vendosur që të specializohen në disa fusha për të cilat ata kanë fituar një zotësi dhe aftësi në mënyrën e bërjes biznes në këto fusha, që konsiderohet si një avantazh konkurrues dhe kështu mund të sigurojë norma të larta kthimi për aksionerët. Për t'iu përgjigjur kësaj dileme mes diversifikimit dhe/ose specializimit, mendohet që banka është më efikase në atë masë që çdo funksion bankar është mbështetur nga një prodhues i specializuar dhe kompetent në kategorinë ku operon, sidomos rasti i komercialëve që duhet të merren me shpërndarjen e kredisë dhe i investitorëve që menaxhojnë rrezikun.

Përfundimet e kapitullit

Në këtë kapitull mundëm të bëjmë një guidë që nga fillimet ushtarake të strategjisë e deri në modelet kryesore strategjike. Kemi parë pra në detaj modelin Porter, Modelin BCG, modelin e Mintzberg, modelin LCAG, matricën e General Electric dhe atë të Ansof. Për të kuptuar më qartë mënyrën e vendosjes dhe insipirimit strategjik është përshkruar gjithashtu ndarja midis burimit të strategjisë nga analiza SWOT dhe burmit nëpërmjet karakterisitikave kryesore si zona gjeografike, produkti, klienti dhe teknologjia. Duke patur fokusin mbi bankat, mundëm të përmbledhim tendencat e tipologjitë e ndryshme të

strategjisë bankare për Evropën dhe Shtete e Bashkuara. Ky kapitull na lejon të shohim se strategjitë e përbashkëta janë miratuar nga grupet kryesore bankare apo nga një përqindje gjeografike e konsideruaeshme ndërkombëtare. Përtej karakteristikave kombëtare, u konkludua shfaqja e katër llojeve të bankave në nivelin ndërkombëtar :

- Bankat kombëtare
- Bankat rajonale
- Bankat universale (si në gamë produktesh dhe në shtrirje)
- Bankat e specializuara (në një ose disa produkte apo shërbime)

Ndërkohë për sa i përket shpërndarjes së strategjive më dominuese në Shtet e Bashkuara mund të themi që kemi një karakterizim strategjik të përbashkët në drejtimet e Specializimit, Ndërkombëtarizimit, Blerjeve dhe Bashkimeve, ndërkohe që kemi një dominim të fortë në Evropë kundrejt strategjisë së Bankës universiale, ndërkohë që në bankat amerikane dominon më shumë strategjia e Diversifikimit.

KAPITULLI V: METODOLOGJIA E STUDIMIT. NGA ANALIZA KONCEPTUALE TEK ANALIZA EMPIRIKE.

Hyrje

Ndërtimi i një kornize teorike dhe konceptuale është e domosdoshme për të ngritur kështu një skelet mjftueshëm solid për të mundësuar më tej një anallizë empirike. Në fakt analiza teorike mbi mbikëqyrjen, analiza historike mbi marrëveshjet Bazel, si dhe analiza mbi aksin potencialisht të ndikueshëm, pra strategjinë, na lejon kështu të mund ti ndërthurim këto dimensione për një analizë më të detajuar e më pas të na orientojnë drejt akseve empirike për t'u studjuar.

Përgjatë këtij kapitulli do të mund të fokusohemi kështu mbi thelbin e studimit, pra ballafaqimit me hipotezën dhe pyetjet kërkimore që drejtojnë. Do të nisemi me dyshen mbikëqyrje-strategji, duke përcatuar më në detaj influencat e mbikëqyrjes sipas marrëveshjes Bazel III mbi strategjinë e bankës. Për të vazhduar më pas me ngritjen e një propozimi të detajuar kërkimor.

Do të përmbyllim më metodologjinë e përdorur për të kontrolluar/vërtetuarpropozimin e përpiluar. Në këtë seksion në fakt, do të trajtjmë metodologjinë kërkimore që përfaqësohet fillimisht nga procesi i kampionimit, më pas i drejtohemi ndërtimit dhe zhvillimit të një pyetësori që prezantohet edhe nën formën e intervistave të gjysëm strukturuara dhe prezantimin e teknikave të analizës, eksplorimin e të dhënave, përshkrimin e materialit dhe informaconit cilësor të përthithur prej tij duke përfunduar me rezultatet që arrihen prejt tyre.

5.1 Mbikëqyrja Sipas Bazel III Përballë Strategjisë Bankare

Pas mësimeve të nxjera nga konfrontimi me pjesën teorike dhe atë praktike kombëtare e ndërkombëtare, konkludojmë së pari mbi nivelin e rëndësisë së rregulloreve mbikëqyrëse e prudenciale, së dyti mbi strategji të bankaredhe së treti, si përfundim rrjedhës incidencën apo influencën potnciale të këtyre rregulloreve mbi strategjitë bankare. Në fakt, analiza e gjendjes ekonomike e financiare ndërkombëtare na ka mundësuar të identifikojmë arsyet kryesore që çojnë në gjenezën paketave mbikëqyrëse që nga krijimi Bazel I në vitin 1988, shkaqet të cilat kanë kontribuar në zhvillimin e tij dhe nëkalimin në Bazel II e më pas nga pamjaftueshmëria e vëzhguar në Bazel III. Kështu, kemi studiuar parimet themelore të këtyre standartevë ndërkombëtare.

Bazel III i ruan të tre shtyllat që kish krijuar Bazel II, ku shtylla e parë përmban kërkesat në mjaftueshmërine e kapitalit, shtylla e dytë përmban menaxhimin e rrezikut dhe mbikëqyrjen, ndërkohë që shtylla e tretë përmban disiplinën e tregut. Në të tre shtyllat Bazel III prezanton ndryshime dhe risi që tentojnë në përmirësimin radikal të mbikëqyrjes dhe prudencës bankare e financiare. Në fakt, pjesa më e rëndësishme është ripërkufizimi i kapitalit, duke i rritur cilësinë, shtim në raportin e mjaftueshëmërisë së kapitalit. Bazel III bën kalimin e Tier 1 nga niveli 4% ne nivelin 6% dhe do të kalojë kapitalin bazë nga niveli 2% në nivelin 4.5% të totalit të aktiveve të ponderuara me rrezik. Sa për kategorinë Tier 2, ajo mund të jetë deri në 2% duke patur parasysh se shuma totale e kapitalit të kërkuar mbetet momentalisht në nivelin 8%. Si me Bazel II, edhe nën Bazel III bankat duhet të mbajnë një raport minimal të totalit të kapital prej të paktën 8% të aktiveve të ponderuara me rrezik. Përveç kërkesave minimale të kapitalit prej 8% ka në rritje të kërkesës së kapitalit nga futja e dy "jastekëve"të kapitalit, jastëku i konservimit të kapitalit dhe jastëku kundër-ciklik i kapitalit, të cilët kanë për qëllim të sigurojnë që bankat të kenë nivele të mjaftueshme të kapitalit për të thithur humbjet e aktiveve, veçanërisht gjatë periudhave të stresit financiar dhe ekonomik. Një risi dhe përmirësim tjetër përbëhet nga prezantimi i kritereve mbi likuiditetin e bankave, kriter i cili siguron një harmoni potenciale në kohë krize. Pra janë studiuar në detaj komponentët e paketës Bazel III për t'i lidhur me

influencat e tyre mbi sferën strategjike të bankës, dhe ndryshimet potenciale të modelit të biznesit të tyre nën presionin e marrëveshjeve të mbikëqyrjes dhe prudencës ndërkombëtare.

Analiza e kryer na lejon të zbulojmë marrëdhëniet dhe varësitë e rregulloreve mbikëqyrëse dhe prudenciale ndërkombëtare dhe strategjive bankare. Në të vërtetë, vëzhgohet se rregullorja ka një peshë të konsiderueshme në sjelljen e bankierëve dhe rrjedhimisht diktojnë zgjedhjet e tyre strategjike. Në fakt po të fillojmë që nga implementmi i Bazel I vëmë re se zbatimi i tij i çoi bankat të miratojnë strategji të ndryshme në varësi të kufizimeve dhe fushave të zhvilluara. Kjo marrëveshje ka nxitur bankat të përzgjedhin klientelën e tyre dhe kërkimin e aktivitetve të cilat nuk kanë nevojë për kapital të lartë në mënyrë që të përmbushin kërkesat mbi nivelin minimal të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në këtë drejtim, bankat kanë konverguar drejt specializimit për klientët dhe aktivitetet që kanë të ardhura të larta dhe kërkojnë më pak kapital. Kështu kemi orientimin drejt strategjive të segmentimit dhe fokusimit. Bankat kanë kërkuar gjithashtu të diversifikojnë duke zhvilluar bashkimet dhe blerjet për të ruajtur pozitën konkuruese të tyre. Këto operacione kanë çuar ne trende të bankave të kombësive të ndryshme, kështu kemi patur diversifikim në nivel produkti dhe zone gjeografike duke zhvilluar modelin e bankingut universal në sektorin bankar global (shfaqja e gjigantëve bankar).

Ndërkohë që edhe nën Bazel III do të vazhdojë zhvillimi i operacioneve të bashkimeve dhe blerjeve duke qënë se janë parë si alternativë për të kapërcyer kufizimet e imponuara nga rregullorja e re ndërkombëtar dhe për të ndërtuar kompani të afta për të menaxhuar konkurrencën. Gjithashtu, do të vëzhgohet shfaqja e aktorëve të specializuar në disa produkte apo shërbime që i lejojnë ata të përputhen me standardet e mbikëqyrjes dhe prudencës për të përmbushur kërkesat rregullative. Këto tendenca do të ndodhin brenda të njëjtën konglomerat financiar që do të thotë se banka do të jetë në formën e njësive financiare të diversifikuara nga larmishmëria e fushat e shumta të aktivitetit bankar, dhe çdo fushë do të menaxhohet nga njësi të specializuara. Sipas disa autorëve, Bazel III do të

jetë drejtues i madh i strategjisë bankare për një periudhë të zgjatur, ku bankat e specializuara do ti kthehen diversifikimit dhe bankat e divesifikuara do të ndryshojnë përzierjet e biznesit për të përmbushur të gjitha dispozitat rregullatore dhe për të ruajtur ose ndërtuar reputacionin e tyre. Gjithashtu disa banka mund të inkurajohen ti largohen disa aktiviteteve apo zonave gjeografike mbështetur në nivelin e rrezikut që i karakterizon, për të evituar sado pak mbingarkimin në nivelin bazë të mjaftueshmërisë së kapitalit.

Pra marrëveshjet Bazel kanë shtyrë në diversifikimin e bankingut dhe të zonave gjeografike, ndaj kemi tendenca e strategji të reja deri në krijimin e bankave universale. Për të patur një pamje më të qartë dhe më në detaj mund të vëzhgojmë përmbledhjen më poshtë, e cila na ofron për secilën strategji se si do të ndikohet nga normat e secilës shtyllë[33] përbërëse të Bazel III, pra prezantohet ndërthurja midis strategjive kryesore të indentifikuara dhe komponentëve të marrëveshjes Bazel III.

1- Strategjia e diversifikimit

Shtylla e pare :

- **Marrja në konsiderate e llojeve të ndryshme të rreziqeve do ti shtyjë bankat të diversifikojnë dhe të ndryshojmë për optimizimin e portofolëve të tyre.**
- **Orientimi drejt aktiviteteve që kanë më pak nevoje për më kapital.**
- **Tendencë për blerje e bashkime për uniformizimin e rreziqeve.**

Shtylla e dytë:

- **Komunikim më i zhvilluar dhe transparent midis bankave dhe autoriteteve mbikëqyrëse mund ti shtyjë në diversifikim për t'u bërë më robuste dhe të afta për të përmbushur kërkesat prudenciale.**
- **Mbikëqyrja nga autoritet mund të limitojë me raste diversifikimin në aktivitete të konsideruara të rrezikshme.**

[33] Duke rikujtuar që shtylla 1 përfaqeson "Kërkesat për likuiditet dhe mjaftueshmëri kapitali", shtylla 2 përfaqëson "Procesin e rishikimit të mbikqyrjes për menaxhimin e rrezikut dhe planifikimin e kapitalit" si dhe shtylla 3 që përfaqëson " Disiplinën e tregut dhe zbulimin e rrezikut".

Shtylla e tretë:

- **Detyrimi mbi publikimin e pasurive, fondeve dhe metodave të vlerësimit të rrezikut mund të frenojnë diversifikimin nga vështirësia e agregimit të shumë sektorëve të aktiviteteve të bankës.**

2- Strategjia e specializimit

Shtylla e pare :

- **Kërkesat e reja, mund të shtyjnë bankat në specializim në disa aktivitete apo zona gjeografike në mënyrë që edhe të respektojnë kërkesat rregullatore edhe të mbajnë konkurueshmërinë**
- **Shtyn në zhvillimin e njësive të specializuar edhe brenda bankës së diversifikuar, pra kemi specializimin e brendshëm.**

Shtylla e dytë:

- **Mbikëqyrja dhe komunikimi me autoritetet do ti shtyjë bankat e vogla drejt specializimit për të mundur të respektojnë kërkesat.**

Shtylla e tretë:

- **Specializimi do ti ndihmojë bankat të kënë një komunikim më cilësor dhe të besueshëm, e duke patur më pak përsipër do të jetë më e thjeshtë të qënit konform kërkesave rregullatore.**

3- Strategjia e segmentimit

Shtylla e pare :

- **Segmentimi do të incitohet si pasojë e kërkesave për një menaxhim më të mirë të rrezikut, përqëndrimi në vetëm disa segmente optimizon kuptiin dhe menaxhimin e rrezikut.**

Shtylla e dytë:

- **Mbikqryja e autoriteteve mund të ndikojë në evitimin e segmentimit për shkak të orientimit në segmente të cilat nuk e lejojnë bankën të përmbushë kërkesat rregullatore.**

Shtylla e tretë:

- **Përqëndrimi në segmente të caktuara i jep akoma më shumë përparësi bankës në transparencë dhe publikime cilësore, duke përmbushur kështu më lehtë edhe kërkesat rregullatore.**

4- Strategjia e fokusimit

Shtylla e pare :

- **Marrja në konsideratë e rrezikut operacional kërkon më shumë kapitale të bllokuara gjë që do të shtyjë bankat të fokusohen.**
- **Për shembull zgjedhja e strategjisë së folesë është një shembull i mirë për përmbushjen e kërkesave rregullatore dhe mbajtjen e konkurueshmërisë.**

Shtylla e dytë:

- **Fokusimi e ndihmon përgjigjen ndaj mbikëqyrjes së autoriteteve, si nga përmbledhja e rreziqeve edhe nga thjeshtësimi i komunikimit me autoritetet**.

Shtylla e tretë:

- **Fokusimi i ndihmon bankat në publikimin e informacionevë cilësore dhe të besuaeshme duke patur kështu një diapazon më të ngushtë në vlerësim të rreziqeve apo menaxhim të aktiviteteve, duke e lehtësuar kështu barrën e respektimit të kësaj shtylle.**

5- Strategjia e ndërkombëtarizimit

Shtylla e pare :

- **Fakti i vlerësimit të njëjtë të rrezikut nga të gjithë bankat do të mund të lehtësojë zbatimin e këtyre strategjive dhe bashkëpunimin mdis tyre pavarësisht shtrirjes gjeografike.**
- **Mund të ndihmojë gjithashtu në diversikimiin e rrezikut në zona të ndryshmë gjeografike.**

Shtylla e dytë:

- **Mbikëqyrja mund të frenojë shkallën e rritjes gjeografike nëse kemi rregulla të ndryshme dhe mungesë bashkëveprimi midis autoriteteve përkatëse.**

Shtylla e tretë:

- **Detyrimi i publikimeve mund të frenojë dëshirën e ndërkombëtarizimit, sepse sa më shumë një bankë zhvillohet gjeografikisht aq më shumë vështirësi do të këtë në formulimin dhe publikimin e informacioneve të nevojshmë për të plotësuar kërkesat rregullatore.**

Pra mund të vrojtohet qartë që secila shtyllë ka një incidencë mbi një aks strategjik të caktuar të cilin një bankë mund ta zgjedhë. Kjo do të thotë shprehimisht që marrëveshjet rregullatore ndërkombëtare të tipit Bazel kanë shtyrë në orientime strategjike nëpërmjet kufizimeve të imponuara prej tyre. Në të vërtetë, këto standardeve globale, kanë eliminuar disa srategi e kanë nxjerrë në pah disa të tjera sidomos diversifikimin, blerjet e bashkimedh dhe ndërkombëtarizimin që shtyjnë bankët të transformohet në një "one stop shop"[34].

5.2 Propozimi I Modelit Kërkimor:

Nga analizat e literaturës, teorisë dhe ballafaqimet e rregulloreve me sjelljen potenciale të bankës në përgjigje të tyre e sidomos nga emergjenca e një pakti të ri lind pyetja : "Si ta përcakotjmë influencën e standarteve ndërkombëtare rregullatore bankare mbi modelin e biznesit të bankës e strategjisë së saj?".

Le të shtjellohemi më shumë, kjo do të thotë të kuptojmë pikë së pari penetrimin e këtyre rregulloreve e më pas të vëzhgojmë se si këto të fundit ndikojnë në nivelin e strategjisë së bankës duke indentifikuar kështu një "ndërhyrje" në nivele orientuese, kushtëzuese,

[34]Dyqan me një ndalesë, pra ku banka të ofrojë të gjithë shërbimet e mundshme duke i lehtësuar klientët.

detyruese apo ndonjë formë tjëter e perceptuar prej banakve. Është e rëndësishme të përcaktohet pra nëse ekziston një korrelacion i tillë mes vektotir të variablave mbikëqyrëse e prudenciale dhe vektorit të sjelljes banakre. Për këtë mund të realizohet një analizë relacionale midis këtyre akseve. Më poshtë mud të gjeni të renditur përbërësit e vektorëve të sipërpërmendur.



Figura 5.1 Vektorët e elementëve të mbikëqyrjes e strategjisë

Nëpërmjet kryqëzimit të këtyre dy sferave potencialisht priten informacioni mbi:

- Njohjen dhe penetrimin e mbikëqyrjes ndëkombëtare
- Perceptimi nga ana e bankave
- Ndikimet e veçanta të mbikëqyrjes
- Mundësitë apo kufizimet e rregullatoreve mbikëqyrëse
- Prespektivat mbi Bazel III

Ndërkohë për sa i përket influencave rregullatorë-strategji bankare pritet rezultate të tipit 1- normat mbikëqyrëse janë factor primar i disa drejtimeve strategjike, 2- normat mbikëqyrëse pengojnë disa drejtime strategjike, 3- normat mbikëqyrëse janë totalisht pa incidencë në drejtimet strategjike. Pra qëllimi ynë është studimi i propozimit kërkimor të mëposhtëm :

"Mbikëqyrja bankare ndërkombëtare luan një rol të rëndësishëm në formëzimin, strukturimin dhe akset strategjike të sistemit bankar kombëtar. Duhet studjuar më në detaj se cilat prej akseve strategjike (diversifikim, specializim, ndërkombëtarizim, blerje e bashkim etj) ndikohen nën influencën e marrëveshjëve rregullatore të mbikëqyrjes bankare ndërkombëtare duke përcaktuar gjithashtu shkallën e efektit të tyre (pa ndikim, ndikim i lehtë, ndikim i konsiderueshëm, orientuese, detyruese)".

Në bazë të këtyre gjetjeve krijohet një vision më i plotë i situatës së ndërthurjes së sferave në fjalë për realizimin e analizës e studimit të rëndësisë dhe penetrimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare në mënyrë që të testohen hipotezat :

- **H_1: Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare njihen, vlerësohen dhe konsiderohen optimale nga bankat kombëtare.**

- **H_2: Situatat, tregu bankar ndërkombëtar dhe mbikëqyrja ndërkombëtare kanë ndikimi mbi rregulloret e mbikëqyrjes kombëtare.**

- **H_3: Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare kanë ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare.**

- **H_4: Marreveshja ndërkombëtare mbikëqyrëse Bazel III ka ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare.**

5.3 Metodologjia Dhe Puna Në Terren

5.3.1 Kampionimi

Për sa i përket përzgjedhjes së kampionit të vrojtimit nuk ishte shumë e vështirë. Në fakt diversiteti i tipologjisë së bankave në sistemin bankar shqiptar është i sheshuar sepse kemi vetëm banka të tregtare. Përmes tyre kemi marrë banka me një pjesë ë lartë të peshës së tregut, banka me penetrim të mesëm e të vogël. Në kampion janë përfshirë banka me portofol të gjerë apo më të reduktuar, me kapital vendas e të huaj, pjesë grupesh të mëdha ndërkombëtare apo degëzime më të vogla duke bërë kështu që diversifikimi i kampionit të jetë në nivele të larta e të mund të përfaqësojë sa më mirë popollatën bankare. Për shkak të numrit shumë të vogël të bankave që operojnë në tregun shqiptar, të dhënat e marra janë plotësisht konfidenciale, dhe nuk mund të transmetohet asnje informacion për burimin e informacionit. Për hir të kësaj "fshehtësie" më është e detyrueshme të mos bëj transparente listën e bankave.

Teorikisht përmasa e vogël e sistemit bankar shqiptar do të kish mundësuar shumë thjeshtë analizën e të gjithë popullatës (vetëm 16 banka). Por fakti i refuzimit të përgjigjes nga disa prej tyre si dhe mos ekzistenca e tyre që prej fillimit të sistemit bankar na ka detyruar ta ulim numrin e bankave të vizituara, por që gjithsesi përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të totalit të bankave si numër. Ndërkohë pavarësisht numrit të njësive të vizituara, duke u bazuar mbi rezultatet e ponderimitt të peshave specifike të bankave sipas akseve të tregut është mbuluar mbi 70% e tregut, duke bërë kështu që analiza të ketë konsekuencën dërmuese në treg. Si është realizuar ky ponderim? Duke u bazuar mbi peshën specifike të deklaruar në Raportin Vjetor të Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë[35] kemi tetë komponëntë të matur:

[w] http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_Vjetor_i_Mbikeqyrjes_2012_6603_1.php?kc=0,8,6,0,0

1- Totalin e bilancit
2- Burimet e Përhershme
3- Kapitalin Aksioner
4- Tepricën e Kredisë
5- Kredinë me Probleme
6- Bonot e Thesarit
7- Letrat me Vlerë
8- Totalin e depozitave

Natyrisht pesha specifike e secilit komponent të listuar më lartë është përafërsisht në të njëjtat vlera duke ruajtur një devijim standart minimal në të gjithë kampionin e përftuar. Në fakt kemi mesatarisht një devijim standart prej 4 njësish në të gjithë kampionin ku vlerat e koefiçentit të variacionit [36] mbahen në nivele të pranueshme midis 20-50%. Që do të thotë që peshat specifike të ponderuara për secilën bankë në tregun bankar shqiptar janë me cilësi të mirë dhe të përdorshme si mesatare domethënëse.

Duhet qartësuar që tani që për shkak të ligjeve të konfidencialitetit që mbulojnë sektorin bankar nuk mundemi kurrsesi në asnjë moment të divulgojmë informacion dallues apo burim personal të bankave të vizituara[37]. Për sa më shumë pertinencë dhe varietet janë shpërndarë disa pyetësorë për secilën bankë të vizituar në mënyrë për të konsoliduar dhe rritur përgjegjshmërinë e përgjigjeve dhe cilësinë e tyre. Edhe një herë për çështje konfidencialiteti nuk mundemi të shprehemi për numrin ekzakt të tyre për të mos lejuar rillogaritje që çojnë në burim.

Ndërkohë është shprehur një kujdes i veçantë në diversifikim në mënyrë që të përfaqësohen sa ma mirë llojet e ndryshme përmes tyre, si për shembull kriteri i pronësi (së huaj apo vendase) kriteri i grupimit (grup ndërkombëtar apo lokal) kriteri i madhësisë së vetë bankës apo të madhësisë së grupit në të cilin bën pjesë. Justifikimi për një zgjedhje të tillë përfaqësohet nga synimi i mirëpërfaqësimit të çdo lloji banke si për nga qasja e tyre

[36] $KV = \sigma / \mu$
[37] Asnjë emër bankë, punonjësi të saj apo përqindjeje të izoluar nuk do të përdoret, do të kemi vetëm të dhëna të anonimizuara dhe agregatet përkatëse në nivel shpjegueshmërie të pranueshëm.

strategjike edhe për nga qasja e tyre me marrëveshjet ndërkombëtare (me raste të induktuara nga banka mëmë).

5.3.2 Pyetësori/ analiza e gjysëmstrukturuar

Mënyra e administrimit më korrekt të pyetësorit është hyrja në kontakt me të intervistuarit për të marrë përgjigjet e tyre, por ka raste që kjo mënyrë të refuzohet. Ka mënyra të ndryshme të "hetimit", të tilla si korrespondenca, telefoni, mjetet elektronike, kontaktit i drejtpërdrejtë, të gjitha varietetet janë përdorur ne fakt.

Pyetësorët janë plotësuar në dy mënyra ose me raste në dy etapa. Një grupi të caktuar i janë dorëzuar pyetësorët dhe më pas kemi përgjigjet e tyre të shkruara, një pjese tjetër i është kryer intervista direkte në kohë reale, dhe ka raste që janë ndërthurur të dy mënyra thjesht të ndara në dy vizita. Koha që është kërkuar për plotësimin e këtyre të fundit ka zgjatur rreth 8 muaj. Në Shtojcën numër 6[38] mund të gjeni disa prej shembujve të pyetësorëve të plotësuar, duke ju ilustruar një varietet të sasisë dhe cilësë së informacionit të përftuar, nga plotësimet më cilësore në ato më pak cilësore, gjithnjë të anonimizuar. Ndërthurja e të gjithë llojeve të intervistimit dëshmon të jetë më efektive për shkak se ajo jep informacion në një shkallë të lartë të saktësisë dhe cilësisë.

Përveç kësaj, drejtuesit apo udhëheqësit e bankave në përgjithësi konsiderojnë se shumica e informacioneve është konfidenciale dhe refuzojnë ta transmetojnë. Për të fituar besimin e tyre, ne do ti tregojmë respektin më të lartë të anonimitetit dhe se informacioni i mbledhur nuk do të copëzohet në pjesë dalluese nga njëra bankë në tjetrën. Ky kujdes i lartë për të bërë të qartë situatën ka qënë e vetmja mënyrë për të mundur të përthithim informacionin e duhur.

Për nga natyra e informacionit që ne kërkojmë ka nevojë që të intervistuarit të zgjidhen me kujdes në mënyrë që të jemi të sigurt që ata të zotërojnë informacionin e plotë dhe të duhur për tu përgjigjur. Pra, nevoja primare është të targetohen punonjës të top-menaxhmentit të bankës në mënyrë që të kenë akses në hulumtimet e vendimmarrjes së lartë të bankës por

[38] Shtojca 6 faqe 373

gjithashtu edhe në raportimet e auditimet mes autoritetit mbikëqyrës për të bërë "urën" mes ty "pikave të nxehta" (qëllimit të analizës pra, lidhjes mes strategjisë dhe mbikëqyrjes). Informacioni që ne duam të mbledhim duhet të jetë i detajuar, dhe për këtë, ne jemi kujdesur të përzgjedhim të intervistuarit ekskluzivisht në postet menaxheriale të auditit të brendshëm, të kontrollit të menaxhimit, të kontabilitetit, të analizës financiare si dhe të raportimeve dhe rakordimeve me Bankës e Shqipërisë.

Për të kuptuar më mirë peshën dhe saktësinë e përgjigjeve mund të shohim më poshtë shpërndarjen e posteve të të intervistuarve:

Posti

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		9	56.3	56.3	56.3
	DREJTOR I GRUPIT TE RREZIKUT	3	18.8	18.8	75.0
	DREJTORE E DREJTORISE SE KREDIVE TE BIZNESIT TE MADH	2	12.5	12.5	87.5
	MANAGER	2	12.5	12.5	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Tabela 5.1 Posti i të intervistuarit

56% e të intervistuarve kanë prefuruar të mos përgjigjen mbi postin e tyre edhe pse pyetësorët ishin të targetuar për ta. Ndërkohë, për sa i përket pjesës tjetër të tyre janë marrë individë të nivelit top management në departamentet e rrezikut, kredisë dhe auditit (personat më të prekur nga mbiqyrja, ndaj më ekspertët e fushës në fjalë).

Në mënyrë për të studjuar marrëdhëniet mes rregulloreve mbikëqyrëse e prudenciale bankare dhe strategjisë së bankës, për të parë më pas variablat që ndikojnë në këto dy elemente, ne kemi përdorur pyetje specifike dhe të drejtpërdrejta në mënyrë që të identifikojnë informacione të nevojshme dhe të dobishme .

Për këtë, janë përpiluar dy lloj pyetjesh, pyetjet e mbyllura të cilat japin një informacion ekzakt, të detajuar pa hapësirë interpretimi subjektiv, dhe pyetjet e hapura të cilat i lejojnë të intervistuarit një shkallë lirie në organizimin dhe formulimin e reagimit të tij duke e pasuruar studimin me informacione dhe justifikime të shumta.

Pyetjet e mbyllura janë të ndërtuara në formën e mëposhtme :

- **Pyetjet dikotomike të thjeshta** : Përgjigja e pritshme ka një zgjedhje midis "po " dhe "jo".
- **Pyetjet me disa eventualitete por me përgjigje unike**: Janë të lehtë për studimin dhe numërimin.
- **Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë, por disa përgjigje:** I intervistuari mund të zgjedhë më shumë se një ngjarje.
- **Pyetjet tabelare**: Ku formohet një matricë me dy dimensione.

Këto pyetje do të përbëjnë atëherë dy lloj analizash: analizën një dimensinale (përshkruese) dhe analizën dy dimensinale (cross-tabulare/ analitike) Antonious (2003).

Në mënyrë për të bërë një kalim gradual nga një temë në tjetrën, një kalim historik gradual dhe mbi të gjitha për të thjeshtësuar kuptimin e pyetjeve pyetësori ynë përfshin temat në vijim :

➔ Karakteristikat e zhvillimit të rregullimit bankar dhe shkaqet kryesore të saj.
➔ Karakteristikat e indikacioneve mbikëqyrëse dhe pozitën e tyre në lidhje me standardet ndërkombëtare .
➔ Disa pyetje të përgjithshme rreth vet rregullimin mbikëqyrws/prudencial bankar.
➔ Themelet e zgjedhjes strategjike bankare.
➔ Vlerësimi i ndikimit mes rregullores ekzistuese prudenciale dhe strategjisë.
➔ Vlerësimi i ndikimit mes rregullores prudenciale të Bazel dhe strategjisë.
➔ Prekonizimet dhe prespektivat në një implementim potencial të Bazel III.

5.3.3 Të dhënat dhe trajtimi i tyre :

Pas mbledhjes së të gjithë pyetësorevë dhe shkrimit të të gjithë informacionit të marrë gojarisht dhe tekstualisht kalojmë në fazën e kodimit, të trajtimit të të dhënave dhe zgjedhjes së tëknikave adapte për analizimin e tyre. Këto komponentë formojnë atë çka quhet metodologjia e përdorimit dhe përpunimit të të dhënave. Në fakt, këto mjete

statistikore të sigurojnë së pari të transformosh të dhënat në një format më të kuptueshëm, të përdorshëm e të manovrueshëm (në një format tabelar) dhe së dyti, të sigurojnë nxjerrjen e informacionit kuptimplotë të fshehur.

Për më tepër, për të kryer analizën tonë, ne kemi përdorur software-in SPSS 19. Për ta bërë këtë, ne kemi koduar pyetësorin në mënyrë që informacioni i mbledhur të jetë lehtësisht i "përtypshëm" nga ana e programit kompiuterik. Për pyetjet e thjeshta të mbyllura kemi dhënë një kod binar që është transkripti i përgjigjes "po" dhe "jo". Për pyetjet me eventualitete të shumfishta, por një përgjigje, çdo alternativë e propozuar është konsideruar si një variabël i veçantë me dy modalitete , po prapë e koduar në mënyrë binare për "po" dhe "jo" që përcaktojnë zgjedhjen në fjalë.

Nga ana tjetër pyetjet me zgjedhje të shumëfishta, me shumë përgjigje përfaqësojnë një variabël të vetëm, eventualitetet e pyetjes janë modalitetet e këtij variabli. Pra fillimisht është ndërtuar e ashtuquajtura strukturë pyetësori në program e më pas, një e nga një, janë hedhur përgjigjet. Gjithçka është gati për analizë. Për të shpjeguar dhe interpretuar rezultatet, ne kemi kryer dy lloje të analizave nga SPSS, së pari klasifikimi i thjeshtë dhe së dyti klasifikimi i ndërthurur i rezultateve. Klasifikimmi i thjeshtë është një analizë një dimensinale për të përcaktuar frekuencën në vlera absolute dhe relative të secilës kategori të variablave.

Kjo na lejon për të përcaktuar shpërndarjen në kampion të të gjitha variablave. Ndërkohë, klasifikimi i ndërthurur është një analizë dy dimensinale për të studiuar marrëdhëniet në mes të dy variablave për të provuar nëse ekziston një marrëdhënie e rëndësishme midis dy variablave në fjalë. Nuk duhet të harrojmë që ekzistojnë edhe një sasi e lartë pyetjesh të hapura dhe opinioniste të cilat janë tejet të rëndësishme për studimin tonë dhe analiza e tyre bëhët duke i dhënë rëndësinë maksimale e duke i shqyrtuar një e nga një. [39]

[39]Ekzistojnë edhe programe për kryerjen e analizave cilësore, por që nuk janë në zoterimin tonë, për shembull programi NVivo.

KAPITULLI VI: IMPAKTI I MBIKËQYRJES BANKARE MBI STRATEGJINË E BANKËS

Hyrje

Kriza globale ekonomike i ka dhënë rregullatorëve një mundësi për të ristrukturuar rrënjësisht qasjen ndaj rrezikut dhe rregullimin në sektorin financiar. Anëtarët ndërkombëtarë të Komitetit të Bazelit për Mbikëqyrjen Bankare kolektivisht kanë rënë dakord mbi reformat për " forcimin e kapitalit global dhe rregullat e likuiditetit me synim promovimin e një sektori bankar më elastik nën Bazel III. Fillimisht, rregullatorët kombëtarë nuk u pajtuan në shumë aspekte të zbatimit të Bazel III por në fund u ra dakord mbi parimet themelore, por jo pa ndonjë kompromis. Gjatë diskutimeve, rregullatorët u fokusuan në nevojën për jastëkë në rritje për kapitalin dhe për likuiditetin, si dhe në nevojën për gjithëpërfshirje të menaxhimit të rrezikut, zgjerimin e stress-testeve, dhe rreshtimin e rrezikut dhe menaxhimit të kapitalit me bërthamën e strategjisë së firmave.

Disa banka kanë vendosur afate shumë ambicioze për të arritur me përputhshmërinë e Bazel III. Zbatimi i hershëm i marrëveshjes shihet prej disa bankave si një avantazh konkurrues, apo një mënyrë për të treguar qëndrueshmërinë ndaj rregullatorëve, si dhe tregut. Këto banka shohin si rrezik potencial vënien në lojë të reputacionit dhe në qoftë se banka në fjalë është shumë e ngadaltë në procesin e implementimit kjo gje mund të perceptohet si një problem mbi "shëndetin" e bankës në fjalë, duke i ulur kështu pikë mbi reputacionin e saj, që do të gjenerojë akoma më shumë problem financiare.

Nën kornizën e re të Bazel III, kërkesat e kapitalit të përbashkët shkojnë me raste deri në dyfishin e nivelit të kërkesave të mëparshme. Kjo çon në një reduktim të ndjeshëm të kapitalit në dispozicion që i duhet bankës për të bërë biznes. Përveç raportit si vlerë e përqindjes së kërkuar ndikon shumë edhe mënyra dhe ponderimi i rrezikut që nga ngurtësimi i mëtëjshëm rregullator ri-ngushton akoma më shumë hapësirën e disponibilitetit të bankës në kapital. Prandaj, kombinimi i kërkesave për kapital shtesë, si dhe ngarkesa më e larta në ponderimin e rrezikut, do të ketë ndikim mbi normën e kthimit

të kapitalit (ROE) të bankës. Por ky efekt është i pasigurt, dhe do të varet kryesisht nga modeli i biznesit që do të adoptojë secila bankë.

Sa më i rrezikshëm të jetë aktiviteti i një bankë, apo i aseteve që ajo krijon aq me i lartë do të jetë niveli i kapitalit rregullator të cilin banka duhet të bllokojë. Ndërkohë që këtu mund të ndërhyjë "bankingu hijë" (shadow banking) duke mbuluar boshllëqet e lëna prej bankave, gjë që do ti detyrojë bankat të inovojnë në mënyrë që të mos humbin konkurueshmëinë apo akoma më keq klientelën e tyre. Krahas propozimit për rritjen e rregullimit në fushat e kapitalit dhe likuiditetit ka gjithashtu një debat mbi intensitetin e mbikëqyrjes nga autoritetet përkatëse. Rritja e mbikëqyrjes është një process që nuk do të evitohet e do të risë finalizimin e implementimit të Bazel III. Përveç kësaj, zgjedhja e rregullatorit për të patur ndryshim në modelet apo strategjitë e bankave si një mënyrë për të drejtuar ndryshimin strukturor në industrine bankare apo për të rritur përpjekjet e mbikëqyrëse për të siguruar që dështimet ekonomike të jenë të përmbajtura, do të ketë ndikim të lartë mbi çdo institucion. Institucionet që do të preken nga zbatimi i Bazel III duhet të mbajnë një fleksibilitet në lidhje me veten e tyre për të arritur të përshtaten deri në detaj për një kohë të gjatë e për reformat që ende do të vinë. Të ardhurat e bankave do të reduktohen nëse ato nuk bëhen inovatore, dhe tregjet e braktisura do të fitohen nga konkurentë të industrive të tjera të cilët nuk janë të prekur dhe përkufizuar nga Bazel, e për pasojë mund ti lejojnë vetes të jenë më innovator e kreativ, qoftë kjo edhe në marrjen e rreziqeve më të larta në kurriz të konsomatorit.

Në këtë kapitull do të mund të shohim nëpërmjet analizës empirike, pikërisht, situatën në nivelin e mbikëqyrjes kombëtare në tregun bankar shqiptar, perceptimin mbi mbikëqyrjen ndërkombëtare si dhe do të analizojmë akset e ndikueshmërisë potenciale midis mbikëqyrjes dhe aktivitetit bankar më në detaj e pikërisht strategjisë bankare. Do mund të gjejmë nën një pjesë të parë një përshkrim të sistemin fillimisht si përbërje të tij e më pas një analizë përmes ekspertëve të situatës së tregut bankar shqiptar dhe situatës ekonomike që e rrethon aktualisht. Kalohet më pas në metodikën empirike të punimit dhe analizën sasiore të të gjithë akseve kërkimore. Kjo analizë hap pas hapi do të na mundësojë përballjen me hipotezat e propozimit kërkimor duke i vërtetuar apo hedhur poshtë gradualisht.

6.1 Situata E Sistemit Financiar E Bankar Në Shqipëri Sipas Analizës Opinioniste Të Ekspertëve

6.1.1 Sistemi bankar shqiptar dhe mbikëqyrja e tij

Pa dashur të lejohet që punimi të bjerë në një "cliché"[40] për sa i përket prezantimit historik apo aktual të sistemit bankar dhe përbërësve të tij po kalojmë përmes një guide shumë të shkrutër të këtyre të fundit. Sistemi bankar shqiptar karakterizohet nga një dinamizëm dhe rritje të ndjeshme. Që prej privatizimit të bankës së kursimeve në vitin 1996, ky dinamizëm është mishëruar në rritjen në madhësi e cilësi si të bankave edhe të produkteve e shërbimeve që ata ofrojnë. Në fakt që prej vitit 1997 ku operonin gjithsej 5 banka sot kemi një trefishim të numrit të tyre, raport i cili tregon qartë zhvillimin e sistemit bankar. Bankat të cilat operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë janë pjesë kyçe e sistemit financiar në Shqipëri i cili përbëhet nga disa aktorë. Mund të shihni më poshtë një skemë të plotë të sistemit financiar, marrë nga dokumentat zyrtare të Bankës së Shqipërisë për fundvitin 2012.



Figura 6.1 Përberja e sistemit financiar shqiptar. Burimi Banka e Shqipërisë[41]

Në sistemin tonë bankar kemi 2 nivele veprimi, Bankën e Shqipërisë në krye e bankat e tregtare. Në fund të vitit 2012, aktivet e bankave llogariten në nivelin 93.6 % të totalit të

[40] Cliché: nga frëgjishtja, gjë e njëjtë.
[41] http://www.bankofalbania.org/ëeb/Raporti_Vjetor_i_Mbikeqyrjes_2012_6603_1.php?kc=0,8,6,0,0

aktiveve të sistemit financiar dhe në nivelin 87.9 % të Produktit të Brendshëm Bruto. Bankat e tregtare ofrojnë produkte financiare si kursimet dhe huatë por gjithashtu edhe shërbime pagesash e ndërmjetësime të ndryshme financiare. Altualisht, siç mund të vrojtohët në figurën 5.1 në tregun bankar shqiptar kryejnë aktivitetin e tyre 16 banka të tregtare. Listuar më poshtë mund të gjejmë emrin dhe datat e liçencisimit të secilës prej tyre[42].

1. ***BANKA RAIFFEISEN SH.A.*** *Licenca Nr. 2/1998, datë 11.01.1999. Miratuar mevendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 163, datë 11.12.1998.*

2. ***BANKA E BASHKUAR E SHQIPËRISË SH.A.*** *Licenca Nr. 3/1998, datë 11.01.1999.Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 165, date 11.12.1998.*

3. ***VENETO BANKA SH.A.*** *Licenca Nr. 5/1998, datë 11.01.1999. Miratuar me vendimin eKëshillitMbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 164, datë 11.12.1998.*

4. ***BANKA KOMBËTARE TREGTARE SH.A.*** *Licenca Nr. 6/1998, datë 11.01.1999.Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 162, date 11.01.1999.*

5. ***BANKA TIRANA SH.A.*** *Licenca Nr. 07, datë 12.09.1996. Miratuar me Vendimin eKëshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, datë 12.09.1996.*

6. ***DEGA E BANKËS KOMBËTARE TË GREQISË, TIRANË.*** *Licenca Nr. 08, date 25.11.1996. Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 4,datë 14.03.1996.*

7. ***BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE SH.A.*** *Licenca Nr.09, datë 20.02.1997.Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 9, date 30.04.1996.*

8. ***DEGA E BANKËS ALPHA – ALBANIA.*** *Licenca Nr.10, datë 07.01.1998. Miratuar mevendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.01/03/96, datë 27.12.1997.*

9. ***BANKA INTESA SANPAOLO ALBANIA SH.A.*** *Licenca Nr.11, datë 10.08.1998.Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 105, date 10.08.1998.*

10. ***BANKA PROCREDIT SH.A.*** *Licenca Nr. 12, datë 15.03.1999. Miratuar me vendimin eKëshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 03.03.1999.*

11. ***BANKA EMPORIKI – SHQIPËRI SH.A.*** *Licenca Nr. 14, datë 28.10.1999. Miratuar mevendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.105, datë 19.10.1999.*

12. ***BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË SH.A.*** *Licenca nr. 15, datë 28.08.2002.Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 28. 08.2002.*

13. ***BANKA CREDINS SH.A.*** *Licenca nr. 16, datë 31.3.2003. Miratuar me vendimin eKëshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 22, datë 26.03.2003.*

[42] http://www.bankofalbania.org/web/Rregjistri_i_Bankave_tregetare_50_1.php

14. ***BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA SH.A.*** *Licenca nr. 17, datë 16.02.2004.Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqiprisë nr. 06, date 11.02.2004.*

15. ***BANKA UNION SH.A.*** *Licenca nr. 18, datë 09.01.2006. Miratuar me vendimin eKëshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 101, datë 28.12.2005.*

16. ***BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.*** *Licenca nr. 19, date 06.07.2007. Miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 35,datë 27.06.2007*

Ku peshat e secilës bankë janë si vijojnë[43]:

Dhjetor`12								
BANKAT (Treguesi në %)	Totali i bilancit	Burimet e përhershme	Kapitali aksioner	Teprica e kredisë	Kredi me probleme	Bono thesari	Letra me vlerë	Totali i depozitave
Banka Raiffeisen	26.4	22.3	25.1	22.6	23.2	18.5	40.1	28.3
Banka e Bashkuar e Shqipërisë	0.5	1.1	1.3	0.3	0.8	0.7	-	0.5
Banka Veneto	1.4	2.2	2.5	2.2	1.3	0.5	-	1.2
Banka Kombëtare Tregtare	20.5	14.4	14.6	15.7	8.7	27.1	24.1	20.1
Banka Tirana	7.7	9.3	10.3	9.3	16.6	10.6	2.4	7.3
Banka Ndërkombëtare Tregtare	0.7	1.0	1.1	0.5	0.4	0.8	1.1	0.7
Banka Intesa SanPaolo Albania	10.7	12.3	13.0	8.5	10.4	11.9	16.7	10.8
Banka Procredit	3.4	4.2	3.5	4.2	2.6	3.6	0.3	3.2
Banka Credit Agricole - Shqipëri	2.6	4.1	3.2	4.0	6.1	0.9	-	1.7
Banka NBG Albania	3.1	3.6	2.4	5.1	7.6	3.6	1.0	3.1
Banka Alpha Albania	6.3	6.3	4.9	6.4	11.5	9.6	6.5	6.6
Banka e Parë e Investimeve	1.1	1.0	1.2	1.1	0.4	0.9	1.2	1.0
Banka e Kreditit të Shqipërisë	0.1	0.9	1.1	0.0	(0.0)	0.0	-	0.0
Banka Credins	7.8	10.0	8.0	11.8	6.6	3.6	0.4	7.9
Banka Societe Generale Albania	5.1	5.4	5.9	6.0	2.4	5.4	3.8	5.2
Banka Union	2.3	1.8	1.9	2.4	1.4	2.4	2.3	2.4
TOTALI	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Tabela 6.1 Pesha specifike e secilës bankë në sistemin banakr shqiptar

(Burimi: Raporti vjetor i mbikëqyrjes 2012, Banka e Shqipërisë[44])

Në fakt, siç mund të vrojtohet është pikërisht Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë që mundëson liçensimin bankave tregëtare. Citojmë: "Banka e Shqipërisë është autoriteti mbikëqyrës i subjekteve që me ligj licencohen prej saj. Kjo sanksionohet në nenin 12 të ligjit nr.8269, datë 23.12.97, "Për Bankën e Shqipërisë", i cili i jep asaj autoritetin e organit që ka të drejtën ekskluzive të japë miratimin për fillimin e aktivitetit bankar nëpërmjet dhënies së licencës, si dhe të mbikëqyrë aktivitetin e çdo subjekti, i cili ka marrë licencë

[43]Informacioni mbi peshat specifike të bankave do të bëhet i dobishëm në analizën empirike.
[44]http://www.bankofalbania.org/web/Raporti_Vjetor_i_Mbikeqyrjes_2012_6603_1.php?kc=0,8,6,0,0

për ushtrimin e veprimtarisë bankare në Republikën e Shqipërisë."[45] Sipas këtij nëni përcaktohet se Banka e Shqipërisë ka të drejtën për të nxjerrë akte nënligjore të tipit vendime, udhëzime, rregullore, dhe urdhra, për t'u zbatuar nga të gjitha bankat e subjektet e tjera financiare të licencuara prej saj. Kjo gjë ka për synim respektimin e misionit dhe kuadrit mbikëqyrës për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemit bankar. Tërësia e akteve rregullative mbikëqyrëse apo të përgjithsme që burojnë nga Banka e Shqipërisë e formulojnë kuadrin rregullativ të mbikëqyrjes. Ky kuadër rregullativ mundëson pikërisht prudencën dhe kufizimin e marjes së rreziqeve të ndryshme prej bankave e subjekteve të tjera financiare. Si udhëzues kryesor për hartimin e këtij kuadri rregullativ shërbejnë "Parimet bazë për një mbikëqyrje efektive" të Komitetit Të Bazel-it[46] dhe të gjithë udhëzuesit në vazhdimësi që Komiteti i Bazelit lëshon. Mbajtja e parave, kursimeve dhe kredive të konsumatorëve dhe bizneseve përfshin rrezik jo vetëm për konsumatorët dhe ndërmjetësit, por për të gjithë shoqërinë. Frika se falimentimi i bankave mund të shkaktojë një krizë sistemike ka rritur ndjeshëm shkallën e rregullimit të aktivitetit bankar. Në fakt, sektori bankar ka pasur rregullime të ndjeshme siç janë: kontrolle të normave të interesit, pagesave dhe komisioneve, kontrollin mbi liçensimin, kapitali fillestar dhe kapitali rregullator, norma e likuiditetit e plotë komponentë të tjerë[47]. "Aktualisht Banka e Shqipërisë operon në përputhje me ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", sipas të cilit Banka e Shqipërisë është autoriteti i vetëm përgjegjës për dhënien e licencave dhe mbikëqyrjen e të gjitha bankave në Republikën e Shqipërisë , si dhe të ligjit nr. 8365, datë 20.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë"[48]. Duke u mbështetur në këto dy ligje bëhet i mundur rregullimi i sektorit bankar duke siguruar:

a) Përcaktimin e kushteve dhe të kërkesave për krijimin e bankave dhe të degëve të bankave të huaja, me qëllim krijimin e një sistemi bankar efektiv.
b) Përcaktimin e operacioneve bankare.

[45] http://www.bankofalbania.org/web/Historiku_i_Mbikqyrjes_Bankare_ne_Shqiperi_52_1.php
[46] http://www.bis.org/
[47] Të listuara në raportin vjetor të mbikqyrjes apo në http://www.bankofalbania.org/web/Rregulloret_e_mbikeqyrjes_bankare_53_1.php
[48] http://www.bankofalbania.org/web/Historiku_i_Mbikqyrjes_Bankare_ne_Shqiperi_52_1.php

c) Mbikëqyrjen e sistemit bankar.

d) Përcaktimin e rregullave në lidhje me kujdestarinë dhe me likuidimin e bankave.

6.1.2 Analiza opinioniste e ekpertëve

Për të ilustruar sa më mirë situatën aktuale të tregut financiar e bankar si dhe për të kuptuar më mirë rolin e Bankës së Shqipërisë dhe prognozës në vazhdim të sistemit është zgjedhur një metodë analitike opinioniste. Në fakt, janë zgjedhur rastësisht ekspertë të sistemit bankar dhe mbikëqyrës, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë, të cilëve ju është drejtuar një intervistë cilësore. Përgjatë kësaj interviste ata janë "ngacmuar" për tematike pikante si dhe iu është lënë koha adekuate për ta vlerësuar përgjigjen e tyre në mënyrë për thithjen e informacionit sa më të saktë dhe cilësor. Analiza e përgjigjeve të tyre do të mundësojë një imazh më të qartë dhe një ekspertizë më cilësore mbi sitemin bankar dhe atë mbikëqyrës.

Cili është qëllimi? Nëpërmjet mjeteve deduktive dhe induktive në zotërimi qëllimi i kësaj analize është të nxirren në pah vrojtimet e aktualitetit për të përfunduar mbi situatën dhe nevojat e saj, por gjithashtu edhe të listojmë kuadrin teorik dhe ta paralelizojmë atë me situatën në fjalë e cila na ofron përfundime mbi rëndësinë, ndërlidhjet e mbikëqyrjes dhe një prognozë për të ardhmen.

Intervista me ekspertët ka prekur tematika të ndryshme që nga kriza e fundit financiare dhe ndikimi i saj në sistemin tonë bankar, stabiliteti dhe fortësia e sistemit bankar, performanca e tij, roli i vendimarrjes së Bankës së Shqipërisë në strukturën financiare/bankare dhe masat e marra, rreziqet e perceptuara e parashikimet për të ardhmen, si dhe paralelizimin me mbikëqyrjen ndërkombëtare. Për të kryer këtë analizë opinioniste do të shqyrtohet secila fushë e intervistës duke paraqitur aty mendimet e përbashkëta dhe dalluese të ekspertëve të shprehur. [49]

[49]Për arsye konfidencialiteti nuk mund të jepet intitullimi konkret i ekspertëve por do prezantohet një agregad në dakortësi apo dallimet e opinionit të tyre.

1. **Cfarë mendimi keni për krizën e fundit financiare?**

Kanë kaluar tashmë gjashtë vjet që nga shpërthimi i krizës financiare globale, por Shqipëria nuk ka qënë aq e prekur prej saj, vendi ynë ka qënë i prekur tërthorazi dhe nuk përjetoi goditje të mëdha strukturore, megjithatë nuk mund të themi ende që ka kaluar për shkak të zhvillimeve aktuale që po kalon Eurozona. Kriza financiare globale ka patur dy faza, e para kriza e pasurive të patundshme në SHBA dhe faza e dyte kriza e borxheve sovrane në Eurozonë. Shqipëria e ka përjetuar në dy menyra të ndryshme, pjesa e parë u shoqerua me një tronditje besimi tek individët ndaj sistemit bankar shqiptar duke reaguar me tërheqjen masive të depozitave. Rënia e depozitave arriti përafërsisht në nivelin 15% të totalit të tyre. Por, fatmirësiht kjo valë reagimi u shua shpejt, edhe falë masave të mara nga Banka e Shqipërisë (me rritjen e limiteve të depozitave të siguruara duke rritur besimin drejt sistemit banakar), madje pas rikthimit të normalitetit është vëzhguar tejkalimi i nivele të parakrizës të depiozitave. Faza e dyte e saj, është pikërisht transmetimi i efekteve të krizës nga sfera financiare në sferën reale. Në fakt, kriza tronditi fort ekonomitë e dy partënerëve tonë më të rëndësishëm (Greqinë dhe Italinë), duke vazhduar ende të ketë një influencë të konsiderushme në ekonominë e vendit tonë.

Recensioni i thellë i tyre, reduktoi kërkesën tonë të huaj, rënien e remitancave nga emigrantet dhe investimet e huaja direkte, duke ngadalesuar ndjeshem rritjen ekonomike të vendit tonë. Zhvillimet e ardhshme në Eurozone, do të vazhdojnë të kushtëzojne zhvillimet në ekonominë shqiptarë. Analizat dhe vleresimet e muajit të fundit sugjerojnë nje gjallërim të Eurozonës e për pasojë priten edhe influenca pozitive të transmetueshme në ekonominë shqiptare për sa i përket vitit të ardhshëm.

2. **Si e ka ndikuar/ndikon kriza e fundit sistemin tonë bankar?**

Sistemi jonë bankar është mjaft i ri dhe akoma shumë i ekspozuar nga zhvillimet e tregut ndërkombëtar (ekspozim nëpërmjet kapitalit të huaj të bankave, dhe pronësisë e menaxhimit të tyre të huaj). Çdo luhatje financiare në vendet e rajonit sidomos partënerët kryesorë, interferon në sistemin tonë bankar. Kriza e fundit financiare ka ndikuar dhe vazhdon të ndikojë në sistemin tonë bankar. Së pari, tregues i këtij ndikimi është rritja e

kredive të këqija (në fund të gjashtëmujorit të parë të 2013 arriti në nivelin 24,2%), situatë e cila rriti provigjonimin e bankave, rrit koston e veprimarise së bankave, ul shkallën e ndërmjetësimit financiar të tyre e riinduktimin në ekonomi, si dhe kërkon përdorim të shtuar dhe joeficent të kapaciteteve. Pasiguria për zhvillimet e pritshme ka ndrydhur iniciativat e investuesve të bizneseve dhe individeve duke ulur kërkesën për financim, në fakt vërehet më shumë një tendencë në rritjen e depozitave dhe uljen e huamarrjes. Politika fiskale dhe nevoja për konsolidim, kanë kufizuar hapësirat për një pozicion aktiv të saj në shlyerjen e detyrimeve publike ndaj sektorit privat, duke penguar bizneset të shlyejnë detyrimet ndaj sektorit bankar.

3. Pozicioni kundrejt krizës vjen nga "fortësia" e sistemit bankar? Cili ka qënë roli i Bankës së Shqipërisë?

Pavarësisht mungesës së eksperiencës në kriza financiare madhore, sistemi ynë bankar ka arritur të kapërcejë shumë prej efekteve negative të saj. Sa më i fortë dhe elastik të jetë ai aq më shumë do të ulet ekspozimi kundrejt krizave. Në fakt ndikim për këtë kanë qënë kryesisht masat e marra nga Banka e Shqipërisë. Politikat konservatore të ndjekura pre saj përpara shpërthimit të krizës financiare, kanë qënë një mburojë korrekte dhe adapte për sistemin tonë bankar. Janë marrë masa shtrënguese mbi nivelin e kapitalit rregullator, i cili është mbajtur në nivele edhe më të larta se sa detyrimi ligjor mbi kërkesat minimale dhe rregllative, janë rivlerësuar rreziqet me banka të caktuara sidomos me bankat greke, janë ndërmarrë stress-teste më perpetuale, levizja dhe mbrojtja e valutës në banka me rankim sigurie më të lartë, si dhe direktiva për shkëputje nga bankat mëmë.

Banka e Shqipërisë, si institucion përgjegjës për politikën monetare, për mbikëqyrjen, rregullimin dhe ruajtjen e stabilitetit financiar ka ndërmarrë masa konkrete për mbrotjen nga pasojat e krizës dhe nxitjen e kërkesës së brendshme në ekonomi. Ajo ka ulur normën e interesit në nivele minimale historike dhe akoma po vazhdon të ndjekë një politikë monetare stimuluese. Ka furnizuar sistemin bankar me likuiditetin e kërkuar për funksionimin normal të tregjeve financiare. Është miratuar dhe po zbatohet paketa e masave rregullative në mbeshtetje të kreditimit. Me synim konsolidimin e mëtejshëm të

rolit të saj mbikqykës Banka e Shqipërisë ka hartuar dhe miratuar në Parlament Ligjin " Për Sistemin e Pagesave ", i cili përbën një kuadër ligjor të domosdoshëm për nxitjen e sigurisë, qëndrueshmërisë dhe efikasitetit të Sistemit Kombëtar të Pagesave në Shqipëri. Kursi i ndjekur është pozitiv në ruajtjen e ekuilibrave makroekonomik dhe të stabilitetit financiar, por transmetimi i tyre në nxitjen e aktivitetit ekonomik kërkon një reflektim më të mirë nga sistemi bankar.

4. **Si do e përshkruanit performancën e sistemit bankar në raport me krizën?**

Është e natyrshmë që përballë një krize me të tilla përmasa një ndikim i lartë ishte i paevitueshëm për sistemin tonë bankar, por masat e marra nga Banka e Shqipërisë apo edhe vetë bankat e tregtare kanë dhënë rezultate të pëlqyeshme duke e lënë situatën brenda limiteve të pranueshme. Në fakt, pas stuhisë një seri fjalësh shumë kuptimplota e karakterizojnë sistemin tonë, sistem i qëndueshëm, i mirëkapitalizuar dhe likuid! Sistemi bankar shqiptar ka ndarë me ekonominë shqiptare një pjesë të mirë të kostove të ngadalësimit ekonomik shkatuar nga kriza, por e përballoi dhe vazhdon akoma të përballojë pasojat e krizës pa përdorur në asnjë rast fondet publike. Sistemi bankar shqiptar ka performuar qëndrueshëm përgjatë harkut kohor të krizës. Ecuria e indikatorëve të qëndrueshmërisë, kapitalizimi, likuiditeti, perfomanca financiare, raportii kredive me probleme dhe ecuria e aseteve e argumentojënë së miri sitautën. Treguesit e kapitalizimit dhe likuiditetit paraqiten në nivele të kënaqshme, ndërsa fitimi i aktivitetit është ulur. Rritja më e ngadaltë e depozitave dhe rritja e dobët e kreditimit ka bërë që vellimi i aktivitetit bankar të ngadalësohet. Cilësia e portofolit të kredisë është përkeqesuar, duke bërëqë një pjesë e fitimeve të shkojnë si rezervë për mbrojtjen nga rreziku i kredisë. Rreziku i kredisë përbën sfidën më të rëndësishme të veprimtarisë, ndërkohe që rreziku i tregut dhe ai i likuiditetit mbeten të kufizuar.Rezultatet e stres-testeve të kryera nga Banka e Shqipërise provojnë për një rezistence të sistemit bankar në terma të nevojave për kapitalet shtesë, në kushtet e skenarit bazë të ushtruar. Ndërkohë që skenari i rënduar, dështon për nevoja të kapitalit shtesë për banka të veçanta.

5. **Cili ka qënë impakti i vendimmarrjes së bankës mbi strukturën e sistemit bankar/financiar?**

Natyrisht që impakti i vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë mbi strukturën e sistemit bankar ka qënë shumë i madh për vetë faktin se strukturat vendimmarrëse përgjigjen për përballimin e efekteve negative të krizes financiare. Janë ndërmarrë në fakt masa të ndryshme si ristrukturimet e kapitalit bankar, rikapitalizim nëse ka qënë nevoja, riklasifikimi i kredive dhe analizës së tyre, optimizimi i monedhës midis kredimarrësve dhe depozituesve, mbikëqyrja e valutës brenda territorit vendas, si dhe përmirësimi i raportimit të bankave.

Siç është cituar më lartë sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar në vend, aktivet e të cilit përfaqesojnë rreth 92,6% të totalit të aktiveve të sistemit financiar në tërësi dhe rreth 87,9% të PBBsë. Kështu, zhvillimet në sistemin bankar janë përcaktuese për qëndrueshmërine e sistemit financiar. Banka e Shqipërisë ka drejtuar një Politikë Monetare akomoduese, duke ulur normën bazë të interesit në nivele historike, aktualisht 3,5 %. Uljet e vazhdueshme janë transmetuar në tregun primar të letrave me vlerë, në tregun ndërbankar dhe pjeserisht në normat e interesit të depozitave. Nuk është transmetuar në normat e interesit të kredive, për shkak të një pozicioni më konservator të bankave ndaj ofertës së kredisë. Sjellja shtrënguese e bankave ndaj kredidhënies ka bërë që fondet të orientohen për investim drejt blerjes së letrave me vlere të qeverisë.

6. **Masa janë marrë nga bankat e tregtare por edhe nga banka qëndrore, cili ka reaguar më saktë?**

Të dyja nivelet kanë reaguar në mënyrën e duhur, megjithatë në situatën aktuale, bankat e tregtare duhet të bejnë më shumë për nxitjen e kreditimit. Ato duhet të pastrojnë bilancet nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit dhe të vleresojnë më realisht cilësinë e kredimarrësve. Duhet të jenë më fleksibël në procesin e ristrukturimit të kredive për ti dhënë më shumë frymemarrje bizneseve që e meritojnë. Shpesh here masat e marra prej tyre ka qënë edhe të diktura nga marrëdhënia me bankat mëmë , të cilat i përgjigjen legjislacionit evropian i cili ka pësuar ndryshime të rëndësishme post krizës.

Bankat e nivelit te dytë kanë marrë masa të mira për ruajtjen e shëndetit të tyre. Qasja strikte e orientuar drejt rrezikut që ato po aplikojnë ndaj financimeve të reja, përfaqëson në vetvete një masë kujdesi për ruajtjen e shëndetit të tyre. Përpos kesaj, bankat e tregtare kanë forcuar kapacitetet e tyre rregullative dhe audituese. Banka e Shqipërise nga ana tjetër ka ndjekur një Politikë Monetare lehtësuese, por në shërbim të funksionit të saj të mbikëqyrjes ka ndërmarrë edhe masa me karakter lehtësues rregullativ. Masat e marra nga Banka e Shqipërisë mund t'i konsiderojmë të duhura si në kohë edhe në madhësi.

7. **Cilët do të ishin rreziqet e perceptuar apo të mundshëm me të cilët do të duhen të përballen bankat në vijim?**

Rreziku më pertinent për sistemin bankar mbetet rreziku i kredisë, i cili përbën sfidën kryesore të sektorit në fjalë i cili paraqitet i mbrojtur kundrejt rrezikut të kursit të këmbimit apo të normës së interesit por mund të vrojtohet që së fundmi ndjeshmëria është rritur. Një nënçmim i ndjeshëm i kursit të këmbimit ose një rritje e normës së interesit mund të dëmtojë aftësinë paguese të klienteve të sektorit bankar dhe kryesisht të biznesit. Kanali kryesor i këtij transmetimi është kredia në valutë kur burimi i shlyerjes është në monedhën vendase dhe nga kredia me normë të ndryshueshme interesi. Rreziku i likuiditetit vleresohet në nivele të moderuara. Aktiviteti i sektorit bankar financohet konsiderueshëm nga depozitat e klientëve të cilat mbulojnë 1,7 herë vlerën e kredive. Edhe pse treguesi i kapitalizimit është i mirë, bankat duhet të vlerësojnë nevojat për kapital shtesë në përputhje me profilin e rrezikut të veprimtarisë së tyre.

8. **Si e gjykoni reagimin e Evropës kundrejt problemeve bankare të gjeneruara ?**

Nëse do t'i referohemi masave të kombinuara që ka ndërmarrë Banka Qëndrore Evropjane (BQE), ulja e normës bazë të interesit, ofrimi i likuiditetit bankave për të mbështetur ristrukturimin e tyre, dhe disa ndryshime rregullative, konsiderohen totalisht si masa te drejta. Komunikimet e BQE qetësuan situatën duke premtuar për të bërë gjithçka në mbrojtje të Eurozonës dhe Euros. Stabiliteti financiar vazhdon të jetë i brishtë, i kërcënuar nga rreziqet e kanosura nga gjendja e bilanceve të sistemit bankar, kompanive dhe individeve. Direktivat e Bashkimit Evropian, Regullorja e Kërkesës për Kapital (CRR) dhe Direktiva e Kërkesës për Kapital (CRD), shkojnë përtej rregullores tradicionale të raportit

të kapitalit ndaj aseteve të peshura me rrezik, duke përfshirë edhe elementë të rinj. Ndërsa CRR është rregullore krejtësisht e re, CRD është versioni i katërt i saj. Të dyja së bashku njihen si paketa CRD IV shumë e rëndësishme në terma të perspektivës makroprudenciale.

Masat e marra nga autoritetet mbikëqyrëse të Eurozonës kanë patur ndikimin e tyre edhe në vendet joanëtare të BE ku operojnë filiale sistemike të grupeve bankare evropiane. Në mënyrë të veçantë, kërkesat e EBA-s (European Baning Authority[50]) mbi nivelin e kapitalizimit të grupeve të mëdha bankare, nxitën një proces të tkurrjes së mbështetjes me kreditim të vendeve pritëse të Evropës Lindore dhe Juglindore. Këto efekte negative evidentuan faktin që masat me natyrë makroprudenciale të ndërmarra në Eurozonë, nuk i kishin marrë mjaftueshëm në konsideratë implikimet për vendet pritëse ku operojnë grupet bankare evropiane. Këto grupe nëpërmjet filialeve të tyre, shërbejnë si kanale të rëndësishme të transmetimit të efekteve të zhvillimeve si në tregje ashtu edhe në sferën e rregullimit dhe mbikëqyrjes nga Eurozona drejt vendeve të Evropës në zhvillim. Pikërisht për të trajtuar shqetësimet e vendeve pritëse përkundrejt zhvillimeve në eurozonë dhe masave të ndërmarra nga autoritetet evropiane, është riaktivizuar Nisma e Vjenës (Viena Inittiative[51]). Në këtë kuadër, midis autoriteteve të vendeve të BE dhe atyre pritëse jashtë BE-së do të trajtohen edhe implikimet e reformave madhore që janë duke u ndërmarrë në BE, e sidomos Bashkimit Bankar.

9. A na adaptohen masat e tyre?

Ekonomia dhe sistemi ynë bankar është ende i vogël dhe i papërfillshëm në krahasim me ekonomitë e sistemet evropiane. Megjithatë ka plot masa që i përshtaten në mënyrë të drejtpërdrejtë ekonomisë tonë. Në fakt mund të konsiderojmë që na adoptohen shumë mirë, duke bërë diferencime të caktuara në kërkesat për kapital, sidomos ato me rëndësi sistemike. Nga ana tjeter qasja makroprudenciale, që këto rregullore përcojnë, përmes nevojës së perfshirjes së instrumentave të rinj të makroprudencës, është një udhëzim i nevojshëm në drejtim të ruajtjes së stabilitetit financiar të sistemit si i tërë. Ka plot

[50] Autoriteti Bankar Evropian
[51] http://www.eib.org/projects/regions/vienna-initiative.htm

kmponëntë si rregullator mbikëqyrës e prudencial të cilët do të orientonin në mënyrë të përgjegjshme dhe të eksperimentuar inkuadrimin e komponentëve të caktuar të sistemit financiar të cilët ende nuk kanë lindur në vendin tonë. Pra do të ishte një kornizë e gatshme e një niveli më të lartë analize dhe kujdesi. Prej këtyre rregulloreve përfitohen herë pas here gjithashtu modele të reja të vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të tij.

10. Ku jemi ne me Bazel I? Po Bazel II?

Konceptet dhe detyrimet e përcaktuara në paketën rregullatore të Bazel I, të cilat për herë të parë u prezantuan në Evrope, në vitin 1988, janë adoptuar në sistemin bankar shqiptar duke filluar nga viti 1999, pas aprovimit nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë "Për mjaftueshmërinë e kapitalit". Bazuar në këtë rregullore bankat janë të detyruara të mbajnë kapitalin e mjaftueshëm për të mbuluar aktivet e tyre me rrezik. Pavarësisht se sipas Bazel I, norma minimale e mjaftueshmërisë duhet të jetë 8 %, për vetë kushtet dhe nivelin e zhvillimit të sistemit tonë bankar norma e mjaftueshmërisë u vendos të ishte më e lartë, në nivelin 12 %.

Paketa e Bazel II u prezantua në vitin 2004 dhe përbëhet nga tre Shtylla kryesore.

a) Shtylla e parë përcakton kërkesat për kapital për tre rreziqet kryesore (rreziku i kredisë, rreziku i tregut dhe rreziku operacional), si edhe metodat përkatëse për llogartitjen e tyre.
b) Shtylla e dytë përcakton detyrimin e bankave për krijimin e një procesi të përshtatshëm vlerësimi të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në strategjitë për administrimin e rreziqeve.
c) Shtylla e tretë përcakton kërkesat për transparencë, të cilat lejojnë pjesemarresit e tregut për të vlerësuar mjaftueshmerinë e kapitalit të një banke.

Kalimi nga Bazel I drejt Bazel II ka qene një ndër prioritet e Bankës së Shqipërise, e shprehur qartësisht edhe në startegjitë afatmesme dhe afatgjata të departamentit të mbikëqyrjes. Megjithatë u desh nje periudhë gati 10 vjecare që ky standart të implementohej në sistemin tonë bankar, pas testimit në banka të cilat janë aktive në tregjet

ndërkombëtare dhe për të cilat ai ishte dizenjuar, duke krijuar një pamje të plotë me të gjitha anët pozitive dhe negative të dëshmuara nga zbatimi në praktikë i tij. Më 31 Korrik 2013, Këshilli Mbikëqyres miratoi rregulloren e re të mjaftueshmerisë së kapitalit, e cila do të hyjë në fuqi në 31 dhjetor 2014, duke zevendësuar rregulloren e mbështetur në standartin Bazel I.

Në lidhje me shtyllën e parë, qasja që sjell kjo rregullore siguron një lidhje racionale të kapitalit të bankës me profilin e rrezikut/qeve të saj dhe trajton kryesisht, kërkesa dhe rregulla të autoritetit mbikëqyrës. Përsa i përket shtyllës së dytë, kjo rregullore përcakton detyrimin e bankave për krijimin e një procesi të përshtatshëm vlerësimi të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, bazuar në strategjitë për administrimin e rreziqeve (ICAAP). Më tej, në vitin në vazhdim parashikohet hartimi i nje manuali që percakton pritshmëritë e rregullatorit në lidhje me këtë proces. Kjo rregullore nuk prek shtyllën e tretë, pra kërkesat për transparencë. Kërkesat e kësaj shtylle do të konsiderohen gjatë rishikimit të rregullores "Për kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave" në vitin në vijim.

11. Cfarë mendoni për direktivën e katërt (CRV IV) të miratuar nga parlamenti Evropian më 26 qershor 2013?

Nëse po flisnim deri tani për marrëveshjen Bazel I, II apo III, ato mbeten në nivlin e orientimit dhe këshillimit, ndërkohë për sa i përket CRD IV , kjo e fundit përfaqëson tanimë kalimin nga orientime në ligj evropian për të gjithë institucionet financiare evropiane. Në fakt kjo direktivë përqafon ngushtë marrëveshjën Bazel III dhe evidenton disa risi sidomos në nivelin e qeverisjes së korporatave. Direktiktiva e Kërkesës për Kapital, lejon të ngrihen në nivel kombëtar rregullore për disa banka, në bazë të madhësisë ose rëndesisë së tyre, si dhe në bazë të impaktit të kolapsit të tyre në stabilitetin e sistemit financiar dhe në ekonominë si e tërë. Pra këto rregullore kombëtare, mund të vendosin kërkesa shtesë për kapital për bankat me rendësi sistemike. Bazuar në rolin dominant të bankave në sistemin financiar shqiptar dhe përqëndrimin e lartë të sektorit bankar në

Shqipëri, Banka e Shqipërise do të jetë e gatshme të aplikojë nevojën për kapital shtesë në të ardhmen.

12. Deri ku duhet të shtrihet mbikëqyrja, avantazhet dhe rreziqet që perceptohen prej saj.

Teorikisht mund të themi që mbikëqyrja duhet të qëndrojë koherente e gjithëpërfshirëse, gjithnjë duke i lënë hapësirë frymëmarrjeje aktivitetit normal të bankës pa e ndrydhur atë. Por, në rrethanat e reja, roli i mbikëqyrjes konsiderohet shumë i rëndesishëm. Ajo mbikëqyr operatorët e sistemit bankar, jo bankar dhe shoqërive të kursim kreditit. Ekzaminimet e kryera në vend me shkallë ekspertize të lartë, identifikojnë herët problemet dhe adresojnë masat e duhura për zgjidhjen e tyre.

Këto inspektime kanë vërtetuar së fundmi shqetësimin mbikëqyrës lidhur me ecurinë e cilësisë së portofolit të kredive të bankave. Rekomandimet adresojnë nevojen për ngritjen e infrastrukturës për administrimin e portofolit me probleme, si dhe rritjes së cilësisë së kontrolleve të brendshme. Globalizimi dhe përmirësimet teknologjike rritën kërkesat për harmonizimin dhe shëmbjen e mureve kundër "sëmundjeve ngjitëse" financiare. Ngjarjet e krizës së fundit financiare me falimentimin e bankave, shërbyen si një leksion për mbikëqyrjen e bankingut si një biznes ndërkombëtar, i cili kërkon bashkëpunim ndërkombëtar për të siguruar një mbikëqyrje efektive. Pra e thënë ndoshta pa moderim, shtrirja e mbikëqyrjes duhe të shkojë në maksimum.

13. Cfarë matshmërie ofroni për ndikimet e rregullatoreve në ekonomi ?

Matja më e mirë e ndikimit të masave apo të rregulloreve në sistemin bankar është reagimi i bankave ndaj tyre apo reagimi i klientëve të bankave. Për disa rregullore matja e efekteve bëhet nëpërmjet raportimeve dhe komunikimeve midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave tregtare shqiptare. Ruajtja e stabilitetit financiar dhe e ekuilibrave macroekonomik, shëndeti financiar i individëve dhe bizneseve janë tregues, të cilët jo vetem garantojnë një rritje ekonomike të qëndueshme, por janë në të njëjtën kohë matës së performancës së rregullatoreve në ekonomi .

6.1.3 Përmbledhje deductive/inductive e ekpertëve të mbikëqyrjes mbi sistemin bankar shqiptar

Siç u parashtrua që në kapitullin e kuadrit teorik vërehet qartë nevoja për të mbikëqyrur në mënyrë të strukturuar e strikte sistemin bankar në mënyrë që të sigurohet besimi në të, harmonia dhe fluiditeti i kalimit të fondeve dhe induktimit të tyre në ekonomi për të arritur në nivele të kënaqshme të stabilitetit dhe rritjes së sitemit financiar dhe sektorit të ekonomisë reale. Globalizimi i aktivitetit bankar kërkon/detyron që edhe strukturat e mbikëqyrjes të globalizohen, pra të kemi si një qëndërzim të vendimmarrjes globale në nivelin e mbikëqyrjes (për të konsultuar të gjithë diversitetet globale) edhe një delegim i të njëjtës bazë mbikëqyrëse në çdo nivel kombëtar (për harmonizimin e aktivitetit bankar ndërkombëtar dhe eliminimin e konkurencës së pa drejtë).

Ekspertët njërëzi konsiderojnë mënyrën indirekte të prekjes së sistemit tonë bankar nga kriza financiare globale, dhe po ashtu njëzëri bien dakort për masat konservatore të ndërmarra për të siguruar situatën dhe më pas për të siguruar përmirësimin e saj. Përgjatë kapitullit të analizës historike dhe krahasuese të marrëveshjeve të Bazel-it kemi parë si përbërjen dhe rëndësinë e komponëntëve të tyre, paralelizimi me sistemin bankar shqiptar dhe evoluimi i tij drejt rrjedhës ndërkombëtare indentifikon po prapë tendencën dhe pashmangshmërinë e adaptimit të indikacioneve ndërkombëtare.

Një pikë shumë e rëndësishme e nxjerrë prej opinioneve të ekspertëve është pikërisht shkalla e ndikimit në modelin e biznesit të bankave. Në fakt, përcaktohet shumë qartë edhe prej tyre që implementimi i mbikëqyrjes dhe rregulloreve prudenciale ka një penetrim të qartë dhe të thellë në modelimin e sjelljes së bankës pra të menaxhimit të saj strategjik për frontiera të reja përfitueshmërie dhe stabiliteti.

Nën këto ripërsëritje të llogjikës së ndikueshmërisë së paketave mbikëqyrëse mbi strategjinë bankare le të vijojmë me vazhdimësine e analizës empirike për të indentifikuar kështu impaktin real mbi bankat e tregtare të sistemit bankar shqiptar.

6.2 Analiza Sasiore Sipas Akseve Kërkimore

Kjo pjesë i dedikohet totalisht prezantimit të analizës empirike dhe rezultateve përkatëse pas trajtimit të të dhënave në zotërimin tonë. Në këtë pjesë ju pret një analizë dhe vlerësim për çdo temë, duke kombinuar kështu të dyja rezultatet e analizave, si ato një dimensionale edhe ato të analizës dy dimensionale . Kjo e fundit është e bazuar në kryqëzime të cilat i kemi konsideruar logjike, që duken relevante dhe përsosin hulumtimet tona, secili prej variablave është nxjerrë nga një seksion kryq i çështjeve në lidhje me një temë të veçantë.

6.2.1 Gjeneza e rregulloreve mbikëqyrëse e prudenciale bankare

I. Analiza një dimensionale

a) A mendoni se përgjatë viteve rëndësia e mbikëqyrjes dhe rregulloreve ndërkombëtare është rritur, mbajtur apo reduktuar?

Mbikëqyrja bankare nderkombetare deri ne 2000

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Mbajtur	8	50.0	72.7	72.7
	Ulur	3	18.8	27.3	100.0
	Total	11	68.8	100.0	
Missing	System	5	31.3		
Total		16	100.0		

Vëmë re që në 5 raste nuk kemi përgjigje, arsye e të cilës është paaftësia e personit në fjalë për të dhënë përgjigje mbi periudha në të cilat nuk ka qënë në atë post. Ndëerkohë, mendohet që rëndësia e mbikëqyrjes ndërkombëtare deri para viteve 2000 është ruajtur,mbajtur në një nivel (72% e të përgjigjeve, apo 50% e totalit nëse marrim parasysh edhe rastet boshe).

Mbikëqyrja bankare nderkombetare deri ne 2004

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Rritur	4	25.0	26.7	26.7
	Mbajtur	11	68.8	73.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

Kur kalojmë në periudhën deri në 2004, vihet re që ka një pjesë të konsiderueshme që deklarojnëpikërisht se mbikëqyrja ndërkombëtare është rritur në rëndësi. Vetëm një individ nuk është përgjigjur duke patur kështu 27 % për rritje të rëndëisë, 73% për mbajtjen e saj.

Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Rritur	16	100.0	100.0	100.0

Për sa i përket ditëve të sotme pa kompromis kemi 100% të intervistuarve të cilët konfirmojnë një rritje të rëndësisë së mbikëqyrjes ndërkombëtare. Në fakt, zhvillimi në këtë drejtim i përket pikërisht situatës botërore financiare të kapluar nga krizat dhe pasiguria. Në shumicën prej institucioneve mendohet që ka ardhur duke u rritur, ka qënë kriza globale e 2007-2008 që ndikoi në rritjen e mëtejshmë të vëmendnjes dhe rishikimit të rregulloreve të mbikëqyrjes dhe prudencës, me rëndësi ndaj rregulloreve të kapitalit, likuiditetit dhe rrezikut të kredisë. Shkaqet e rritjes së rregulloreve mbikëqyrëse po ti përmbledhim dhe ti grupojmë, të intervistuarit përgjigjen mbi këto shkaqe të zhvillimeve të mësipërme:

Shkaqet e rendesise se zhvillimit te mbikëqyrjes nderkombetare

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	6	37.5	37.5	37.5

	BANKAT QE OPEROJNE NE SHQIPERI NE SHUMICEN E TYRE JANE PJESE E GRUPEVE TE BANKAVE TE HUAJA.BANKA E SHQIPERISE ESHTE NE PERPJEKJE TE PERAFRIMIT TE RREGULLOREVE TE VETA ME STANDARTET DHE RREGULLATORET E BANKAVE QËNDRORE EVROPIANE.DUKE PASUR STATUSIN E VENDIT KANDIDAT SHQIPERIA DUHET TE PERAFROJE KETO RREGULLORE ME ATO NDERKOMBETARE	2	12.5	12.5	50.0
	KRIZA GLOBALE E VITIT 2007-2008 NDIKOI NE RRITJEN E VEMENDJES SE BANKES QËNDRORE NE EFEKTET E KESAJ KRIZE NE MBARE BOTEN. RISHIKOI SHUME RREGULLORE E MBIKËQYRJE DUKE RRITUR KERKESAT RREGULLATORE PER BANKAT E NIVELIT TE DYTE,DUKE I DHENE NJE RENDESI TE VECANTE RREGULLOREVE TE KAPITALIT, LIKUIDITETIT DHE RREZIKUT TE KREDISE	4	25.0	25.0	75.0
	NDIKIMI I KRIZAVE FINANCIARE SI SUBPRIME LOANS DHE EU DEBT CRISIS	3	18.8	18.8	93.8
	NE DITET E SOTME RENDESIA ESHTE RRITUR DHE SHKAKU KRYESOR ESHTE RREZIKU QE SHOQERON KRIZEN FINANCIARE.DERI NE VITIN 2004 NORMAT KANE QENE KONSTANTE	1	6.3	6.3	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Pra mbi 50% deklarojnëse janë pikërisht krizat financiare globale që kanë detyruar zhvillimin e rëndësisë së mbikëqyrjes ndërkombëtare.



Grafiku 6.1 Arsyet e zhvillimit të rregulloreve mbikëqyrëse

Sipas këtyre të dhënave mund të konkludojmë se rëndësia e rregulloreve mbikëqyrëse pranohet unaninmisht që ka qënë në rritje, kjo për arsye të ndryshme ku pjesa dërmuese e bankave mendojnë se vjen si rrezultat i krizave financiare dhe me më pak përfshirje si rezultat i trendeve bankare, pra zhvillimit të aktivitetit bankar, ku rregulloret e ndjekin atë

në mënyrë skrupuloze. Ka një përqindje modeste të bankave që mendojnë edhe përafrimin me rregulloret ndërkombëtare si të jetë arsye e rritjes së vëmendjes së tyre.

Rregulloret janë hartuar për të plotësuar hapjen e nevojave të ekonomisë dhe kërkesat e standarteve ndërkombëtare të sigurisë bankare sepse ndjekja e kontekstit global për të lehtësuar integrimin e bankave në sferën e financave ndërkombëtare është tejet e rëndësishme duke marrë parasysh faktin e përqindjes së lartë të prezencës së bankave të huaja në vend. Le ta shohim më poshtë se si konsiderohen rregulloret tona në krahasim me ato ndërkombëtare.

b) Cfarë mendoni ju mbi mbikëqyrjen bankare shqiptare?

Mbikëqyrja bankare shqiptare ne krahasim me nderkombetaren

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Mikste	15	93.8	100.0	100.0
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

93% e të intervistuarve deklarojnëse mbikëqyrja bankare shqiptare është mikste midis kombëtares dhe ndërkombëtares. Në fakt rregulloret mbikëqyrëse e prudenciale shqiptare, siç është shtjelluar në seksionin e mëparshëm janë midis dy marrëveshjeve Bazel ndërkohë që për elementë kryesorë të kapitalit ka indikacione më strikte. Arsyet e tendencës në konformitetin me rregulloret ndërkombëtare cilësohen të jenë:

- ➔ Kërkimi perpetual i fazimit me komunitetin ndërkombëtar
- ➔ Hapja e ekonomisë dhe prezenca e bankave të huaja
- ➔ Globalizimi dhe mondializimi financiar
- ➔ Përafrimi me marrëveshjen e Bazel për tu përgatitur për konkurencën ndërkombëtare

Por duhet ditur që fakti i të qënit miks rrjedhon nga vonesa në implementim në kohë reale me rregulloren e momentit dhe sistemi financiar dhe bankar shqiptar është gjithashtu larg të qënit një sistem i zhvilluar me prezencë të të gjithë diversitetit të produkteve e shërbimeve ndërkombëtare.

Le ti grupojmë përgjigjet dhe mund të vëzhgojmë :

Perse ky krahasim

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		5	31.3	31.3	31.3
	BANKA E SHQIPERISE ESHTE ME KONSERVATORE SE BANKAT QËNDRORE EVROPIANE/PSH NIVELI MINIMAL I MJAFTUESHMERISE SE KAPITALIT NGA SHUMICA E BANKAVE EVROPIANE ESHTE 8&%,NE SHQIPERI ESHTE 12%.SHQIPERIA APLIKON NJE MIKSIM TE BAZEL I ME ELEMENTE TE BAZEL II NDERKOHE QE BANKAT EVROPIANE JANE DUKE IMPLEMENTUAR BAZEL III	2	12.5	12.5	43.8
	MBIKËQYRJA BANKARE SHQIPTARE BAZOHET NE MBIKËQYRJEN NDERKOMBETARE POR APLIKON EDHE STANDARTE TE TJERA SI PSH NDRYSHIM KANE STANDARTET E KONTABILITETIT DHE STANDARTET NDERKOMBETARE TE RAPORTIMIT FINANCIAR	3	18.8	18.8	62.5
	MBIKËQYRJA BAZOHET NE STANDARTET E BAZEL I NDERSA MBIKËQYRJA NDERKOMBETARE ESHTE DUKE APLIKUAR BASE III	2	12.5	12.5	75.0
	SHQIPERIA ESHTE AKOMA MIDIS BAZEL I DHE NE HAPAT E PARE TE BAZEL II. NDERKOHE QE STANDARTET NDERKOMBETARE PO NDRYSHOJNE DREJT BAZEL III.VEMENDJES SE LIKUIDITETIT DHE KAPITALIT TE BANKAVE TE NIVELIT TE DYTE	4	25.0	25.0	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Sinteza :

Rezultatet e nxjerra na mundësojnë të kuptojmë që rregulloret mbikëqyrëse e prudenciale kanë njohur një zhvillim të madh. Zhvillimet në fjalë kanë kaluar nëpër faza të ndryshme të përputhshme me boom-e zhvillimi të aktivitetit bankar, me friza financiare apo me përmirësimin (up-grade) e rregulloreve ndërkombëtare. Vëmë re që rregulloret ndërkombëtare njihen dhe vlerësohen. Në fakt vëzhgohet një sistem mbikëqyrës kombëtar miks, i cili ka një prije të qartë drejt rregulloreve ndërkombëtare për nivelin e tyre të mirë dhe barazpeshimin e kërkesave bankare me tregun ndërkombëtar ***duke na mundësuar një përgjigje pozitive ndaj Hipotezës 1.***

6.2.2 Zhvillimi i rregulloreve mbikëqyrëse e prudenciale bankare

I. Analiza një dimensionale

a) Si e gjykoni ju sistemin e rregullave të mbikëqyrjes bankare përgjatë këtyre periudhave ?

Gjykimi mbi regulat e mbikëqyrjes deri ne 2000

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Te pergjithshme	11	68.8	78.6	78.6
	Fleksibel	3	18.8	21.4	100.0
	Total	14	87.5	100.0	
Missing	System	2	12.5		
Total		16	100.0		

Vërejmë që deri ne vitet 2000 gati 70% e të intervistuarve deklarojnëqë rregulloret mbikëqyrëse kombëtare kanë qënë të përgjithshme, 20% deklarojnënë rregullore fleksibël, ndërkohë që kemi një pjesë prej 12 % të cilët nuk janë përgjigjur për këto vite.

Gjykimi mbi regulat e mbikëqyrjes deri ne 2004

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Te pergjithshme	8	50.0	50.0	50.0
	Te inkuadruara	2	12.5	12.5	62.5
	Te ngurta	4	25.0	25.0	87.5
	Fleksibel	2	12.5	12.5	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Ndërkohë sapo kalojmë në periudhën 2000-2004 50% e të intervistuarve i klasifikojnë rregulloret si të përgjithshme, 25% si të ngurta, 12.5% si të inkuadruara dhe mbetet një pjesë prej 12.5% si në vitet paraardhëse që i konsiderojmë sërish fleksibël. Pra vihet re një zhvillim i shpejtë dhe i përqëndruar.

Gjykimi mbi regulat e mbikëqyrjes sot

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Te inkuadruara	5	31.3	31.3	31.3
	Te ngurta	11	68.8	68.8	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Ndërkohë nga momenti që kalojmë në periudhën post 2004, periudhë e turbulluar nga shumë kriza e luhatje, rregulloret klasifikohen menjëherë në gati 70% si të ngurta, gati 30% si të inkuadruara duke fshirë totalisht nga mundësitë e emërtimit të tyre klasifikimin në fleksibël apo të përgjithshme. Le të grupojmë arsyet kryesore për të cilat ka ndodhur kjo metamorfrozë:

Perse

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		7	43.8	43.8	43.8

	AKOMA BANKA QËNDRORE PUNON ME METODOLOGJI TE VJETRA PER MATJEN E RREZIKUT DHE NUK BAZOHET NE HISTORIKUN E DATA DHE AKOMA NE KETO RREGULLORE NUK MERREN PARASYSH SKK. STANDARTET LOKALE JANE AKOMA LARG METODOLOGJIVE TE PERDORURA NGA INSTITUCIONET RREGULLATORE DNERKOMBETARE	4	25.0	25.0	68.8
	MBIKËQYRJA BANKARE KA PERDITESUAR RREGULLAT DUKE I ADAPTUAR ATO ME RREGULLAT NDERKOMBETARE	3	18.8	18.8	87.5
	NE MOMENTET E KRIZES FINACNAIRE KUR TE GJITHA BANKAT QËNDRORE MOREN MASA LEHTESUESE PER TE RIKTHYER LIKUIDITETIN E MUNGUAR NE TREGUN E PARASE, BANKA E SHQIPERISE FORCOI KUADRIN RREGULLATOR DUKE MOS LEHTESUAR POR DUKE E RENDUAR KRIZEN E LIKUIDITETIT	2	12.5	12.5	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Sipas kësaj përmbledhjeje frekuencash 43% nuk janë shprehur për arsyet e këtyre ndryshimeve. Ndërkohë pjesa tjetër tregojnë mbi rëndësinë e modeleve të përditësuara ndërkombëtare nga të cilat duhen inspiruara rregulloret kombëtare si dhe nga rëndësia që kanë patur krizat në ndryshimin e tyre.

b) Sipas mendimit tuaj si ka qënë rrugëtimi i sistemit mbikëqyrës në ambientin bankar shqiptar?

Rrugetimi i mbikëqyrjes shqiptare

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	I shpejte	2	12.5	13.3	13.3

	I konsiderueshem	13	81.3	86.7	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

Zhvillimi i mbikëqyrjes është i konsiderueshëm në përqindjen më të madhe të tregut, ku arsyet e vetë zhvillimit i kemi cilësuar më lartë, ndërkohë për një pjesë të vogël të bankave konsiderohet madje një ndryshim i shpejtë. Shpejtësia e zhvillimit të tyre në fakt shpjegohet shumë mirë nga pozita e vendit tonë si një vend emergjent,sepse në përgjithësi rregulloret mbikëqyrëse e prudenciale konsiderohen të jenë "një kantier punimi" në vendet emergjente. Struktura dhe teknologjia që e karakterizon sistemin tonë bankar tregon mirë pse nuk ka patur shpejtësi maksimale. Në të vërtetë, autoritetet në tregjet në zhvillim duhet të përfshihen në harmonizimin ndërkombëtar të rregullimit mbikëqyrës e prudencial, por edhe duhet të marrin kohë për të gjetur një mekanizëm që përshtatet me procesin e veçantë të sistemeve bankare kombëtare. Në Shqipëri, progresi në rregullore është bërë, por disa çështje mbeten për t'u zhvilluar dhe ritmi i zhvillimit në përgjithësi ndjek karakteristikat e ekonomisë dhe strukturën e tregut financiar. Le të grupojmë arsyet e këtij rrugëtimi sipas të intervistuarve:

Perse

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		10	62.5	62.5	62.5
	NE NJE KOHE TE SHKURTER U THEMELUA DHE U HARTUA GJITHE KUADRI RREGULLATOR DUKE PERFSHIRE DHE LIGJIN PER BANKAT DHE FILLOI TE FUNKSIONOJE SISTEMI BANKAR ME DY NIVELE	2	12.5	12.5	75.0

	NE SHQIPERI SISTEMI I MBIKËQYRJES ESHTE ZHVILLUAR KRAHASUAR ME STARTIN E KALIMIT NE SISTEMIN BANKAR ME 2 NIVELE.RREGULLATORET DHE POLITIKAT E MBIKËQYRJES JANE ZHVILLUAR DHE PERMIRESUAR SHUME SIDOMOS 5 VITET E FUNDIT.ATO PO PERPIQEN GJITHMONE E ME SHUME TE AFROHEN ME STANDARTET E BAZEL.	4	25.0	25.0	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Pjesa dërmuese kanë preferuar të mos përgjigjen ndërkohë që kemi pjesën tjetër të të intervistuarve që kanë detajuar si arsye kryesore të zhvillimit të konsiderueshëm e jo shumë të shpejtë vetë faktin e vonesës në zhvillimin e tregut bankar dhe financiar në Shqipëri, ndërkohë që vitet e fundit dëshira dhe vendoshmëria për t'ju përafruar rregulloreve ndërkombëtare kanë karaktërizuar një zhvillim pozitiv deri në të shpejtë të rregulloreve kombëtare.

c) Tregoni cila nga këto indikacione mbikëqyrëse ka pësuar ndryshime të rëndësishme në periudhat e dhëna.

Deri në vitet 2000

Ndryshime ne raport likuiditeti deri ne 2000

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Raporti i likuiditetit	5	**31.3**	100.0	100.0
Missing	System	11	68.8		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne diversifikim rreziku deri ne 2000

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Shperndarja e rrezikut	3	**18.8**	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne raport solvabiliteti deri ne 2000

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Raporti i solvabilitetit	5	**31.3**	100.0	100.0
Missing	System	11	68.8		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne rrezik operacional deri ne 2000

		Frequency	Percent
Missing	System	16	**100.0**

Ndryshime ne rrezikun e kredise deri ne 2000

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Rreziku i kredise	2	**12.5**	100.0	100.0
Missing	System	14	87.5		
Total		16	100.0		

Deri në vitet 2000 pra, vëzhgojmë që rregulloret nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim madhor, pjesa dërmuese deklarojnëse ato kanë qënë në profil të ulët, rregulloret mbi rrezikun e slovabilitetit dhe likuiditetit kanë qënë më prezente në ndryshime, ndërkohë që rregulloret mbi rrezikun operacional ende nuk ishin zhvilluar në atëkohë.

Deri në vitet 2004

Ndryshime ne raport likuiditeti deri ne 2004

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Raporti i likuiditetit	5	**31.3**	100.0	100.0
Missing	System	11	68.8		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne diversifikim rreziku deri ne 2004

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Shperndarja e rrezikut	7	**43.8**	100.0	100.0
Missing	System	9	56.3		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne raport solvabiliteti deri ne 2004

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Raporti i solvabilitetit	3	**18.8**	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne rrezik operacional deri ne 2004

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Rreziku operacional	2	**12.5**	100.0	100.0
Missing	System	14	87.5		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne rrezikun e kredise deri ne 2004

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Rreziku i kredise	9	**56.3**	100.0	100.0

Missing	System	7	43.8		
Total		16	100.0		

Ja teksa shohim ndryshimet e balancave, duke vëzhguar së pari një rëndësi mbi rrezikun operacional, së dyti rritjen e peshës së rëndësisë së shpëerndarjes së rrezikut si dhe rrezikut të kredisë. Rregulloret mbi likuiditetin dhe solvabiliteitn qëndrojnë në po të njëjtën peshë, rregulloret mbi shpërndarjen e rrezikut karegorizohen në rritje të peshës së tyre nga 19% në 44% të të intervistuarve, dhe rregulloret mbi rrezikun e kredisë konsiderohen të kenë ndryshuar shumë duke bërë që të reagojnë nga 12.5% e të intervistuarve në 56% të tyre.

Deri në ditët e sotme

Ndryshime ne raport likuiditeti sot

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	16	**100.0**	100.0	100.0

Ndryshime ne diversifikim rreziku sot

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Po	16	**100.0**	100.0	100.0

Ndryshime ne raport solvabiliteti sot

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	25.0	28.6	28.6
	Po	10	**62.5**	71.4	100.0
	Total	14	87.5	100.0	
Missing	System	2	12.5		
Total		16	100.0		

Ndryshime ne rrezik operacional sot

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	6	37.5	37.5	37.5
	Po	10	**62.5**	62.5	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Ndryshime ne rrezikun e kredise sot

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	2	12.5	14.3	14.3
	Po	12	**75.0**	85.7	100.0
	Total	14	87.5	100.0	
Missing	System	2	12.5		
Total		16	100.0		

Me unanimitet rregulloret mbi raportin e likuiditetit dhe shpërndarjes/diversifikimit së rrezikut kanë pësuar ndryshime deri në ditët e sotme. Ndërkohë kemi një rritje të konsiderueshme të ndjesisë së ndryshimit të të gjithë rregulloreve të sipërpërmendura. 62.5% e totalit të bankave të intervistuara dhe 71.5% e atyre që janë përgjigjur deklarojnëse ka ndryshime në rregulloren mbi raportin e solvabilitetit. 62.5% e bankave të intervistuara deklarojnëse ka ndryshime në rrëgulloren mbi rrezikun operacional. 75% e të intervistuarve apo 85.7% e atyre që janë përgjigjur shprehen për një ndryshim në rregulloren e rrezikut të kredisë, një përqindje e lartë që na tregon peshën reale të kësaj rregulloreje në fjalë.

Pra mund të vëzhgojmë që në bazë të eksperiencës dhe të modeleve të reja të menaxhimit të rrezikut kemi një zhvillim dhe metamorfozë të përgjithshme të rregulloreve duke vënë theks mbi konceptet e reja të rrëzikshmërisë dhe "shkarjeve" potenciale të sistemit bankar në kriza e kolapse.

d) Si i shikoni indikacionet mbikëqyrëse shqiptare?

Indikacionet mbikëqyrese shqiptare

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	kushtezuese	9	**56.3**	56.3	56.3
	Strikte	3	18.8	18.8	75.0
	Te paqarta	4	25.0	25.0	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Pra fatkeqësisht në këtë pikë kemi një shpërndarje të lartë por konotacioni është paksa negaiv për sa i përket indikacioneve vendase. Mbi gjysma e bankave të pyetura mendojnë se janë kushtëzuese, ndërkohë një pjesë me e vogël e bankave të pyetura por me një pjesë tregu më të lartë i konsiderojnë indikacionet shqiptare ende të paqarta, me nota të tendencave strikte.

e) Si i shikoni indikacionet ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

Indikacionet mbikëqyrese nderkombetare

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	kushtezuese	2	12.5	14.3	14.3
	adapte me4 situaten financiare	12	**75.0**	85.7	100.0
	Total	14	87.5	100.0	
Missing	System	2	12.5		
Total		16	100.0		

Indikacionët ndërkombëtare nga ana tjetër shihen në mënyrë të njëjtë nga të gjithë bankat duke u konsideruar si adapte me situatën financiare, kjo ndoshta nga ideja që përcillet pas përditësimeve të bëra se herë ka një krizë apo mungesë stabiliteti në tregjet financiare

ndërkombëtare. Por pavarësisht kësaj, ndjehet një nocion kushtëzimi edhe prej tyre, 12.5 % e bankave të intervistuara shprehen për këtë. Le të grupojmë arsyet për këtë kategorizim të tyre:

Perse

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		10	62.5	62.5	62.5
	JANE MIDIS TE NGURTES DHE ADAPTE ME SITUATEN AKTUALE FINANCIARE. RENDESIA ME E MADHE NE NDRYSHIMET AKTUALE I KUSHTOHET LIKUIDITETIT DHE SOLVABILITETIT TE BANKAVE, MJAFTUESHMERISE SE KAPITALIT PER TE EVITUAR SITUATAT E FALIMENTIMIT TE GRUPEVE TE MEDHA BANKARE NE VITIN 2007-2008	4	25.0	25.0	87.5
	NE SITUATEN E KRIZES DISA INDIKACIONE FINANCIARE U PERSHTATEN ME SITUATEN NE VENDET EVROPIANE, NDERKOHE QE NE SHQIPERI U BENE ME KUSHTEZUESE	2	12.5	12.5	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Nga individëd që janë përgjigjur gati 70 % e tyre deklarojnërregullat ndërkobëtare janë midis të ngurtës dhe adaptes duke shprehur idenë që është vetë situata që i kërkon këto masa të jënë strikte, pavarësish pengesave apo kushtëzimeve që mund të induktojnë në aktivitetin e bankave.

f) Si i konsideroni indikacionet ndërkombëtare të mbikëqyrjes në raport me indikacionet shqiptare?

Indikacionet nderkkombetare ne raport me ato kombetare

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Me shume strikte	2	12.5	14.3	14.3

	Me pak strikte	2	12.5	14.3	28.6
	Te ngjashme	**4**	25.0	28.6	57.1
	Te ndryshme	2	12.5	14.3	71.4
	Koherente	**4**	25.0	28.6	100.0
	Total	14	87.5	100.0	
Missing	System	2	12.5		
Total		16	100.0		

Mënyra se si perceptohet krahasimi midis mbikëqyrjes kombëtare e asaj ndërkombëtare anon drejt rregulloreve shqiptare më strikte duke marrë parasysh pjesën e tregut që zënë bankat që kanë deklaruar këtë anë të peshores (llogjike për shembull kapitali rregullator në nivele më të larta nga 8% sipas Bazel dhe në 12% sipas rregullores shqiptare). Një pjesë tjetër e bankave, 25% e tyre, i konsiderojnëtë ngjashme (inspirimi i rregulloreve tona nga Bazel arsyeton këtë vrojtim) dhe të ndryshme për pjesën më të vogël të tregut që zënë bankat e intervistuara me 12.5%, kjo është llogjike dhe e pritshme për nga vetë ndryshimi i strukturave të sisteme financiare shqiptare me ato ndërkombëtare.

Për sa i përket nivelit të disa raporteve të rregulloreve ndërkombëtare ato janë si nivele të ndryshme por nuk duhet harruar se menyra e përllogaritjes së rrezikut dhe ponderimi i aseteve rrinë kryesisht në nivele të krahasueshme (jemi ne që jemi inspiruar nga modelet e sprovuara ndërkombëtare). Duke i konsideruar më adapte, koherente dhe të ngjashme mund të konkludojmë në një pëlqyeshmëri të rregulloreve ndërkombëtare, të cilat apriori mund ti japin bankës nivel lirshmërie më të lartë.

Sinteza:

Analiza e deritanishme na mundëson të kuptojmë që zhvillimi i rregulloreve mbikëqyrëse ka patur tendencë të drejtohet nga rrepësia e ngurtësia duke i bërë rregulloret më prezente në aktivitetin bankar. Rregulloret mikste midis kombëtareve dhe ndërkombëtareve kanë pësuar një ndryshim të konsiderueshëm thuajse të shpejtë me një inspirim nga rregulloret ndërkombëtare . Ndryshimet e vëzhguara kanë patur si arsye kryesore krizat financiare

ndërkombëtare e situatën ekonomike që ka ndjekur. Rregulloret e deklaruara në zhvillim të vazhdueshëm janë direktivat mbi raportin e likuiditetit dhe mbi diversifikimin e rrezikut. Rrgulloret e raportit të solvabilitetit dhe rrezikut të kredisë kanë filluar të kenë një rëndësi më të madhe ndërkohë që kemi edhe regullore të futura rishtazi si direktivat mbi rrezikun operacional, të cilat po marrin një peshë të lartë. Pra marrëveshjet ndërkombëtare shihen në të njëjtën kohë edhe si kushtëzuese por edhe si faktorë të rëndësishëm duke na rikonfirmuar pranimin e ***Hipotezës 1 dhe duke na orientuar mbi Hipotezën 2***. Pra ngrihet pyetja: "A ka ndikuar rëndësia e rregulloreve ndërkombëtare në ndryshimet në rregulloret kombëtare? "

II. Analiza dy dimensionale

Analiza në këtë pjesëz do të mundësojë kryqëzimin midis rëndësisë së rregulloreve ndërkombëtare dhe ndryshimit të komponentëve të rregulloreve lokale. Ky kryqëzim aksesh na ofron mundësinë të vëzhgojmë atë cka nuk ju kërkohet në mënyrë direkte të intervistuarve për të rezultuar me një ndikueshmëri direkte mes dy akseve të sipërpërmendura. Le ti përgjigjemi pyetjes së ngritur pak më lartë.

Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot * Ndryshime ne raport likuiditeti sot Crosstabulation

		Ndryshime ne raport likuiditeti sot	
		Po	Total
Mbikëqyrja bankare Rritur nderkombetare sot	Count	16	16
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	**100.0%**	100.0%
Total	Count	16	16
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	100.0%	100.0%

Verejmë që në 100% të rasteve me rritjen e rëndësisë së rregulloreve ndërkombëtare kemi patur në të njëjtën kohë edhe ndryshime në rregulloren e raportit të likuiditetit. Pra ndikueshmëria e fshehur mes tyre rrezulton të pranohet.

Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot * Ndryshime ne diversifikim rreziku sot Crosstabulation

		Ndryshime ne diversifikim rreziku sot	
		Po	Total
Mbikëqyrja bankare Rritur nderkombetare sot	Count	16	16
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	**100.0%**	100.0%
Total	Count	16	16
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	100.0%	100.0%

Vërejmë që në 100% të rasteve me rritjen e rëndësisë së rregulloreve ndërkombëtare kemi patur në të njëjtën kohë edhe ndryshime në rregulloren e shpërndarjes/diversifikimit të rrezikut. Pra ndikueshmëria e fshehur mes tyre rrezulton të pranohet.

Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot * Ndryshime ne raport solvabiliteti sot Crosstabulation

		Ndryshime ne raport solvabiliteti sot		
		Jo	Po	Total
Mbikëqyrja bankare Rritur nderkombetare sot	Count	4	10	14
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	28.6%	**71.4%**	100.0%
Total	Count	4	10	14
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	28.6%	71.4%	100.0%

Vërejmë që në 71.4% të rasteve me rritjen e rëndësisë së rregulloreve ndërkombëtare kemi patur në të njëjtën kohë edhe ndryshime në rregulloren e raportit të solvabilitetit. 28.6% deklarojnë që këto rregulore nuk kanë ndryshime pavarësisht rritjes së rëndësisë së rregulloreve mbikëqyrëse. Ndërkohë kemi dy banka që nuk janë shprehur për ndryshimin e rrregullores[52]. Pra ndikueshmëria e fshehur mes tyre rrezulton të pranohet.

[52] Mund ta gjeni në tabelën "Ndryshime ne raport solvabiliteti sot" fq.

Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot * Ndryshime ne rrezik operacional sot Crosstabulation

		Ndryshime ne rrezik operacional sot		
		Jo	Po	Total
Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot Rritur	Count	6	10	16
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	37.5%	**62.5%**	100.0%
Total	Count	6	10	16
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	37.5%	62.5%	100.0%

Vërejmë që në 62.5% të rasteve me rritjen e rëndësisë së rregulloreve ndërkombëtare kemi patur në të njëjtën kohë edhe ndryshime në rregulloren e rrezikut operacional. 37.5% deklarojnë që këto rregulore nuk kanë ndryshime pavarësisht rritjes së rëndësisë së rregulloreve mbikëqyrëse, përqindje e cila shpjegohet edhe nga inekzistenca e mëparshme e kesaj rregulloreje. . Pra ndikueshmëria e fshehur mes tyre rrezulton të pranohet.

Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot * Ndryshime ne rrezikun e kredise sot Crosstabulation

		Ndryshime ne rrezikun e kredise sot		
		Jo	Po	Total
Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot Rritur	Count	2	12	14
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	14.3%	**85.7%**	100.0%
Total	Count	2	12	14
	% within Mbikëqyrja bankare nderkombetare sot	14.3%	85.7%	100.0%

Vërejmë që në 85.7% të rasteve, prej të cilave këmi një përjgigje, me rritjen e rëndësisë së rregulloreve ndërkombëtare kemi patur në të njëjtën kohë edhe ndryshime në rregulloren e rrezikut të kredisë. 14.3% deklarojnë që këto rregulore nuk kanë ndryshime pavarësisht rritjes së rëndësisë së rregulloreve mbikëqyrëse. Ndërkohë kemi dy banka që nuk janë

shprehur për ndryshimin e rregullores[53]. Pra ndikueshmëria e fshehur mes tyre rrezulton të pranohet.

Sinteza:

Nëpërmjet analizës dy dimensionale të mësipërme mund të kuptopjmë që vetë rritja e rëndësisë së rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare përfaqëson një rëndësi të lartë mbi rregulloret ndërkombëtare duke i parë të ecin paraleleisht në shumicën e rasteve e duke nxitur integrimin e direktivave të reja apo matshërive të ndryshme. ***Konkludojmë në pranimin e Hipotezës së ndikueshmërise duke i dhënë një përgjigje pozitive Hipotezës 2****.*

6.2.3 Regulloret dhe indikacionet e mbikëqyrjes dhe prudencës kombëtare

I. Analiza një dimensionale

a) Cilat marrëveshje kombëtare mbi mbikëqyrjen zbatoni?

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi administrimin e rrezikut te kredise?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	2	12.5	13.3	13.3
	Po	13	81.3	86.7	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

[53] Mund ta gjeni në tabelën "Ndryshime ne rrezikun e kredise sot" fq.

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi administrimin e rrezikut operacional?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	25.0	26.7	26.7
	Po	11	68.8	73.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi administrimin e rrezikutnga pozicionet e hapura valutore?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	25.0	26.7	26.7
	Po	11	68.8	73.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi administrimin e rrezikut te likuiditetit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	25.0	26.7	26.7
	PO	11	68.8	73.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi administrimin e rrezikut nga ekspozimet e medha?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	25.0	26.7	26.7
	Po	11	68.8	73.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi administrimin e rrezikut nga veprimtarite e degeve te huaja bankare?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	8	50.0	53.3	53.3
	Po	7	43.8	46.7	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi bashkeveprimin me subjektet jobanka?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	8	50.0	53.3	53.3
	Po	7	43.8	46.7	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi kerkesat e minimumit te publikimit te informacionit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	25.0	26.7	26.7
	Po	11	68.8	73.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi sigurine e ambienteve?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	4	25.0	26.7	26.7
	Po	11	68.8	73.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A zbatoni marreveshjen kombetare mbikëqyrese mbi transparencen?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	5	31.3	31.3	31.3
	Po	11	68.8	68.8	100.0
	Total	16	100.0	100.0	



Grafiku 6.2 Rregulloret e zbatuara në nilevin kombëtar

Mund të vëmë re që ka një pjesë të vogël të cilët nuk i janë përgjigjur këtij sektori, ndërkohë që pjesa dërmuese e bankave dhe të intervistuarve mbi 68.8% shprehen mbi një njohje dhe zbatim të thuajse të gjithë rregulloreve të sipërpërmendura, së pari për natyrën e detyrueshme të shumicës prej tyre së dyti për orientimin që ato ofrjojnë e së treti për uniformizim të disa parametrave duke krijuar kushte të barabarta konkurence në treg. Të vetmet rregullore të cilat janë subjektive dhe jo të detyrueshme kuptohen nga përqindja e ulët e zgjedhjeve të tyre si administrimi i rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja dhe bashkëveprimi me subjektet jobanka.

Kuptpjmë kështu një shtrirje të detajuar, insistuese e skrupoloze të Bankës së Shqipërisë në mbarëvajtjen dhe sigurinë e aktivitetit bankar në tregun tonë.

b) Ku i shihni ju konkretisht avantazhet e rregulloreve dhe indikacioneve mbikëqyrëse?

Le të vëzhgojmë një grupim të përgjigjeve të dhëna:

Ku i shihni ju konkretisht avantazhet e indikacioneve mbikëqyrese?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		4	25.0	25.0	25.0
	ADMINISTRIMI I RREZIKUT TE KREDISE ESHTE AFRUAR ME B. 2-SHIT	2	12.5	12.5	37.5
	JANE TE APLIKUESHME PER TE GJITHE SISTEMIN BANKAR ME BAZE TE NJEJTE DHE RUAJNE KONKURENCEN E DREJTE.SHERBEJNE PER TE MBROJTUR INTERESAT E KLIENTEVE	1	6.3	6.3	43.8
	ME DETYRIMIN PER TE MBAJTUR INDIKACIONET MBIKËQYRESE SIPAS AUTORITET BoA MENAXHIMI I BANKES BEHET ME PRUDENT NDAJ RREZIKUT,FAKTOR SHUME I RENDESISEHM NE KETE PERIUDHE KRIZE	2	12.5	12.5	56.3
	MINIZIMIN I HUMBJEVE DUKE KONKRETIZUAR NE AFAT TE GJATE NJE RRITJE KONSTANTE DHE TE VAZHDUESHME TE BIZNESIT	3	18.8	18.8	75.0
	RREZIKU I KREDISE,TRASPARENCA DHE KERKESAT LIDHUR ME KAPITALIN DHE MJAFTUESHMERINE E TIJ	4	25.0	25.0	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Të gjithë rregulloret/indikacionet janë të aplikueshme në të gjthë sistemin bankar që sheshon diferencimet dhe tenton për konkurueshmëri të drejtë. Modelet e llogaritjes dhe të menaxhimit të rrezikut janë të vlerësueshme dhe e ndihmojnë bankën. Këto indikacione sigurojnë përgjithësisht një menaxhim e prudencë më të lartë nga ajo që do të kryente në mënyrë spontane një bankë duke harmonizuar dhe stabilizuar sistemin financiar. Inspirimi i rregulloreve kombëtare nga ato ndërkombëtare ka ofruar një besim më të lartë duke u mbështetur kështu në modele më të sprovuara dhe të përparuaraa, modele të cilat kanë patur mundësinë të testojnë suksesin apo dështimin e tyre duke qënë sa më të përditësuara dhe prundenciale.

c)Cilat indikacione apo rregullore mbikëqyrëse ju kanë penguar në aktivitetin tuaj?

A ju kane penguar indikacionet mbikëqyrese mbi kerkesat e mjaftueshmerise se kapitalit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	8	50.0	53.3	53.3
	Po	7	43.8	46.7	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A ju kane penguar indikacionet mbikëqyrese mbi raportet e likuiditetit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	11	68.8	73.3	73.3
Rregulloret mbi rrezikun e normës së interesit konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve, një ndikim të konsiderueshëm në 31% të rasteve mbi strategji. Rregulloret mbi rrezikun e ekspozimit bankar konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve, një ndikim të konsiderueshëm në 31% të rasteve mbi strategji. Rregulloret mbi rrezikun e tregut konsiderohen në një nivel prej 38% te rasteve me një ndikueshmëri të lehtë dhe në 19% të rasteve me një ndikueshmëri të konsiderueshme mbi strategji.

Rregulloret mbi rrezikun operacional konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve, një ndikim të konsiderueshëm në 19% të rasteve mbi strategji dhe kemi po ashtu një nivel prej 12% të rasteve që i konsederon pa ndikim. Rregulloret mbi rrezikun e kredisë konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 31% të rasteve, një ndikim orientues mbi strategji në 25% të rasteve. Së fundmi, rregulloret mbi rrezikun e likuiditetit konsiderohen në një nivel prej 25% te rasteve me një ndikueshmëri të lehtë dhe në 31% të rasteve me një ndikueshmëri të konsiderueshme mbi strategjinë e specializimit.

f3)Ndikueshmëria mbi strategjinë e diversifikimit

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun e likuiditetit mbi strategjine e diverisfikimit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	6	37.5	54.5	54.5
	Orientuese	2	12.5	18.2	72.7
	Detyruese	3	18.8	27.3	100.0
	Total	11	68.8	100.0	
Missing	System	5	31.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun e kredise mbi strategjine e diverisfikimit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	4	25.0	36.4	36.4
	Ndikim i konsiderueshem	2	12.5	18.2	54.5
	Orientuese	2	12.5	18.2	72.7
	Detyruese	3	18.8	27.3	100.0
	Total	11	68.8	100.0	
Missing	System	5	31.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun operacional mbi strategjine e diverisfikimit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	7	43.8	77.8	77.8
	Orientuese	2	12.5	22.2	100.0
	Total	9	56.3	100.0	
Missing	System	7	43.8		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun e tregut mbi strategjine e diverisfikimit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	4	25.0	44.4	44.4
	Ndikim i konsiderueshem	2	12.5	22.2	66.7
	Orientuese	3	18.8	33.3	100.0
	Total	9	56.3	100.0	
Missing	System	7	43.8		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi ekspozimin bankar mbi strategjine e diverisfikimit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	4	25.0	44.4	44.4
	Ndikim i konsiderueshem	2	12.5	22.2	66.7
	Orientuese	3	18.8	33.3	100.0
	Total	9	56.3	100.0	
Missing	System	7	43.8		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun normes se interesit mbi strategjine e diverisfikimit.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent

Valid	Ndikim i lehte	4	25.0	44.4	44.4
	Orientuese	5	31.3	55.6	100.0
	Total	9	56.3	100.0	
Missing	System	7	43.8		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi veprimtarine valutore mbi strategjine e diverisfikimit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	4	25.0	44.4	44.4
	Orientuese	5	31.3	55.6	100.0
	Total	9	56.3	100.0	
Missing	System	7	43.8		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi mjaftueshmerine e kapitalit mbi strategjine e diverisfikimit.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Orientuese	5	31.3	45.5	45.5
	Detyruese	6	37.5	54.5	100.0
	Total	11	68.8	100.0	
Missing	System	5	31.3		
Total		16	100.0		



Grafiku 6.14 Pesha e ndikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare mbi strategjinë bankare/3

Mund të vëzhgojmë sërish që nuk i kemi asnjëherë të cilësuar si pa ndikim komponentët e rregulloreve ndërkombëtare, ndërkohë që vezhgohet po prapë një miksim dhe peshim shumë më diferencues edhe mbi strategjinë e diversifikimit. Rregullorja mbi mjaftueshmërinë e kapitalit konsiderohet në 31% të rasteve orientuese dhe në 38% të rasteve si detyruese në strategjinë e divesifikimit. Rregulloret mbi veprimtarinë valutore konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve dhe në 38% të rasteve një ndikim orientues mbi strategjinë në fjalë. Rregulloret mbi rrezikun e normës së interesit konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve dhe në 38% të rasteve një ndikim orientues mbi strategjinë në fjalë.

Rregulloret mbi rrezikun e ekspozimit bankar konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve, një ndikim të konsiderueshëm në 12% të rasteve dhe një ndikim orientues mbi strategji në 12% të rasteve. Rregulloret mbi rrezikun e tregut konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve, një ndikim të konsiderueshëm në 12% të rasteve dhe një ndikim orientues mbi strategji në 19% të rasteve. Rregulloret mbi rrezikun operacional konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 44% të rasteve dhe një ndikim orientues mbi strategji në një nivel prej 12% të rasteve. Rregulloret mbi

rrezikun e kredisë konsiderohen të kenë një ndikueshmëri të lehtë në 25% të rasteve, një ndikueshmëri të konsiderueshme në 12% të rasteve dhe një ndikim orientues mbi strategji në po prapë 12% të rasteve. Së fundmi, rregulloret mbi rrezikun e likuiditetit konsiderohen në një nivel prej 38% te rasteve me një ndikueshmëri të lehtë dhe në 12% të rasteve me një ndikueshmëri orientuese mbi strategjinë e diversifikimit.

f4)Ndikueshmëria mbi strategjinë e blerjeve dhe bashkimeve

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun e likuiditetit mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun e kredise mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun operacional mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Detyruese	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun e tregut mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent

Valid	Ndikim i lehte	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi ekspozimin bankar mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi rrezikun normes se interesit mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi veprimtarine valutore mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Ndikim i lehte	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		

Jepni rendesine e ndikimit te indicacioneve mbikëqyrese mbi mjaftueshmerine e kapitalit mbi strategjine e blerjeve dhe bashkimeve.

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Detyruese	3	18.8	100.0	100.0
Missing	System	13	81.3		
Total		16	100.0		



Grafiku 6.15 Pesha e ndikimeve të marrëveshjeve ndërkombëtare mbi strategjinë bankare

Për sa i përket blerjeve dhe bashkimeve kemi një uniformitet mbi mënyrën se si rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare ndikojnë mbi këtë aks strategjik, ndërkohë që duhet cilësuar që shumë pak i janë përgjigjur duke konsideruar kështu që nuk është një aks strategjik i cili nuk është shumë i përqafuar. Për pjesën e përgjigjur, në 100% të rasteve konsiderohet një ndikim i lehtë nga rregulloret mbi veprimtarinë valutore, rregulloret mbi rrezikun e normës së interesit, të ekspozimit bankar, rrezikut të tregut , nga rregulloret e rrezikut të kredisë dhe të likuiditetit. Dhe në po 100% të përgjigje konsiderohet një ndikimi orientues mbi këtë strategji nga rregulloret ndërkombëtare të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të rrezikut operacional.

Sinteza :

Edhe një herë vlen për tu ricilësuar fakti që marrveshjet ndërkombëtare mbeten një bazë orientimi e këshillimi teksa nuk janë kaluar ende në legjislacionin vendas. Në sistemin tonë bankar kemi arritur deri në implementimin e pjesës dërmuese të marrëveshjes Bazel II. *Të intervistuarit e bankave shprehen se nëse do të kishin aplikimuar marrëveshjet ndërkombëtare do të kishin po të njjtat ndikime në akset e ndryshme strategjike,*

pavarësisht aksit, por theksohet që ndikueshmëria është prezente në thuajse të gjitha strategjitë. Në fakt pamë që rasti i mungesës së ndikueshmërisë ishte gati inekzistent.

Pra kryefjala qëndronte ndikueshmëria. Në varësi të strategjisë(më të aplikuara apo jo), të lidhjes së rregulloreve në mënyrë të drejtperdrejtë me të (rregulloret më shumë ndikuese apriori apo jo) apo të menyrës së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të prezencës së mbikëqyrjes ndërkombëtare (nëse ekziston teksi në fjalë në ligjin kombëtar apo influenca mund të vijë nga banka mëmë e një grupi ndërkombëtar) natyrisht që pamë nivele të ndryshme influence apo prezence të mbikëqyrjes ndërkombëtare në fjalë.

Ajo që vlen për tu cilësuar dhe theksuar është ***ekzistenca e ndikueshmërisë së rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare mbi akset strategjike te bankave tregtare shqiptare***, duke zbardhur, qartësuar dhe rikonfirmuar për të disatën here pranimin e **Hipotezës 3**, dhe fakti i ndikueshmërisë së vetme të përmendur, asaj të Bazel III, edhe pranimi paraprak i **Hipotezës 4**.

g) Cilat janë kufizimet që ju shihni në këto indikacione të mbikëqyrjes ndërkombëtare?

A shihni ju kufizime nga keto indikacione mbikëqyrese nderkombetare ne hapesirat vendimmarrese?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	11	68.8	73.3	73.3
	Po	4	25.0	26.7	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A shihni ju kufizime nga keto indikacione mbikëqyrese nderkombetare ne strategjine e investimit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	10	62.5	66.7	66.7
	Po	5	31.3	33.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		

A shihni ju kufizime nga keto indikacione mbikëqyrese nderkombetare ne strategjine e investimit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	10	62.5	66.7	66.7
	Po	5	31.3	33.3	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A shihni ju kufizime nga keto indikacione mbikëqyrese nderkombetare ne menaxhimin e aktiveve/pasiveve?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	8	50.0	53.3	53.3
	Po	7	43.8	46.7	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A shihni ju kufizime nga keto indikacione mbikëqyrese nderkombetare ne marrjen e rrezikut?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	15	93.8	100.0	100.0
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A shihni ju kufizime nga keto indikacione mbikëqyrese nderkombetare ne ekspozimin kombetar/nderkombetar?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	12	75.0	80.0	80.0
	Po	3	18.8	20.0	100.0
	Total	15	93.8	100.0	
Missing	System	1	6.3		
Total		16	100.0		

A shihni ju kufizime nga keto indikacione mbikëqyrese nderkombetare ne ndonje aspekt tjeter?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid		15	93.8	93.8	93.8
	NUK MARRIN PARASYSH KUSHTET DHE KLIMEN E BIZNESIT SIPAS VENDEVE TE NDRYSHME	1	6.3	6.3	100.0
	Total	16	100.0	100.0	



Grafiku 6.16 Kufizimet që shihen në rregulloret ndërkombëtare

Pikat më të nxehta në të cilat indikacionet mbikëqyrëse ndërkombëtare kufizojnë janë pikërisht strategjitë e investimit me një pjesë të konsiderueshme të tregut prej 44%, më pas vjen marrja e rrezikut me 31%, kemi hapësirat vendimmarrëse me 25%, menaxhimi i aktiveve/pasive konsiderohet i kushtëzuar nga rregulloret ndërkombëtare për 19% të rasteve dhe në vend të fundit vjen ekspozimi kombëtar/ndërkombëtar në nivelin 6%. Të gjithë komponentët e prekur i përkasin një aksi të caktuar strategjik, dhe në varësi të popullaritetit të atij aksi vendoset edhe ndikimi i gjerë apo jo i mbikëqyrjes. *Kryqëzimi i*

tendencave strategjike dhe strategjive të ndikueshme tregojnë rëndësinë e lartë të ndikimit të mbikëqyrjes në strategji duke na fortësuar pranimin e **Hipotezës 3**.

h) Cilat ndryshime do të dëshironit të propozonit?

Cilat ndryshime do te deshironit te propozonit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Lehtesimin	2	12.5	16.7	16.7
	Ndryshime sipas kontekstit ekonomik kombetar	7	43.8	58.3	75.0
	Ndryshime sipas tregut bankar kombetar	3	18.8	25.0	100.0
	Total	12	75.0	100.0	
Missing	System	4	25.0		
Total		16	100.0		



Grafiku 6.17 Ndryshimet e dëshiruara mbi marrëveshjet ndërkombëtare

Pavarësisht ndikimeve me raste kushtëzuese, vumë re që marrëveshjet ndërkombëtare janë shumë ndihmëse, ja ku shprejgohet kjo gje nëpërmjet dëshrës për ndryshimin e tyre e absolutisht jo heqjes së tyre. Sa për lehtësimin siç e pamë në raportin mbikëqyrje kombëtare-ndërkombëare, disa prej rregulloreve e normave të mbikëqyrjes sonë kombëtare rrezultojnë më strikte ndaj lehtësimi nuk qëndron (llogjike). Ndërkohë problematikat e nxjerra më parë riverifikohen duke konluduar në nevojën e adaptimit të tyre me kontekstin ekonomik kombëtar në nivelin 44% dhe adaptimi sipas tregut bankar kombëtar në 19% të rasteve. Këto rezultate janë shumë pozitive dhe shprehin dëshirën absolute të bankave shqiptare për tu përafruar me legjislacionin dhe tregun bankar ndërkombëtar.

i) Në prespektivë me integrimin drejt marveshjes Bazel III, si e shihni ju ndikimin e mundshëm mbi strategjinë bankare?

Ne prespektive me integrimin drejt Bazel III si e shihni ju ndikimin e mundshem mbi strategjine bankare?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Me ndikim ne ndryshimin e pjesshem te strategjise	11	68.8	100.0	100.0
Missing	System	5	31.3		
Total		16	100.0		



Grafiku 6.18 Ndikimet që priten në prespektive implementimi të Bazel III

Kjo pyetje e drejtpërdrejtë e ndërtuar mbi Hipotezën 4 i thotë tëgjitha! Në fakt vetëm 69% kemi përgjigje por 100% e tyre shprehen në unanimitet se zbatimi/implementimi i paketës ndërkombëtare mbikëqyrëse Bazel III do të sillte ndryshime të pjesshme në strategji. Pra pranojmë **Hipotezën 4**, kjo marrëveshje ndërkombëtare ka ndikueshmëri mbi strategjinë e bankës së tregtare (bankës tregëtare).

j) Në prespektivë me integrimin drejt marveshjes Bazel III, cilët akse strategjike të aktivitetit tuaj bankar do të ndikohen?

Ne prespektive me integrimin drejt marreveshjes Bazel III,a do te ndikohet strategjia bankare e nderkombetarizimit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	7	43.8	43.8	43.8
	Po	9	56.3	56.3	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Ne prespektive me integrimin drejt marreveshjes Bazel III,a do te ndikohet strategjia bankare e specializimit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	16	100.0	100.0	100.0

Ne prespektive me integrimin drejt marreveshjes Bazel III,a do te ndikohet strategjia bankare e diversifikimit?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	9	56.3	56.3	56.3
	Po	7	43.8	43.8	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Ne prespektive me integrimin drejt marreveshjes Bazel III,a do te ndikohet strategjia bankare e blerjeve dhe bashkimeve?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	11	68.8	68.8	68.8
	Po	5	31.3	31.3	100.0
	Total	16	100.0	100.0	

Ne prespektive me integrimin drejt marreveshjes Bazel III,a do te ndikohet nje tjeter strategji bankare?

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo	16	100.0	100.0	100.0



Grafiku 6.19 A do të preken akset strategjike kryesore nga implementimi i Bazel III?

Ka koherencë të plotë me po të njejtën pyetje mbi marrrëveshjet ndërkombëtare në përgjithësi, e duke u nisur nga fakti që kur flasim për to, flasim për Bazel, kalimi në Bazel III i përafrohet totalisht prognozës së bankave mbi ndikueshmërinë potenciale. Në fakt

përveç një pjese të vogël të bankave që nuk preferuan të shprehen për mungesë informacioni të plotë, mbahet e njëjta tendencë ndikueshmërie. Strategjia më e prekur është ndërkobëtarizimi me 56% të rasteve, që natyrshëm dhe logjikshëm prekte e ndikohet nga një marrëveshjë mbikëqyrëse ndërkombëtare, së dyti kemi me 44% të raste strategjinë e diversifikimit, si një strategji shumë e përdorur e cila ka një shtrirje të gjerë si në treg po edhe në inkuadrimin e tregut (pra në nivelin rregullator) ndaj është e prekur kaq në masë dhe së fundi strategjia e blerjeve dhe bashkimeve e cila po është subjekt delikat i rregulloreve që do të thotë do të ishte sërish e ndikuar nga Bazel III. Rezultatet e kësaj pyetje na rijapin dhe na risigurojnë edhe nje here në mënyrë të drejtpërdrejte mbi **Hipotezën 4** duke e pranuar atë.

Përfundimet e kapitullit

Përgjatë këtij kapitulli kemi patur mundësinë të bëjmë një tur të guiduar mbi sistemin bankar shqiptar, duke u nisur nga aktorët e tregut e më pas duke e plotësuar këtë kornizë përmes një analize drejtuar ekspertëve te fushës të cilët janë zgjedhur rastësisht nën sistemit bankar dhe mbikëqyrës, brenda dhe jashtë Bankës së Shqipërisë. Kjo metodë analitike opinioniste e realizuar përmes një interviste cilësore ndihmon për të ilustruar sa më mirë situatën aktuale të tregut financiar e bankar si dhe për të kuptuar më mirë rolin e Bankës së Shqipërisë dhe prognozës në vazhdim të sistemit Përgjatë kësaj interviste ekspertët janë "ngacmuar" për tematike pikante ndaj analiza e përgjigjeve të tyre na mundësoi një imazh më të qartë dhe një ekspertizë më cilësore mbi sitemin bankar dhe atë mbikëqyrës.

Vërehet qartë nevoja për të mbikëqyrur në mënyrë të strukturuar e strikte sistemin bankar në mënyrë që të sigurohet besimi në të, harmonia dhe fluiditeti i kalimit të fondeve. Kuptuam nga kjo analizë pozicionin e fortë të sisteimit tonë bankar përballë krizës, pozicion i cili i duhet në pjesë të madhe edhe rregullatorit, Bankës së Shqipërisë, për sistemin mbikëqyrës e qartë strikt por natyrisht efektiv për mbajtjen e harmonisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit.

Globalizimi i aktivitetit bankar kërkon që edhe strukturat e mbikëqyrjes të globalizohen, pra të kemi si një qëndërzim të vendimmarrjes globale në nivelin e mbikëqyrjes edhe një delegim i të njëjtës bazë mbikëqyrëse në çdo nivel kombëtar. Ekspertët në unanimitet konsiderojnë mënyrën indirekte të prekjes së sistemit tonë bankar nga kriza financiare globale, dhe po ashtu bien dakort për masat konservatore të ndërmarra për të siguruar situatën dhe më pas për të stimuluar përmirësimin e saj. Një pikë shumë e rëndësishme e nxjerrë prej ekspertëve është pikërisht shkalla e ndikimit në modelin e biznesit të bankave. Në fakt, përcaktohet shumë qartë edhe prej tyre që implementimi i mbikëqyrjes dhe rregulloreve prudenciale ka një penetrim të qartë dhe të thellë në modelimin e sjelljes së bankës pra të menaxhimit të saj strategjik për frontiera të reja përfitueshmërie dhe stabiliteti.

Nën këto ripërsëritje të llogjikës së ndikueshmërisë së paketave mbikëqyrëse kombëtare apo ndërkobëtare mbi strategjinë bankare kalojmë më pas në analizën empirike e cila na jep përgjigjë për çdo pyetje të ngriturtë e na mundëson kështu të japim një vendim mbi hipotezat e ngritura. Kalojmë në mënyrë kronologjike sipas radhës së vetë hipotezave në kërkimin e së pari perceptimit të mbikëqyrjes në tëresi, më pas ndikueshmërisë dhe vlerësismit të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi sistemin tonë bankar dhe mbikëqyrës për të kaluar së fundmi në thelbin e kërkimit tonë mbi linjën e ndikueshmërisë mbikëqyrje bankare në strategji bankare qoftë kjo së pari në nivelin kombëtar së dyti në nivlin ndërkombëtar e së treti në detajimin e mbikëqyrjes përmes marrëveshjes ndërkombëtare të mbikëqyrjes Bazel III. Shkallë pas shkalle të gjithë hipotezat ka gjetur përjgigjen e tyre duke na mundësuar një prarim të plotë të sistemit të tyre e duke na dhënë mundësinë kështu në një mirëkuptim më të thelle e të detajuar të shtrirjes së “tentakulave” të rregulloreve mbikëqyrëse e prudenciale në aktivitetin e bankave tregëtare në Shqipëri.

KAPITULLI VII: KONKLUZIONE

7.1 Përmbledhje E Studimit

Bankat kanë qenë tradicionalisht të rregulluara dhe mbikëqyrura nga vendet e tyre. Në vitet e fundit, përparimet në teknologji dhe komunikime kanë ulur koston e shërbimeve bankare për distancat e mëdha, duke përfshirë shërbimet bankare edhe përtej kufijve kombëtarë. Me rritjen e kërkesës për shërbime të tilla, bankat janë zgjeruar përtej kufijve kombëtarë si fizikisht edhe virtualisht duke kryer biznes përtej kufijve. Në përgjigje të këtij trendi, shumë nga shqetësimet e njëjta që çuan qeveritë të rregullojnë bankat vendase kanë shtyrë në rritjen e presionit për rregullimin dhe harmonizimin ndërkombëtar bankar.

Bankat kanë pranuar gjithnjë e më shumë se metodat tradicionale të menaxhimit të rrezikut janë bërë të vjetëruara (mbi të gjitha nga bazuar në krizat e pësuara të cilat nuk janë mundur të evitohen) dhe se nevojiten masat e reja të nevojshme për të vlerësuar rrezikun e instrumenteve të reja financiare. Objektivi i reduktimit të rrezikut në tregjet financiare komplekse ka çuar në diversifikimin e të ardhurave të bankës, që kanë rritur aktivitetin bankar ndërkombëtar. Kjo ka sjellë për pasojë që shumë banka të përdorin instrumente të reja financiare për të diversifikuar të ardhurat midis disa vendeve në mënyrë që, në bazë vjetore, duke balancuar nga në anë humbjet në prezencën në një shtet nga fitimet nga prezenca në një shtet tjetër. Operacionet e zgjeruara dhe të larmishme bankare ndërkombëtare kërkojnë kondesimin në një bazë të përbashkët të standardeve mbikëqyrëse dhe rregullatore të cilat të jenë të njohura e të pranuara nga rregullatorët e mëdhenj financiar botëror. Për më tepër, këto standarde kryesore ndërkombëtare kërkojnë mbikëqyrje efektive ndërkombëtare për të zvogëluar rrezikun sistemik.

Hapi i parë për arritjen e mbikëqyrjes ndërkombëtare efektive është prezenca e një autoriteti ndërkombëtar për të lehtësuar koordinimin efektiv të përgjegjësive kombëtare

rregullatore dhe për të promovuar standardet minimale dhe normat e praktikës së mirë për mbikëqyrjen e veprimtarive bankare ndërkombëtare.

Këtu vjen në "shpëtim" BIS me krijiin e BCBS i cili që prej marrëveshjes se vitit 1988, ka patur qëllimi adresimin e kufizimeve dhe problemeve me të cilat ballafaqohej sistemi bankar si në nivlein kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Marrëveshja Bazel I pati si qëllim përgjigjen kundrejt problemit të harmonizimit të rregullatorëve si dhe të rreziqeve të marrë në konsideratë për të llogaritur vlerën e kapitalit për tu mbajtur/ruajtur. Por kjo marrëveshje ka patur kufizimet e veta, provuar ga dështimi i sitemit në atë kohë. Në fakt matja e rrezikut kishte mangësi të dukshme. Për këtë pamjaftueshmëri të rregullatorit ekzistueses, lindi Bazel II që mori në konsiderate mangësitë e të parit, por fatkeqësisht as kjo marrëveshje nuk ishte e mjaftueshëm. Edhe Basel II mbështetej në përdorimin e metodave të vlerësimit të rrëzikut bazuar në sasi kapitali, nga ku shihej një mbivlerësim i zërave të kapitalit, pra cilësisë e tij. Kriza e rradhës riçoi në nevojën e rishikimit të marrëveshjes, e jemi sot në marrëveshjen Bazel III, e cila adresoi të gjithë kritikat e të mëparshmeve dhe ka ofruar plot risi si cilësore edhe sasiore.

Kjo marrëveshje është karakterizuar kryesisht nga një ripërkufizim i kapitalit, si dhe futjen e jastëkëve kundërciklik dhe raporteve të likuiditetit. Megjithatë, kjo marrëveshje është larg nga të qënit e përsosur. Është për t'u vlerësuar që rregullimi bankar ka evoluar, në bazë të këtij trendi, bankat janë përshtatur dhe kanë gjetur mënyra të reja për të shmangur rritjet e konsiderueshme në kapitalin e tyre, duke përfshirë sigurimin e kredive. Pavarësisht nga teprimet në sigurimin e kredive, rregullimi bankar ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë i dobishëm për të zgjidhur problemet e identifikuara në sistem.

Gjithashtu, del një tjetër pyetje: a do ta shkatëronte mbikëqyrjen një mbi dozë rregulloreje ? Duke analizuar efektet e Bazel III, mund të konkludojmë se Bazel III është i kushtueshëm në afat të shkurtër, por në afat të gjatë ajo do të "paguajë". Megjithatë, që kjo marrëveshje të jetë më efektive, duhen zhvilluar masa për bankat sistemike dhe institucionet "fantazmat". Së fundi, theksohet se efektet e paraqitura janë vlerësime të bazuara në arsyetim ekonomik, sepse nuk kemi patur ende kohën e mjaftueshme për

tëvëzhguar çdo të ndodhë në realitet. Kështu, Bazel III është një kuadër shumë më i rreptë dhe më i qëndrueshme rregullator në nivelin global, por, si do të impaktojë Bazel III sitemin dhe aktivitetin bankar, më specifikisht, strategjinë bankare si target të analizes sonë?

Duke patur fokusin mbi bankat, mund të përmbledhim tendencat e tipologjitë e ndryshme të strategjisë bankare ndërkombëtare, të shohim se strategjitë e përbashkëta janë miratuar nga grupet kryesore bankare apo nga një përqindje gjeografike e konsideruaeshme ndërkombëtare. Përtej karakteristikave kombëtare, konkludojmë në shfaqjen e katër llojeve bankave në nivelin ndërkombëtar :

Bankat kombëtare ; Bankat rajonale ; Bankat universale ;(si në gamë produktesh dhe në shtrirje); Bankat e specializuara (në një ose disa produkte apo shërbime) . Ndërkohë për sa i përket strategjive më dominuese mund të themi që kemi një karakterizim strategjik të përbashkët në drejtimet e Specializimit, Ndërkombëtarizimit, Specifikim, Folkusim, Segmentim. Nga analizat e literaturës, teorisë dhe ballafaqimet e rregulloreve me sjelljen potenciale të bankës në përgjigje të tyre e sidomos nga emergjenca e një pakti të ri lind pyetja : "Si ta përcakotjmë influencën e standarteve ndërkombëtare rregullatore bankare mbi modelin e biznesit të bankës e strategjisë së saj?".

Le të shtjellohemi më shumë, kjo do të thotë të kuptojmë pikë së pari penetrimin e këtyre rregulloreve e më pas të vëzhgojmë se si këto të fundit ndikojnë në nivelin e strategjisë së bankës duke indentifikuar kështu një "ndërhyrje" në nivele orientuese, kushtëzuese, detyruese apo ndonjë formë tjëter e perceptuar prej banakve. Është e rëndësishme të përcaktohet pra nëse ekziston një korrelacion i tillë mes vektotir të variablave mbikëqyrëse e prudenciale dhe vektorit të sjelljes banakre. Për këtëështë realizuar një analizë relacionale midis këtyre dy sferave, ku, nëpërmjet kryqëzimit të tyremarrim informacion mbi:

- Njohjen dhe penetrimin e mbikëqyrjes ndëkombëtare
- Perceptimi nga ana e bankave
- Ndikimet e veçanta të mbikëqyrjes

- Mundësitë apo kufizimet e rregullatoreve mbikëqyrëse
- Prespektivat mbi Bazel III

Le të përshkojmë një përmbledhje cilësore të analizës empirike në mënyrë që të rifreskojmë informacionin e përthithur. Së pari mund të nisim nga rëndësia e rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare, rëndësi e cila do të na mundësojë të mirëkuptuojmë vendin e tyre me kalimin e kohës. Sipas të dhënave mund të konkludojmë se rëndësia e rregulloreve mbikëqyrëse pranohet unaninmisht që ka qënë në rritje, kjo për arsye të ndryshme ku pjesa dërmuese e bankave mendojnë se vjen si rrezultat i krizave financiare dhe me më pak përfshirje si rezultat i trendeve bankare, pra zhvillimit të aktivitetit bankar, ku rregulloret e ndjekin atë në mënyrë skrupuloze. Ka një përqindje modeste të bankave që mendojnë edhe përafrimin me rregulloret ndërkombëtare si të jetë arsye e rritjes së vëmendjes së tyre.

Në të vërtetë shkaqet e rritjes së kësaj rëndësie burojnë prej faktit qe rregulloret janë hartuar për të plotësuar hapjen e nevojave të ekonomisë dhe kërkesave të standarteve ndërkombëtare të sigurisë bankare sepse ndjekja e kontekstit global për të lehtësuar integrimin e bankave në sferën e financave ndërkombëtare është tejet e rëndësishme duke marrë parasysh faktin e përqindjes së lartë të prezencës së bankave të huaja në vend.

Në krahasim me rregulloret ndërkombëtare shohim qërregulloret mbikëqyrëse e prudenciale shqiptare janë midis dy marrëveshjeve Bazel ndërkohë që për elementët kryesorë të mjaftueshmërisë së kapitalit ka rregullore edhe më strikte. Pra në fakt kritika apo elementi që bankat e vendeve të tjera vënë në dukje, norma e lartë e kapitalit rregullator nuk do të jetë një problem nga ana e bankave shqiptare për vetë faktin se kanë mbajtur një nivel të lartë dhe ndryshimet e propozuara nga Bazel III tashmë konvergjojnë. Arsyet e tendencës në konformitetin me rregulloret ndërkombëtare e sidomos atë Bazel cilësohen të jenë:kërkimi perpetual i fazimit me komunitetin ndërkombëtar, hapja e ekonomisë dhe prezenca e bankave të huaja, globalizimi dhe mondializimi financiar si dhe përafrimi me marrëveshjen e Bazel për tu përgatitur për konkurencën ndërkombëtare. Por duhet ditur që fakti i të qënit miks rrjedhon nga vonesa në implementim në kohë reale me rregulloren e momentit dhe sistemin financiar e bankar shqiptar që është gjithashtu larg të

qënit një sistem i zhvilluar me prezencë të të gjithë diversitetit të produkteve e shërbimeve ndërkombëtare.

Atëherë, në bazë të rezultateve të nxjerra mund të kuptojmë që rregulloret mbikëqyrëse e prudenciale kanë njohur një zhvillim të madh, zhvillim i cili ka kaluar nëpër faza të ndryshme të përputhshme me boom-e zhvillimi të aktivitetit bankar, me kriza financiare apo me përmirësimin e rregulloreve ndërkombëtare. Vëmë re që rregulloret ndërkombëtare njihen dhe vlerësohen. Në fakt vëzhgohet një sistem mbikëqyrës kombëtar miks, i cili ka një prije të qartë drejt rregulloreve ndërkombëtare për nivelin e tyre të mirë dhe barazpeshimin e kërkesave bankare me tregun ndërkombëtar. Kjo analize e komponentit të parë na mundëson ti japim një përgjigje pozitive Hipotezës 1, pra "Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare njihen, vlerësohen dhe konsiderohen optimale nga bankat kombëtare".

Zhvillimi i mbikëqyrjes është i konsiderueshëm në përqindjen më të madhe të tregut, ku arsyet e vetë zhvillimit i kemi cilësuar më lartë, ndërkohë që për një pjesë të vogël të bankave konsiderohet madje një ndryshim i shpejtë. Shpejtësia e zhvillimit të tyre në fakt shpjegohet shumë mirë nga pozita e vendit tonë si një vend emergjent, sepse në përgjithësi rregulloret mbikëqyrëse e prudenciale konsiderohen të jenë "një kantier ndërtimi" në vendet emergjente. Struktura dhe teknologjia që e karakterizon sistemin tonë bankar tregon mirë pse nuk ka patur shpejtësi maksimale. Në të vërtetë, autoritetet në tregjet në zhvillim duhet të përfshihen në harmonizimin ndërkombëtar të rregullimit mbikëqyrës e prudencial, por edhe duhet të marrin kohë për të gjetur një mekanizëm që përshtatet me procesin e veçantë të sistemeve bankare kombëtare. Në Shqipëri, progresi në rregullore është bërë, por disa çështje mbeten për t'u zhvilluar dhe ritmi i zhvillimit në përgjithësi ndjek karakteristikat e ekonomisë dhe strukturën e tregut financiar vendas.

Mund të shohim më qartë këto ndryshime përmes rrezultateve të përftuara ku me unanimitet rregulloret mbi raportin e likuiditetit dhe shpërndarjes/diversifikimit së rrezikut kanë pësuar ndryshime. Ndërkohë kemi një rritje të konsiderueshme të ndjesisë së ndryshimit të të gjithë rregulloreve. Pjesa dërmuese e tregut bankar shqptar deklarojnë se

ka ndryshime në rregulloren mbi raportin e solvabilitetit, në rrëgulloren mbi rrezikun operacional, dhe akoma më shumë për një ndryshim në rregulloren e rrezikut të kredisë, një përqindje e lartë që na tregon peshën reale të kësaj rregulloreje në fjalë. Pra mund të vëzhgojmë që në bazë të eksperiencës dhe të modeleve të reja të menaxhimit të rrezikut kemi një zhvillim dhe metamorfozë të përgjithshme të rregulloreve duke vënë theks mbi konceptet e reja të rrëzikshmërisë dhe "shkarjeve" potenciale të sistemit bankar në kriza e kolapse.

Ndërkohë kur paralelizojmë regulloret vendase me ato ndërkombëtare fatkeqësisht kemi një shpërndarje të lartë por konotacioni është paksa negaiv për sa i përket rregulloreve vendase. Mbi gjysma e bankave të pyetura mendojnë se rregulloret vendasejanë kushtëzuese, ndërkohë një pjesë me e vogël e bankave të pyetura por me një pjesë tregu më të lartë i konsiderojnë rregulloret shqiptare ende të paqarta, me nota të tendencave strikte. Rregulloret ndërkombëtare nga ana tjetër shihen në mënyrë të njëjtë nga të gjithë bankat duke u konsideruar si adapte me situatën financiare, kjo nga ideja që përcillet pas përditësimeve të bëra sa herë ka një krizë apo mungesë stabiliteti në tregjet financiare ndërkombëtare. Por pavarësisht kësaj, ndjehet një nocion kushtëzimi edhe prej tyre. Për sa i përket nivelit të disa raporteve të rregulloreve ndërkombëtare ato janë në nivele të ndryshme por nuk duhet harruar se mënyra e përllogaritjes së rrezikut dhe ponderimi i aseteve rrinë kryesisht në nivele të krahasueshme (jemi ne që jemi inspiruar nga modelet e sprovuara ndërkombëtare). Duke i konsideruar më adapte, koherente dhe të ngjashme dhe duke na mundësuar të konkludojmë në një pëlqyeshmëri të rregulloreve ndërkombëtare, të cilat apriori mund ti japin bankës një nivel më të lartë adaptueshmërie me situatën ndërkombëtare ekonomike, por që gjithsesi do ta kushtëzojnëdisi.

Pjesa e dytë e analizës na mundëson të kuptojmë që zhvillimi i rregulloreve mbikëqyrëse ka patur tendencë të drejtohet nga rrepësia e ngurtësia duke i bërë rregulloret më prezente në aktivitetin bankar. Rregulloret mikste midis kombëtareve dhe ndërkombëtareve kanë pësuar një ndryshim të konsiderueshëm thuajse të shpejtë me një inspirim nga rregulloret ndërkombëtare. Ndryshimet e vëzhguara kanë patur si arsye kryesore krizat financiare ndërkombëtare e situatën ekonomike që ka ndjekur. Rregulloret e deklaruara në zhvillim të

vazhdueshëm janë direktivat mbi raportin e likuiditetit dhe mbi diversifikimin e rrezikut. Rregulloret e raportit të solvabilitetit dhe rrezikut të kredisë kanë filluar të kenë një rëndësi më të madhe ndërkohë që kemi edhe regullore të futura rishtazi si direktivat mbi rrezikun operacional, të cilat po marrin një peshë të lartë. Pra marrëveshjet ndërkombëtare shihen në të njëjtën kohë edhe si kushtëzuese por edhe si faktorë të rëndësishëm duke na rikonfirmuar pranimin e Hipotezës së parë dhe duke na orientuar mbi Hipotezën e dytë ("Situatat, tregu bankar ndërkombëtar dhe mbikëqyrja ndërkombëtare kanë ndikimi mbi rregulloret e mbikëqyrjes kombëtare"). Duke na hapur shteg mbi pyetjen: "A ka ndikuar rëndësia e rregulloreve ndërkombëtare në ndryshimet në rregulloret kombëtare? "

Për ti dhënë përgjigje kësaj të fundit është aplikuar analiza dy dimensionale nëpërmjet të cilës kemi ndërthurur këto dy akse. Pra nga njëra anë rëndësinë ë rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare e nga ana tjeter ndryshimet e vëzhguara në të njëjtat periudha kohore. Në sajë të analizës së kryqëzuar mund të kuptopjmë që vetë rritja e rëndësisë së rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare përfaqëson një rëndësi të lartë mbi rregulloret ndërkombëtare duke i parë të ecin paralelisht në shumicën e rasteve e duke nxitur integrimin e direktivave të reja apo matshmërive të ndryshme. Konkludojmë në pranimin e Hipotezës së dytë, "Situatat, tregu bankar ndërkombëtar dhe mbikëqyrja ndërkombëtare kanë ndikimi mbi rregulloret e mbikëqyrjes kombëtare".

Kalojmë ne seksionin e fokusit mbi rregulloret kombëtare për të hulumtuar mbi një stad fillestat mbi hipotezën e tretë. Kur janë vënë përballë alternativave të disa direktivave kryesore mbikëqyrëse mund të vëmë re që ka një pjesë të vogël të bankave të cilat nuk i janë përgjigjur këtij seksioni, ndërkohë që pjesa dërmuese e bankave të intervistuara, mbi 68.8% shprehen mbi një njohje dhe zbatim të thuajse të gjithë rregulloreve të sipërpërmendura[61], së pari për natyrën e detyrueshme të shumicës prej tyre, së dyti për orientimin që ato ofrjojnë e së treti për uniformizim të disa parametrave duke krijuar kushte të barabarta konkurence në treg. Të vetmet rregullore të cilat janë subjektive dhe jo të detyrueshme, kuptohen nga përqindja e ulët e zgjedhjeve të tyre,janë administrimi i rrezikut në veprimtarinë e degëve të bankave të huaja dhe bashkëveprimi me subjektet

[61]Shih Shtojcën 6, Pyetësori, në seksion Nr.5

jobanka[62]. Kuptojmë kështu një shtrirje të detajuar, insistuese e skrupoloze të Bankës së Shqipërisë në mbarëvajtjen dhe sigurinë e aktivitetit bankar në tregun tonë.

Opinioni i bankave përmblidhet atëherë nga fakti që gjithë rregulloret janë të aplikueshme në të gjthë sistemin bankar që sheshon diferencimet dhe tenton për konkurueshmëri të drejtë. Modelet e llogaritjes dhe të menaxhimit të rrezikut janë të vlerësueshme dhe e ndihmojnë bankën. Këto rregullore sigurojnë përgjithësisht një menaxhim e prudencë më të lartë nga ajo që do të kryente në mënyrë spontane një bankë duke harmonizuar dhe stabilizuar sistemin financiar. Inspirimi i rregulloreve kombëtare nga ato ndërkombëtare ka ofruar një besim më të lartë duke u mbështetur kështu në modele më të sprovuara dhe të përparuara, modele të cilat kanë patur mundësinë të testojnë suksesin apo dështimin e tyre duke qënë sa më të përditësuara dhe të kujdeshme.

Një pjesë prej 6% e të intervistuarve deklarojnë se nuk kanë patur absolutisht pengesa nga ana e rregulloreve mbikëqyrëse, 93.8% e tyre deklarojnë që nuk kanë patur pengesa nga rregulloret mbi disiplinën e tregut dhe ato mbi raportet e solvabilitetit të bankës. Ndërkohë rregulloret të cilat kuotohen si penguese të aktivitetit bankar janë pikërisht me 25% të rasteve rregulloret mbi administrimin e rrezikut të kredisë, me po 25% të rasteve rregulloret mbi raportet e likuiditetit dhe rregullorja e cila konsiderohet më penguesja në absolut është me 43.8% të rasteve rregullorja mbi mjaftueshmërinë e kapitalit. Eshte e qartë që konsiderata e parë mbi Bankën e Shqipërisë, pavarësisht vlerësimit që i bëhet punës së saj, është kushtëzimi ligjor me të cilin kjo e fundit i vendos para faktit të gjithë bankat e nivelit të dyte. Ndërkohë ka një përqindje të lehtë bankash që përveç kushtëzimit konsiderojnë edhe ndihmën por edhe ndikim e bankës në aktivitetin e tyre,ndikim i cili ritregon sërish incidencën mbi aktivitetin e bankës duke mbështetur kështu përpilimin e bazës së hipotezave të hartuara mbi optikën ndërkombëtare të mbikëqyrjes.

Cfarë mund të vëmë re për sa i përket vendosjes së strategjisë nga ana e bankave është se ka rënë në maksimum me kalimin e kohës tendenca e strategjive agresive ku 75% janë përgjigjur negativisht dhe pjesa tjetër nuk është shprehur, si dhe tendencat e strategjive

[62]Rishtazi banka e Shqipërisë ka përditësuar rregulloret për këto tematika. Vendimi Nr.63 datë 14.11.2012 dhe Vendim Nr.2 datë 17.01.2013.

impulsive ku 81% janë përgjigjur negativisht dhe po prapë pjesa tjetër nuk është përgjigjur. Kemi një rritje të ndjeshme në ndjekjen e strategjive të bazuara mbi sitituata të ngjashme kombëtare me 62.5% në favor të tyre dhe të situatave ndërkombëtare me po 62.5% në favor të tyre. Pra shohim një tendencë në hapjen drejt modelit ndërkombëtar dhe tashmë kuptojmë një sheshim të agresivitetit në treg duke përfaqësusar kështu një stabilizim dhe maturi të numrit të bankave në treg.

Pra në varësi të periudhës, fillestare apo më tej, këmi patur tendenca të ndryshme që kanë motivuar, induktuar apo orientuar strateginë në fjalë. Atëherë kur tregu nuk kishte shumë konkurencë dhe hapja me tregun ndërkombëtar nuk qe e lartë, strategjia ka qënë kryesisht në varësi të situatës kombëtare. Me kalimin e kohës, shtimin e bankave si numër, hapja me marrëdhëniet ndërkombëtare, prej vetë faktit që bankat që operojnë janë pikërisht pjesë grupesh të mëdha ndërkombëtare, bënë që edhe akset strategjike të influencohen prej tyre e të ketë agresivitet në treg për instalimin e një peshe sa më të mirë për secilën bankë. Ndërkohë që në ditët e sotme, së pari për arsye të sheshimit të konkurrencës në treg, të konsolidimit të pjesëve të tregut që zenë bankat që operojnë si dhe lëvizjeve të shumta në menaxhimin ndërkombëtar të sistemit bankar, kanë induktuar në tregun tonë përshtatjen jo vetëm me situatën kombëtare por edhe me atë ndërkombëtare duke dhënë peshë direktivave të jashtme. Përfundim i cili na dha mundësinë rikonfirmojmë sërish pranimin e Hipotezëssë dytë (Situatat, tregu bankar ndërkombëtar dhe mbikëqyrja ndërkombëtare kanë ndikimi mbi rregulloret e mbikëqyrjes kombëtare).

Analizës së mësipërme i vjen në mbështetje mënyra e ndryshimit të strategjisë së bankës, ku kemi një nivel prej 62.5% të bankave që shprehen për një ndryshim të strukturuar të strategjisë bankare, jo pak por 12.5% e tyre shprehen që e kanë ndryshuar totalisht strategjinë,ndërkohë që 25% deklarojnë për një ndryshim të pjesshëm. Gati gjysma e të intervistuarve nuk kanë shtjelluar më tej, ndërkohë që vëmë re 25% të bankave, që përfaqësojnë 45% e të përgjigjurve shprehen për ndryshime të përvitshme të cilat janë adaptuar në raport me grupin e bankës mëmë. 12.5% e bankave të intervistuara,që përfaqësojnë23% e të përgjigjurve shprehen për një ndryshim si në bazë të grupit edhe në bazë të zhvillimit të kushteve të tregut të brendshëm. Dhe së fundmi, kemi një nivel prej

18.8% e bankave të intervistuara,që përfaqësojnë 32% e të përgjigjurve shprehen vetëm për ndryshime për shkak të tregut ndërkombëtar. Pra kuptojmë që me kalimin e kohës pesha e strukturës së tregut ndërkombëtar, e situatave të ndryshme ekonomike ndërkombëtare e natyrisht kuadri ligjor e mbikëqyrës ndërkombëtar kanë patur një ndikim mbi motivimin strategjik të aktivitetit bankar shqiptar. Përfundim i cili na dha mundësinë ti përgjigjemi Hipotezës së tretë ,"Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare kanë ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare",pozitivisht.

Ndërkohë mund të vëzhgojmë që deri në ditët e sotme ndryshimet në rang kombëtar e ndërkombëtar, krizat financiare si dhe konsolidimi i tregut bankar kanë bërë që zgjedhja strategjike të ketë një shumllojshmëri burimi. Në fakt në 68.8% të rasteve zgjedhja strategjikë është bazuar mbi ristrukturimin në bazë të rregulloreve makro prudenciale e mbikëqyrëse, në 56.3% të rasteve kemi madje një kushtëzim prej tyre, së treti në 25% të rasteve kemi një zgjedhje strategjie të bazuar mbi përdorimin optimal të burimeve dhe së fundmi me 12.5% kemi një zgjedhje tëbazuar mbi krijimin e një avantazhi konkurues si dhe opsion arsyeje tjetër për të cilën të intervistuarit nuk janë shprehur.

Vetë zhvillimi i sistemit bankar shqiptar ka bërë që, që në gjenezat e tij e deri në vitet 2000 bankat kanë qënë minimalsite e janë mjaftuar me përdorimin e burmive të tyre, më pas deri në vitet 2004 janë treguar më agresive e të interesuara të përthithin pjesë të tregut por me kalimin e kohës dhe sidomos pas krizave financiare të ndjera në nivel ndërkombëtar agresiviteti u shëndërua në zvogëlim e mirëmenaxhim të rrezikut ndërkohë që edhe Banka e Shqipërisë, e cila i ka përforcuar dhe përditësuar rregulloret si nga eksperienca kombëtare edhe ajo ndërkombëtare, ka luajtur një rol dhe një drejtim kryesor në zgjedhjen stratregjike. Orientimi apo ndikimi i mbikëqyrjes ndërkohë mund të vërejmë që vlerësohet më shumë të jetë një ristrukturim i zgjedhjes strategjike sesa një kushtëzim i saj.

Siç mund ta merrnim shumë mirë me mend, që deri në ditët e sotme shumë parametra kanë ndryshuar, si në tregun bankar, si në situatën ekonomike dhe natyrisht edhe në nivelin e mbikëqyrjes, pra akset që kanë patur deri tani një influecë kanë dryshuar dhe mund të vëzhgojmë që faktori më influencues sot deklarohet të jenë së pari autoritet publike

nëpërmjet mbikëqyrjes bankare me 56.3% të të intervistuarve që deklarojnë këtë, së dyti me 43.8% faktor influencues ka qënë konteksti ekonomik ndërkombëtar e së treti me 25% iniciative e bankierëvë. Ndërkohë vëzhgojmë se ka lindur një ndikues i ri, marrëveshjet ndërkombëtare mbikëqyrëse, në nivelin 18.8% e të intervistuarve që deklarojnë këtë influencë dhe së fundi konteksti ekonomik kombëtar e cili nuk lihet i papërfillur me 12.5%. Ja ku del sërish në pah ndikimi i rregulloreve mbikëqyrëse të cilat jo vetëm orientojnë e kushtëzojnë aktivitetin bankar, por bëhen tashme motivim i strategjisë bankare. Kjo taktikë në fakt aplikohet me largpamësi për të mos rënë ndesh me rregulloret mbikëqyrëse dhe në këtë mënyrë integrohen që në zgjedhjet strategjike.

Pra ky rezultat është tejet i rëndësishëm duke rimbështur Hipotezën e dytë dhe Hipotezën e tretë mbi rëndësinë dhe incidencën e situatave, tregut ndërkombëtar dhe rregulloreve të mbikëqyrjes dhe makro prudencës mbi strategjinë bankare si dhe mbi modelin e biznesit bankar.Gjithashtu është futur në lojë edhe konteksti ndërkombëtar i cili natyrisht merret parasysh për pasojë e çrregullime që kanë ndodhur të cilat transmetohen nga politikat e grupit dhe të bankave mëmë si dhe përditësimeve edhe në optikën mbikëqyrëse ndërkombëtare.

Nëse drejtohemi nga njohuritë që kanë bankat për sa i përket marreveshjeve të ndryshme ndërkombëtare niveli i përgjigjeve të dhëna nuk është shumë i lartë, ndërkohë që 80% e përgjigjeve drejtohen nga marrëveshja ndërkombëtare e Bazelit, një nivel prej 20% i të përgjigjurve apo 12.5% e totalit të kampionit tonë kanë cilësuar të njohin gjithashtu edhe marrëveshjet e Financial Stability Board.Për vetë faktin e mbështetjes në plot raste të vetë mbikëqyrjes kombëtare në marrëveshjen e Bazelit, kuptohet që në rastin e një pengese potenciale kemi pikërisht marrëveshjen Bazel që do të provokojë këtë të fundit. Në fakt, kemi vetëm 25% të përgjigjur, ku të gjithë janë përgjigjur për marrëveshjen e Bazel, pa evokuar asnjë marrëveshje tjetër si penguese të aktivitetit bankar.Dhe në fakt është pikërisht jo adaptueshmëria e plotë e marrëveshjes me tregun tonë, apo e parë nga jashtë e tregut tonë me marrëveshjen në fjalë që sjell një barrë penguese në aktivitetin bankar kombëtar. Komponentë të shumtë të tregut financiar, produkteve, kanaleve ndërmjetëse e

kështu me rradhë janë komponentë që nuk janë plotësisht prezent në tregune Shqipërisësiçjanë në rastin e tregjeve ndërkombëtare të cilat zbatojnë marrëveshjen Bazel.

Kjo situatë sjell atëherë mospërpuethshmëri midis strukturave target të marrëveshjes mbikëqyrëse në fjalë dhe strukturës së tregut tonë bankar. Përkrah mund të përmendim gjithashtu edhe kategorizimin si jo pjestarë të BE, kategorizim i cili mbivlerëson parametrat e ponderuar me një rrezikshmëri më të lartë si vend. Këtu zbulohet një dynjëzim interesant i cili bën dallimin midis bankave të cilat kanë një tendencë ndërkombëtarizimi ndaj ndihen të prekura, e nga ana tjeter bankat që veprojnë shumë lokalisht e ndaj nuk ndihen të prekura nga këto marrëveshje, që vlen ta cilësojmë nuk janë të detyrueshmë në fakt për askënd pa kaluar në ligjet e vendit përkatës, ndaj për sa kohë një pjesë e mire e tyre nuk janë në paketën mbikëqyrëse të legjitimuar nga Banka e Shqipërisë nuk kanë një efekt të drejtpërdrejtë.

Cka mund të vëzhgojmë është përqëndrimi i pengesave në nivelin 37.5% të rasteve nga strukturimi i kapitalit si dhe raportet e likuiditetit ndërkohë që ndiqen modestisht në nivelin 12.5% nga pengesat në strategji, rezultat i cili tregon një ndikueshmëri në strategji edhe pse ky prezantohet si një pengesë, duke na ndihmuar në përgjigje për Hipotezën e tretë.

Pavarësisht mungesës së bazës ligjore të marrëveshjeve ndërkombëtare ato kanë një ndikim të ndjeshëm në aktivitetin bankar shqiptar. Në fakt, 56.3% deklarojnë se marrin ndihmë për menaxhimin e rrezikut nga marrëveshjet ndërkombëtare. 31.3% deklarojnë se ndihmohen me orientime ndaj rrezikut dhe në nivelin strategjik. 12.5% konsiderojnë ndihmë në vendosjen e standarteve të njëjta dhe rritjen e sigurimit të investitorëve. Pra në të shumtën e rasteve këto marrëveshje janë shumë ndihmuese. Natyrisht që bëhët fjalë për kryesoren marrëveshjen Bazel, ku siç e pamë më parë ishte e vetmja që ishte e njohur për të gjithë kampionin, dhe e vetmja e cilësuar si ndikuese, qoftë ky ndikim i kategorizuar pengues apo ndihmues.

Ky rrezultat na mundëson të pranojmë plotësisht Hipotezën 1, Hipotezën 2, Hipotezën 3 dhe na mundëson një përgjigje ndaj Hipotezës 4. Qoftë ky ndikim i pjeshëm apo i plotë nuk ka dyshime që marrëveshjet ndërkombëtare kanë ndikim mbi strategjinë e bankës së

tregtare në sistemin bankar shqiptar. Në fakt, mungojnë 2 përgjigje ndërkohë që në 100% të rasteve të përgjigjura kemi një ndikim, mbi nivelin strategjik të aktivitetit bankar. Arsyet janë të ndryshme, por mosndikueshmëria prej tyre përjashtohet. Ndërkohë vlen të cilësohet se më shumë peshon ndryshimi i pjesshëm i strategjisë me 64.3% të rasteve, se sa pesha prej 35.7% që deklaron një ndryshim të plotë të strategjisë. Ky rezultat na rikonfirmon edhe një herë pranimin e Hipotezës së tretë.

Le të përmbledhim në vazhdim ndikueshmëritë më të detajuara mbi aktivitetin bankar dhe akset strategjike të zgjedhura. Motivimi mbi akset strategjike ka ndryshuar, vëmë re një ulje në nivelin 12.5% të blerjeve dhe bashkimeve duke rikonfirmuar një stabilizim të tregut në lëvizjet e tilla. Vërejmë një ulje të tendencave në specializim nga niveli 31.3% në 25% duke përfaqësuar kështu një numër të vogël bankash që kërkojnë fokus të ngushtë në specializimin e produkteve e shërbimeve të tyre. Ndërkohë rritet ndejshëm tendenca në aksin strategjik të diversifikimit nga 31.3% në 75%, një rritje e cila tregon qartë edhe sjelljen menaxhuese e transmetuese të rrezikut duke diversifikuar aktivitetin e portofolin bankar. Së fundi vëmë re që një pjesë prej 43% deklarojnë në një aks të ri strategjik, atë të ndërkombëtarizimit. Pra mund të vërejmë që me kalimin e kohës spektri ndërkombëtar bëhet gjithnjë e më shumë atraktiv në strukturë dhe drejtim të aktivitetit bankar. Nga kjo pjesë e pyetësorit mundëm të vëmë në dukje përtej tendencave më të fundit ndërkombëtare mbi akset strategjike se cili ka qënë zhvillimi ndër vite i akseve strategjike të ndjekura dhe cilat janë akset strategjike aktuale të cilat përbëjnë interes për aktivitetin bankar duke veçuar kështu diversifikimun dhe ndërkombëtarizimin. Studimi i mëtejshëm i këtyre akseve nën influencat e mbikëqyrjes mund të na japë një matshmëti mbi ndikim konkret të rregulloreve ndërkombëtare duke na mundësuar ti japim përgjigje Hipotezës së tretë dhe më pas për më shumë detaj Hipotezës së katërt (Marreveshja ndërkombëtare mbikëqyrëse Bazel III ka ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare).

Dukshëm, rregulloret mbikëqyrëse dhe makro prudenciale nga shumica e të intervistuarve deklarohen të kenë impakt mbi strategjinë e investimit si një komponent direkt strategjik. Së dyti ndikim mbi ekspozimin kombëtar/ndërkombëtar, si aks strategjik dhe model strategjik i parapëlqyer, së treti është kushtëzimi i hapësirave vendimmarrëse (mund të jetë

edhe vendimmarrje strategjike) dhe së fundmi kemi të deklaruar ndikimin në menaxhimin e aktiveve/pasiveve të bankës.

Mbi strategjinë e ndërkombëtarizimit, asnjë rregullore nuk është konsideruar pa ndikim. Në mënyrë të përshkallëzuar mund të vëzhgojmë që kemi një ndikim të lehtë të rregulloreve të rrezikut operacional, të rrezikut të tregut, të rrezikut të ekspozimit bankar, të rrezikut të normës së interesit dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit. Vërejmë se kemi një ndikueshmëri të konsiderueshme të rrezikut të likuiditeit, kemi gjithashtu ndikueshmëri orientuese për rregulloret e likuiditetit, kredisë, mjaftueshmërisë së kapitalit dhe rrezikut operacional. Ndërkohë në po të njëjtin nivel kemi një ndikueshmëri detyruese të rregulloreve të rrezikut të tregut, ekspozimit bankar, normës së interesit, dhe veprimtarisë valutore. Pra kuptojmë që mbi strategjinë e ndërkombëtarizimit rregulloret mbikëqyrëse kanë ndikim të dynjëzuar midis nivleit të ndikimit të konsiderueshëm dhe atij orientues. Fakti i prezencës të nivelit detyrues për disa nga rregulloret na bën të kuptojmë akoma më shumë ndikueshmërinë në fjalë.

Strategjia e specializimit është shumë e përdorshme në tregun bankar shqiptar. Eksremet në detyrueshmëri apo pa ndikueshmëri nuk janë prezente. Vëmë re që pjesa dërmuese deklarojnë për një ndikueshmëri të lehtë dhe një ndikueshmërie të konsiderueshme. Dy rregulloret më ndikuese janë mjaftueshmëria e kapitalit në ndikim të lëhtë dhe rregullat mbi rrezikun e kredisë në ndikim të konsiderueshëm. Ky rrjedh nga fakti i vetë specializimit të disa bankave në kreditim të ekonomisë, ndaj edhe strategjia e tyre ndikohet në nivele të larta dhe është pikërisht lloji i strategjisë së përdorur në masë që sjell nivelin sa do të vogël apo të lartë të ndikimit.

Edhe për strategjinë e diversifikimit, e përdorur sërish në masë në tregun bankar shqiptar kemi një shpërndarje shumë të lartë të rëndësisë së ndikimit në strategji nga rregulloret mbikëqyrëse. Në fakt shpërndarja në këtë rast është e larmishme. Pa ndikim gjejmë rregullat mbi veprimtarinë valutore dhe ato mbi rrezikun e likuiditetit (të cilat a priori nuk kanë pse të kenë ndikim mbi diversifikimin).Vihet re një ndikim i lehtë i ndikueshmërisë së rregulloreve mbi rrezikun operacional. Me ndikueshmëri të konsiderueshme mbi

strategjinë e diversifikimit spikasin rregulloret mbi rrezikun e kredisë, së dyti rregulloret mbi rrezikun e ekspozimit bankar, së treti vëmë re ndikueshmërinë e rregulloreve mbi rrezikun operacional, rregulloret e veprimtarisë valutore dhe mjaftueshmërisë së kapitalit. Ndërkohë këmi një përfshirje më të lartë në nivelin orientues të ndikimit të rregulloreve mbi strategjinë e diversifikimit. Në fakt spikat influenca e rregulloreve mbi rrezikun e normës së intersit dhe veprimtarisë valutore e rregulloret e rrezikut të kredisë. Po të kalojmë në nivelin detyrues vëmë re ndikueshmëri të rregulloreve mbi rrezikun e likuiditetit. Mund të themi më bindje së të gjithë komponëntët pavarësisht shkallës së rëndësisë ndikojnë në këtë strategji, polarizimi i rëndësisë luhet mes orientimit dhe ndikimit të konsiderueshëm. Pra kuptojmë që edhe kjo strategji sërish e përhapur në tregun bankar shqiptar ka një nivel të lartë të influencës nga rregulloret mbikëqyrëse.

Blerjet dhe bashkimet janë një strategji e përdorur vetëm nga 33% e tregut bankar. Këto banka që e përdorin deklarojnë një dynjëzim mes mungesës së ndikueshmërisë dhe ndikimit të lehtë në strategjinë në fjalë, gjithashtu vëmë re një pjesë shumë të vogël që deklarojnë detyrueshmëri mbi strategjinë e blerjeve dhe bashkimeve nga rregulloret mbi rrezikun e kredisë, atë operacional dhe të mjaftueshmërisë së kapitalit. Pra kuptojmë që në këtë aspekt nuk kemi incidencë të lartë rregulloreve mbi strategjinë në fjalë.

Edhe strategjia e ekspasionit nuk është aq e përhapur, madje bankat e shprehura mbi të deklarojnë që rregulloret kryesisht kanë një ndikim të lehtë ose të konsiderueshëm në strategji ndërkohë që shumë pak prej tyre thonë që nuk kanë aspak ndikim. Niveli që deklaron prekje prej tyre mbi këtë strategji mbetet 12.5%. Sërish pra me një aks strategjik jo shumë i “shqetësuar” nga rregulloret mbikëqyrëse.

Për sa i përket analizës së kryer, secila bankë është shprehur për strategjinë që ajo përdor. Një pjësë shumë e vogël e tregut e konsideron detyruese ndikueshmërinë e rregulloreve mbikëqyrëse mbi këto strategji, një pjesë shumë e konsiderueshmë ndërkohë deklaron një ndikueshmëri të lehtë ose të konsiderueshme por ndihet një aks ndikueshmërie mbi strategjitë e zgjedhura duke u bazuar mbi faktin që pyetja ka qënë mbi impaktin mbi strategjinë. Qëllimi i kësaj analiza pra, ka patur për qëllim identifikimin e strategjive më të

influencuara nga rregulloret mbikëqyrëse. Në fakt, rezultoi qe strategjitë më të influencuara janë edhe strategjitë më të përdorura nga bankat e sistemit tonë bankar, strategjia e specializimit dhe ajo e diversifikimit, rezultate të cilat na risjellin sërish në afirmimin e ndikimit të mbikëqyrjes mbi strategji.

Po ti shohim në një këndvështrim global mund të veçojmë pra që në një nivel prej 37.5% ndikimet e rregulloreve mbi strategji japin një modifikim të pjesshëmt të strategjisë. Në vend të dytë me një nivel prej 25% kemi dynjëzimin mes mungesës së ndikimit dhe ndikueshmërisë që çon në një ndryshim të plotë të strategjisë. Rikonfirmojmë një incidencë mes strategjisë dhe mbikëqyrjes në pjesën dërmuese të bankave duke na riorientuar drejt një korrelacioni mbi të cilin ndërtohen hipotezat e punimit, më në veçanti Hipoteza e tretë (Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare kanë ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare).

Për sa i përket ndryshimeve që bankat do të dëshironin të propozonim vëzhgojmë që pjesa më e madhe e tregut bankar në nivelin 44% shprehen për ndryshime sipas kontekstit ekonomik ndërkombëtar, 38% e tyre shprehen për ndryshime sipas kontekstit ekonomik kombëtar, dhe 31% shprehen për ndryshime sipas tregut bankar kombëtar dhe vetëm 25% shprehen mbi lehtësimin e tyre, por gjithsesi kryefjala qëndron “ndryshimi”, duke kuptuar dhe nënkuptuar shkallën e penetrimit të tyre në modelin dhe aktivitetin bankar. Duke u fokuasuar më pas mbi se si kanë evoluar strategjitë dhe sjellja bankare kemi vënë re që në periudhat më të afërme përgjigjet shumohen duke mos patur kështu mungesa e duke spostuar totalisht shkaqet e motivimit të sjelljes bankare larg rastësisë. Në fatk 100% e bankave nuk shprehen më për këtë komponent. Ulet përqindja e bankave që e kundërshtojnë rrezikun nga 37.5% në 12.5% duke i lënë vend sjelljes që trajtojnë rrezikun. Së pari kemi një rritje të pjesës së bankave që zhgjedhin një sjellje bankare të tërhequr nga rreziku nga 12.5% në 25%. Nga niveli 25% të sjelljes bankare menaxhuese të rrezikut kemi kaluar në një nivel prej 62.5%. Dhë së fundi kemi daljen në sipërfaqe të atyre bankave që zgjedhin ta transmetojnë rrezikun, më një nivel prej 37.5 %. Me kalimin e viteve pra, qasja përkundrejt rrezikut ka kaluar një metamorfozë. Në fillimet e sistemit bankar kemi një stepje kunderjt rrezikur e duke mbizotëruar kështu një sjellje e rastësishme, më pas kemi

një tërheqje masive drejt tij, ndërkohë që në ditët e sotme shohim që tendenca e tërheqjes sikur qëndron e fortë por "plotësohet" nga qasjet e menaxhimit apo transmetimit të rrezikut. Atëherë lind pyetja nëse kjo metamorfozë e qasjes ndaj rrezikur vjen si pasojë e rregulloreve mbikëqyrëseapo jo. Atëherë, realizuam një analizë të kryqëzuar për të kuptuar më mirë incidencën midis këtyre dy tematikave.

Vëzhgojmë që me kalimin e kohës me rritjen e rëndësisë së mbikëqyrjes ndërkombëtare ka ndryshuar qasja ndaj rrezikut, në momentet kur mbikëqyrja ka patur një nivel konstant të rëndësisë së saj vërejmë momente të sjelljes së rastësishme apo kundërshtuese ndaj rrezikut. Ndërkohë me konfirmimin e rritjes së rëndësisë së saj asgjësohet mundësia e një qasjeje të rastësishme duke u zëvendësuar me transmetimin, menaxhimin e deri në tërheqjen ndaj rrezikut duke konkluduar në këtë mënyrë e duke rikonfirmuar edhe përfundimet e mëparshme mbi mbikëqyrjen ndërkombëtare e cila perceptohet dhe aplikohet nga një anë si faktor optimizues dhe nga ana tjetër si faktor kushtëzues i cili në këtë rast kategorizohet si ndikues në qasjen përkundrejt rrezikut.

Aksi dydimansional që lidh gjykimet mbi rëndësinë e mbikëqyrjes dhe influencën e saj në zgjedhjen strategjike, rrezulton që në ditën e sotme të ketë një incidencë duke anuar më shumë në ristrukturim se sa në kushtëzim ndërkohë që po në këtë drejtim përtej gjykimit të mbikëqyrjes si e ngurtë kemi edhe peshën që ze fakti i të qënit mbikëqyrje e inkuadruar. Pra jemi drejtuar në mbështetje të llogjikës së hipotezave tona, ku ngremë një bazë rëndësie të rregulloreve mbikëqyrëse së pari kombëtare, së dyti ndëkombëtare e së fundmi konkretisht e marrëveshjes së mbikëqyrjes ndëkombëtare Bazel III.

Vëzhgojmë se 100% deklarojnë që rëndësia e mbikëqyrjes ndërkombëtare është rritur, në këtë mënyrë duke e lidhur edhe me dimensionin e dytë, të ndikueshmërisë së saj në ristrukturimin apo kushtëzimin e zgjedhjes strategjke mund të konkludojmë që në 73% të rasteve kryqëzimi i rëndësisë së rritur të mbikëqyrjes ndërkombëtare jep ndikueshmërinë e saj mbi ristrukturimin e strategjisë bankare. Ndërkohë si dhe në rastin e mbikëqyrjes kombëtare, 60% lidhin rritjen e rëndësisë së saj me kushtëzimin në zgjedhjen strategjie të bankës. Kjo analizë dy dimensionale na mundësoi pikërisht të veçojmë dhe cilësojmë një

lidhje direkte midis rritjes së rëndësisë së rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare dhe zgjedhjes strategjike të cilat ristrukturohen ose deri në kushtëzohen nga këto të fundit. Ky rezultat ndihmon në rikonfirmimin e pranimit të Hipotezës së tretë (Indikacionet dhe rregulloret e mbikëqyrjes ndërkombëtare kanë ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare), dhe natyrshëm një kalim mbi pranimin e Hipotezës së katërt (Marreveshja ndërkombëtare mbikëqyrëse Bazel III ka ndikim në strategjinë e bankave tregtare shqiptare),për sa i përket aktualitetit të mbikëqyrjes ndërkombëtare nën Bazel III[63].

Pjesa në vazhdim e analizës dy dimensionale na mundëson të veçojmë dhe cilësojmë një lidhje direkte midis gjykimit të zhvillimit të mbikëqyrjes kombëtare në të ngurtë apo inkuadruar dhe transformimit të autoriteteve publike përmes rregullave mbikëqyrëse në faktor influencues të strategjisë bankare. Ky rezultat ndihmon në kuptimin e një aksi ndikueshmërie midis rregulloreve mbikëqyrëse dhe strategjisë bankare duke nga lejuar të hulumtojmë në një shkallë më lartë, në raport me rregulloret ndërkombëtare dhe ndkikueshmërinë e tyre. Më tej kjo analizë na mundësoi të veçojmë dhe cilësojmë një lidhje direkte midis rëndësisë së mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe transformimit të autoriteteve publike përmes rregullave mbikëqyrëse në faktor influencues të strategjisë bankare. Ky rezultat na ndihmon drejtpërdrejt në përgjigje pozitive mbi Hipotezën e tretë, dhe mbi Hipotezën e katërt. Në fakt kemi një nivel prej vetëm 25% të cilët realizojnë një lidhje të drejtpërdrejtë midis rritjes së rëndësisë së rregulloreve ndërkombëtare dhe transformimit të tyre në një faktor influencues. Nuk është një nivel i neglizhueshëm, ndërkohë që është e natyrshme që kur kërkohet ndikimi i drejtpërdrejtë ai nuk mund të jetë totalisht i prekshëm për sa kohë sistemi bankar shqiptar nuk është nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë ndërkombëtare, por kjo influencë është e tërthortë dhe ka një kohë amortizimi pak më të lartë sesa në vendet e tjera duke qënë se fillimisht duhet të kalojë në marrje në kosideratë nga Banka e Shqipërisë, të kalojë nëpër filtrat e adaptimit me rregulloret kombëtare e më pas të ketë influencën mbi tregun bankar e strategjitë bankare.

[63]Duke marrë parasysh që Bazel III është pikërisht marrëveshja ndërkombëtare mbi mbikqyrjen bankare në fuqi aktualisht.

Vlen për tu ricilësuar fakti që marrveshjet ndërkombëtare mbeten një bazë orientimi e këshillimi teksa nuk janë kaluar ende në legjislacionin vendas. Në sistemin tonë bankar kemi arritur deri në implementimin e plotë të marrëveshjes Bazel II. Të intervistuarit e bankave shprehen se nëse do të kishin implementuar marrëveshjet ndërkombëtare do të kishin po të njjtat ndikime në akset e ndryshme strategjike, pavarësisht aksit, por theksohet që ndikueshmëria është prezente në thuajse të gjitha strategjitë. Në fakt pamë që rasti i mungesës së ndikueshmërisë ishte gati inekzistent. Pra kryefjala qëndronte ndikueshmëria. Në varësi të strategjisë (më të aplikuara apo jo), të lidhjes së rregulloreve në mënyrë të drejtperdrejtë me të (rregulloret më shumë ndikuese apriori apo jo) apo të mënyrës së drejtpërdrejtë apo të tërthortë të prezencës së mbikëqyrjes ndërkombëtare (nëse ekziston teksi në fjalë në ligjin kombëtar apo influenca mund të vijë nga banka mëmë e një grupi ndërkombëtar) natyrisht që pamë nivele të ndryshme influence apo prezence të mbikëqyrjes ndërkombëtare në fjalë.

Pikat më të nxehta në të cilat rregulloret mbikëqyrëse ndërkombëtare kufizojnë janë pikërisht strategjitë e investimit me një pjesë të konsiderueshme të tregut prej 44%, më pas vjen marrja e rrezikut me 31%, kemi hapësirat vendimmarrëse me 25%, menaxhimi i aktiveve/pasive konsiderohet i kushtëzuar nga rregulloret ndërkombëtare për 19% të rasteve dhe në vend të fundit vjen ekspozimi kombëtar/ndërkombëtar në nivelin 6%. Të gjithë komponentët e prekur i përkasin një aksi të caktuar strategjik, dhe në varësi të popullaritetit të atij aksi vendoset edhe ndikimi i gjerë apo jo i mbikëqyrjes. Kryqëzimi i tendencave strategjike dhe strategjive të ndikueshme tregojnë rëndësinë e lartë të ndikimit të mbikëqyrjes në strategji duke na fortësuar pranimin e Hipotezës së tretë. Pavarësisht ndikimeve me raste kushtëzuese, vumë re që marrëveshjet ndërkombëtare janë shumë ndihmëse, ja ku shprejgohet kjo gje nëpërmjet dëshirës për ndryshimin e tyre e absolutisht jo heqjen e tyre. Sa për lehtësimin siç e pamë në raportin mbikëqyrje kombëtare-ndërkombëare, disa prej rregulloreve e normave të mbikëqyrjes sonë kombëtare rrezultojnë më strikte ndaj lehtësimi nuk qëndron (llogjike). Ndërkohë problematikat e nxjerra më parë riverifikohen duke konluduar në nevojën e adaptimit të tyre me kontekstin ekonomik kombëtar në nivelin 44% dhe adaptimi sipas tregut bankar kombëtar në 19% të rasteve.

Këto rezultate janë shumë pozitive dhe shprehin dëshirën absolute të bankave shqiptare për tu përafruar me legjislacionin dhe tregun bankar ndërkombëtar. Kjo pyetje e drejtpërdrejtë e ndërtuar mbi Hipotezën katër i shpreh të gjitha! Në fakt pavarësisht se kemi vetëm 69% e të intervistuarve, me një mbulim të tregut bankar mbi 75%, kemi 100% të tyre që shprehen në unanimitet se zbatimi/implementimi i paketës ndërkombëtare mbikëqyrëse Bazel III do të sillte ndryshime të pjesshme në strategji. Pra pranojmë Hipotezën e katërt, kjo marrëveshje ndërkombëtare ka ndikueshmëri mbi strategjinë e bankës së tregtare.

Ka koherencë të plotë me po të njejtën pyetje mbi marrrëveshjet ndërkombëtare në përgjithësi, e duke u nisur nga fakti që kur flasim për to, flasim për Bazel, kalimi në Bazel III i përafrohet totalisht prognozës së bankave mbi ndikueshmërinë potenciale. Në fakt përveç një pjese të vogël të bankave që nuk preferuan të shprehen për mungesë informacioni të plotë, mbahet e njëjta tendencë ndikueshmërie. Strategjia më e prekur është ndërkombëtarizimi me 56% të rasteve, që natyrshëm dhe logjikshëm preket e ndikohet nga një marrëveshjë mbikëqyrëse ndërkombëtare, së dyti kemi me 44% të raste strategjinë e diversifikimit, si një strategji shumë e përdorur e cila ka një shtrirje të gjerë si në treg po edhe në inkuadrimin e tregut (pra në nivelin rregullator) ndaj është e prekur kaq në masë dhe së fundi strategjia e blerjeve dhe bashkimeve e cila është subjekt delikat i rregulloreve që do të thotë do të ishte sërish e ndikuar nga Bazel III. Rezultatet e kësaj pyetje na rijapin dhe na risigurojnë edhe nje here në mënyrë të drejtpërdrejte mbi Hipotezën e katërt duke e pranuar atë.

Ajo që vlen për tu cilësuar dhe theksuar është ekzistenca e ndikueshmërisë së rregulloreve mbikëqyrëse ndërkombëtare mbi akset strategjike të bankave tregtare shqiptare, duke zbardhur, qartësuar dhe rikonfirmuar për të disatën here pranimin e ndikueshmërisë së marrveshjeve ndërkombëtare e me specifikiaht të Bazel III duke na konfirmuar pranimin e hipotezës dhe nën hipotezave të studimit.

7.2 Përfundime Dhe Rekomandime

Nën termat e këtij punimi, kemi evidentuar rëndësinë dhe impaktin e rregulloreve mbikëqyrëse mbi strategjitë bankare, duke studiuar kështu pasojat që rezultojnë. Studimet teorike kombëtare e ndërkombëtare kanë përqafuar plotësisht llogjikën që përcakton ekzistencën e një impakti të mbikëqyrjes mbi strategjinë bankare. Mëgjithatë, çdo rrugë e kërkimit ka qënë e karaterizuar nga reflektime të mirë përcaktuara specifike për to.

Ky impakt që karakterizon strategjinë dhe mbikëqyrjen është trajtuar dhe studiuar në mënyrë të ndryshme. Disa autorë shprehen për influencën e rëndësishme të mbikëqyrjes mbi orientimet strategjike, të tjerë na bëjnë të besojmë që nuk janë veçse sekondare apo të pa rëndësishme në kuadrin strategjik. Ndërkohë që kemi autorë të tjerë të cilët kanë vendosur theksin mbi këtë lidhje, duke zhvilluar forma të ndryshme të ndërveprimit midis dy variablave. Nën këtë optikë, ambicja e kërkimit ka qënë indentifikimi dhe përcaktimi i impaktit të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi strategjinë e bankës dhe të tentojmë të veçojmë pasojat e shkallën e ndikueshmërisë.

Në bazë të analizës empirike të realizur në kuadër të këtij studimi mund të konkludojmë në pranimin e hipotezës së punimit ***H: Nëse mbikëqyrja ndërkombëtare bankare, në bazë të marrëveshjes Bazel III, do të implementohet në sistemin bankar në Shqipëri, atëherë do të kemi një ndikim mbi strategjinë e aktivitetit të bankave tregtare shqiptare.***

Tanimë, pas procedimit të hetimeve të ndryshme, këmi mundur të konstatojmë në mënyrë empirike dy periudha të ndryshme të analizës sonë. Hipotezat e modelit që përcaktojnë faktin e ndikimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi strategjinë bankare e cila ka qënë e pranuar për periudhën pas 2004-2008. Përgjatë kësaj periudhe, për shkaqe të zhvillimeve ekonomike e financiare ndërkombëtare, është vënë re një rritje akoma më e madhe e rëndësisë dhe prezencës së rregulloreve mbikëqyrëse sidomos pas krizës së vitit 2008. Përditësimi dhe përmirësimi i këtyre rregulloreve, por natyrshëm edhe dëshira për tu

përafruar me to bëjnë që bankat e sistemit shqiptar ti përqafojnë e të interesehon për arsye nga më të ndryshmet drejt këtyre rregulloreve.

Janë vënë re pika të përbashkëta dhe të ndryshme në raport me studimin teorik dhe praktikën ndërkombëtare. Divergjencat janë vëzhguar kryesisht si pasojë e specifikave të sistemit bankar dhe ekonomise sonë kombëtare, që nënkuptojmë më pas heterogjenitetit e sjelljes bankare dhe të agjentëve ekonomik. Mund ta përmbledhim si më poshtë:

Aksi kërkimor	**Elementët e përbashkët**	**Elementët dallues**
Gjeneza e mbikëqyrjes	Arsye rregullimi dhe nevoje për promovimin e fortësisë e stabilitetit financiar	Natyra e sistemit bankar kombëtar
Shkaqet e evoluimit të mbikëqyrjes	Ndërkombëtarizimi i tregjeve, pamjaftueshmëri dhe rrjedhje të konstatuara në rregulloret ekzistuese	Krizat dhe dështimet e bankave
Normat kryesore	Konvergjencë mbi normën e solvabilitetit, përllogaritjet e RWA	Norma e mjaftueshmwrisë së kapitalit më e lartë
Specifikat strategjike	Tendeca ndërkombëtarizimi dhe blerje e bashkimesh	Diversifikim dhe specializim si pasojë e tregut të vogël.
Evoluimi strategjik	Banka universale	Specializimi

Tabela 7.1 Përballja teori vëzhgim mbi akset kërkimore

Këto indentifikime e të përbashkëtave dhe dallimeve na mundësojmë realizmin e një krahasimi tjetër mes teorisë, praktikës ndërkombëtare dhe rastit shqiptar për impaktet kryesore që spikasin.

Impakti	Në teori	Në praktikën ndërkombëtare	Në rastin shqiptar
Mbikëqyrja detyron diversifikimin	+	+	+
Mbikëqyrja orienton specifikimmin	+	+	+
Mbikëqyrja orienton ndërkombëtarizimin	+	+	+-
Mbikëqyrja orinton blerjet e bashkimet	+	+	+--

Tabela 7.2 Përballja teori praktikë ndërkombëtare dhe rast shqiptar mbi nivelin e impaktit[64]

Në kushtet e skenarëve, është vënë re pra një ngjashmëri midis studimeve teorike dhe empirike. Kjo ngjashmëri ilustrohet nga fakti se impakti nga standardet ndërkombëtare në strategji është verifikuar në disa raste, pavarësisht shkallës së penetrimit. Cilado qoftë natyra e skenarëve, ne mund të tregojmë kështu ekzistencën e një ndikimi të rregulloreve ndërkombëtar mbi strategjinë e bankës.

Në të vërtetë, në cilido stad të marrëveshjes, Bazel II apo Bazel III, rregulloret mbikëqyrëse do të detyrojnë bankat kundrejt një orientimi strategjik për divesrifikim, por gjithashtu do të orientojnë e ndikojnë edhe në akse të tjera strategjike. Në fakt i gjithë studimi i përshkrimit të pyetësorit super të ngarkuar me informacion mbi mbikëqyrjen dhe strategjinë bankare, nuk na solli veç informacion sipërfaqësor por gërmoi më thellë në ndërlidhje dhe rikonfirmime direkte apo indirekte të impaktit të shumë folur.

[64] Ku + do të thotë që po, +- do të thotë po, por nuk e orienton, ka një influencë të konsiderueshme, dhe +-- do të thotë që ka një influencë më të lehtë.

Sado i dobishëm të jetë, studimi i këtij impakti është pasuruar edhe me analizë më fine të bazuar mbi akse të tjera reflektimi që mundësojnë një vlerësim më të mirë dhe pertinent të evolimit të mundshëm të këtij impakti. Në fakt, prirja drejt Bazel III dhe trendit në rritje të bashkimeve bankare pët të cilat jemi dëshmitarë si dhe tendenca drejt zhvillimit të bankingut universal mund të formulojnë plot element të tjerë interesant për një hulumtim në vazhdimësinë e studimit tonë. Pas gjithë analizës së kryer përmes këtij studimi vëzhgohet qartë rëndësia e lartë që i atribuohet mbikëqyrjes. Tendencat ndërkombëtare drejt unifikimit të tregut e natyrisht legjislacioneve dhe mbikëqyrjes përkatëse na lënë të mendojmë që orientimi dhe adaptimi drejt tyre është e vetmja rrugë.

Në bazë të këtij studimi mund të sugjerojmë sa më poshtë:

- **Do të isht shumë e dobishme edhe për Bankën e Shqipërisë të akselerojë hapat e saj drejt krijimit të paktën në bazë legjislacioni rregullimin e elementëve dhe produkteve që ende nuk janë pjesë e tregut bankar shqiptar në mënyrë që të evitojë dështime e problem të mundshme duke mësuar kështu nga ekperiencat ndërkombëtare.**

- **Në fakt rekomandimi më i mirë për çdo bankë do të ishte krijimi i një njësie të adaptimit dhe të ardhmes mbikëqyrëse në mënyrë që të studiojnë sa më mirë elementët dhe të lësohën të përgatisin produktet shërbimet dhe çdo strukturë të tyrën që në gjenezë me keto rregulla të reja.**

- **Bankat të cilat zgjedhin strategjinë e diversifikimit dhe specifikimit duhet të jenë shumë të kujdeshme e të interesohen paraprakisht mbi paketën e plotë te rregullores Bazel III në mënyrë që t'i paraprinë ndryshime të përcaktuara në rregullore, qoftë nëse duan ti përafrohen me tej atyre apo të konsiderojnë në avancë ndryshimin e zgjedhje strategjike.**

- **Bankat të cilat zgjedhin strategjinë e ndërkombëtarizimit, duhet të dinë që do të ketë ndikime orientuese përkundrejt zbatimit të kësaj strategjie ndaj informimi i parakohshëm do t'i shërbente si një mbrjtje kundrejt**

ndryshimeve të mënjëhershme të kërkuara në rast implementimi të marrëveshjes Bazel III.

- **Për sa i përket zgjedhjes strategjike të blerjeve dhe bashkimeve, Bazel III nuk paraqet të ketë në tregun bankar shqiptar një ndikim të lartë, që do të thotë implementimi i kësaj marrëveshjeje nuk do ti përballte bankat që e zgjedhin këtë strategji me ndryshime të mëdha deri t'i detyronte në heqjen dorë prej saj.**

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Abrams, R. dhe Taylor,M. (2000). Issues in the Unification of Financial Sector Supervision. IMF Working Paper WP/00/213.

Acemoglu, D. Johnson,S. dhe James R. (2002). Reversal of Fortune: Geography and Institutions in the Making of the Modern World Income Distribution. Quarterly Journal of Economics 107,1369-401.

Acemoglu, D. Johnson, S. dhe James R. (2005). Institutions as a Fundamental Cause of Long Run Growth. In Handbook of Economic Growth, edituar nga P. Aghion dhe S. Durlauf. Amsterdam: Elsevier.

Allen, F. dhe Gale, D. (2000). Comparing Financial Systems, TheMIT Press.

Allen, L. dhe Saunders, A. (2002). Credit risk measurement. New approaches to Value at risk and other paradigms. Edicioni i dytë. John Wiley & Sons, Inc. New York.

Andrianova, S., Demetriades,P. dhe Shortland, A. (2002). State Banks, Institutions and Financial Development. Department of Economics, University of Leicester. Discussion Paper Nr. 02/13.

Antonious, R. (2003). Interpreting Quantitative Data with SPSS. Sage

Arestis, Ph. dhe Demestriades, P. O. (1998).Financial development and economic growth : Assessing the evidence. The economic journal 107,783-799.

Aron, J. (2000). Growth and Institutions: A Review of the Evidence. The World Rank Research Observer 15(1), 99–135.

Arnone, M. dhe Gambini, A. (2007). Financial supervisors architecture and banking supervision.në Masciandaro dhe Quintyn, Designing financial supervision institutions : Independence accountability and governance. Cheltenham.

Asogwa, R. (2006). Global Financial Regulatory Harmonization, Central Banks' Supervisory Effectiveness and Macroeconomic Performance in the West African Monetary Zone (WAMZ) Countries: Analyzing the Role of Institutional Factors. 7th Global Development Network Annual Conference, St Petersburg, Rusi.

Bae, K., Kang, J.K. dhe Lim, Ch.W. (2002). The Value of Durable Bank Relationships: Evidence from Korean Banking Shocks. Journal of Financial Economics 64,181-214.

Bain, E. dhe Harper, I. (1999). Integration of Financial Services: Evidence from Australia. Paper presented at the Bowles Symposium, Georgia State University, AT, 9–10.

Banlaoi, R. (2004). Globalization and Nation-Building in the Philippines: State Predicaments in Managing Society in the Midst of Diversity. In Growth and Governance in Asia, edituar nga Sato, Y. Hawaii: Asia-Pacific Center for Security Studies.

Barro, R. (1998). Determinants of Economic Growth. Cambridge, MA: MIT Press.

Barth, J. R., Caudill, S. B., Hall, Th. dhe Yago, G. (2000). Cross-Country Evidence on Banking Crises: Do Financial Structure and Bank Regulation Matter? në Bank

Fragility and Regulation: Evidence from Different Countries, Research in FinancialServices: Private and Public Policy, George G. Kaufman, 3-23. JAI.

Barth, J., Caprio,G. dhe Levine, R. (2001). The Regulation and Supervision of Banks Around the World: A New Database në Integrating Emerging Market Countries into the Global Financial System, e Robert E. Litan and Richard Herring, Brookings- Wharton Papers on Financial Services, Washington, D.C.: Brookings Institution Press, 183-240.

Barth, J., Dopico,L. G., Nolle, D. dhe Wilcox, J. A. (2002). An International Comparison and Assessment of the Structure of Bank Supervision, në Financial Regulation: A Guide to Structural Reform, e Jan-Juy Lin and Douglas Arner, Hong Kong: Sweet & Maxwell, 57-92.

Barth, J., Nolle, D., Phumiwasana, T. dhe Yago, G. (2002). A Cross-Country Analysis of the Bank Supervisory Framework and Bank Performance.Economic and Policy Analysis, Office of the Comptroller of the Currency, Washington DC. Working Paper 02-2.

Barth, J.,Nolle, D., Phumiwasana, T. dhe Yago, G. (2003). "A Cross-Country Analysis of the Bank Supervisory Framework and Bank Performance.Financial markets, institutions and instruments Volumi 12 No 2.

Barth, J. R., Caprio, G. dhe Levine, R. (2006). Rethinking Bank Regulation: Till Angels Govern? New York: Cambridge University Press, 428-442.

Barth, J. R., Caprio, G. dhe Levine, R. (2007). Bank Regulations are changing: But for Better or Worse? World Bank Discussion Paper, 4646, The World Bank.

Barth, J. R., Caprio, G. dhe Levine, R. (2012). The evolution and impact of bank regulations. Policy Research Working Paper Series 6288, The World Bank.

Barth, J. R., Caprio,G. Jr. dhe Levine, R. (2013). Bank Regulation and Supervision in 180 Countries from 1999 to 2011, National Bureau of Economic Research Inc, NBER Working Papers 18733.

Basel Committee for Banking Supervision . (2006). Basel II: International convergence of capital measurements and capital standards. BIS.

Basel Committee for Banking Supervision . (2010). 80th Annual report . BIS.

Basel Committee for Banking Supervision . (2011). 81th Annual report . BIS.

Basel Committee for Banking Supervision . (2012). 82th Annual report . BIS.

Basel Committee for Banking Supervision . (2013). 83th Annual report . BIS.

Basel Committee for Banking Supervision . (2011). Basel III: A global regulatory framework for more resilient banks and banking system. BIS.

Basel Committee for Banking Supervision . (2011) .The transmition channels between the financial and real sectors: a critical survey of the literature. BCBS WP Nr.18. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2011). Messages from the academic literature on risk measurements for the trading book. BCBS WP Nr.19. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2012) .The policy implications of transmission channels between the financial system and the real economy. BCBS WP Nr.20. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2012) .Models and tools for the macroprudential analysis. BCBS WP Nr.21. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2012) Progres report on Basel III implementation. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2012) History of the Basel Committee. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2013). Basel III: The liquidity Coverage Ratio and liquidity risk monitoring tools. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2013). Foundations of the proposed modified supervisory formula approach. BCBS WP Nr.22. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2013) Progres report on implementation of the Basel III regulatory fremework. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2013) Report to G20 on monitoring implementation of the Basel III regulatory reforms. BIS

Basel Committee for Banking Supervision . (2012) The regulatory framework" balancing risk sensitivity, simplicity and comparability-Discussion Paper . BIS

Beck, Th., Levine, R. dhe Loayza, N. (2000). Finance and the source of growth. Journal of financial economics 58, 261-300.

Beck, Th., Demirgüç-Kunt, A. dhe Levine, R. (2001). Law, Politics, and Finance. World Bank Working Paper 2146.

Beck, Th. dhe Levine, R. (2001). New Firm Formation and Industry Growth: Does Having a Market- or Bank-Based System Matter? World Bank Policy Research Working Paper 2383.

Beck, Th., Demirgüç-Kunt, A. dhe Levine, R. (2003). Law and Finance: Why Does Legal Origin Matter? Journal of Comparative Economics, 31, 653-75.

Beck, Th. dhe Laeven, L. (2005). Institution Building and Growth in Transition Economies.World Bank Policy Research Working Paper 3657.

Bench, R. (1993). Development in international financial regulation: some observations. Artikull në konferencën vjetore të Gain Institute of Finance, Salr Lake City, Utah.

Benston, G. dhe Kaufman, G. (1996). The Appropriate Role of Bank Regulation, The Economic Journal, 106.

Benston, G. (1999). Regulation financial markets: a critique and some proposals. AEI Press. Washington DC.

Bester, H. (1985). Screening vs. Rationing in Credit Markets with Imperfect Information. American Economic Review 75, 850-855.

Bliss, R. R. (2003). Resolving large complex financial organizations. WP(2003)-07 Federal Reserve Bank of Chicago.

Bonin, J. dhe Wachtel, P. (2003). Financial sector development in transition economies: lessons from the first decade. Financial markets, institutions and instruments Nr.12.

Briault, C. (2001). Building a Single Financial Services Regulator. International Conference on Challenges for the Unified Financial Supervision in the New Millennium, Tallinn.

Carden, A. (2005). Inputs and Institutions as Conservative Elements. Draft paper marrë nga http://www.gmu.edu/rae/featured/archives/Carden_essay.pdf.

Carmichael, J. (2002). Experiences with Integrated Regulation. Finance Forum 2002: Aligning Financial Sector Knowledge and Operations, World Bank Institute, Washington, DC.

Carmichael, J. dhe Kaufmann, D. (2001). Public Sector Governance and the Finance Sector. Paper presented at the World Bank/International Monetary Fund, Federal Reserve Board Conference on Policy Challenges for the Financial Sector in the Context of Globalization, Washington, DC.

Caprio, G. Jr dhe Levine, R. (2002). Corporate governance of banks: concepts and international observations. Artikull në Global Corporate Governance Forum Netwrok Meeting.

Caprio, G. Jr dhe Honohan, P. (2008). Banking crisis. Departamenti Ekonomik, Williams College. WP(2008)-07.

Chamberlain, E. (1933). The theory of monopollistic competition. Harvard economic studies,vol.38. Harward University Press.

Chang, H.J. (2005). Understanding the Relationship between Institutions and Economic Development: Some Key Theoretical Issues. UNU/WIDER Jubilee Conference, Helsinki.

Chu, K.Y. (2003). Collective Values, Behavioral Norms and Rules: Building Institutions For Economic Growth and Poverty Reduction. In Perspectives on Growth and Poverty. Tokyo: United Nations University Press.

Čihák, M., dhe Podpiera, R. (2006). Is One Watchdog Better than Three? International Experience with Integrated Financial Sector Supervision.IMF Working Paper Nr.WP/06/57.

Čihák, M. dhe Podpiera, R. (2007). Experience with Integrated Supervisors: Governance and Quality of Supervision. Designing Financial Supervision Institutions: Independence, Accountability and Governance, Edward Elgar, Cheltenham, 309-341.

Colomoris, Ch. W. dhe Gorton, G. (1991). The origins of banking panics: Models, facts, and bank regulations. Kapitull në Financial market and financial crisis. National bureau of ecnomic reseach, Inc, 109-174.

Das, U. dhe Quintyn, M. (2002). Crisis Prevention and Crisis Management: The Role Of Regulatory Governance. IMF Working Paper Nr.WP/02/163.

Davis, E. P. dhe Obasi, U. (2009). The effectiveness of banking supervision. Research paper, Brunel University.

De Nicoló, G., Bartholomew, P., Zaman, J. dhe Mary Zephirin. (2003). Bank Consolidation, Internationalization, and Conglomeration: Trends and Implications for Financial Risk. IMF Working Paper Nr.WP/03/158.

Demetriades, P. dhe Andrianova, S. (2003). Finance and Growth: What We Know and What We Need to Know. Discussion Paper Nr. 03/15, Department of Economics, University of Leicester.

Demirguc-Kunt, A. dhe Detragiache, E. (1998). The Determinants of Banking Crisis in Developed and Developing Countries.IMF Working Paper Nr.WP/97/106.

Demirgüç-Kunt, A. dhe Levine, R. (2001). Financial Structure and Economic Growth. Cambridge: The MIT Press.

Dewatripont, M. dhe Tirole, J. (1994). A theory of dept and equity:diversity of securities and manager-shareholder congruence. The quarterly Journal of Econimics, MIT Press, 109(4), 1027-1054.

Dowd K. (1996). Laissez-faire banking. Routledge Foundations of the Market Economy. Taylor and Francis Ltd.

Diamond D. dhe Dybvig Ph. (1983). Bank Runs, Deposit Insurance, and Liquidity. Journal of Political Economy Vol. 91, Nr. 3, 401-419.

Diamond, D. W. (1984). Financial Intermediation and Delegated Monitoring. Review ofEconomic Studies 51, 393-414.

Diamond, D. dhe Dybvig, Ph. (2000). Bank Runs, Deposit Insurance, and Liquidity.Federal Reserve Bank of Minneapolis Quarterly Review 24, 4-23.

Easterly, W. dhe Ross L. (2001). It's Not Factor Accumulation: Stylized Facts and Growth Models. The World Bank Economic Review15.

Eatwell, J. dhe Taylor L. (1999). Global Finance At Risk: The Case for International Regulation, Report, World Financial Authority Project. Cambridge.

Eicher, Th. dhe Leukert, A. (2006). Institutions and Economic Performance: Endogeneity and Parameter Heterogeneity. Evropean Economic Association and Econometric Society Parallel Meetings,Vienna.

Fama, E. F. (1985). What's Different about Banks? Journal of Monetary Economics 15,29-39.

Freixas, X. dhe Laffont, J.J. (1990). Optimal Banking Contracts, në Essays in Honor of Edmond Malinvaud: Volume 2: Macroeconomics, e Paul Champsaur, et al., 33- 61. Cambridge, MA: M.I.T. Press.

Freixas, X. dhe Rochet, J.Ch. (1998). Fair pricing of deposit insurance. Is it possible? Yes. Is it desirable? Nr. Economics WP 13, Research in Economics, Elsevier, 52(3), 217-232.

Fukuyama, F. (2006). Development and the Limits of Institutional Design. Punim prezantuar në Seventh Annual Global Development Network Conference, St.Petersburg.

Gan, J. (2003). Financing Choices of Banks: the Role of Non-Binding Capital Requirements. Hong Kong University of Science and Technology Working Paper.

Gan, J. (2003). The Value of Banking Relationship: Evidence an Exogenous Shock to Bank Health. Hong Kong University of Science and Technology Working Paper.

Girma, S. dhe Shortland, A. (2004). The Political Economy of Financial Development. Working Paper Nr. 04/21, Department of Economics, University of Leicester.

Girma, S. dhe Shortland, A. (2005). The Political Economy of Financial Liberalisation. Working Paper Nr. 05/12,Department of Economics, University of Leicester.

Goldsmith, R. (1969). Financial Structure and Development. New Haven: Yale University Press.

Goodhart, Ch. A. (1998). Financial regulations, why, how and where now? Routledge.

Goodhart, Ch.A. (2002). The Political Economy of Financial Supervision in Europe, marrë nga Jeroen J.M. Kremers, Dirk Schoenmaker and Peter J. Wierts, Financial Supervision in Europe, Edward Elgar, Cheltenham.

Gwartney, J. dhe Lawson, R. (2006). Economic Freedom of the World 2006 Annual Report. Vancouver: The Frasier Institute.

Haber, S. (2006). Political Institutions and Financial Development: Evidence from the Economic Histories of Mexico and the United States. Allied Social Science Associations Annual Meeting, Boston.

Hart, D. O. dhe Jaffee, M. D. (1974). On the application of portfolio theory to depository financial intermediaries. Review of economic studies, vol.41, nr/.1, fq.129-147.

Haubrich, J. dhe Santos, J. (2003).Alternative Forms of Mixing Banking with Commerce: Evidence from American History, Financial Markets, Institutions and Instruments Vol.12 Nr.2, 121-164.

Haubrich, J. (1996). Combining Bank Supervision and Monetary Policy. Economic Commentary, Federal Reserve Bank of Cleveland.

Hawkesby, Ch. (2000). The Institutional Structure of Financial Supervision: A Cost-Benefit Approach. Punim i prezantuar në konferencën Rules, Incentives and Sanctions: Enforcement in Financial Regulation, London School of Economics.

Hellmann, Th., Murdock, K. dhe Stiglitz, J. (2000). Liberalisation, Moral Hazard in Banking and Prudential Regulation: Are Capital Requirements Enough? American Economic Review, 90(1): 147-165.

Hermings, R.J dhe Carmassi, J. (2008). The Structure of Cross – Sector Financial Supervision, Financial Markets, Institutions and Instruments, Vol.17, Nr.1.51-76.

International Monetary Fund. (2001). International Capital Markets: Developments, Prospects, and Key Policy Issues. Washington, DC: International Monetary Fund.

Iyade, A. I. (2006). The impact of regulations and supervision on the activities of banks in Nigeria. Teze doktorale pranë Universitetit të St. Clements, Zvicër.

Jalilian, H., Kirkpatrick, C. dhe Parker, D. (2007). The impact of regulation on economic growth in developing countries: A cross country analysis. World Development, Elsevier, 35(1), 87-103.

Joint Forum. (1995). The Supervision of Financial Conglomerates: A Report by the Tripartite Group of Bank, Securities, and Insurance Regulators. Bazel Committee, Bank for International Settlements.

Jütting, J. (2003). Institutions and Development: A Critical Review. Working Paper Nr. 210, OECD Development Centre.

Kapur, D. (2001). Expansive Agendas and Weak Instruments: Governance Related Conditionalities of International Financial Institutions.Journal of Policy Reform 4.

Khan, M. S. dhe Senhadj, A. S. (2000). Financial Development and Economic Growth: an overview. IMF WP, International Monetary Fund, WP/00/209.

Kaufman, D. (2002). Public and Private Misgovernance in Finance. In Financial Sector Governance, edituar nga R. Litan, M. Pomerleano, dhe V. Sundararajan. Washington, DC: Brookings Institution Press.

Kaufmann, D., Kraay, A. dhe Zoido-Lobaton, P. (1999). Governance Matters. World Bank Policy Research Working Paper Nr. 2196, Washington, DC.

Kaufmann, D., Kraay, A. dhe Zoido-Lobaton, P. (2002). Governance Matters II: Updated Indicators for 2000/01. World Bank Policy Research Working Paper Nr. 2772.

Kaufmann, D., Kraay, A. dhe Mastruzzi, M. (2003). Governance Matters III. World Bank Policy Research Working Paper Nr. 3106, Washington, DC.

Kaufmann, D., Kraay, A. dhe Mastruzzi, M. (2004). Governance Matters IV: Governance Indicators for 1996, 1998, 2000, dhe 2002. World Bank Economic Review18.

